SURJA FATIHA - 1

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ (1) الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ (2) الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ (3) مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ (4) إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ (5)

اهدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ (6) صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلاَ الضَّالِّينَ (7)

Shqipërimi:

1) Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit,
2) Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve,
3) Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit,
4) Sunduesit të Ditës së Gjykimit.
5) Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.
6) Udhëzona në rrugën e drejtë!
7) Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!

Surja Fatiha i ka zbritur Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) në periudhën e Mekes dhe ka shtatë ajete. Surja e parë që ka zbritur e plotë njëherësh. Duke qenë si hyrja e Kuranit Famëlartë, është quajtur Fatihatu'l-Kitab ose el'Fatiha, që ka kuptimin "hap diçka ose një vend, fillues".

Ibn Abasi, Katade dhe Ebu-el'Alij thonë se Fatiha'ja ka zbritur në Meke. Allahu (xh.sh.) thotë:

﴿وَلَقَدْ آتَيْنَاكَ سَبْعًا مِّنَ الْمَثَانِي﴾

"**Ne të kemi shpallur shtatë vargje që përsëriten** (shtatë ajetet e sures Fatiha që përsëriten)"[1].

Emrat e tjerë të sures Fatiha

Fatiha'ja ka rreth njëzet emra të tjerë që tregojnë vlerat e saj. Për shembull disa prej tyre janë:

1. Surja Fatiha quhet edhe Suret's-Salah (surja e namazit), sepse këndimi i saj është kusht për vlefshmërinë e namazit. Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) ka thënë: "*Ai që nuk këndon suren Fatiha, nuk ka namaz.*"[2] Për këtë arsye, lexohet në çdo rekat.

[1]. Surja Hixhr, 15:87
[2]. Muslim, Salat 34-36; Ebu Dauud, Salat 136

2. Fakti që është zbritur nga thesari i arshit të Allahut (xh.sh.) dhe, duke qenë thesar i kuptimeve madhore, është quajtur Kenz (thesar). Siç thotë i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) përcjellë prej Allahut (xh.sh.): "Fatihatul-Kitab (Sureja Fatiha) është një thesar prej thesareve të Arshit Tim."[3]
3. Ngaqë është e vetëmjaftueshme është quajtur Uafije, Kafije.
4. Ajo njihet ndryshe si Umu'l-Kitab "nëna e Kuranit" ose origjina e të gjitha sureve, rrënja e fara tyre.
5. Po ashtu, quhet edhe Suretul-Esas (themeli), sepse kjo sure është themeli (esenca, baza) e Kuranit.
6. Fakti që fillon me الْحَمْدُ للَّهِ dhe duke pasur në kontekstin e saj falënderimin, quhet edhe Suretu'l-Hamd, el-Hamd, el-Hamdu lilah, ose Suretu esh-Shukr.
7. Duke qenë duaja më e madhe dhe më kuptimplotë nga ana kuptimore, quhet Suretu ed-Dua.
8. Duke qenë shëruese për shumë sëmundje, veçanërisht ato psikologjike dhe shpirtërore, emërtohet si Suretu esh-Shifa. Transmetohet nga i Dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të, të ketë thënë: "*Fatihatul-Kitab është shërim për çdo sëmundje përveç vdekjes*".[4]
9. Po ashtu quhet "Suretul-Methani (Surja e Përsëritjes)" sepse kjo sure përsëritet në çdo namaz.

Këto ishin disa nga njëzet emrat e Sures Fatiha, ose disa nga cilësimet e saj. Kjo tregon vlerën dhe madhështinë e kësaj sureje. Në të vërtetë kjo sure famëlartë, është si një përmbledhje e Kuranit dhe shtylla e jetës adhurimore në Islam. Mësimet themelore të Kuranit janë këto:

1. Teuhidi, njëshmëria e Allahut (xh.sh.).
2. Nubu'ueti, profetësia.
3. Ahireti, bota e përtejme.
4. Qëndrueshmëria, duke përfshirë adhurimin dhe drejtësinë.

Surja Fatiha i trajton qartë këto specifika: nga 'el-Hamdulilah' deri tek 'ijjeke na'budu' trajton teuhidin, 'en'amte alejhim' profetësinë, 'jeumi'd-din' ahiretin, ndërsa 'sirat'u mustekim' qëndrueshmërinë dhe drejtësinë. Në këtë sure, ka plot tregues të tjerë që cekin këto katër principe të Kuranit Famëlartë, por këtu po mjaftohemi me kaq.[5]

Temat e trajtuara në suren Fatiha

Në këtë sure trajtohet adhurimi, i cili është vetëm për Allahun (xh.sh.); që ndihma vjen vetëm prej Allahut, ndjekja e rrugës së drejtë dhe ruajtja nga devijimi mund të jenë të mundura vetëm duke u mbështetur në vullnetin e Allahut, sepse në këtë sure përmenden specifikat që të mirën dhe të keqen e krijon Allahu (xh.sh.).

---

3. Transmeton Ibn Rahauejh, Fejdul-Kadir, (4/420)
4. Transmeton Seid b. Mensur, Ebu Shejh në Eth-Thevab, Fejdul-Kadir, (4/418); Ed-Dejlemi në Musnedul-Firdaus, (nr. 4385) me shprehjen: "*Surja Fatiha është shërim përveç vdekjes*."
5. Suat Yildirim, Fatiha ve En'am Surelerinin Tefsiri, Izmir 1989, f. 39.

Kurani ka zbritur që t'i tregojë njerëzve rrugën e drejtë. Specifikat që përmban Kurani në mënyrë të përgjithshme gjenden edhe në suren Fatiha, sepse në këtë sure, përmendet se vetëm Allahu është Ai që i meriton të gjitha lëvdatat, madhërimet dhe adhurimet. Tregon fuqinë e Tij, që s'ka asnjë fuqi tjetër tek e cila mund të mbështetemi përveçse tek Ai, na tregon lutjen që të bëhemi njerëz të mirë e të vazhdojmë në rrugën e drejtë.

Kjo sure, në fakt, është një dua që Allahu ua mëson atyre që duan të lexojnë librin e Tij. Për t'i transmetuar lexuesit këtë mesazh është vendosur në fillim të Kuranit: Nëse me të vërtetë kërkon që të përfitosh prej Kuranit, duhet t'i lutesh Allahut (xh.sh.) në këtë mënyrë.

Në fakt, interpretimi i sures Fatiha është shumë i gjerë. Për shembull, Fahrudin er-Razi, që ka shkruar tefsirin e Kuranit në 32 vëllime, tefsirin e Fatihasë e ka përmbledhur në një libër të tërë. Edhe ne duke ia lënë vendin për detaje këtyre librave, do mundohemi të qëndrojmë mbi specifikat që janë më të dobishme për cilindo besimtar.

TEFSIRI

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

1. Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit

Sipas juristëve ku bën pjesë edhe Ebu Hanife, bismilahi nuk është ajet i sures Fatiha apo i sureve të tjera. Vetëm bismilahi në ajetin e 30-të të sures Neml është ajet kuranor. Ndërsa në fillim të sureve të tjera është shkruar vetëm për begati. Për këtë arsye nuk lexohet me zë në namaz.

Ndërsa, një grup tjetër juristësh, ku bën pjesë edhe imam Shafiu, janë të mendimit se, bismilahi është ajeti i parë i Fatihasë dhe sureve të tjera. Për rrjedhojë, pasuesit e medhhebit shafii, e lexojnë me zë besmilahin në namaz.

الْحَمْدُ للَّهِ رَبِّ الْعَلَمِينَ

2. Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve

Hamd; lavdërim, është fjalë me kuptim ndërmjet med'h (lavdërim) dhe shukrit (falënderim). Med'h, bëhet për frymorët dhe jofrymorët. Por, jofrymorëve nuk u bëhet hamd. Med'h, mund të bëhet edhe para se të dhurohet diçka, po ashtu edhe pas. Ndërsa, Hamd bëhet vetëm pas një favori ose mirësie. Nuk është kusht që të jetë mirësi që e ka përfituar personi ose jo. Ndërsa për shukrin, kjo është kusht, sepse shukri (falënderimi) bëhet me fjalë ose vepra në shenjë respekti ndaj atij që të jep një të mirë.

الْحَمْدُ el-Hamdu, ka në krye shkronjat e përcaktimit (ال). Kjo bën që hamd të marrë këtë kuptim: Që prej para ekzistencës e deri në pafundësi, prej kujtdo që të jenë, në cilëndo formë qofshin, të gjitha hamde't (falënderimet) i përkasin vetëm Allahut (xh.sh.), sepse çdo kohë, vend apo krijesë, janë pronë e Tij, dhe hamde't (falënderimet) i përkasin vetëm Atij.

اللَّهِ Allah, është emri i ekzistencës më të lartë në vetvete (vaxhibul vuxhud – ekzistencë e domosdoshme) dhe të denjë për të gjitha lavdërimet dhe falënderimet. Pra, është emër individual dhe i përveçëm. Është një shenjë dalluese e Zotit, e cila përmban në vetvete të gjitha kuptimet e emrave të tjerë të Allahut.

رَبِّ Rab, edhe pse në të vërtetë është infinitiv me kuptimin "edukim", është përdorur si emër për edukuesin në formë figurative. Po ashtu, ka edhe kuptime të tilla si: posedues, mbret, administrues dhe furnizues.

الْعَالَمِينَ Fjala alemin, është shumësi i fjalës a'lem. Ka kuptimin e botëve të panumërta, që i di vetëm Allahu. Ka kuptimin e të gjithë botëve, nga mikrobota në makrobotë, bota e shpirtrave, bota e shëmbëlltyrës, bota e varrit e, po ashtu, bota e kafshëve dhe bimëve. Po ashtu, çdo yll në qiell është një botë më vete. Sipas studimeve astronomike, në gjithësi ka njëqind miliard galaktika. Ndërkohë që vetëm në galaktikën e "Rrugës së qumështit" ka mbi dyqind miliard yje. Kjo tregon madhështinë dhe pafundësinë e Allahut, Zotit të botëve.

Sipas disa komentuesve të Kuranit para **الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَلَمِينَ** nënkuptohet folja **قولوا** "thoni".

الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

3. Ai, është i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë

الرَّحْمَٰنِ Rrahman, i Gjithëmëshirshmi, mëshira e të Cilit përfshin gjithçka, të mirë e të keq, besimtar e mohues, pa bërë kurrfarë dallimi.

Sipas disa dijetarëve të tefsirit, Rrahman në këtë ajet ka kuptimin "Rrezak", Furnizues. Pra, Allahu i Lartë, furnizon çdo gjallesë në masën e duhur dhe i kënaq të gjithë pa nënvlerësuar askënd. Ashtu si dërgon në barkun e milingonës ushqimin e duhur, po ashtu, dërgon edhe në barkun e balenës së madhe ushqimin e duhur.

الرَّحِيمِ Rrahim, ka kuptimin "mëshirëshumë, mëshirëmadh, mëshirëplotë". Thuhet që ka kuptimin që, në botën tjetër u jep mirësi vetëm besimtarëve. Allahu i Lartë, edhe pse u jep mirësi të gjithëve në këtë botë, në botën tjetër për besimtarët do të ketë mirësi e begati të veçanta.

الرَّحِيمِ shpreh mëshirën. Mëshira e Allahut përfshin gjithçka. Veçanërisht, kjo është më e theksuar tek të vegjlit e njerëzve dhe kafshëve kur vijnë në këtë botë. Si një rrezatim i kësaj mëshire, luani i egër, i shërben të voglit të tij. Pula me zogj nuk ha vetë por ushqen të vegjlit e saj, madje ajo është e

gatshme t'i hidhet në sulm edhe qenit për të mbrojtur të vegjlit e saj. Gati-gati pula sikur jeton vetëm për zogjtë e saj.

Pas ajetit **الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ** "i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë", është e rëndësishme ardhja e ajetit **مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ** "Sunduesit të Ditës së Gjykimit", sepse mëshira merr kuptim me ardhjen e ahiretit (botës tjetër). Po ashtu, edhe mirësia merr kuptim duke qenë e përjetshme. Në të kundërt, mirësia më e madhe e njeriut, mendja, i shndërrohet në bela më të madhe. Sa herë që mendon për të ardhmen, përpara i del varri dhe, e humbet fare kënaqësinë e momentit. Po ashtu, duke menduar se do të ndahet nga të afërmit e tij, dashuria e të cilëve është fryti më i vyer i mëshirës shndërrohet në dhimbje të papërballueshme.

مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ

4. Sunduesit të Ditës së Gjykimit

يَوْمِ الدِّينِ ka kuptimin "dita e fesë". Fjala din mbart edhe shumë kuptime të tjera, por kuptimi më i saktë këtu është "shpërblimi i punëve" dhe "feja e njohur". Kështu që, dita e fesë, është dita kur do të shpërblehen punët dhe kur do të ndodhin ngjarjet e njoftuara prej fesë. Sipas disa dijetarëve, me ditën e fesë është synuar Kiameti. Atë ditë do t'i fryhet bririt, do të ringjallen njerëzit dhe do të shpërndahen librat e punëve. Në vijim, të mirët do të marrin shpërblimin ndërsa të ligët dënimin.

Një kuptim tjetër i ditës së fesë, është, edhe dita kur do të shfaqet feja. Një besimtar i beson Allahut, engjëjve, librave, profetëve, ahiretit (botës së përtejme) dhe kaderit (paracaktimit hyjnor). Po ashtu, ka besim të plotë dhe e praktikon namazin, agjërimin, zekatin dhe haxhin. Të gjitha këto do të shfaqen në formën e tyre të vërtetë Ditën e Gjykimit. Po, atë ditë, do të shfaqet feja me të gjitha të vërtetat e shprehura në Kuran dhe hadithe, nga më e vogla deri te besimi në Allahun e Lartë.

Fakti që në këtë ajet Allahu (xh.sh.) është përmendur si "Sundues i Ditës së Gjykimit", ndërkohë që është Zot i kësaj bote dhe tjetrës, mund të shpjegohet kështu:

1. Për arsye se atë ditë, do të largohet perdja e shkaqeve të jashtme, që ndodhet në këtë botë, si urtësi për të mbuluar Madhështinë, dhe se çdo gjë do të shfaqet në formën e saj origjinale, është shprehur me fjalët "Sundues i Ditës së Gjykimit".
2. Qëllimi këtu është theksimi i rëndësisë së asaj dite të veçantë.
3. Njerëzit në këtë botë janë pronarë figurativë. Pra, ata thonë: shtëpia ime, prona ime, toka ime, etj., por në të vërtetë të gjitha këto janë pronë e Allahut (xh.sh.). Atë ditë, do të zhduken edhe këto pronësi të figurshme dhe do të shfaqet Sunduesi dhe Pronari i vetëm i gjithçkaje, Allahu (xh.sh.).

يَوْمِ الدِّينِ "jeumu'd-din", jeum ka kuptimin ditë.

Ashtu si jeta e njeriut ka një ditë, po ashtu edhe popujt dhe qytetërimet e kanë një ditë. Po ashtu, ka edhe një ditë, dhe ajo është dita e jetës së kësaj bote. Ka edhe një ditë tjetër, karshi jetës së kësaj bote dhe ajo është Dita e Gjykimit. Kur themi sot kjo botë e nesër ahireti, kemi si qëllim këto dy ditë; kjo botë është një ditë dhe bota e përtejme një ditë. Në pushtetin absolut të Allahut, kjo botë dhe e

përtejmja janë vetëm dy ditë. Të gjitha kohërat në krahasim me Atë, janë si një çast i vetëm, që vjen e shkon. Për Allahun nuk ekziston koha. Ai (xh.sh.), "nuk ha e nuk pi, koha nuk ekziston për Të, i pastër është nga gjithçka Allahu". Po, kur të plotësohet dita e njerëzimit, do të japë llogarinë e kësaj dite, atë ditë.

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ "Gjithë falënderimet dhe lavdërimet janë për Allahun, Zotin e gjithësisë!" në krye të sures, duke qenë se jep një gjykim gjithëpërfshirës, mund të lindë një pyetje e tillë: Falënderimet dhe lavdërimet përse janë vetëm për Allahun? Si përgjigje vjen menjëherë ajeti pas tij, që përmend atributet e Allahut (xh.sh.). Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë Allahut, sepse Ai është **رَبِّ الْعَـٰلَمِينَ** Zoti i gjithësisë. Krijuesi dhe furnizuesi i gjithçkaje, dhe vazhduesi i ekzistencës së tyre; sepse Ai është Mëshirues e Mëshirëplotë. Ai që e vezullon gjithësinë me mëshirën e Tij të pafundme. Ai që i ka vënë në shërbim të njeriut diellin, hënën, yjet, të gjitha kafshët e bimët. Për më tepër, jeta nuk është e kufizuar vetëm në këtë botë. Jeta e vërtetë e njeriut, i cili ka marrë përsipër një përgjegjësi shumë të rëndë, duke pasur përkohësisht rolin e mëkëmbësit të Zotit në tokë, është në botën tjetër (ahiret). Pra, Allahu është edhe **مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ** Sunduesi i vetëm i Ditës së Gjykimit.

Duke qenë kështu, atëherë të gjitha falënderimet dhe lëvdatat, që prej krijimit të gjithësisë deri në ditën e Kiametit, prej kujtdo dhe në çdo kohë qofshin, i përkasim vetëm Allahut (xh.sh.).

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë

Duket sikur deri në këtë pjesë të sures, duke përmendur atributet e larta të Allahut, si një varg dhikri (përmendjeje), na u mundësua t'i kuptojmë ato dhe, të përgatitemi për të dalë para prezencës së Tij. Na përgatiti, sikur e shohim Atë, na lartësoi në nivelin e komunikimit me Të, dhe me dëshirën e paraqitjes së robërisë para Tij themi: **إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ**.

Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) duke na tërhequr vëmendjen në këtë pikë thotë: "*Namazi është miraxhi i besimtarit.*"[6] Robi përpiqet me mish e me shpirt, e tejkalon materialen, ngjitet në majat më të lartë shpirtërore dhe thotë: "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!" Sa lumturi e madhe për besimtarin, të cilit, i bëhet e mundur lartësimi 5 herë në ditë me besim të plotë në gradën që u ngjit vula e Profetëve natën e miraxhit, Muhamedi (sal'la llahu alejhi ue sel'lem).

Nëse një njeri gjatë namazit e këndon këtë sure, duke menduar edhe kuptimin e saj, e ndjen veten e tij në prezencën e Audiencës Hyjnore. Kështu arrin edhe kuptimin e hadithit: "*Adhuroje Zotin tënd sikur ta shihje Atë, nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të shikon ty*."[7]

6. Sherhu sunen-i Ibni Maxhe, I, 313
7. Muslim, Iman, 1.

Në fakt, ky ajet mund të ishte إِيَّاكَ نَعْبُدُ "të adhurojmë Ty, por duke thënë: **إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ** "Jo tjetërkënd, por vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë", tregon që e adhurojmë dhe duhet të adhurojmë vetëm Allahun (xh.sh.).

وَإِيَّاكَ نَسْتَعِين O Zot! Si në adhurime dhe bindje, po ashtu, edhe në punët e tjera vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë. Nuk i kërkojmë ndihmë askujt tjetër përveç Teje.

Në këtë ajet, foljet nuk janë në njëjës "Vetëm Ty të adhuroj dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkoj!", por janë në shumës "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!". Ndoshta, është e drejtë të thuhet se imami kur fal namazin me xhemat, duke pasur si synim edhe xhematin mbrapa e këndon në shumës. Pra, imami duke qenë se lutet edhe për ne, mund të thotë "ne". Megjithatë mund të lindë pyetja: Kur dikush e fal namazin vetëm, pse duhet ta lexojë sërish "ne" në shumës? Dijetarët tanë i janë përgjigjur kështu kësaj pyetjeje: Duke thënë "ne të adhurojmë dhe ne ndihmë kërkojmë", nënkuptohet se:

1. Të gjitha organet e trupit tonë që duken dhe që nuk duken.

2. Të gjitha krijesat e vetëdijshme, duke përfshirë xhinët dhe engjëjt.

3. Duke u nisur nga fakti se Allahu është Zoti i gjithësisë, të gjitha krijesat frymore dhe jofrymore.

Gjithashtu, ky ajet nxit atmosferën e xhematit, sepse ne në këtë ajet e braktisim "unin" dhe themi "ne". Namazi është simboli i barazisë, ekuilibrit dhe disiplinës sonë shoqërore. Nëse ne arrijmë ta ndjejmë këtë në namaz, edhe bashkëjetesa jonë në shoqëri do të marrë një formë të përkryer. "Ne" nuk jemi një bashkësi thjesht në numër, por jemi një bashkësi e përkryer me lidhje shpirtërore. Kështu individi, për herë të parë, arrin atmosferën shpirtërore të bashkësisë, shpëton nga jetesa pa ndjenja.

Allahu i Lartë, me anë të Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) na tregon se këtë dua që ia mësoi robit të Tij e pranon dhe se e ka ndarë suren Fatiha midis Tij dhe robit.

Allahu ka thënë: قسمت الصلاة بيني وبين عبدي نصفين ، فنصفها لي ونصفها لعبدي ولعبدي ما سأل

"E kam ndarë namazin ndërmjet Meje dhe robit Tim në dy gjysma, gjysma është e Imja e gjysma e robit Tim, dhe atij (robit) do t'i jepet ajo që dëshiron."

Kur robi thotë: ﴿الْحَمْدُ للَّهِ رَبِّ الْعَـٰلَمِينَ﴾ "Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve", Allahu thotë: "Robi im më lavdëroi".

Kur robi thotë: ﴿الرَّحْمَـٰنِ الرَّحِيمِ﴾ "Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit", Allahu thotë: "Robi Im më lartësoi".

Kur robi thotë: ﴿مَـٰلِكِ يَوْمِ الدِّينِ﴾ "Sunduesit të Ditës së Gjykimit", Allahu thotë: "Robi Im më lavdëroi (i është bindur Madhërisë sime)".

Kur robi thotë: ﴿إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ﴾ "Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë", Allahu thotë: "Kjo, është mes Meje dhe robit Tim dhe, ai do ta fitojë atë për të cilën është lutur".

Kur robi thotë: ﴿اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ – صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلاَ الضَّالِّينَ﴾ "Udhëzona në rrugën e drejtë, në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur", Allahu thotë: "Kjo është për robin Tim, dhe robi Im do të ketë atë që ka kërkuar".[8]

Kështu, kur e këndojmë suren Fatiha duhet t'i kushtojmë vëmendje kësaj lidhjeje dhe ndarjeje. Robi thotë: "O Zoti im, më udhëzo në rrugë të drejtë, në rrugën e mesme midis shpërdorimit dhe plogështisë, në rrugën që nuk të çon drejt epsheve të egos, në rrugën që nuk të çon drejt dënimit Tënd... Më ruaj mua nga rënia në rrugën e mendjelehtëve, të pamendëve dhe të çoroditurve. Më udhëzo në rrugën e profetëve, të dëshmorëve e njerëzve të drejtë. Mos më bëj prej atyre që kundër vetes tërhoqën hidhërimin, e as prej atyre që e humbën veten e tyre. Dhe Allahu (xh.sh.) thotë: "Kjo i përket robit Tim, dhe robit Tim do t'i jepet çka kërkon."

Në ajetin إِيَّاكَ نَعْبُدُ "vetëm Ty të adhurojmë", ka një hollësi të tillë: O Zoti im, duke e pohuar me fjalë, me vepra dhe me zemër, vetëm tek Ti drejtohemi, vetëm përpara Teje përulemi, vetëm pranë Teje e kërkojmë qetësinë, dhe besojmë se vetëm pranë Teje do të arrijmë lumturinë.

Një pikë tjetër e rëndësishme është edhe kjo: Në ajet, në vend të foljes "abedna" në kohën e shkuar është përdorur koha e tashme "na'budu". Një përzgjedhje e tillë është bërë sepse, folja "abede" e së shkuarës ka edhe kuptime të tilla si; e adhuruam, e bëmë, u falëm... Në këto fjalë ekziston në një mënyrë apo një tjetër zhytja në mburrje e mendjemadhësi, që bie ndesh me shpirtin e adhurimit. Ndërsa, në foljen "na'budu" të kohës së tashme, nuk ekziston një rrezik i tillë, sepse njeriu kur thotë "të adhurojmë", tregon dobësinë dhe varfërinë e tij përpara Ekzistencës më të Lartë. Duke e synuar e përsëritur këtë vazhdimisht, sikur dëshiron të thotë: "O Zoti im, unë jam i vendosur që të mos e sakrifikoj lirinë time përpara asgjëje përveç Teje, po ashtu, jam i vendosur që të mos përulem përpara asnjërit dhe asgjëje përveç Teje. Kështu që, të drejtohem Ty me robëri të plotë me qëllim adhurimi, zemra ime drejtohet vetëm nga Ti, tërhiqem me bindje dhe dashuri karshi Teje dhe largohem nga çdo gjë që Ti e ndalon dhe nuk e pëlqen. Qëllimi im është puna ime më e madhe dhe dëshira ime më e madhe është që ta pranosh qëllimin tim si punë. Kërkoj konsideratën Tënde, jo në sajë të veprave të mia, por në sajë të atyre që kam si qëllim të bëj..."

Dhe njeriu, në këtë gradë sikur zbulon se i jepet një mundësi dhe e drejtë për të kërkuar diçka. Për rrjedhojë, ai duhet ta shfrytëzojë në formën më të mirë këtë mundësi. Kështu që, duhet të kërkojë atë që është më primare në këtë kontekst dhe të mos e humbasë këtë mundësi. Për këtë arsye pa humbur kohë kërkon që Allahu ta udhëzojë në rrugën e drejtë **اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ** "Udhëzona në rrugën e drejtë"!

---

8. Muslim, Salat 38, 40; Ebu Dau'ud, Salt, 132; Tirmidhi, Tefsir, Sure 1, 1; Nesai, Iftitah 23; Ibn Maxhe, Edeb 52; Musned, II, 241.

اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ

6. Udhëzona në rrugën e drejtë

اهْدِنَا ka kuptimin; na udhëzo, na përforco në udhëzimin e na bëj të qëndrueshëm në të.

Nëse personi që e lexon këtë ajet nuk është udhëzuar, kjo është një dua për të, që të udhëzohet. Po në rastin kur e lexon një besimtar mysliman këtë ajet, çfarë kuptimi mbart, sepse ai është i udhëzuar në rrugën e drejtë? Sipas shpjegimeve të dijetarëve të tefsirit (interpretimit të Kuranit), kjo dua, në këtë rast mbart dy kuptime:

1. Na përforco në udhëzimin.

2. Na bëj të vazhdueshëm e të qëndrueshëm në udhëzim.

الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ "Sirata'l-mustekim", rrugë e drejtë pa devijime, rrugë e mesme, rruga e gjallë e Kuranit, rruga e Profetit (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) dhe shokëve të tij besnikë, rruga e Xhenetit, rruga e vërtetë, Islami, feja islame, rruga kryesore, një rrugë ku mund të ecin të gjithë.

الصِّرَاطَ "es-Sirat": Në krye të fjalës gjenden shkronjat përcaktuese (elif-lam). Kjo mund të tregojë që fjala "sirat" mbart këto kuptime: Një rrugë e qartë në të cilën kanë kaluar para nesh miliona njerëz të devotshëm, mijëra profetë e evlia (njerëz të dashur tek Allahu).

Robi, kur e adhuron Allahun ashtu si duhet dhe fiton kënaqësinë e Tij, arrin në gradën e duasë dhe kërkon prej Zotit të tij gjënë më jetike për të, që ta udhëzojë në rrugën e drejtë. Shprehja "siratu'l-mustekim", refuzon dhe mohon çdo lloj feje dhe ideologjie të shtrembëruar, sepse "siratu'l-mustekim", do të thotë që ta njohësh të vërtetën, ta zgjedhësh atë para çdo gjëje, dhe të përpiqesh me sa ke mundësi që e vërteta të dalë triumfuese.

صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ

7. Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur

أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ "u ke dhuruar mirësi". Siç shihet, ajeti nuk i ka specifikuar ata të cilët u janë dhuruar mirësitë, por Kurani, disa ajete që kanë kuptim të paqartë, i sqaron me ajete të tjera. Ky ajet shpjegohet në suren Nisa: "**Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!**"[9]

أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ "u ke dhuruar mirësi". Fjala **أَنْعَمْتَ** "i begatove" aludon për mirësitë e ndjekjes së rrugës së drejtë, sepse udhëzimi në rrugën e drejtë është mirësia absolute. Nëse e zotëron këtë mirësi, të tjerat

9. Surja Nisa, 4:69

vijnë nga pas si hije. Rrjedhimisht kuptohet se udhëzimi në rrugë të drejtë është ndihma më e madhe dhe, njëkohësisht, është mirësia më e madhe. Po ashtu, kjo nuk është një rrugë që e kanë hapur profetët apo njerëzit e devotshëm, kjo është rruga e Allahut dhe mirësia më e madhe, por, duke qenë se edhe ata kanë ecur në këtë rrugë cilësohet si "rruga e tyre".

الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ "që kanë shkaktuar zemërimin Tënd", transmetohet që të jenë çifutët.

الضَّالِّينَ "që janë të humbur!", transmetohet që të jenë të krishterët. Por, kjo nuk do të thotë se ata që kanë shkaktuar zemërimin e Zotit dhe ata që janë të humbur, janë vetëm çifutët dhe të krishterët.

Surja Fatiha është përmbledhje e Kuranit dhe burim begatie aq i madh, sa disa dijetarë e kanë komentuar atë në një duzinë librash. Kurse Aliu (r.a.) ka thënë: "Nëse do të kisha mundësi, do të shkruaja rreth komentimit të sures Fatiha aq libra, sa t'i ngarkonin në 70 deve".[10] Kurani është si një trup perfekt, ku Fatihaja është koka e tij, ndërsa bismilahi kurora mbi kokë.[11]

Amin آمين

Amin, ka kuptimin "pranoje". Me anë të Fatihasë, shfaqim përpara Allahut të Lartë, robërinë tonë, kërkojmë prej Tij të na i plotësojë nevojat tona, dhe në fund themi amin (na i prano lutjet tona).

Amin, nuk është ajet nga Kurani. Për këtë arsye nuk shkruhet në Mus'haf (Kuran). Në një transmetim të Buhariut dhe Muslimit, Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) ka thënë: "Kur imami të këndojë **وَلَا الضَّالِّينَ** *uele'd-dal-lin, thoni amin, sepse edhe engjëjt thonë amin. Nëse amini që thoni ju, përkon me aminin që thonë engjëjt, ju falen gjynahet e shkuara.*"[12]

Ndërsa në një transmetim tjetër thotë: "*Rrafsh me safet (rreshtat në namaz) e njerëzve në tokë, gjenden edhe safet e banorëve të qiellit. Për rrjedhojë, nëse "amini" i atyre në tokë përkon me "aminin" e atyre në qiell, adhuruesit i falen gjynahet.*"[13]

Në një tjetër hadith transmetohet se: "I Dërguari i Allahut pasi këndonte **وَلَا الضَّالِّينَ** ue le dalin, thoshte bashkë me xhematin amin me një zë aq të lartë saqë dridhej xhamia".[14]

Vlera e Sures Fatiha

1. Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) ka thënë: "*Surja Fatiha është shërim për çdo sëmundje.*"[15]
2. Në një hadith tjetër thotë: "*Surja Fatiha, është surja më e madhe e Kuranit.*"[16]
3. Në një tjetër transmetim thotë: "*Mua më është dhënë surja Fatiha dhe fundi i sures Bekare nga një thesar poshtë Arshit.*"[17]

---

10. Sujuti, el-Itkan, IV, 200.
11. Elmalili, Fatiha tefsiri.
12. Buhari, Edhen 111, 113, Da'uat 4; Muslim, Salat 72.
13. Muslim, Salat 72-76.
14. Ibn Maxhe, Ikame 14; Musned, III, 354; Darimi, Mukaddime 6.
15. Sujuti, el-Itkan fi ulumil Kuran, Kahire 1387, IV, në 137 nga Said b. Mansur dhe el-Bejheki.
16. Buhari, Fedailu'l-Kuran 9.
17. Zeuaid, I, 169-170; Metalib, III, 283, 300.

4. Transmeton Enes b. Malik (r.a.) nga i Dërguari i Allahut (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) se ai ka thënë: "*Nëse lexon suren Fatiha dhe Kul Hu-Allahu Ehad, kur shtrihesh për të fjetur, je i ruajtur nga çdo gjë përveç vdekjes*."[18]
5. Ebu Said ibnu-Mual'la (r.a.) tregon: "Unë po falja namaz në xhaminë e Profetit. I Dërguari i Allahut (alejhi selam) më thirri, por unë ngaqë isha në namaz nuk iu përgjigja. Pastaj i shkova pranë duke i thënë: Po falja namaz o i Dërguari i Allahut (ngaqë nuk iu përgjigja për këtë arsye kërkova falje). I drejtuar nga unë më tha: A nuk thotë Allahu në Librin e Tij fisnik "O besimtarë! Përgjigjuni Allahut dhe Profetit kur t'ju thërrasë?!", pastaj shtoi e më tha: "*A ta mësoj suren më të madhe* (nga pikëpamja e shpërblimit) *të Kuranit para se të dalësh nga xhamia*?", dhe më kapi prej dore. Kur po dilte nga xhamia i thashë: A nuk më thatë se do të më mësonit suren më të madhe? Profeti (alejhi selam) më tha: "*Ajo sure është Elhamdu lilahi Rabi'l-alemin, që* (lexohet vazhdimisht në namaz) *ka shtatë ajete* (seb'a methanij) *dhe është Kurani fisnik që më është dhënë mua*."[19]
6. Tregon Ibn Abbas (r.a.): Xhebraili (a.s.), kur ishte ulur pranë Profetit (s.a.s.), dëgjoi nga lart një zë të ngjashëm me zhurmën e derës. E ngriti kokën sipër dhe tha: "Në qiell u hap një derë, që nuk ishte hapur asnjëherë më parë deri sot". Në atë çast nga ajo derë zbriti një engjëll. Xhebraili (a.s.) foli sërish: "Në tokë zbriti një engjëll, që nuk kishte zbritur asnjëherë më parë". Engjëlli përshëndeti Profetin (s.a.s.) me selam dhe i tha: "Po të jap sihariqin e dy dritave që të janë dhënë Ty. Këto, nuk i janë dhënë asnjë profeti para Teje: Njëra nga këto është surja Fatiha, dhe tjetra pjesa e fundit e sures Bekare. Për çdo shkronjë që lexon prej tyre do të kesh shpërblim shumë të madh".[20]
7. Sipas një transmetimi Hasanu'l-Basri ka thënë: Allahu i Lartë ka zbritur njëqind e katër libra. Dijen e këtyre librave e ka përmbledhur në katër libra, dhe dijen e këtyre katër librave e ka përmbledhur në Kuran. Dijen e Kuranit e ka përmbledhur në suret e shkurtra (mufassal) dhe, dijen në suret e shkurtra e ka përmbledhur në Ummu'l-Kuran, Fatiha, ndërsa dija e Fatihas është përmbledhur në këto dy fjalë **إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ**. E gjithë dija e zbritur në librat e shenjtë është përmbledhur në këto dy fjalë.[21]

Fatihaja, duaja më e bukur

Kur duam të bëjmë dua, duke u nisur nga një hadith profetik, këndojmë suren Fatiha. Pastaj themi me këtë kuptim: "O Zoti im, Fatihaja është pretekst shërimi, dhe Ti je Shërues, vetëm Ti jep shërim. Nuk ka kush tjetër që të japë shërim veç Teje e, nuk ka shërim tjetër veç shërimit tënd. Më shëro nga sëmundja, ma largo dhimbjen. Më mundëso shërim të plotë, që të mos mbesë asnjë shenjë sëmundjeje."

Fatihaja është duaja më e bukur. Nëse këndohet me zemër të sinqertë, me lejen e Zotit bëhet shërim për çdo sëmundje. Në fakt, një nga emrat e kësaj sureje është edhe Shafije. Përveç këtij emri ka mbi njëzet emra të tjerë. Për shembull: Fakti që këndimi i saj në namaz është vaxhib, quhet Suretu's-Salat;

18. Zeuaid, X, 1212.
19. Buhari, Tefsir 1; Nesai, Iftitah 26; Ebu Dau'ud, Vitr 15.
20. Muslim, Musarrifin 254: Nesai, Iftitah 25.
21. Ibn Tejmije, Fetaua, 17:4.

duke qenë e vetëmjaftueshme quhet Uafije dhe Kafije; duke qenë si origjina e përmbledhja e çdo sureje, quhet edhe Ummu'l-Kitab ose Esas.

Po ashtu, për largimin e çdo sëmundjeje e shqetësimi mund ta këndojmë këtë sure e të themi "Zoti im, kjo sure është Kafije. Me lejen Tënde është e mjaftueshme për çdo shqetësim. Ti je i Mjaftueshëm. Për hatër të kësaj sureje që këndova, më ndihmo në problemet dhe shqetësimet e mia."

SURJA DUHA – 93

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

وَالضُّحَىٰ (1) وَاللَّيْلِ إِذَا سَجَىٰ (2) مَا وَدَّعَكَ رَبُّكَ وَمَا قَلَىٰ (3) وَلَلْآخِرَةُ خَيْرٌ لَكَ مِنَ الْأُولَىٰ (4) وَلَسَوْفَ يُعْطِيكَ رَبُّكَ فَتَرْضَىٰ (5) أَلَمْ يَجِدْكَ يَتِيمًا فَآوَىٰ (6) وَوَجَدَكَ ضَالًّا فَهَدَىٰ (7) وَوَجَدَكَ عَائِلًا فَأَغْنَىٰ (8) فَأَمَّا الْيَتِيمَ فَلَا تَقْهَرْ (9) وَأَمَّا السَّائِلَ فَلَا تَنْهَرْ (10) وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ (11)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Betohem në shkëlqimin e paradites

2. dhe në natën kur terret e qetësohet,

3. se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhamed)!

4. Natyrisht, jeta e ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë,

5. e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur.

6. A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë?

7. A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) e të udhëzoi?

8. A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt?

9. Prandaj, mos e shtyp jetimin,

10. lypësin mos e shty me ashpërsi

11. dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd!

Surja Duha është surja e 93-të sipas radhitjes së sureve në Kuranin Fisnik. Kjo sure është mekase, duke qenë se i ka zbritur Muhamedit (sal'la llahu alejhi ue selem) në Meke, pra para emigrimit të tij për në Medine. Përmban gjithsej 11 ajete. Kjo sure e ka marrë emrin nga ajeti hyrës i saj: "**Ued-Duha – Betohem në shkëlqimin e paradites!**", në të cilin Allahu (xh.sh.) betohet për këtë pjesë të ditës, duke qenë një ndër kohët më të rëndësishme për jetën dhe gjallërinë e njeriut.

Në këtë sure, duke u betuar për kohën më të shndritshme të ditës, kur dielli vezullon me gjithë shkëlqimin e tij, dhe duke u betuar për errësirën e natës, e cila kaplon gjithçka dhe qetësia mbizotëron kudo, Allahu (xh.sh.) e ngushëllon të Dërguarin e Tij (sal'la llahu alejhi ue selem), duke i thënë se nuk e ka braktisur, nuk është hidhëruar prej Tij dhe nuk e ka lënë atë vetëm, dhe se jeta e tij e pasme do të jetë më e mirë se ajo e para, ose ahireti do të jetë më i mirë se kjo botë dhe se Allahu (xh.sh.) do ta begatojë atë me mirësitë e Tij të pafundme aq sa ai të jetë i kënaqur. Po ashtu, duke përmendur mirësitë që i ka dhënë Allahu në këtë botë dhe në tjetrën, deklaron edhe falënderimin ndaj këtyre begative.

Shkaku i zbritjes

Profetit (sal'la llahu alejhi ue selem) pasi i zbret revelata hyjnore (uahji) e parë, ndodh një ndërprerje e uahjit për një kohë të caktuar, e cila emërtohet si "fetretu'l-uahj". Për këtë arsye Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) mërzitet pa masë. Në lidhje me kohëzgjatjen dhe arsyen e kësaj ngjarjeje ka transmetime të ndryshme.

Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi dhe të tjerët nga Xhundubi, se Muhammedi (sal'la llahu alejhi ue selem) u sëmur për dy-tri ditë dhe nuk mundi të ngrihej natën të falte namaz. Kjo bëri që Ummi Xhemil, gruaja e Ebu Lehebit t'i thoshte me ironi: "O Muhamed! Shpresoj se të la shejtani yt se shoh që s'po të vjen, s'po të afrohet ka disa ditë…" Pas kësaj Allahu (xh.sh.) i shpalli suren Duha.[22]

Transmetohet nga Seid bin Mensuri dhe El-Ferjaniu nga Xhundubi: Xhibrili disa ditë nuk i erdhi me shpallje (uahj) Muhammedit (sal'la llahu alejhi ue selem), gjë që i shtyu politeistet mekas të talleshin duke u shprehur se Zoti i tij e kishte harruar, e kishte lënë dhe e kishte përbuzur.[23] Rreth kohëzgjatjes së ndërprerjes së shpalljes (uahjit), ka transmetime të ndryshme, të cilat thonë: katër ditë, dymbëdhjetë ditë, pesëmbëdhjetë ditë, njëzet e pesë dhe dyzet ditë, Allahu e di më së miri.

Nga transmetimet kuptojmë se, Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) sëmuret për disa ditë dhe nuk ngrihet për të kryer adhurimet natën, dhe, për një urtësi të caktuar (që e di Allahu), shpallja (uahji) u ndërpre për një kohë të caktuar. Që do të thotë se vonimi i shpalljes nuk ka kuptimin e braktisjes nga ana e Allahut (xh.sh.) të Dërguarin e Tij (sal'la llahu alejhi ue selem). Dikush nga të afërmit apo komshinjtë, që e dinte dhe e shihte atë (sal'la llahu alejhi ue selem) të falej gjatë natës, ndoshta edhe

[22]. Buhari, Fedasilu'l-Kuran, 1, Tehexhud 4, Tefsiru Sure 93/1; Muslim, Salah 82, 84, 91, Xhihad 115; Ebu Dauud, Salah 68.
[23]. Muslim, Xhihad, 114; Tirmidhi, Tefsir 82.

fqinja e Tij që nuk besonte (gruaja e Ebu Lehebit, xhaxhait të Tij, Ummu Xhemil) ka thënë kështu kur e ka vënë re se Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) nuk është ngritur për namaz nate dhe nuk i ka ardhur uahji. Po ashtu edhe politeistët mekas thanë: "Muhamedi u braktis". Për rrjedhojë, Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) ishte mërzitur dhe shqetësuar nga kjo situatë.

TEFSIRI

وَالضُّحَى

1. Betohem në shkëlqimin e paradites

Duha, është intervali kohor kur dielli fillon të lartësohet dhe të shkëlqejë, koha kur zbardh dita. Por fjala "Duha" në ajet, është përdoruar si e kundërta e natës, si kulmi i ditës. Ose mund të tregojë edhe kohën e lindjes së të vërtetës nga horizonti i Muhamedit "**si mëshirë për botët**"[24] dhe përhapja e rrezeve në çdo skaj me anë të detyrës së delegacioneve.

وَاللَّيْلِ إِذَا سَجَى

2. Dhe në natën kur terret e qetësohet

Koha e natës, për të cilën është betuar Allahu (xh.sh.) është ajo pjesë nate në të cilën errësira kaplon gjithçka dhe qetësia mbizotëron kudo. Në atë pjesë kohe, errësira arrin kulmin e saj, e kaplon gjithçka mundet në maksimum dhe bëhet si një motër binjake me heshtjen e qetësinë.

Një nga urtësitë e shumta të betimit për "paraditen dhe natën", mund të jetë edhe ky: Drita e ditës, për arsye të angazhimeve që ka në të, e lodhin njeriun. Errësira e natës është e nevojshme që njeriu të qetësohet e të çlodhet. Në të njëjtën mënyrë, edhe shpallja (uahji) ishte një ngarkesë e madhe për Profetin Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem). Ndërprerja e uahjit ndodhi që Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) të çlodhej e të qetësohej. Shpallja (uahji) është si drita e diellit, ndërprerja e tij i lë vend qetësisë së natës. Shkurtimisht, brenda vorbullës së kohës që ndryshon vazhdimit dhe pa ndaluar nga drita në errësirë dhe nga errësira në dritë, betohet veçanërisht për paraditen e cila është fillimi i jetës, i gjallërisë e haresë. Po ashtu, betohet për natën, e cila mbulon dritën dhe në të njëjtën kohë është edhe lajmëtari i një dite e jete të re që do të vijë.

مَا وَدَّعَكَ رَبُّكَ وَمَا قَلَى

3. Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhamed)

[24]. Surja Enbija, 21:107

Në fakt, emërorja **teudi'** që rrjedh nga folja **uede'a**, ka kuptimin e lamtumirës ose takimit të mikut kur largohet, që thotë "**mirë mbetshi**" ose "**paqja qoftë mbi ju**", duke uruar mirësi, shëndet dhe sukses. Po ashtu, ka edhe kuptimin e lamtumirës përfundimtare, kur dikush largohet pa u kthyer më asnjëherë. Meqenëse një lamtumirë e tillë nuk mund të imagjinohet për Allahun, është komentuar si braktisje, lënie. Edhe vetë zbritja e sures është argument i qartë që, Allahu (xh.sh.) nuk e ka braktisur dhe وَمَا قَلَى as nuk e ka përbuzur të Dërguarin e Tij (sal'la llahu alejhi ue selem).

وَلَلْآخِرَةُ خَيْرٌ لَكَ مِنَ الْأُولَى

4. Natyrisht, jeta e ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë

Çdo përfundim i gjendjes Tënde, është më i mirë dhe më i hajrit se fillimi i saj. Pra, Ti do të lartësohesh nga dita në ditë, nga gjendja në gjendje, nga e mira dhe dobishmja në më të mirën e më të dobishmen. Për shembull, fillimi i profetësisë në krahasim me fillimin e jetës Tënde, ardhja e shpalljes në krahasim me ndërprerjen e saj, janë shumë herë më të mira dhe më të hajrit. Po ashtu, ahireti (jeta e pasme) do të jetë shumë herë më e mirë për Ty se sa jeta e kësaj bote kalimtare. Ti vazhdimisht do të lartësohesh nga gjendja në gjendje dhe nga e mira në më të mirën.

لَكَ për ty, specifikimi për ty, i cili mundësohet nga shkronja 'lam', ka kuptimin "jo sipas të gjithëve atyre përveç Teje, por sipas mosbesimtarëve që të keqtrajtojnë Ty do të jetë më e hajrit". Kjo, nuk është pengesë që ahireti (jeta e pasme) e popullit (umetit) që i besoi atij (sal'la llahu alejhi ue selem) të mos jetë më e hajrit dhe më e mirë se kjo botë. Kjo sepse pasuesit e Profetit (sal'la llahu alejhi ue selem) janë prej Tij, siç shprehet ai vetë në një hadith: "*Kush më pason, më ndjek mua është prej meje*".[25] Ajo që është e mirë dhe e hajrit për Profetin është e mirë dhe e hajrit edhe për popullin (umetin) e tij, sepse edhe mosbesimtarët mund të përfitojnë nga mirësia e tij në këtë botë, por bota tjetër është vetëm për besimtarët.

Për ta sqaruar më mirë dhe më qartë gjendjen e të qenët më e hajrit dhe më e mirë thotë:

وَلَسَوْفَ يُعْطِيكَ رَبُّكَ فَتَرْضَى

5. E, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur

Zoti yt, në të ardhmen do të dhurojë ty mirësi e begati të panumërta, saqë ti do të jesh i kënaqur dhe nuk do të mbetet më asnjë dilemë "se çfarë do të ndodhë?", nuk do të presësh më me ankth dhe frikë, por do të jesh i kënaqur në botën e pafundme.

---

[25]. Surja Ibrahim, 14:36 - "**Ai që më pason mua, është i fesë sime; ndërsa për atë që më kundërshton mua, Ti, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirëplotë**."

Sipas Hasan El-Basri ajeti "Dhe Zoti yt do të të japë ty, e ti do të kënaqesh", ka për qëllim ndërmjetësimin (shefa'at) që do t'i jepet Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) për umetin (popullin) e tij.

Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) ka thënë: "*Unë do të ndërmjetësoj për umetin tim derisa Allahu të më thotë 'A je i kënaqur o Muhamed?' Atëherë unë do të them 'Po, O Zoti im! Jam i kënaqur*".[26] Ndërsa në një hadith tjetër shprehet: "*Çdo profet e ka një dua të pranuar. Të gjithë profetët e kanë bërë duanë menjëherë, ndërsa unë e kam fshehur duanë time për umetin tim për në ditën e Kiametit.*"[27]

Ibn Abas (r.a.) është shprehur kështu rreth këtij ajeti: Një nga kënaqësitë e Muhamed'it (sal'la llahu alejhi ue selem) është edhe dëshira që askush nga Ehli Bejti (familja e tij e nderuar) të mos futet në Xhehenem (zjarr). Ndërsa në një transmetim tjetër nga Ibn Abasi (r.a.): "Kënaqësia e tij (sal'la llahu alejhi ue selem) është që i gjithë umeti i tij të futet në parajsë." Fitimi i kënaqësisë së bashkësisë së Profetit (sal'la llahu alejhi ue selem) dhe fitimi i ndërmjetësimit (shefa'atit) të tij arrihet duke i besuar atij dhe duke ndjekur rrugën e tij të bekuar.

Duke hulumtuar edhe kuptimin e përgjithshëm të ajetit, nuk do të thotë që ta kufizojmë kënaqësinë vetëm me ndërmjetësimin (shafa'at). Për këtë arsye disa dijetarë janë shprehur: Më e përshtatshmja është që të përfshihem të gjitha mirësitë e kësaj bote dhe botës së përtejme. Sigurisht që mirësitë në botën tjetër do të jenë shumë herë më të mëdha.

Për të treguar se çdo gjendje e ardhshme është më e mirë dhe më e hajrit për Profetin (sal'la llahu alejhi ue selem), surja vazhdon kështu:

أَلَمْ يَجِدْكَ يَتِيمًا فَآوَى

6. A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë?

Babai i Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem), Abdullah b. Abdu'l-Mutalib, ndërroi jetë para se të lindte Profeti (s.a.s.). Ai (s.a.s.) ishte akoma në barkun e nënës 6-të muajsh. Rrjedhimisht, ti (sal'la llahu alejhi ue selem) erdhi në këtë botë jetim, pa baba. Qëndroi pranë nënës së tij, Eminesë dhe gjyshit të tij, Abdu'l-Mutalibit. Më pas, kur ishte 6-të vjeç, humbi edhe nënën e tij. Gjyshi i tij, Abdu'l-Mutalibi u kujdes për të derisa edhe ai ndërroi jetë kur Profeti (s.a.s.) ishte dymbëdhjetë vjeç. Atëherë kujdestarinë për të, e mori xhaxhai i tij, Ebu Talibi.

Allahu i Lartë, i siguroi Profetit (sal'la llahu alejhi ue selem) strehim që kur erdhi në këtë botë, meqenëse lindi jetim, duke i siguruar që e ardhmja të ishte më e mirë se e kaluara, dhe nuk e braktisi atë asnjëherë. Në ajet tregohet se, ashtu siç Allahu (xh.sh.) e strehoi të Dërguarin e Tij, edhe ai që strehon një jetim do të fitojë kënaqësinë e Allahut (xh.sh.).

---

[26]. Ebu Nuajm, Hiljetu'l-Eulija, III, 179; Sujuti, Durru'l-Menthur, VIII, 534.
[27]. Buhari, Teuhid 31; Muslim, Iman 338. Transmetimi i Buhariut është me fjalë të tjera.

وَوَجَدَكَ ضَالًّا فَهَدَى

7. A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) e të udhëzoi?

Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) asnjëherë nuk ka qenë i devijuar (dal) nga ana mendore apo fetare. Është rritur me besim monoteist, nuk është përkulur para asnjë idhulli apo statuje, nuk ka njohur asnjë Zot përveç Allahut (xh.sh.) dhe nuk ka kryer asnjë vepër negative. Kjo për arsye se profetët janë të ruajtur nga këto cilësi negative.

Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) i kishte vënë re që para se t'i shpallej profetësia problemet e besimit që kishte populli i tij (politeistët e Mekës). Po ashtu, i kishte ndjerë edhe devijimet e hebrenjve e të krishterëve. Por, perceptimi i rregullave dhe detyrimeve fetare si dhe gjetja e fesë së drejtë nuk ishte e mundur vetëm me anë të mendjes së thjeshtë. Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) kishte mbetur i hutuar përpara faktit se si mund ta nxirrte njerëzimin nga kaosi ku ishte zhytur drejt fesë së drejtë.

Për këtë arsye, Allahu (xh.sh.), iu drejtua në këtë mënyrë: Pra, ti para se të vinte shpallja ishe i painformuar për të vërtetat dhe legjislacionin fetar që s'mund të mësohen nga logjika e thjeshtë pa shpallje hyjnore. Ti po ashtu ishe në udhëkryq dhe kërkoje rrugën e drejtë, a nuk të zgjodhi ty Allahu dhe të udhëzoi në rrugë të drejtë?! A nuk ta tregoi ty rrugën e drejtë me shpallje dhe librin që të zbriti?!

وَوَجَدَكَ عَائِلًا فَأَغْنَى

8. A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt?

عَائِل A'il, ka kuptimin i varfër e nevojtar. Pra, a nuk të gjeti ty nevojtar e të varfër e të dha pasuri? Profetit (sal'la llahu alejhi ue selem) nuk i mbeti trashëgimi nga babai tij asgjë tjetër veç një shërbëtori dhe një deveje. Më pas Allahu (xh.sh.) e pasuroi atë me tregtinë që bëri si fillim në Damask. Pas martesës me Hatixhen (r.a.), ajo ia dhuroi të gjithë pasurinë Profetit (sal'la llahu alejhi ue selem) që ta shpenzonte ne rrugë të Allahut (xh.sh.). Kështu, Allahu (xh.sh.) e ruajti Profetin (s.a.s.) nga varfëria.

Allahu (xh.sh.), pas përmendjes së tre mirësive që i dha Profetit (s.a.s.), e urdhëroi Atë me tre gjëra të tjera:

فَأَمَّا الْيَتِيمَ فَلَا تَقْهَرْ

9. Prandaj, mos e shtyp jetimin

Pra, duke qenë gjendja kështu, si një shenjë falënderimi të mirësive që të ka dhënë Allahu (xh.sh.) dhe premtimit të mirësive që do të japë, ti mos e përçmo dhe mos e poshtëro jetimin. Jetimi nuk duhet vlerësuar për hatër të njerëzve të tjerë apo të nënës dhe babait, por duhet vlerësuar për faktin se edhe ai është njeri. Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) thotë në një hadith: "*Unë dhe dorëzanësi i*

jetimit (për aq kohë sa i ruan dispozitat e Allahut) *jemi si këta të dy*", dhe tregon gishtin tregues dhe të mesit.[28]

وَأَمَّا السَّائِلَ فَلَا تَنْهَرْ

10. Lypësin mos e shty me ashpërsi

Mos e nënçmo lypësin, mos e përzër atë duke e nënçmuar apo duke e poshtëruar, plotësoja nevojën që ka, ose më e pakta thuaji fjalë të mira.

فَلَا تَنْهَرْ Fela tenher, ka kuptimin mos e poshtëro, mos e nënçmo dhe mos i fol vrazhdë.

Disa dijetarë të tefsirit fjalës السَّائِلَ i kanë dhënë kuptimin "lypës që kërkon diçka që ka të bëjë me këtë botë." Ndalimi i të folurit vrazhdë lypësit është në atë rast kur lypësi nuk këmbëngul në kërkesën e tij. Nëse largimi me të mirë nuk bën dobi, atëherë mund të largohet duke i folur ashpër. Këtë e thekson edhe ajeti: "(**Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t'i njohësh nga pamja e tyre. Ata nuk i mërzisin njerëzit duke lypur. E çdo gjë që shpenzoni prej të mirave, Allahu i di ato**."[29]

Ndërsa disa dijetarë të tjerë kanë thënë se fjala "sail" në ajet nuk ka kuptimin e atij që kërkon diçka në lidhje me këtë botë, por dikush që kërkon dije dhe bën pyetje rreth fesë, sepse lypësit të pasurisë edhe nëse nuk e ndihmon dhe e përzë me të mirë, kur ke mundësi ta ndihmosh, nuk ke ndonjë kërcënim. Por, gjendja e atij që i kërkohet dije fetare dhe nuk përgjigjet, kur ka mundësi, është ndryshe. Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) thotë në një hadith: "*Atij që i pyetet diçka* (në lidhje me fenë) *dhe e fsheh atë që di, i vendoset një grep prej zjarri në gojë*."[30]

Për rrjedhojë, cilido qoftë kuptimi i fjalës "sail" (lypës, kërkues, pyetës), nuk duhet folur vrazhdë, edhe, po qe se, nuk i jepet çka kërkon duhet të largohet me të mirë dhe me fjalë të mira, pra nuk duhet ofenduar. Në rast se sillet keq dhe këmbëngul, duhet me iu përgjigj në mënyrën që e meriton. Ndihmesa ndaj atij që është në vështirësi me aq sa ke mundësi, sipas situatës, mund të shkojë deri në gradën e farzit (obligimit).

Lypja e dijes në shumë raste është lavdëruar. Në këtë rast, pa e tejkaluar kufirin dhe pa kaluar në mungesë respekti, është cilësuar si diçka e pëlqyeshme këmbëngulja në kërkimin e dijes. Ndërsa kërkimi i pasurisë është cilësuar si diçka jo e pëlqyeshme. Vetëm nëse nuk gjen mundësi tjetër për të jetuar, është si një leje për ata që kanë nevojë.

---

[28]. Buhari, Talak 25, Edeb 24; Muslim, Zuhd 42; Ebu Daud, Edeb 123; Tirmidhi, Birr 14; Mu'uata, Shi'r 5.

[29]. Surja Bekare, 2:273

[30]. Ebu Daud, Ilm 9; Tirmidhi, Ilm 3; Ibn Maxhe, Mukaddime 24; Musned, II, 263.

وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ

11. Dhe shpalli dhuntitë e Zotit tënd

Jo për t'u mburrur dhe për t'u dukur, por për të vlerësuar mirësitë dhe për të sjellë në vend falënderimin, tregoju të tjerëve me fjalë dhe vepra në mënyrë që edhe ata të përfitojnë prej këtyre mirësive, sepse tregimi i mirësive, është falënderim për ta.

Përmendja e mirësive dhe tregimi i tyre, mund të ketë disa kuptime të ndryshme. Çdo mirësi, në varësi të përbërjes që ka, mund të tregohet në një formë të caktuar. Një mënyrë e tregimit të mirësive është falënderimi i Allahut me fjalë, njohja e këtyre mirësive si dhurim nga Allahu (xh.sh.), sepse është e qartë që këto nuk i ka fituar vetëm me punën e vet.

Për shembull tregimi i mirësisë së profetësisë është kështu: Kryerja e detyrës së kumtesës në formën më të mirë. Tregimi i mirësisë së Kuranit Famëlartë është kështu: Leximi dhe kuptimi i tij, sjellja në vend e urdhrave të tij, qëndrimi larg atyre që ka ndaluar, si dhe mësimi i tij të tjerëve që nuk e dinë. Tregimi i mirësisë së udhëzimit është kështu: Tregimi i rrugës së drejtë atyre që janë në rrugë të gabuar. Vetëm se kur e kryen këtë mision duhet te jemi të durueshëm përballë të gjitha vështirësive.

Alusi thotë kështu: Ti ishe jetim, nuk e njihje fenë dhe ishe i varfër. Allahu (xh.sh.) të strehoi ty, të tregoi ty rrugën e drejtë dhe të bëri të pasur. Mos i harro këto tre mirësi që t'i ka dhënë Allahu (xh.sh.). Prandaj sillu butë me jetimin dhe ki mëshirë ndaj nevojtarëve, sepse ti e provove të jesh jetim dhe nevojtar. Ashtu siç ta tregoj Allahu (xh.sh.) rrugën e drejtë ty, ashtu tregoja edhe ti robërve rrugën e drejtë.

Sqarim

Të thuash Allahu Ekber në fund të sures Duha dhe të gjitha sureve në vijim deri në fund të Kuranit është sunet. Ky është edhe transmetimi nga i Dërguari i Zotit (sal'la llahu alejhi ue selem) që vazhdon të praktikohet deri në ditët tona. Është transmetuar me metodën e një prej shtatë imamëve të Kiraeteve (këndimit të Kuranit) Ibn Kethirit. Arsyeja e për këtë mendim është se siç u përmend edhe më sipër, pas ndërprerjes së shpalljes për një kohë, kur zbriti surja Duha Profeti (s.a.s.) nga gëzimi tha: "Allahu Ekber".[31]

Kur këndohet surja Nas thuhet "Allahu Ekber". Pastaj këndohet surja Fatiha dhe pesë versetet e para të sures Bekare dhe në fund duaja e hatmes (këndimit të plotë të Kuranit). Kjo quhet "Halul-murrtehil", që do të thotë mbarimi i një hatmeje dhe fillimi i një tjetre. Kështu ai që mbaron hatmen, duke kënduar suren Fatiha dhe pesë versetet e para të sures Bekare fillon një hatme të re. Dhe kështu vazhdon hatmeja e re që filloi, kur e mbaron tjetrën...

[31]. En-Nisaburi, Garibu'l-Kuran, XXX, 113.

Nuk mund të thuhet se çdo person, që bën hatme, duhet patjetër ta kryejë këtë veprim. Megjithatë kushdo që e bën, ka bërë diçka të mirë dhe të pëlqyeshme. Ndërsa ai që se bën nuk ka ndonjë gjynah.

SURJA INSHIRAH - 94

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

أَلَمْ نَشْرَحْ لَكَ صَدْرَكَ (1) وَوَضَعْنَا عَنْكَ وِزْرَكَ (2) الَّذِي أَنْقَضَ ظَهْرَكَ (3) وَرَفَعْنَا لَكَ ذِكْرَكَ (4) فَإِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا (5)

إِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا (6) فَإِذَا فَرَغْتَ فَانْصَبْ (7) وَإِلَى رَبِّكَ فَارْغَبْ (8)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Vallë, a nuk ta hapëm ty (Muhamed) kraharorin (për të pranuar besimin)

2. dhe ta hoqëm barrën,

3. e cila ta rëndonte tepër kurrizin,

4. dhe ta ngritëm lart emrin?!

5. Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!

6. Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!

7. Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në adhurim)

8. dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!

Surja Inshirah ka zbritur në Meke pas sures Duha. Përmban 8 ajete. Kjo sure është emërtuar nga verseti i parë. Fjala "**neshrah**" që ka kuptimin e qetësimit të zemrës së Profetit nga ana e Allahut (xh.sh.) është tema kryesore e sures. Pesha e rëndë e profetësisë, që rëndonte mbi shpatullat e Profetit (sal'la llahu alejhi ue selem), u lehtësua me ndihmën e Allahut (xh.sh.). Kjo sure është burim fuqie shumë i rëndësishëm për ata që ndjekin rrugën e Profetit (sal'la llahu alejhi ue selem) dhe shërbejnë në rrugën e kumtesës islame. Kjo sure ka aq shumë ngjashmëri me suren Duha saqë kuptohen qartë që kanë zbritur në të njëjtën periudhë dhe për të njëjtën situatë. Pra, për të ngushëlluar Profetin Muhamed (s.a.s.) në fillim zbriti surja Duha, dhe pas saj surja Inshirah. Në këtë sure Allahu (xh.sh.) i drejtohet të Dërguarit të Tij: Ne të dhuruam Ty tre mirësi. Kështu që, për aq kohë sa posedon këto mirësi, nuk ke arsye për t'u mërzitur... E këto mirësi ishin: e para mirësia e

"**Sherhus-Sadri**" **(zgjerimi i kraharorit)**. E dyta, heqja e barrës nga supet. E treta, lartësimi i famës.

TEFSIRI

أَلَمْ نَشْرَحْ لَكَ صَدْرَكَ

1. Vallë, a nuk ta hapëm ty (Muhamed) kraharorin (për të pranuar besimin)

A nuk ta hapëm kraharorin e ta zgjeruam për të qenë i lumtur? Kështu, a nuk t'u rehatua trupi, e t'u qetësua zemra e shpirti?

Sadr, ashtu siç ka kuptimin e pjesës së përparme të çdo gjëje, ka edhe kuptimin e pjesës së përparme e të sipërme të njeriut ku përfshihet zemra, gjoksi dhe kraharori.

"**Sherhus-Sadri**", ka kuptimin e hapjes dhe zgjerimit të pjesës së kraharorit. Po ashtu, përdoret edhe si shprehje me kuptim të figurshëm, që ka kuptimin e rehatimit të trupit dhe qetësimit të zemrës e shpirtit. Për rrjedhojë, në të shumtën e rasteve, "hapja e kraharorit" nuk ka kuptimin e hapjes së kraharorit në mënyre fizike, por ka kuptimin e zgjerimit të kraharorit në mënyrë shpirtërore, që të jep qetësi dhe rehati shpirtërore.

Pyetja në ajet "**A nuk ta zgjeruam Ne ty kraharorin?**", është pyetje retorike (?!). Pra, O Profet! Ne ta qetësuam zemrën me udhëzim, besim dhe dritën e Kuranit. Allahu i lartë thotë në një ajet tjetër: "**Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për** (të pranuar) **Islamin**."[32]

Ibn Kethir thotë kështu: Pra, ta zgjeruam dhe ndriçuam zemrën. Allahu (xh.sh.) ashtu siç rehatoi dhe qetësoi zemrën e Profetit (s.a.s.), po ashtu e bëri fenë të gjerë, tolerante dhe të lehtë. Në fe nuk ka as vështirësi e as mbingarkesë.[33] Ndërsa Ebu Hajan shprehet kështu: Zgjerimi i kraharorit ka kuptimit e qetësimit dhe rehatimit të zemrës për të përcjellë shpalljen hyjnore (uahjin).[34]

Sipas disa dijetarëve të tefsirit "**zgjerimi i kraharorit të Profetit**" ka dy kuptime:

I pari: Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) edhe para profetësisë e dinte se të krishterët, çifutët, politeistët dhe zoroastritët ishin në rrugë të gabuar. Në të njëjtën kohë nuk ishte i qetë prej monoteizmit (hanif) që besonin mekasit, sepse besimi i tyre ishte i fshehtë dhe enigmatik. Mbi të gjitha Profeti (s.a.s.) nuk e dinte se cila ishte rruga e drejtë. Për rrjedhojë, Ai gjendej në një lloj hezitimi mendjeje. Allahu i Lartë duke i dërguar profetësinë Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) ia largoi atij të gjitha hezitimet dhe i fali qetësi shpirtërore.

I dyti: i "**zgjerimit të kraharorit**" është: Allahu (xh.sh.) Profetit (s.a.s.) së bashku më profetësinë i dhuroi atij guxim, ndihmë, vullnet të fortë dhe rehati shpirtërore. I Dërguari i Zotit (s.a.s.), për të

---

32. Surja En'am, 6:125
33. Ibn Kethir, Tefsirul-Kuranil-Adhim, Kahire ts., IV, 524.
34. Ebu Hajjan, Bahrul-Muhit, VIII, 487.

kryer detyrën e profetësisë, ishte aq i mirëpajisur me dijen e nevojshme, saqë mendja e askujt tjetër nuk mund ta përballonte këtë. Profetit (s.a.s.) iu dha aftësia për t'i rregulluar problemet që ekzistonin si një urtësi nga Allahu (xh.sh.). Kjo urtësi i ishte dhënë atij për të lartësuar flamurin Islam brenda një populli të zhytur në injorancë (në pamje të parë pa asnjë mbështetje dhe pa asnjë fuqi mbrojtëse).

Disa dijetarë shprehjen "**sherhus-sadri**" e kanë interpretuar si "**shekkus-sadri**" **(çarje e kraharorit).** Sipas tyre, sherhus-sadri ashtu siç ka ardhur edhe në transmetime, ka ndodhur në fëmijërinë e Profetit, ose pak para ardhjes së profetësisë, ose natën e Israsë/Miraxhit, si një operacion fizik. Ky operacion ka ndodhur duke i çarë kraharorin Profetit (s.a.s.), nxjerrjen jashtë të zemrës, pastrimin e saj dhe pas rivendosjes së saj në vend, mbushjen me besim dhe urtësi.

Ata që nuk besojnë se operacioni fizik i zemrës ka lidhje me gjëra shpirtërore si besimi, dija, urtësia, duke mos i konsideruar të logjikshme këto transmetime i kanë refuzuar. Ndërsa, ata që besojnë se pastrimi fizik i zemrës ka lidhje me gjërat shpirtërore si besimi, dija, urtësia, i kanë pranuar si të vërteta transmetimet dhe për më tepër kanë insistuar se ky është edhe kuptimi i ajetit.

Meqenëse këto transmetime zënë vend në librat më të besuar të hadithit si Buhariu e Muslimi - edhe pse nuk dihet përmbajtja e vërtetë e ngjarjes - edhe ne jemi të mendimit se duhen besuar dhe pranuar ashtu siç janë.

Duke mos thënë "zemrën" por "kraharorin", tregon se kjo çarje nuk mjaftohet vetëm me pjesën e brendshme por veprat e saj duken edhe jashtë. Zemra e Profetit (s.a.s.), duke iu bindur urdhrit të Kuranit Famëlartë: "**Me besimtarët sillu butë**"[35], është e mbushur me mëshirë dhe butësi ndaj besimtarëve.

Përdorimi i "**nun**" **أَلَمْ نَشْرَحْ** "**a nuk ta zgjeruam Ne?**" në vend të "**a nuk ta zgjerova Unë?**", ka këtë kuptim: Nun tregon madhështi dhe lartësi, po ashtu tregon madhështinë dhe lartësinë e Dhuruesit të mirësisë.

وَوَضَعْنَا عَنْكَ وِزْرَكَ (2) الَّذِي أَنْقَضَ ظَهْرَكَ (3)

2-3. Dhe ta hoqëm barrën, e cila ta rëndonte tepër kurrizin

وِزْر uizr, ka kuptimin peshë e rëndë, barrë. Po ashtu, ka edhe kuptimin e gjynahut dhe mëkatit.

Sipas disa dijetarëve وِزْرَكَ "**barrën tënde**" ka për qëllim gabimet që ka bërë Profeti (s.a.s.). Kuptimi i largimit të kësaj barre prej Profetit (s.a.s.) ka kuptimin e faljes së gjynaheve. Allahu (xh.sh.) thotë**:** "**për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në rrugën e drejtë**".[36] Këtu nuk ka për qëllim gjynahe të

[35]. Surja Hixhr, 15:88
[36]. Surja Fet'h, 48:2

mëdha, sepse profetët janë të ruajtur prej gjynaheve, por kanë thënë se këto janë gjëra që Profeti (s.a.s.) i ka kryer me ixhtihadin (konkluzionin) e tij dhe më pas nuk i ka pëlqyer.

Por, ky mendim nuk ka marrë shumë miratim. Sepse, fjala "**uizr**" nuk ka vetëm kuptimin gjynah. Kjo fjalë ka edhe kuptimin peshë ose barrë e rëndë. Rrjedhimisht, kjo fjalë nuk mund të marrë kuptimin gjynah pa pasur asnjë arsye. Fjala "uizr" në verset nuk ka kuptimin gjynah, por ka kuptimin e barrës së rëndë të profetësisë ose disa ngjarje të rënda që i ndodhën Profetit (sal'la llahu alejhi ue selem) pak para se t'i vinte shpallja e profetësisë ose gjatë shpalljes. Ky opinion ka marrë miratim më të gjerë dhe është më i saktë, sepse Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) edhe para profetësisë kishte një jetë aq të pastër saqë Kurani Fisnik i sfidoi kundërshtarët e tij duke dhënë jetën e Profetit (s.a.s.) si shembull.

"**Enkadudh-dhahri**", ka kuptimin e rëndimit të peshës në shpinë dhe shtypjes së kockave nga presioni, ose rënia në gjendje të dobët nga mërzia. Qëllimi këtu është krahasimi i vështirësive që kishte Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem), me një barrë të rëndë. Allahu (xh.sh.) i tregon të Dërguarit të Tij (s.a.s.) se ia lehtësoi këtë barrë të rëndë.

وَرَفَعْنَا لَكَ ذِكْرَكَ

4. Dhe ta ngritëm lart emrin?!

ذِكْر këtu ka kuptimin e famës dhe nderit. Lartësia e emrit të Profetit (s.a.s.) është lartësia e famës së tij midis profetëve dhe të dërguarve. Emri e tij rendet pas emrit së Allahut të Lartë, për aq kohë sa të përmendet Allahu (xh.sh.) do të përmendet edhe Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem).

Në një transmetim i Dërguari i Allahut (sal'la llahu alejhi ue selem) thotë: "Xhebraili (a.s.) më erdhi dhe më tha: Zoti im dhe i Yti thotë kështu: "A e di se si ta kam lartësuar emrin? 'Allahu e di më së miri', i thashë unë. Tha: 'Kur të përmendem Unë do të përmendesh edhe ti'."[37] Kjo tregon edhe gradën më të lartë të nderit dhe emrit, sepse kur përmendet Allahu (xh.sh.), përmendet edhe i Dërguari i Tij (sal'la llahu alejhi ue selem). Kur thuhet "**La ilahe il'la llah**" menjëherë pas saj vjen "**Muhamedun resulullah**".

Ebu Hajjan thotë: Allahu i Lartë e ka përmendur emrin e Profetit të Tij të dashur në fjalën e dëshmisë, në ezan, në ikamet, në teshehud (ulja gjatë faljes së namazit), në hutbe, në Kuran dhe në shumë vende të tjera bashkë me Emrin e Tij. Nuk ka asnjë vend në botë që të mos jetë vendbanim për myslimanët e të mos këndohet ezani, duke lajmëruar emrin dhe profetësinë e Tij (s.a.s.). Po ashtu, në çdo ditë të vitit dhe në çdo 24 orësh në rruzullin tokësor përmendet emri i tij i bekuar. Ky është një argument i qartë i Kuranit Famëlartë.

[37]. Et-Taberi, Xhemi'ul-Bejan, Bejrut 1988, XV, 235. Ibn Hibban, Sahih, V, 162.

فَإِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا

5. Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi [38]

Zgjerimi i kraharorit, heqja e barrës nga kurrizi, lartësimi i emrit, të gjitha këto tregojnë se pas vështirësisë vjen lehtësimi. Vërtet pas vështirësisë vjen lehtësimi. Për këtë arsye ta mundësuam që të arrish lehtësimin dhe sërish do të bëjmë që të arrish lehtësimin.

Sipas disa dijetarëve të tefsirit, Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) dhe shokët e tij (r.a.) për shkak të keqtrajtimeve të politeistëve, kaluan shumë ditë të vështira në Meke. Allahu (xh.sh.), për ta ngushëlluar dhe qetësuar Profetin (s.a.s.), ashtu siç i përmendi në fillim mirësitë që i dhuroi atij, në këtë ajet i premtoi lehtësi që t'i qetësohet zemra dhe t'i shtohet shpresa.

إِنَّ مَعَ الْعُسْرِ يُسْرًا

6. Me të vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi

Bashkë me vënien në pah të asaj që u tha në ajetin paraardhës, theksohet një fillim i ri me premtime të njëpasnjëshme. Që tani e më pas, kur të përballesh me një vështirësi, duhet ta dish se pas vështirësisë vjen lehtësimi, miratoji premtimet dhe mos u tremb prej vështirësive. Prite vështirësinë me kënaqësi.

Fjala **مَعَ** "**bashkë**" këtu ka kuptimin "**ba'de**" **pas**, sepse vështirësia dhe lehtësimi janë gjëra të kundërta me njëra-tjetrën, që s'mund të jenë bashkë, por vijnë njëra pas tjetrës. Ajeti tregon se, për besimtarin pas vështirësisë ka dy lehtësira, njëra në këtë botë dhe tjetra në ahiret (jetën e përtejme).

Kur zbriti ky ajet, Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem), duke buzëqeshur, tha: "*Nuk i mposht dot një vështirësi dy lehtësi. E, pa dyshim se pas vështirësisë vjen lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi.*" [39] Kuptimi i kësaj shprehjeje është shpjeguar me faktin se, fjala "**usr**" me kuptimin vështirësi është e përcaktuar (ma'rife), ndërsa fjala "**jusr**" me kuptimin lehtësi është e papërcaktuar.

Gjithashtu, nuk do të thotë se bashkë me vështirësinë të shfaqet lehtësia për të gjithë. Ebu Ubejde (r.a.) shkruan një letër drejtuar Omerit (r.a.), ku i thotë se romakët janë të shumtë në numër dhe për këtë arsye ndjen një lloj frike dhe hezitimi. Omeri (r.a.) i shkruan atij kështu: "Patjetër që, në një zemër besimtare, nëse ka ndonjë shqetësim, Allahu (xh.sh.) zbret në të qetësi dhe, një vështirësi nuk i mund dy lehtësi."[40] Me shprehjen "**zemër besimtare**", tregon që besimtari, me besimin e tij gëzon qetësi shpirtërorë dhe është i durueshëm.

---

38. إِنَّ inne, tregon se ky premtim është i vërtetë.
39. Mu'uata, Xhihad, 6.
40. Mu'uata, Xhihad, 6.

فَإِذَا فَرَغْتَ فَانْصَبْ

6. Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiqu fort (në adhurim)

Kur të jesh i lirë, pra, siç edhe u theksua më parë se pas vështirësisë vjen lehtësimi, kur ta kryesh një punë, adhurim, kur kalon nga vështirësia në lehtësim, pastaj çlodhesh pak, për shembull, kur të zbret një ajet, e kumton atë dhe i kryen farzet (detyrimet), mos e lësho veten tënde në rehati, ngrihu dhe angazhohu me një adhurim tjetër, nëse mbaron farzet, fal nafile (namaze suplementare), nëse mbaron namazin bëj dua, që të shtohet lehtësia dhe të vazhdojë falënderimi. Ky urdhër nuk është vetëm për të Dërguarin e Allahut (sal'la llahu alejhi ue selem), por për të gjithë myslimanët.

Ky ajet, është një nga ajetet më të rëndësishëm, që tregon rëndësinë e punës në Islam, sepse i paraqet myslimanit një rregull të rëndësishëm jetese dhe një filozofi të mënyrës së angazhimit. Po, myslimani duhet të jetë në çdo kohë në lëvizje. Lëvizje edhe në punë, lëvizje edhe në pushim... me fjalë të tjera, ai duhet t'i organizojë punët e tij në mënyrë që të mos lerë hapësirë për boshllëqe. Në fakt, nga nevojat e të qenët njeri është edhe çlodhja. Por, edhe çlodhja duhet të jetë aktive. Për shembull, një njeri që e lodh trurin me shkrim dhe lexim, ashtu siç mund të çlodhet duke u shtrirë, mund të çlodhet edhe duke ndryshuar angazhim; mund të lexojë Kuran, mund të falë namaz, mund të bëjë gjimnastikë, mund të bisedojë me dikë ose, sipas rrethanave, mundet edhe të bëjë ndonjë shaka me dikë. Kur të çlodhet me këto, kthehet sërish te studimi i librit. Shkurt, vazhdimisht lëvizje; vazhdimisht kalon nga një punë në tjetrën... Kështu pra, "të qetësohesh duke punuar, dhe të punosh duke u qetësuar", është një nga vlerat e besimtarëve.

وَإِلَى رَبِّكَ فَارْغَبْ

7. Dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu

Vendosja e mef'ul (rrethanorit) إِلَى رَبِّكَ te Zoti yt përpara foljes, është për t'i dhënë kuptimin "**vetëm**". Pra, kërko dhe duaj vetëm Zotin tënd, çfarëdo që të kërkosh kërkoje prej Tij. Mos u pengo nga shkaqet e jashtme për të arritur tek Ai, mos syno diçka tjetër përveç Tij, dhe vazhdimisht drejtohu Atij (xh.xh.).

SURJA TIN - 95

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

وَالتِّينِ وَالزَّيْتُونِ (1) وَطُورِ سِينِينَ (2) وَهَذَا الْبَلَدِ الْأَمِينِ (3) لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ (4) ثُمَّ رَدَدْنَاهُ أَسْفَلَ سَافِلِينَ (5)

إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ (6) فَمَا يُكَذِّبُكَ بَعْدُ بِالدِّينِ (7) أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمِ الْحَاكِمِينَ (8)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për fikun dhe ullirin,

2. për malin e Sinait

3. dhe për këtë Qytet të sigurt (Mekën),

4. Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer,

5. pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët,

6. përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera.

7. Atëherë, çfarë të shtyn ty (o njeri), që ta mohosh Ditën e Kiametit?

8. A nuk është Allahu Gjykatësi më i drejtë?!

E zbritur në Meke, ka 8 versete. Disa dijetarë mendojnë se ka zbritur në Medine, por shumica e dijetarëve janë të mendimit se ka zbritur në Meke. Një prej argumenteve të qarta që surja ka zbritur në Meke është ajeti që gjendet në të "ue hadha'l beledu'l emin" (dhe për këtë qytet të sigurisë). Nëse do të kishte zbritur në Medine, kjo shprehje nuk do ishte e saktë për Meken.

Në sure duke u betuar për Tin (fikun), Zejtun (ullirin), Tur-i Sinin (malin Sina) dhe Beledu'l Emin (qytetin e sigurisë) tregohet se njeriu është krijuar në formën më të bukur; pastaj rënien e tij në më të ulëtin e të ulëtëve; përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, ata kanë shpërblim të pandërprerë. Ndërsa, në ajetet e fundit të sures flitet se pas këtyre ajeteve të qarta, nuk mund të mohohet dita e gjykimit dhe theksohet se Allahu është më i urti i gjykuesve.

TEFSIRI

وَالتِّينِ وَالزَّيْتُونِ

1. Për fikun dhe ullirin

Dijetarët e tefsirit kanë shprehur dy mendime rreth Tinit dhe Zejtunit që përmenden në ajet.

Mendimi i parë: Disa dijetarë kanë thënë se, Tin dhe Zejtun në ajet ka për qëllim frutin e njohur të fikut dhe ullirit, ose pemën e fikut dhe të ullirit, sepse ashtu siç vihet re nga kuptimi gjuhësor i fjalëve, po ashtu edhe dijetarët si: Hasan, Muxhahid, 'Ikrime, Ibrahim, Nehai, Ata, Mukatil, Kelbi,

Ibn Abbas është transmetuar të kenë thënë: "Ai është fiku dhe ulliri juaj."[41], ose "Ai është fiku që hahet ose ulliri që shtypet."[42], ose "Ai është fryti që hanë njerëzit."[43]

Sipas atyre që kanë këtë mendim, për arsye se në ajet nuk ka ndonjë lidhës që të tregojë krahasim ose metaforë, nënkuptohet fiku dhe ulliri që ne hamë. Për arsye se duhet menduar edhe lidhja që ka "**fiku dhe ulliri**" me "**krijimin e njeriut në formën më të bukur**" në sure, kanë thënë se: Fiku dhe ulliri, duke qenë si fruta të shijshme për njeriun edhe si ilaç për të, ushqim i shëndetshëm për njeriun dhe një mundësi e mirë tregtie, janë cilësuar si fruta shumë të dobishme.

Sa i përket mendimit të dytë: Disa dijetarë të tefsirit kanë thënë se: Me fjalën **tin** dhe **zejtun** këtu nuk synohen frutat që hamë, por, janë vende të shenjta ku ka lindur dhe ka jetuar Isai (a.s), sepse përmendja e Turi Sina'it ku Allahu (xh.sh.) i foli Musait (a.s.) dhe Beled-i Emin ku Allahu (xh.sh.) dërgoi Muhamedin (sal'la llahu alejhi ue selem), është një argument i qartë që e forcon mendimin e dytë. Po ashtu, edhe Alusi si shumë dijetarë të tjerë, duke thënë se: "Këto janë betime për vende të shenjta", e ka preferuar këtë mendim. Për sa i përket vendndodhjes së këtyre vendeve, ka tre mendime se mund të jenë: emra malesh, mesxhidesh ose vendbanimesh.

وَطُورِ سِينِينَ

2. Për malin e Sinait

Mali Sininë është vendi ku Musai (a.s.) u nderua duke folur me Allahun (xh.sh.). Njihet edhe si mali Sinë ose Sajna. Ky mal, gjendet midis Akabes dhe Egjiptit, në afërsi të Tihut. Sininë ka kuptimin bereqet, bollëk.

Rreth këtij mali ka disa mendime të ndryshme, por mendimi më i drejtë është mendimi të cilin e mbështet edhe dijetari i tefsirit, Ibn Xherir et-Taberi, i cili thotë: "Tur'i Sininë është mali që e njohim të gjithë".

وَهَذَا الْبَلَدِ الْأَمِينِ

3. Dhe për këtë Qytet të sigurt (Mekën)

O Muhamed! Betohem në këtë qytet, në të cilin ti ndodhesh, ku linde dhe u rrite, ku u dërgove si Profet, ku je i sigurt në madhështinë e tij; pra në këtë qytet të sigurt. Dijetarët e tefsirit janë të gjithë të një mendimi se, ky qytet është Meke.

El-Beledul-Emin, ka kuptimin qytet i sigurt, vend i sigurt. Ky vend, që prej kohës së Ibrahimit (a.s.) është cilësuar si një zonë e paprekshme dhe që respektohet nga të gjithë arabët. Aty askush nuk

41. Kurtubi, Ahkamu'l-Kuran, XX, 110.
42. Kurtubi, Ahkamu'l-Kuran, XX, 110.
43. Hakim, el-Mustedrek, Bejrut, II, 528.

e sulmon tjetrin, nuk gjuan për gjueti dhe nuk i pret pemët ose barin e këtij vendi. Në një kohë kur hajdutët bënin ligjin në shkretëtirë, Meke ishte bërë një vend sigurie për jetën e gjithkujt.

Ky vendbanim është bërë i sigurt nga Allahu (xh.sh.), por këtu ka dhe një nuancë të hollë, që besimtarët duhet të garantojnë sigurinë e këtij vendi të shenjtë. Pra, merrini të gjitha masat e duhura që ky qytet të vazhdojë garancinë dhe sigurinë si **Beledul-Emin** (vend i sigurt).

لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيم

4. Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer

Pra, e kemi krijuar njeriun në formën më të bukur si nga ana fizionomike, po ashtu edhe nga ana metafizike (shpirtërore). Njeriu është krijuar në formë të bukur, trup të drejtë, me organe që përshtaten me njëri-tjetrin, me mend, me ndjenja, me aftësi për të dalluar të mirën nga e keqja, me gjuhë që flet dhe i pajisur me moral.

Si nga ana fizionomike, po ashtu edhe nga ana metafizike (shpirtërore) e morale, njeriu është krijuar në formën më të përkryer. Njeriu kur lind nuk është kaq i formuar, por, është krijuar i pajisur me potencialin që gjatë rritjes të arrijë një formim të tillë.

ثُمَّ رَدَدْنَاهُ أَسْفَلَ سَافِلِينَ

5. Pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët

Duke mos e sjell në vend potencialin për të cilin është krijuar, Zoti (xh.sh.) e zbriti njeriun në më të ulëtin e të ulëtëve, ose "Duke e kthyer nga gjendja e mirë, në gjendjen më të ulët si nga ana fizike dhe shpirtërore, e shtymë atë drejt Xhehenemit ose shkallës më të ulët të Xhehenemit."

Ndërsa sipas një mendimi tjetër: E kthyem atë në gjendje pleqërie, sepse njeriu i krijuar në formën më të bukur, me kalimin e kohës zbukurohet, fuqizohet dhe arrin drejt pjekurisë. Por, pas arritjes së pjekurisë fizike kthehet drejt rënies. Fillon kthimi pas. I bie fuqia, i rrudhet fytyra, lëkura i varet, arrin në një gjendje aq të pafuqishme saqë jeta bëhet e padurueshme për të. Në suren Haxh thuhet se, njeriu pas arritjes së pjekurisë, ka prej tyre që jetojnë deri në pleqëri të thyer (ila erdhelil-'umur), në mënyrë që të mos dijë asgjë nga dija që ka pasur.[44] Sipas këtij kuptimi, vallë edhe besimtarët do të arrijnë në një gjendje të tillë? Po, edhe trupi i besimtarëve arrin në një gjendje të tillë, por ata nuk mbrapsen me plakjen e trupit, përkundrazi fuqizohen shpirtërisht dhe shpirti i tyre arrin kënaqësinë e pafundme në botën tjetër (Ahiret). Ndërsa, ata që nuk kanë besuar ashtu siç e humbin fuqinë trupore dhe largohen nga kjo botë, në Ahiret (jetën e pasme) do të vuajnë dënimin. Ndërsa mosbesimtarët me kalimin e kohës shkojnë mbrapa fizikisht dhe shpirtërisht, besimtarët shkojnë mbrapa fizikisht por formohen shpirtërisht.

44. Surja Haxh, 22:5.

Sipas Meududit ajeti ka këtë kuptim: Njeriu i krijuar në formën më të bukur, nëse e përdor potencialin e tij fizik dhe mendor për gjëra negative, atëherë Allahu (xh.sh.) i jep atij sukses vetëm në rrugë negative. Për rrjedhojë, ai njeri bie në një gjendje të ulët dhe kështu arrin në një pikë aq të ulët nga pikëpamja morale saqë asnjë lloj krijese nuk arrin aq poshtë. Kjo është një e vërtetë, që duket qartë në shoqërinë njerëzore. Për shkak të sjelljeve negative si: zilia, pangopësia, egoizmi, epshi, shthurja morale, poshtërsia, urrejtja, mëria, etj., me të vërtetë njeriu zbret në gjendjen më të ulët. Kjo rënie është për shkak të punëve dhe veprave të tij. Këtu bëhet fjalë për vullnetin e lirë të njeriut. Përndryshe Allahu (xh.sh.) nuk e poshtëron njeriun pa arsye duke e bërë nga krijesa më e bukur në më të ulëtin e të ulëtëve.

إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ

6. Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë shpërblime të pandërprera

Ata, të cilët e çojnë në vend atë që i ka hije njeriut të krijuar në formën më të bukur, nuk poshtërohen në "më të ulëtin e të ulëtëve", sepse ata, duke iu bindur urdhrave të Allahut (xh.sh.), punojnë dhe përpiqen të kryejnë vepra të mira për fitimin e kënaqësisë së Allahut (xh.sh.). Për ata, ka një shpërblim që nuk mbaron kurrë, nuk shteron dhe i cili do të vazhdojë në pafundësi në jetën e përtejme (ahiret).

فَمَا يُكَذِّبُكَ بَعْدُ بِالدِّينِ

7. Atëherë, çfarë të shtyn ty (o njeri), që ta mohosh Ditën e Kiametit?

Fjala **الدِّينِ** "**din**" ashtu siç mund të ketë kuptimin e fesë islame, ka edhe kuptimin e Ditës së Kiametit (Gjykimit). Në këtë ajet ka kuptimin e Ditës së Kiametit (Gjykimit), sepse fjala "**din**", rrjedh prej foljes "**de'ne**", që ka kuptimin e dhënies së asaj që meriton, shpërblej. Edhe në hadith shprehet me këtë kuptim **كما تدين تدان** "*Si të veprosh do të shpërblehesh*".[45]

Komunikimi në ajet i përcillet njeriut me një stil të shndërrimit të komunikimit nga veta e tretë në vetën e dytë. Pra: O njeri, që je krijuar në formën më të bukur dhe përballesh me rrezikun e poshtërimit në më të ulëtin e të ulëtëve! Ndërkohë që kjo e vërtetë, ky shpërblim dhe dënim duken kaq të qarta që në këtë botë, dhe kur ti je krijuar në formën më të bukur, cila është arsyeja e përgënjeshtrimit tënd? Ç'të shtyn ty të përgënjeshtrosh ditën e shpërblimit pas këtyre argumenteve të qarta?

Ose sipas një interpretimi tjetër: O njeri! Në shoqërinë njerëzore shikohet qartë që, njeriu i krijuar në formën më të bukur nga ana morale mund të zbresë në më të ulëtin e të ulëtëve, po ashtu, mund të

[45]. Ebu Dauud, salet 150; Timidhi, tefsiru sure 95.

ruhet nga kjo rënie duke bërë punë dhe vepra të mira. Qëndron i palëkundur "**në formën më të bukur**" që pritet prej tij, e si mund ta përgënjeshtroni ditën e gjykimit pas kësaj? A jua merr mendja se fundi i këtyre dy tipa njerëzish të ndryshëm do të jetë i njëjtë? A është e drejtë që atyre që bien në më të ulëtit e të ulëtëve mos t'u jepet asnjë dënim?!

أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمِ الْحَاكِمِينَ

8. A nuk është Allahu Gjykatësi më i drejtë?!

Gjyqtarët, liderët, udhëheqësit e popujve i dënojnë ata që kundërshtojnë dhe i shpërblejnë ata që binden. Po Allahu (xh.sh.) që është Gjykuesi i gjykuesve, a është e mundur që mos ta sjellë në vend vendimin e Tij?! Sigurisht që s'është e mundur. Pa asnjë mëdyshje, se Allahu (xh.sh.), i Cili e ka krijuar njeriun në formën më të bukur, është Gjykuesi i gjykuesve. Do ta veçojë të mirën nga e keqja, gënjeshtarin nga fjalë drejti, do ta shpërblejë atë që ka besuar, ka bërë vepra e punë të mira me sinqeritet, dhe do ta dënojë mosbesimtarin dhe mohuesin.

Shënim:

Tirmidhiu, Ebu Daudi dhe Ibn Merdeuijh transmetojnë nga Ebu Hurejre se i Dërguari i Allahut (sal'la llahu alejhi ue selem) ka thënë: Ai që lexon suren Tin dhe kur vjen te ajeti **أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمِ الْحَاكِمِينَ** le të thotë: **بلى وأنا على ذلك من الشاهدين** Bela, ue ene ala dhalike minesh'-shehidin "*Po, dhe unë për këtë jam nga dëshmitarët.*"[46].

SURJA 'ALAK - 96

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ (1) خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ (2) اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ (3) الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ (4) عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ (5) كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لَيَطْغَى (6) أَنْ رَآهُ اسْتَغْنَى (7) إِنَّ إِلَى رَبِّكَ الرُّجْعَى (8) أَرَأَيْتَ الَّذِي يَنْهَى (9) عَبْدًا إِذَا صَلَّى (10) أَرَأَيْتَ إِنْ كَانَ عَلَى الْهُدَى (11) أَوْ أَمَرَ بِالتَّقْوَى (12) أَرَأَيْتَ إِنْ كَذَّبَ وَتَوَلَّى (13) أَلَمْ يَعْلَمْ بِأَنَّ اللَّهَ يَرَى (14) كَلَّا لَئِنْ لَمْ يَنْتَهِ لَنَسْفَعًا بِالنَّاصِيَةِ (15) نَاصِيَةٍ كَاذِبَةٍ خَاطِئَةٍ (16) فَلْيَدْعُ نَادِيَهُ (17) سَنَدْعُ الزَّبَانِيَةَ (18) كَلَّا لَا تُطِعْهُ وَاسْجُدْ وَاقْتَرِبْ (19)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka),

[46]. Ebu Daud, Salet 150; Tirmidhi, Tefsirru Sure 95.

2. e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku!

3. Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh,

4. i Cili, me anë të penës ia mësoi,

5. ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.

6. Por vërtet që njeriu shkel çdo cak,

7. kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.

8. Në të vërtetë, kthimi është te Zoti yt!

9. A e ke parë ti (Muhamed) atë që pengon

10. robin (Tonë) kur falet?

11. A nuk është ai (robi Ynë) në rrugë të drejtë

12. dhe që urdhëron për devotshmëri?!

13. Mendo, nëse ai (penguesi) mohon dhe kthen kurrizin,

14. a nuk e di ai se Allahu i sheh të gjitha?!

15. Jo, jo! Nëse ai nuk tërhiqet nga kjo, Ne do ta kapim për ballukesh (për ta hedhur në zjarrin e Xhehenemit),

16. për ballukesh të gënjeshtarit dhe fajtorit.

17. Atëherë ai le ta thërrasë shoqërinë e vet,

18. Ne do t'i thërrasim Zebanijet (rojet e Xhehenemit)!

19. Kurrsesi mos iu nënshtro atij (o Muhamed), por bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!

Kjo sure e ka marrë emrin nga fjala "**Alak**" në ajetin e dytë që ka kuptimin pikëz gjaku e ngjizur (në mitrën e nënës). Po ashtu quhet edhe surja "**Ikre'**" që ka kuptimin lexo, fjalë e cila kalon në ajetin e parë. Ka 19 ajete dhe nuk ka asnjë kontestim që ka zbritur në Meke, por ka mosmarrëveshje nëse kjo është surja e parë e zbritur në Kuran apo jo?

Nëse bazohemi tek ajetet, 5 të parat e sures Alak janë ajetet e para të zbritura në Kuran. Ndërsa, surja e parë e zbritur e plotë është surja Fatiha. Surja Fatiha, edhe pse e zbritur pas ajeteve të zbritura në suret Alak, Muddeththir, Muzzemmil është surja e parë e zbritur e plotë. Ndër suret, Fatihaja

është surja e parë e zbritur në Kuran, ndërsa ndër ajetet, 5 ajetet e para të sures Alak janë ajetet e para të zbritura në Kuranin Fisnik.

Surja trajton këto tema:

1. Fillimin e shpalljes (uahj) Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) dhe theksohet rëndësia e leximit, shkrimit dhe vlera e dijes.

2. Mosmirënjohja kundrejt Allahut (xh.sh.) e mosbesimtarëve që pasurohen dhe kundërshtimi i urdhrave të Allahut (xh.sh.).

3. Pengimi që i bënte Ebu Xhehli dhe shokët e tij Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) kur falte namaz dhe dënimi i tyre në botën tjetër.

TEFSIRI

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ

1. Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)

Pra, lexo duke filluar me emrin e Tij të lartë "Allah". Fillo të lexosh. Lexo me emrin e Tij, Zotit, i Cili të krijoi ty dhe çdo gjë tjetër.

Kjo është shprehja e parë hyjnore drejtuar Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem). Në këtë fjali bëhet thirrje për lexim, shkrim dhe dije, sepse dija është e detyrueshme në Islam.

خَلَقَ الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ

2. E krijoi njeriun nga një droçkë gjaku

عَلَق është shumësi i fjalës عَلَقَة. Fjala 'alak ka disa kuptime të ndryshme.

Sipas disa dijetarëve të tefsirit kjo fjalë ka këtë kuptim: Shumësi i pikëzës së gjakut që formohet pas fekondimit të spermës në vezore. Por, fjala 'Alak mund të ketë edhe kuptimin e një prej proceseve të fekondimit deri në krijimin e fetusit. Gjatë këtij procesi ndodhin disa të vërteta shkencore, të cilat janë: 1. (Mesatarja e shkarkimeve të derdhjes së spermës nga 40 – 150 milion) të cilat notojnë në rrjedhën e sipërme në drejtim të tubave fallopiane në misionin e tyre për të fekonduar një vezë. 2. Nëse qeliza spermë takon dhe penetron një vezë, ajo do të fekondojë vezën. Kur ndodh fertilizimi, ndryshimet ndodhin në sipërfaqen e vezës për të parandaluar spermatozoidet e tjera nga penetrimi. Në momentin e fekondimit, përbërja gjenetike është e plotë, duke përfshirë edhe gjininë e foshnjës. 3. Veza e fekonduar fillon ndarjen me shpejtësi, duke u rritur në shumë qeliza. Ajo e lë tubën fallopiane dhe hyn në mitër tri apo katër ditë pas fekondimit. 4. Pas implantimit, disa qeliza bëhen placentë ndërsa disa të tjera bëhen embrion. Zemra fillon rrahjet gjatë javës së pestë. Truri i bebes,

palca kurrizore, zemra dhe organet e tjera fillojnë të formohen. Në javën e tetë të zhvillimit të bebes, tanimë të quajtur fetus, është 1.6 cm.[47]

Si përfundim; kjo fjalë që ka kuptimin "**ngjizës, që kapet dhe rri varur**", shpreh se përmendja e krijimit nga një ngjizje, ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes te krijimi i njeriut nga një qelizë e ngjitur në muret e mitrës.

اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ (3) الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ (4) عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا لَمْ يَعْلَمْ (5)

3-5 Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte

Ai është që na e mësoi shkrimin me laps dhe na fiksoi dije me anë të tij. Përndryshe, njeriu i krijuar prej gjakut të ngjizur nuk dinte as penë e as shkrim. Ai (xh.sh.), ashtu siç i mësoi njeriut të pafuqishëm dhe të paaftë shkrimin, duke i dhënë atij aftësi dhe penë, mëson edhe pa pasur nevojën e ndonjë mjeti, pra uehbe (dhuratë nga Allahu).

Allahu (xh.sh.) ashtu siç na mëson me laps, pra me anë të një mjeti, Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem), i cili s'dinte shkrim e këndim, ia mësoi shkrimin e këndimin pa asnjë mjet. Në këtë mënyrë, duke na treguar se Profeti s'ka nevojë që të dijë shkrim për të lexuar dhe duke na treguar se edhe shkrimi me laps është një dhuratë prej Allahut (xh.sh.), e nxit umetin (popullin e Profetit Muhamed s.a.s.) drejt shkrimit dhe këndimit.

Ajetet nga 1-5 kanë zbritur në periudhën kohore kur Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) ishte tërhequr për adhurim në shpellën Hira, gjatë muajit të Ramazanit. Aishja (r.a.) e transmeton kështu këtë ngjarje:

Profeti tha: *"Engjëlli më kapi e më shtrëngoi fort, derisa nuk kisha më fuqi. Më lëshoi dhe më tha 'Lexo!'. 'Unë nuk di të lexoj', i thashë. Më shtrëngoi për herë të dytë, derisa nuk kisha më fuqi dhe më tha sërish 'Lexo!'. 'Unë nuk di të lexoj', i thashë. Më kapi sërish, më shtrëngoi për herë të tretë më lëshoi e më tha: 'Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka). Krijoi njeriun prej një pikëze gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më Bujari. Ai i mësoi (njeriut) të përdorë Penën. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte!'"*[48]

Ashtu siç sqarohet në transmetim, nëse këto janë ajetet e para të Kuranit, këto duhet të kenë zbritur në një natë Ramazani, sepse në suren Bekare, ajeti 186, tregohet se Kurani zbriti në muajin e Ramazanit, po ashtu në suren Kadr, ajeti 1: "**Ne e zbritëm atë (Kuranin) në natën e Kadrit."** dhe, po ashtu, në suren Duhan ajeti 3: "**Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar.**" Duke u bazuar në këto tre ajete, kuptohet se Kurani ka zbritur në një natë të muajit të Ramazanit. Siç mund të kuptohet nga vazhdimi i kontekstit, urdhri "**Lexo**" është rreth leximit të asaj që ka zbritur. Pra, O

47. Shkëputur nga biologjia e zhvillimit para lindjes.

48. Buhari, Bedu'l-Uahj 3.

Muhamed! Lexo Kuranin që të është zbritur, lexo me emrin e Zotit tënd, lexo duke kërkuar ndihmë prej Zotit. Ose "Lexo me emrin e Zotit tënd, lexo për Krijuesin tënd."

Në vijim, Allahu (xh.sh.), për të treguar arsyet e krekosjes dhe ekstremizmit të njeriut, thotë:

كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لَيَطْغَى (6) أَنْ رَآهُ اسْتَغْنَى (7)

6-7. Por vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm

Pjesa tjetër e sures, pas 5 ajeteve të para kuptohet se ka zbritur pas një kohe të gjatë. Transmetohet se shkaku i zbritjes të jetë Ebu Xhehli (babai i injorancës). Në transmetimin e Ibn Abas'it (r.a.) që gjendet te Buhariu dhe Tirmidhiu thuhet:

"Ebu Xhehli tha: Nëse e shoh Muhamedin të falet në Qabe do t'ia shtyp kokën."[49]

Sipas disa interpretuesve të Kuranit, ajeti i drejtohet sërish Profetit (sal'la llahu alejhi ue selem) me kuptimin "Mos u shmang nga leximi o Muhamed!"

كَلَّا إِنَّ الْإِنْسَانَ لَيَطْغَى (6)

6. Por vërtet që njeriu shkel çdo cak

Njeriu i kalon të gjitha caqet, shkon në ekstrem, e mohon Krijuesin e tij dhe u bën dëm krijesave.

أَنْ رَآهُ اسْتَغْنَى (7)

7. Kur mendon se është i vetëmjaftueshëm

Për arsye se e shikon veten si të pavarur prej asgjëje, sikur ta kishte arritur qëllimin e tij final, duke e parë veten në gradën e të pasurve, ai i kalon të gjitha caqet. Por, në fakt, është Allahu (xh.sh.) Ai që ia ka dhuruar atij: pasurinë, mallin, nderin, prestigjin dhe gjërat e tjera që i përkasin kësaj bote. Në vend të falënderimit, ai kundërshton dhe mohon. Për rrjedhojë, asnjëherë mos e shiko veten si të pasur, lexo me emrin e Zotit tënd, lexo vazhdimisht, silli urdhrat në vend, sepse:

إِنَّ إِلَى رَبِّكَ الرُّجْعَى (8)

8. Në të vërtetë, kthimi është te Zoti yt

[49]. Buhari, Tefsiru Sure 96, 4; Muslim, munafikun 38; Tirmidhiu, Tefsiru sure 96, 1.

Ky ajet tregon për Ahiretin (botën e pasme). Njeriut që Allahu (xh.sh.) i ka dhënë mirësi pa fund e ai i kalon të gjitha caqet, i kujton faktin se ai një ditë do të kthehet te Krijuesi i tij dhe do të japë llogari për veprat e kryera. Ky ajet i drejtohet të Dërguarit të Allahut (sal'la llahu alejhi ue selem).

Sipas disa dijetarëve të tjerë, ky ajet është i përgjithshëm, u drejtohet të gjithë njerëzve. Ky ajet dhe pjesa tjetër, deri në fund të sures, janë për Ebu xhehlin (babain e injorancës). Ka zbritur pas një kohe të gjatë pas zbritjes së 5 ajeteve të para. Ebu Xhehli krekosej me pasurinë e tij dhe kalonte në ekstremizëm në armiqësinë ndaj Profetit tonë të dashur (sal'la llahu alejhi ue selem). Këtu nuk merret për bazë specifika e shkakut por përgjithësimi i fjalisë. Pra, duke filluar nga Ebu Xhehli, ajeti flet për të gjithë ata që do të vijnë deri në ditën e gjykimit.

Pra, surja, duke e treguar si shembull atë që pasuria e bën të krekoset e të mburret, në vijim thotë:

أَرَأَيْتَ الَّذِي يَنْهَى (9) عَبْدًا إِذَا صَلَّى (10)

9-10. A e ke parë ti (Muhamed) atë që pengon robin (Tonë) kur falet?

أَرَأَيْتَ "**E raejte?**", **a e pe?** Pra, "**A nuk e shikon?**", me një shprehje që të tërheq vëmendjen. Me kuptimin: Më njofto çfarë ideje apo mendimi ke! Duke qenë se është një pyetje retorike këtu nuk ka si qëllim informimin por tërheqjen e vëmendjes, sepse Allahu (xh.sh.), normalisht, që di gjithçka. A e shikon këtë që duke menduar se është i pasur i kalon të gjitha caqet? Pra, O Muhamed! Ose, O Njeri shiko! Shiko se si e ndalon një rob të shkëlqyer që falet. Ç'guxim dhe ç'kalim caku i madh, të ndalosh një rob pikërisht se fal namaz. Ai e ndalon, sepse e cilëson veten si të pasur dhe të vetëmjaftueshëm.

Shumica e dijetarëve kanë thënë se robi që falet është Muhamedi (sal'la llahu alejhi ue selem) dhe se penguesi është Ebu Xhehli.

Shkaku i zbritjes

Transmeton Ebu Hurejre: "Ebu Xhehli sa herë që e shihte Profetin të falte namaz betohej për Lat'in dhe Uzen se do t'ia shtypte kokën. Kur e pa Profetin (s.a.s.) të falej, i shkon pranë për të kryer atë për të cilën u betua. Por, u tërhoq mbrapa duke vendosur duart para për t'u mbrojtur. Kur e pyesin se "Ç'ka ndodhi", ai u thotë se midis meje dhe atij ka një zjarr, një krijesë të tmerrshme dhe disa flatra."[50] I Dërguari i Allahut (sal'la llahu alejhi ue selem) thotë: "*Nëse do të më afrohej engjëjt do ta bënin atë copë-copë.*"[51] Pas kësaj ngjarjeje Allahu (xh.sh.) zbriti këto ajete.

Gjithashtu nga ky ajet kuptohet se: Allahu i Lartë, pas dhënies së profetësisë Muhamedit (sal'la llahu alejhi ue selem) i mëson Atij edhe faljen e namazit. Në asnjë ajet të Kuranit nuk flitet rreth mënyrës

50. Buhari, Tefsiru Sure 96, 4; Muslim, Munafikun 38; Tirmidhi, Tefsiru Sure 86, 1; Musned, I, 638, II; 370.
51. Muslim, Munafikun 38.

së faljes së namazit. Për rrjedhojë, kjo tregon se Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) i janë dhënë edhe urdhra të tjerë që nuk gjenden në Kuranin Famëlartë.

أَرَأَيْتَ إِنْ كَانَ عَلَى الْهُدَى (11) أَوْ أَمَرَ بِالتَّقْوَى (12)

11-12. A nuk është ai (robi Ynë) në rrugë të drejtë dhe që urdhëron për devotshmëri?!

Pa mendo njëherë! O njeri i krekosur që e privon robin nga falja e namazit! Eh sikur ai robi të ishte në rrugë të drejtë dhe i udhëzuar, ose sikur të lartësohej bashkë me të, duke i këshilluar edhe të tjerët për devotshmëri, që t'i druhen Allahut (xh.sh.) dhe të ndalojnë nga keqja. A s'do të ishte më mirë?!

Ose me një shprehje tjetër: O Muhamed! Tani që e pe atë njeri të krekosur që ndalon nga namazi, pa mendo njëherë: Sa mirë do të ishte sikur ai të mos krekosej e të mos ndalonte nga namazi, ose në vend që të ndalonte nga namazi të këshillonte për mirë, duke u druajtur prej Allahut (xh.sh.). Ai akoma se ka kuptuar se Allahu e shikon atë, apo jo?

Nga ajeti kuptojmë se, një njeri që Allahu e ka udhëzuar, ashtu siç ai nuk e kundërshton Allahun dhe ka frikë prej Tij, po ashtu duhet t'i këshillojë edhe të tjerët që të druhen prej Allahut dhe t'i binden urdhrave të Tij. Sipas ajetit, ata që janë të udhëzuar dhe falin namaz, në rast se nuk këshillojnë për devotshmëri, do të thotë se kanë një mangësi serioze.

أَرَأَيْتَ إِنْ كَذَّبَ وَتَوَلَّى (13)

13. Mendo, nëse ai (penguesi) mohon dhe kthen kurrizin

Po ashtu, edhe në këtë ajet ka dy mundësi komentimi dhe ajeti sërish i drejtohet Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem): "A nuk e shikon, ose, a e pe o Muhamed! Ti je në rrugë të drejtë dhe këshillon për mirë. Ndërsa, ai i krekosuri ndalon nga namazi dhe përgënjeshtron të vërtetën, dhe me këtë përgënjeshtrim mohon të vërtetën. A është mirë kështu?!"

Meqë i drejtohet atij të krekosurit, ka këtë kuptim: "O ti i krekosur që e ndalon robin nga namazi! Nëse ai robi të dëgjon ty dhe e përgënjeshtron të vërtetën, nuk fal namaz por vepron të kundërtën, a do të ishte mirë ashtu?!"

أَلَمْ يَعْلَمْ بِأَنَّ اللَّهَ يَرَى (14)

14. A nuk e di ai se Allahu i sheh të gjitha?

كَلَّا لَئِنْ لَمْ يَنْتَهِ لَنَسْفَعًا بِالنَّاصِيَةِ (15) نَاصِيَةٍ كَاذِبَةٍ خَاطِئَةٍ (16)

15-16. "**Jo, jo! Nëse nuk tërhiqet nga kjo, vërtet Ne do ta kapim për ballukesh. Për ballukesh të gënjeshtarit dhe fajtorit**". [52،53]

نَّاصِيَة "**nasije**", ka kuptimin e flokëve të ballit, balluke. Shprehja "**nasijetin kadhibe**" **balluke gënjeshtare**, ka kuptim të figurshëm, sepse ai që kryen mëkate dhe përgënjeshtron të vërtetën është vetë poseduesi i ballukeve.

فَلْيَدْعُ نَادِيَهُ (17)

17. Atëherë ai le ta thërrasë shoqërinë e vet

Nadi, vjen nga fjala "**ned'ue**" me kuptimin e atij që i thërret dhe njofton njerëzit për ndonjë mbledhje apo diçka tjetër. Kuvendi ku mblidheshin Kurejshët para ardhjes së Islamit quhej "Daru Ned'ue". Nadi ka kuptimin e grupit që merr pjesë në kuvende të tilla si: kuvende qejfesh dhe dëfrimi, kongrese, parlament, etj.

سَنَدْعُ الزَّبَانِيَةَ (18)

18. Ne do t'i thërrasim Zebanijet (rojet e xhehenemit)

زَّبَانِيَ, زَّبَانِيَةَ Zebani, Zebanije, janë engjëjt e ndëshkimit, të cilët janë të sertë dhe të pamëshirshëm.

Sipas transmetimit, Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) po falej në Qabe, te vendi i Ibrahimit (a.s.). Aty vjen Ebu Xhehli dhe i thotë: "O Muhamed! A s'të kam ndaluar që të falesh aty?" Profeti (s.a.s.) kur e dëgjoi këtë iu përgjigj ashpër. Ebu Xhehli pyeti: "Me ç'ka më kërcënon O Muhamed? Unë jam ai që ka më shumë njerëz këtej rrotull". Fill pas kësaj ngjarjeje Allahu (xh.sh.) zbriti këto ajete. Ibn Abas shprehet kështu: "Nëse ai do t'i thërriste njerëzit e tij, engjëjt e ndëshkimit do ta mbërthenin atë në vend."[54]

كَلَّا لَا تُطِعْهُ وَاسْجُدْ وَاقْتَرِبْ (19)

19. Kurrsesi mos iu nënshtro atij (o Muhamed), por bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd

O Muhamed! Mos iu bind urdhrit të atij kryeneçi e mohuesi që të ndalon nga namazi dhe shkel të drejtat e të tjerëve.

---

52. لَنَسْفَعًا "patjetër që e kapim dhe e tërheqim zvarrë"; tenuini, është përfituar nga nga heqja e nun'it لَنَسْفَعن, sepse folja nuk mund të marrë tenuin.

53. سْفَع sef', ka kuptimin tërheq duke e shtrënguar fort. Pra, ka kuptimin që do ta kapim pa asnjë dyshim dhe do ta tërheqim zvarrë.

54. Kurtubi, XIX, 27.

وَاسْجُدْ "**Bëj sexhde**", pra, fal namaz. "O Muhamed! Mos u frikëso, por vazhdo të falësh namaz dhe اقْتَرِبْ kështu afrohu me Zotin tënd." Bindju Zotit tënd, lexo dhe vazhdo me sexhde i palëkundur. Lexo duke iu bindur urdhrit të Zotit tënd dhe vazhdo me sexhde që t'i afrohesh Atij. Afroju Zotit tënd me namaz, me sexhde dhe me ibadete (adhurime) të tjera që janë bërë shkak për t'iu afruar Atij.

Ashtu siç shprehet edhe në një hadith të saktë: "*Çasti kur robi është më pranë Zotit të tij është kur ai është në sexhde.*"[55] Kurse në një hadith kudsi thuhet: "Robi më afrohet Mua vazhdimisht me adhurime nafile (suplementare). Më afrohet në atë gradë sa, Unë bëhem veshi i tij që dëgjon, syri i tij që shikon, dora e tij që mban dhe këmba e tij që ecën."

Po ashtu edhe ne duhet të lexojmë, të themi Allahu Ekber e të bëjmë sa më shumë sexhde, si dhe të përpiqemi t'i afrohemi Allahut (xh.sh.), sepse në fund kthimi tek Ai është.

Sqarim

Ai që e lexon ajetin e fundit të sures 'Alak ose e dëgjon atë, e ka vaxhib, (të domosdoshme) bërjen e sexhdes së tilauetit (leximit). Ai që lexon një nga 14 ajetet e sexhdes, që gjenden në Kuran, e ka të domosdoshme vaxhib, bërjen e sexhdes së tilauetit (leximit). Këto ajete ndodhen në suret: A'raf, Rra'd, Nahl, Isra', Merjem, Haxh, Furkan, Neml, Sexhde, Sa'd, Fussilet, Nexhm, Inshikak dhe 'Alak. Edhe në rast të dëgjimit të këtyre ajeteve është vaxhib, bërja e sexhdes së tilauetit.

Sexhdeja e Tilauetit bëhet në këtë formë: Me nijetin (qëllimin) e sexhdes së tilauetit pa i ngritur duart lart thuhet Allahu Ekber dhe shkohet në sexhde. Në sexhde, thuhet tre herë "Subhane Rabijel-e'ala" ose një herë "Subhane Rabbina in kane ua'du rabbina lemef'ula[56]". Pastaj ngrihemi duke thënë "Allahu Ekber". Kur ngrihemi në këmbë themi: "Gufraneke Rabbena ue ilejkel-mesir".[57]

SURJA KADR - 97

بِسْمِ اللهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِنَّا أَنزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ (1) وَمَا أَدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ (2) لَيْلَةُ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِّنْ أَلْفِ شَهْرٍ (3)
تَنَزَّلُ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِم مِّن كُلِّ أَمْرٍ 4)سَلَامٌ هِيَ حَتَّى مَطْلَعِ الْفَجْرِ (5)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Ne e kemi zbritur (Kuranin) në natën e Kadrit.

55. Muslim, Salat 215; Nesai, Tatbik 78, Meuakit 35; Tirmidhi, Da'auat 118; Musned, II, 421.
56. Surja Isra, 17:108
57. Informacione më të detajuara rreth sexhdes së tilauetit mund të shihni në librat e fikhut.

2. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit?

3. Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj.

4. Engjëj dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.

5. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.

Surja Kadr quhet ndryshe edhe surja **Inna Enzelnahu**. Emërtimin e ka marrë nga fjala kadr në ajetin e parë që ka kuptimin "**Nata e Kadrit**". Surja Kadr është surja e 97-të e zbritur në Meke pas sures Abese. Ka pesë ajete. Allahu (xh.sh.) na njofton se e ka zbritur Kuranin Famëlartë në këtë natë. Duke shtruar pyetjen "E ç'të bëri ty të dish se ç'është nata e Kadrit?" thekson rëndësinë e kësaj nate. Pastaj e tregon rëndësinë e kësaj e natë në tre pika: Tregon se kjo natë është më e vlefshme se një mijë muaj, tregon që me lejen e Zotit atë natë zbresin engjëjt dhe shpirti për secilën çështje dhe se ajo natë është paqe deri në agimin e mëngjesit.

TEFSIRI

إِنَّا أَنزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ (1)

1. Ne e kemi zbritur (Kuranin) në natën e Kadrit

Ne e zbritëm këtë Kuran të mrekullueshëm në një natë me vlera dhe madhështi të lartë. Dijetarët e tefsirit (interpretimit të Kuranit) thonë se kuptimi i zbritjes së Kuranit natën e Kadrit, është zbritja e Kuranit nga Leuhi Mahfudh (pllaka e ruajtur mirë tek i Madhi Zot) në qiellin e botës "**Bejtul-'Izze**". Më pas atë e zbriti Xhibrili (a.s.) për 23 vjet. Ibn Abbasi (r.a.) thotë: "Allahu i Lartë e zbriti Kuranin njëherësh nga Leuhi Mahfudh në qiellin e botës 'Bejtul-'Izze'. Më pas sipas kohës dhe situatës ia zbriti Profetit Muhamed (s.a.s.) për 23 vjet."[58]

Zbritja e Kuranit natën e Kadrit, mbart edhe kuptimin e fillimit të shpalljes (uahjit) në atë natë, sepse shpallja e parë ka ndodhur natën e Kadrit ose nata në të cilën filloi zbritja e Kuranit është natë e Kadrit. Shprehja **إِنَّا أَنزَلْنَاهُ** "**Ne e zbritëm Kuranin**" dhe jo "**Unë e zbrita Kuranin**" tregon madhështinë e Zbritësit dhe shton vlerat e personit që i ka zbritur.

Sipas disa dijetarëve: Shprehja me të cilën Allahu (xh.sh.) drejtohet në disa ajete të Kuranit Famëlartë "**Ne**" është më tepër për gjëra që tregojnë madhështi. Në vende të tilla, Allahu (xh.sh.) kur flet për madhështinë e Tij krijuese të përgjithshme përdor këtë përemër. Ndërsa në rastet kur flet për

58. Kurtubi, XX, 130; Ibn Kethir, Tefsir, IV, 529.

krijimin e Tij të veçantë flet në vetën e parë "**Unë**". Pra, Kurani Famëlartë, si çështje që ka të bëjë me të gjitha krijesat, duke qenë se i ka zbritur Profetit Muhamed (s.a.s.) që ka të bëjë me të gjitha krijesat dhe vendet, dhe meqenëse kjo çështje i përket të gjitha krijesave dhe vendeve, Allahu (xh.sh.) aty flet në emër të madhështisë së Tij krijuese të përgjithshme. Për rrjedhojë, thotë "**Ne e zbritëm atë**".

Duke mos e shprehur hapur emrin e asaj që është zbritur, por duke u mjaftuar me përemrin **هُ** "**Hu, atë**", cilësohet një tregues tjetër i madhështisë së Kuranit, aq sa ai është i ngulitur thellë në memorien e çdokujt pa pasur nevojë për sqarim.

Disa dijetarë kanë thënë se nata e Kadrit është nata e shpërblimit. Ndërsa disa të tjerë thonë se ka kuptimin e vlerës së lartë dhe nderimit, duke marrë kështu emrin nata e vlerave të mëdha. Sipas disa dijetarëve të tjerë ka kuptimin ngushtim ose ngjeshje, sepse engjëjve të shumtë që zbresin atë natë u vjen ngushtë kjo botë. Mbi të gjitha edhe shpallja e Kuranit Fisnik ka filluar me një presion të madh nga engjëlli.

وَمَا أَدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ (2)

2. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit?

Ose, kush të informoi Ty se ç'është nata e Kadrit? Ose, a e di se ç'është nata e Kadrit?; pra, ajo, nata e Kadrit, është një natë aq e vlefshme sa s'është e mundur që ti (Muhamed) ta mësoje vetë vlerën dhe rëndësinë e kësaj nate. Ashtu siç jemi Ne që ta zbritëm këtë Libër, po ashtu jemi Ne që ta mësuam vlerën dhe madhështinë e kësaj nate. Shprehja e ajetit në formë pyetëse, tregon vlerën dhe rëndësinë e kësaj nate të madhe.

لَيْلَةُ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِّنْ أَلْفِ شَهْرٍ (3)

3. Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj

Adhurimet, veprat dhe punët e mira të kryera në këtë natë, dhe përpjekja për të fituar kënaqësinë e Allahut e treguar në këtë natë, kanë më shumë sevape dhe shpërblim se sa veprat dhe punët e mira të kryera në një mijë muaj që s'janë natë Kadri.

Shkaku i Zbritjes

Tregohen dy ngjarje rreth shkakut të zbritjes së kësaj sureje.

a. Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) u tregoi shokëve të Tij se, një ushtar nga Beni Israilët (pasardhësit e Jakubit a.s) kishte luftuar në rrugën e Zotit për një mijë muaj. Myslimanët u

habitën shumë me këtë ngjarje dhe punët e tyre iu dukën shumë të pakta. Pas kësaj Allahu (xh.sh.) zbriti suren Kadr.[59]

b. Profetit Muhamed (s.a.s.) i ishte treguar se popujt më parë kishin jetuar më gjatë se umeti (populli) i Tij. Për këtë arsye, Profeti (s.a.s.) u shqetësua se populli i tij me jetë më të shkurtër nuk mund t'i arrinte sevapet dhe shpërblimet që kishin arritur më parë popujt e tjerë me jetë më të gjatë. Allahu (xh.sh.) i dhuroi Atij (s.a.s.) natën e Kadrit, që është më e vlefshme se një mijë muaj të popujve të mëparshëm.[60]

Ky ajet, duke treguar mirësitë e panumërta që gjenden në këtë natë, është një sihariq për Profetin Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) dhe për umetin (popullin) e tij. Rëndësia e natës së Kadrit në Islam vjen nga fakti se, libri që e nxori njerëzimin nga errësira e injorancës në dritën e udhëzimit filloi të zbresë atë natë. Një mijë muaj janë të barasvlershëm me afërsisht 84 vjet. Pra, adhurimi në këtë natë, është i barasvlershëm me sevapet dhe shpërblimin e 84 viteve.

تَنَزَّلُ الْمَلَائِكَةُ وَالرُّوحُ فِيهَا بِإِذْنِ رَبِّهِم مِّن كُلِّ أَمْرٍ (4)

4. **Engjëj dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet**

Nga ky ajet kuptohet se engjëjt zbresin së bashku me shpirtin (**ruh**). Sipas mendimit të shumicës së interpretuesve të Kuranit me shpirt (**ruh**) nënkuptohet Xhebraili (a.s.). Disa të tjerë kanë thënë se shpirti (**ruh**) është një engjëll aq i madh saqë mund t'i përpijë qiejt dhe tokën si një kafshatë të vetme.

بِإِذْنِ رَبِّهِم "**Me lejen e Zotit të tyre**", normalisht dihet se ata zbresin me urdhrin e Allahut (xh.sh.), por theksimi këtu "**Me lejen e Zotit të tyre**" tregon rëndësinë dhe vlerën e kësaj pune.

مِّن كُلِّ أَمْرٍ "**me të gjitha vendimet**", pra për çdo gjë që është shkruar të ndodhë atë natë. Përkundrejt mundësisë që në çdo punë ka të mira dhe të këqija, për të larguar dyshimin nga e keqja në këtë natë është shprehur:

سَلَامٌ هِيَ حَتَّى مَطْلَعِ الْفَجْرِ (5)

5. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.

Selam, pra paqe. Ose, paqe e dërguar nga Allahu (xh.sh.). Engjëjt vazhdimisht i përshëndesin besimtarët me selam (paqe), sepse engjëjt, që prej fillimit të natës e deri në agimin e mëngjesit, zbresin grupe-grupe. Çdo grup kur zbret përshëndet me selam (paqe) dhe në atë natë vazhdimisht

59. Bejheki, es-Sunenu'l-Kubra, IV, 306.
60. Muuata, Itikaf 15.

jepet selam me zbritjen e grupeve. Fjala "selam" në ajet mund të ketë edhe kuptimin shpëtim. Pra, atë natë nuk zbret asgjë e dëmshme, por vetëm gjëra të dobishme për robërit e Allahut (xh.sh.). Ajo është nata e qetësisë. Atë natë, engjëjt nuk zbresin me dënim apo ndëshkim, sepse ajo natë është natë e sigurt nga vuajtjet dhe dënimet.

حَتَّى مَطْلَعِ الْفَجْرِ "**deri në lindjen e agimit**", deri në zbardhje të ditës.

Meqenëse në këtë natë ka filluar zbritja e Kuranit, që i ka nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë, nga humbja në udhëzim, dhe revolucioni më i madh botëror, që bëri të mundur kalimin nga armiqësia në vëllazëri, kështillohet që ajo të kalohet duke lexuar Kuran me qetësi dhe përkushtim, duke falur namaze nafile (suplementare) dhe duke bërë dua. Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) ka thënë: "*Ai që këtë natë, duke besuar me bindje të plotë dhe për kënaqësinë e Zotit ngrihet* (fal namaz dhe merret me adhurim)*, do t'i falen gjynahet e kaluara.*"[61] Këtë natë, e cila ka fituar kaq shumë vlerë me zbritjen e Kuranit, ta kalosh me adhurime të tjera dhe të jetosh i painformuar nga Kurani, do të thotë të mos e dish vlerën e vërtetë të saj.

Ajo që e bën këtë natë më të mirë se një mijë muaj, është zbritja e Kuranit në të. Atëherë ajo që duhet të bëjë besimtari është: Si fillim duhet të mësojë leximin e Kuranit, pastaj duhet të mësojë kuptimin dhe interpretimin e tij, dhe, më e rëndësishmja, duhet t'i jetojë në jetën e tij mësimet që na jep Kurani. Pastaj duhet t'ia tregojë edhe të tjerëve këto të vërteta që të bëhet shkak për udhëzimin e tyre. Në të kundërt, të merresh me adhurim vetëm natën e Kadrit dhe pjesën tjetër të vitit ta kalosh i painformuar nga Kurani Famëlartë, nuk është aspak e drejtë.

Transmetohet nga Aishja (r.a.) të ketë pyetur Profetin Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem): "O i Dërguari i Allahut! Nëse e kuptoj se është nata e Kadrit çfarë duhet të them? Ai më tha:

اَللّٰهُمَّ إِنَّكَ عَفُوٌّ كَرِيمٌ تُحِبُّ الْعَفْوَ فَاعْفُ عَنِّي

Allahumme inneke afu'un kerimun, tuhibbul afue, feafu anni! (O Allah! Ti je Falës, Bujar, e do faljen, pra më fal mua)"[62]

Përcaktimi kohor i kësaj nate ka qenë temë diskutimesh dhe ka rreth 40 mendime të ndryshme. Nata e Kadrit është e fshehur gjatë muajit të Ramazanit. Por, mundësia më e madhe e gjetjes së kësaj nate janë dhjetë ditët e fundit të tij, netët teke. Mundësia për të qenë nata e 27-të ose nata e fundit është më e madhe. Kjo natë e mirë dhe me vlera përsëritet çdo vit.

Shumica e dijetarëve myslimanë e kanë pranuar natën e 27 të muajit të Ramazanit si natë Kadri. Ndoshta, me qëllimin që njerëzit ta vlerësojnë sa më mirë dhe të përfitojnë sa më shumë nga kjo natë, duke e kaluar me adhurim e lutje. Profeti (sal'la llahu alejhi ue selem) nuk na ka informuar saktësisht se cila është kjo natë e madhe.

---

61. Buhari, Lejletu'l-Kadr 1.
62. Tirmidhi, Da'auat 84; Ibn Maxhe, Dua 5; Musned, I, 419, 438, VI, 171, 182, 183, 258.

SURJA BEJINE - 98

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

لَمْ يَكُنِ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ مُنْفَكِّينَ حَتَّى تَأْتِيَهُمُ الْبَيِّنَةُ (1) رَسُولٌ مِنَ اللَّهِ يَتْلُو صُحُفًا مُطَهَّرَةً (2) فِيهَا كُتُبٌ قَيِّمَةٌ (3)

وَمَا تَفَرَّقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ إِلَّا مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمُ الْبَيِّنَةُ (4) وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ (5) إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ فِي نَارِ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا أُولَئِكَ هُمْ شَرُّ الْبَرِيَّةِ (6) إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَئِكَ هُمْ خَيْرُ الْبَرِيَّةِ (7) جَزَاؤُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتُ عَدْنٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ذَلِكَ لِمَنْ خَشِيَ رَبَّهُ (8)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, nuk do të largoheshin (nga mosbesimi i tyre), derisa t'u vinte Dëshmia e qartë:

2. Një i Dërguar nga Allahu, i cili t'u lexonte faqe të pastra (Kuranin),

3. të cilat përmbanin rregulla të drejta.

4. Ata, që u ishte dhënë Libri, u përçanë vetëm atëherë, kur u erdhi Dëshmia e qartë.

5. E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë.

6. Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e Xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija.

7. Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira.

8. Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet.

Surja Bejine, e zbritur në Medine, ka 8 ajete. Emrin e ka marrë prej fjalës bejine (argument i qartë e i prerë) që ndodhet në ajetin hyrës të sures. Po ashtu, kjo sure emërohet edhe si: Kajjime, Munfekin, Berrije e Lemjekun. Në sure trajtohen këto tema:

a- Qëndrimi i politeistëve dhe pasuesve të librit (të krishterët dhe hebrenjtë) karshi profetësisë së Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem).
b- Adhurimi i Allahut (xh.sh.) me sinqeritet.
c- Çështja që, fatlumët e fatzinjtë, që të gjithë do të shkojnë në botën tjetër, fatlumët në Xhenet (parajsë) dhe fatzinjtë në Xhehenem (zjarr).

Suret nga surja Huxhurat deri në suren Buruxh quhen edhe "**Tiualu mufassal**" (suret e gjata nga fundi i Kuranit), prej saj deri në suren Bejine quhen "**Eusatu Mufassal**" (suret e mesme nga fundi i Kuranit) e, prej saj deri në fund quhen "**Kisaru mufassal**" (suret e shkurtra nga fundi i Kuranit). Ashtu siç qartësohet edhe në librat e fikhut, është e pëlqyeshme që, në namazin farz të sabahut dhe të drekës të lexohet nga suret "**Tiualu mufassal**", në ikindi e jaci të lexohet nga suret "**Eusatu Mufassal**", ndërsa, në aksham të lexohet nga suret "**Kisaru mufassal**". Pra, përveç rasteve që s'kemi mundësi, në namaze të lexosh në masën e këtyre sureve është sunet dhe të lexosh një nga këto sure në çdo rekat është e pëlqyer. Domethënës është edhe fakti që, kjo sure është vendosur pas sures 'Alak dhe Kadr. Në suren 'Alak flitet rreth zbritjes së uahjit (shpalljes) së parë dhe në suren Kadr tregohet koha e fillimit të uahjit. Ndërsa, në suren Bejine tregohet nevoja e dërgimit të një profeti bashkë me këtë Libër.

Në fillim, tregohet nevoja për dërgimin e një profeti. Kjo nevojë është shtjelluar në këtë mënyrë: Shpëtimi i njerëzve nga mohimi, qofshin këta prej pasuesve të librit apo prej mosbesimtarëve, bëhet i mundur me anë të dërgimit të profetëve. Ky libër është një argument i qartë për këtë profet, i cili, ia shpjegon njerëzve librin e Allahut në mënyrë të qartë e të pastër dhe, siguron që mos të përzihet asgjë e pasaktë me këtë Libër të qartë, si dhe, bën të mundur që ky libër mos të deformohet si librat e shenjtë të mëparshëm.

TEFSIRI

لَمْ يَكُنِ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ مُنْفَكِّينَ حَتَّى تَأْتِيَهُمُ الْبَيِّنَةُ

1. **Ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, nuk do të largoheshin (nga mosbesimi i tyre), derisa t'u vinte Dëshmia e qartë**

Pasuesit e librit dhe politeistët, edhe pse bëjnë pjesë në të njëjtën kategori mosbesimi, janë përmendur me emra të veçantë. Me pasuesit e librit ka për qëllim, ata që kanë dhe i besojnë ndonjë libri të dërguar profetëve të mëparshëm, edhe pse mund të jetë i deformuar dhe i paruajtur në formën e tij origjinale. Ndërsa, me politeistët, ka për qëllim ata që nuk i besojnë asnjë profeti dhe nuk kanë asnjë libër.

Ndoshta mund të ketë pasur për qëllim, ata që, edhe pse janë prej pasuesve të librit, duke thënë se Allahu ka fëmijë dhe kanë mendime krahasuese për Krijuesin (duke e krahasuar Allahun me njeriun a diç tjetër), në një mënyrë apo në një tjetër, devijojnë në politeizëm. Kurani Fisnik, e përmend

politeizmin e pasuesve të librit në shumë vende. Por, megjithatë, në asnjë vend nuk e përmend fjalën "politeist" për ata. Ata, janë përmendur si "Pasues të librit" ose atyre që u "është dhënë libër". Në disa raste janë përmendur si, "Jehudi" (hebrenj) e "Nesara" (të krishterë), sepse feja e tyre origjinale është teuhidi (njëshmëria e Zotit). Por, në të njëjtën kohë kanë devijuar edhe në politeizëm.

Përshkrimi i pasuesve të librit si mohues, tregon se, mosbesimi i tyre përfshin Kuranin dhe profetin, po ashtu tregon edhe se, ata mohojnë edhe Teuratin e Inxhilin (Biblën) dhe profetët e tyre.

Politeistët; janë më të përgjithshëm se ata që adhurojnë statujat. Këtu futen të gjithë ata që i bëjnë shokë Allahut, duke adhuruar statuja apo diçka tjetër. Ky emërtim përfshin të gjithë ata që shohin në vetën e tyre, apo në diçka tjetër, pjesë nga Zoti ose ndonjë ortakëri të mundshme, si për shembull Faraoni, i cili i kishte bërë tekat e tij zot, duke mos e njohur Allahun: "E u tha: 'Unë jam zoti juaj më i lartë!'"[63] dhe "Dhe faraoni tha: 'O ju pari! Unë nuk di që për ju ka tjetër zot përveç meje!'"[64]

الْبَيِّنَةُ Bejine, argument i qartë e i prerë. Dihet që, bejine ashtu si nur (drita), duke qenë e qartë për vete i qartëson edhe të tjerët. Për këtë arsye, dëshmitarit që tregon dhe vërteton një çështje, që sjell një argument të qartë e bindës, i thuhet bejine. Këtu ka kuptimin e argumentit dhe faktit që do të vërtetojë dhe shtjellojë të vërtetën.

Në këtë ajet me fjalën argument i qartë nënkuptohet Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem). Jeta e tij e kulluar është një argument i qartë për këtë fe. Vlerat e tij të larta si: i drejtë, i besueshëm, i patëmeta në të gjitha aspektet morale, dhënia atij një libër si Kurani edhe pse nuk dinte shkrim e këndim, ndërhyrja më efikase në rrjedhën e historisë në një popull beduinësh, principet e besimit që solli, adhurimi, ligjet dhe principet morale, duke mos u ndeshur as me logjikën e as me ndërgjegjen, mijëra njerëz që e pasuan atë bënë një progres madhështor si në aspektin shpirtëror, moral apo edhe atë shkencor, dhe duke menduar edhe specifika të tjera të tij, kuptohet se sa të panumërta janë argumentet që flasin për të Dërguarin e Allahut.

Dalja e politeistëve dhe pasuesve të librit prej gjendjes ku ndodhen, nuk është e mundur vetëm se me argumente. Por, pas ardhjes së këtyre argumenteve, përgjegjësia e atyre që vazhdojnë në mohim u mbetet atyre. Pas kësaj, ata nuk mund të fshihen pas pretekstit se nuk u udhëzuan që të ndiqnin rrugën e drejtë.

رَسُولٌ مِنَ اللَّهِ يَتْلُو صُحُفًا مُطَهَّرَةً (2) فِيهَا كُتُبٌ قَيِّمَةٌ (3)

2-3. Një i Dërguar nga Allahu, i cili t'u lexonte faqe të pastra (Kuranin), të cilat përmbanin rregulla të drejta[65]

---

63. Surja Naziat, 79:24
64. Surja Kasas, 28:38
65. **رَسُولٌ مِنَ اللَّهِ** është bedel (ekuivalent) i bejines. Ose, haber (përcaktor) i mahdhuf mubtede (kryefjalë e nënkuptuar), pra interpretim i bejines.

Pra, nuk do të heqin dorë prej mohimit të tyre derisa t'u vijë një i dërguar prej Allahut i ngarkuar me detyrën e profetësisë. Një profet i tillë, që يَتْلُو صُحُفًا مُطَهَّرَةً lexon fletë të pastra, të kulluara, të ruajtura prej duarve të liga. Sipas dëshmisë së ajetit 79 të sures Uakia' "**Atë (Kuranin) e prekin vetëm të pastëtit**", lexon fletë të pastra.

صُحُفًا suhuf është shumësi i fjalës صحيفةٌ sahifetun. Kuptimi leksikor i kësaj fjale është letër, fletë e shkruar, mirëpo në Kuran, ka kuptim terminologjik për "librat e zbritur profetëve". "**Fletë të pastra**", libra që janë larg dyshimeve dhe që nuk janë përzier me gjëra të dyshimta e të pasakta. Janë aq të pastra sa:

فِيهَا كُتُبٌ قَيِّمَةٌ

3- Të cilat përmbanin rregulla të drejta. Pra, libra të pandryshueshëm që përmbajnë të vërtetën, drejtësinë dhe urtësinë, të pa deformuar dhe e vërteta gjendet gjithmonë në brendësi të këtyre librave. Janë pikërisht suret e Kuranit që urdhërohet të lexohen në ajetin "**Lexo**". Meqenëse Kurani Fisnik përmban në brendësi të tij edhe mësimet e librave të mëparshëm, Allahu (xh.sh.) shprehet: "فِيهَا كُتُبٌ قَيِّمَةٌ **Të cilat përmbanin rregulla të drejta.**"

وَمَا تَفَرَّقَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ إِلَّا مِنْ بَعْدِ مَا جَاءَتْهُمُ الْبَيِّنَةُ

4- Ata, që u ishte dhënë Libri, u përçanë vetëm atëherë, kur u erdhi Dëshmia e qartë

Pasuesit e librit, ose dijetarët dhe elita e tyre, u përçanë mes njëri-tjetrit vetëm pasi u erdhi bejine (argumenti i qartë) dhe mrekullia e qartë. Dolën mosmarrëveshje midis atyre që i besuan profetit dhe e ndoqën atë dhe, midis atyre që nuk i besuan atij dhe u kthyen në gjendjen e tyre të mëparshme. Mohimi ndaj Profetit Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) buronte nga zilia dhe nga mos honepsja e këtij fakti prej tyre, sepse në Kuran thuhet: "**Ata që u kemi dhënë Librin, e njohin atë (Profetin a.s.), ashtu siç i njohin bijtë e tyre, por disa prej tyre e fshehin të vërtetën, duke e ditur mirë**."[66] Por, zilia u bë pengesë për besimin e tyre.

Pra, mohuesit nuk ishin në gjendje të largohesh prej mohimit dhe prej traditës së tyre të shthurur, sepse argumenti i qartë që ua shtjellonte të vërtetën nuk kishte ardhur akoma. Gjendeshin në periudhën fitret (periudha midis dy profetëve, ose periudha kur njerëzit nuk kishin dëgjuar rreth ndonjë profeti, apo rreth fesë së drejtë). Për rrjedhojë, atyre iu dërgua ky libër dhe ky profet si argument i qartë për t'u treguar atyre të vërtetën dhe duhej që, pasuesit e librit të largoheshin nga besimi i tyre i devijuar dhe ta ndiqnin këtë argument që u erdhi para se të besonin politeistët. Por, nuk ndodhi ashtu, ata patën mosmarrëveshje mes tyre dhe e mohuan profetin ashtu siç e mohuan adhuruesit e statujave. Kjo mosmarrëveshje, pasi u erdhi argumenti i qartë, nuk ishte për gjë tjetër vetëm se, ata nuk donin të hiqnin dorë prej veseve të tyre të mëparshme dhe prej zilisë e inatit. "Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami. Ata që u është dhënë Libri, patën mospajtime nga zilia që

66. Surja Bekare, 2:146

kishin midis tyre, vetëm pasi u erdhi dituria. Por kushdo që i mohon udhëzimet e Allahut, ta dijë se Allahu është i shpejtë në llogari."[67]

وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ وَذَٰلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ

5- E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë

وَمَا أُمِرُوا Por atyre që iu është dhënë libri më parë nuk u urdhëruan me gjë tjetër **veç إِلَّا** se; **لِيَعْبُدُوا اللَّهَ të adhurojnë Allahun**. Ashtu si në librat e tyre të mëparshëm Teurat dhe Ungjill, po ashtu edhe në Kuranin Famëlartë, kjo ishte një detyrë për të cilën ata u urdhëruan, që të mos i shërbejnë një ideali tjetër, por të kenë si synim vetëm njohjen dhe adhurimin e Allahut (xh.sh.). **مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ**, duke ia dedikuar fenë vetëm Allahut me sinqeritet të plotë dhe me qëllim të pastër. **حُنَفَاءَ** Si **hanif**, larg çdo besimi të kotë e të pabazë, larg moralit të papastër, që i drejtohen gjithmonë së vërtetës, adhurojnë vetëm Allahun (xh.sh.) me sinqeritet si myslimanë, (mu'uahidun) monoteistë që i besojnë vetëm Allahut dhe, shpërblimin e veprave të tyre e presin vetëm prej Tij.

Hanif, si cilësi e fesë së Ibrahimit (a.s.), nuk është e veçantë vetëm për të, por, duke pasur kuptimin e kundërt me ata që adhurojnë statujat, është emri i fesë së gjithë profetëve që kanë ftuar popujt e tyre në monoteizëm. Fjala hanif, mund të përkufizohet si: besimtar që adhuron vetëm Allahun (xh.sh.) e, që nuk devijon në politeizëm. Hanif, është feja që urdhëron të adhurohet vetëm Allahu, duke qëndruar larg çdo lloj politeizmi, është feja që kanë kumtuar të gjithë profetët.

Ithtarët e librit janë urdhëruar që në krye të herës që ta adhurojnë vetëm Allahun dhe me sinqeritet, **وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ** të falin namazin dhe **وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ** dhe të japin zekatin. Pra, **وَذَٰلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ kjo është feja e drejtë,** e ndërtuar mbi tre principe bazë: adhurimi i vetëm Allahut (xh.sh.) dhe me sinqeritet, falja e namazit dhe dhënia e zekatit. Me një shprehje tjetër, Hanif është feja Islame që shpjegojnë librat e drejtë e të pandryshuar siç përmenden më sipër "**fletë të pastra**". Kuptohet se, këto tre principe janë nga principet bazë e të pandryshueshme të çdo feje të drejtë. Namazi dhe zekati janë baza e të gjitha adhurimeve pas besimit. Principet me të cilat u urdhëruan ithtarët e librit janë të njëjtat principe me të cilat u urdhërua Muhamedi (alejhi selam), kështu që, refuzimi që ata i bënë Profetit (s.a.s.) nuk është për diçka tjetër vetëm se prej smirës e zilisë.

إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ وَالْمُشْرِكِينَ فِي نَارِ جَهَنَّمَ خَالِدِينَ فِيهَا أُولَٰئِكَ هُمْ شَرُّ الْبَرِيَّةِ

6- Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e Xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija

[67]. Surja Al 'Imran, 3:19

Në këtë ajeti kuptimi i "**kufrit**" mohimit është refuzimi dhe mospranimi i Profetit Muhamed (alejhi selam). Pra, idhujtarët dhe ithtarët e librit e refuzuan Profetin (s.a.s.) pas ardhjes së shpalljes hyjnore.

شَرُّ الْبَرِيَّةِ Sherrul-berrije, ka kuptimin e krijesës më të ligë e më të dëmshme. Pra, ndër krijesat e Allahut (xh.sh.) nuk ka krijesa më të këqija se ata. Për më tepër ata janë më të ulët se kafshët, sepse kafshët nuk kanë vullnet dhe logjikë të lirë. Ndërsa njeriu, edhe pse ka logjikë dhe vullnet të lirë, sërish e refuzon të vërtetën.

Ditën e Kiametit do të hidhen në zjarrin e Xhehenemit, dhe atje do të jenë përgjithmonë (Allahu na ruajt nga ky dënim i tmerrshëm). Arsyeja e dënimit të përjetshëm është se: Ata janë krijesat më të këqija, dhe vendi i të këqijve është Xhehenemi.

Në të kundërt nga ky grup:

إِنَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ أُولَئِكَ هُمْ خَيْرُ الْبَرِيَّةِ

7- Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira - pikërisht ata janë krijesat më të mira

Më të mirët ndër krijesat e Allahut, më të mirët në vepra dhe më të mirët tek Allahu (xh.sh.). Pra, nëse nuk kryejnë vepra të mira, edhe në mos qofshin më të ligët ndër krijesat e Allahut, nuk mund të jenë më të mirët. **خَيْرُ الْبَرِيَّةِ Hajrul-berrije krijesat më të dobishme**, janë ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira.

جَزَاؤُهُمْ عِنْدَ رَبِّهِمْ جَنَّاتُ عَدْنٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ ذَٰلِكَ لِمَنْ خَشِيَ رَبَّهُ

8. Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet

Meqë "**hulud**" ka kuptimin e përjetësisë, me fjalët **خَالِدِينَ فِيهَا** "**e aty janë përgjithmonë**" shprehet i njëjti kuptim. Por, fjala "**hulud**" përdoret edhe me kuptimin për një kohë të gjatë, dhe për të eliminuar këtë mundësi, e ka përforcuar me fjalën **أَبَدًا** "**ebeden**" pa fund. Ky përforcim është përsëritur në shumë ajete për të treguar përjetësinë e banorëve të zjarrit, dhe përjetësinë e banorëve të parajsës.

Dhe, mbi të gjitha, një shpërblim që qëndron mbi të gjitha llojet e shpërblimit në Xhenet është edhe përgëzimi dhe njoftimi i Allahut (xh.sh.) që, **رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ** "**Allahu është i kënaqur prej tyre**" dhe **وَرَضُوا عَنْهُ** "**dhe ata janë të kënaqur prej Tij**", sepse ata kanë arritur dëshirën më të madhe që qëndron mbi çdo gjë, dhe po ashtu kënaqësinë më të madhe që qëndron mbi çdo gjë, që është kënaqësia e Allahut (xh.sh.).

ذَٰلِكَ Ky shpërblim dhe kjo kënaqësi janë vetëm për ata që, **لِمَنْ خَشِيَ رَبَّهُ i druhen Zotit të tyre.** Pra, shkaku dhe urtësia e fitimit të këtij shpërblimi është frika ndaj Allahut (xh.sh.).

Hashjet, ka kuptimin e druajtjes me respekt, që vjen si rezultat i lartësimit dhe dashurisë. Për këtë arsye hashjet meriton të bukurën në bindje dhe është një gjendje e bukur shpirtërore, që zgjon ndjenjën e emocionit dhe dashurisë, që të lartëson në nivelin e ihsanit (pra, ta adhurosh Allahun sikur e shikon, nëse ti nuk e shikon dot Atë, Ai të shikon ty).

Edhe në hadithin "*Kreu i urtësisë është frika ndaj Allahut*"[68] me fjalën "**mehafet**" frikë, kuptohet ky lloj "hashjeti". Grada e saj është në përputhje me gradë e dijes e të njohurisë. Për këtë arsye në Suren Fatir, ajeti 28, thuhet: "**Me të vërtetë, Allahut i druhen vetëm dijetarët prej robërve të Tij**".

Kjo lloj frike tregon dashuri dhe respekt. Kjo frikë buron nga shqetësimi se mos largohet nga Ai që do dhe qëndrimit larg Tij, duke merituar dënimin e Tij. Për rrjedhojë, ai që i druhet Allahut bën ç'është e mundur që t'i afrohet Atij. Ndërsa në frikën e thjeshtë, njerëzit mundohen t'i qëndrojnë larg asaj që i frikësohen. Për shembull, ai që ka frikë zjarrin qëndron larg tij. Por, ata që i druhen Allahut (xh.sh.), përpiqen që të mos qëndrojnë larg Tij.

SURJA ZELZELE - 99

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زِلْزَالَهَا (1) وَأَخْرَجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا (2) وَقَالَ الْإِنْسَانُ مَا لَهَا (3) يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا (4) بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَى لَهَا (5)

يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِيُرَوْا أَعْمَالَهُمْ (6) فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ (7) وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ (8)

Shqipërimi:

1. Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit),

2. kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj

3. e njeriu të thotë: "Ç'po i ndodh asaj?!"

4. Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj,

5. sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë.

6. Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre:

---

68. Sujuti, el-Fet'hul-Kebir, Bejrut ts., II, 123; Alijjul-Mutteki, Kenzul-Ummal, Bejrut 1985, III, 141 (5873); Axhluni, Keshful-Hafa, Kairo ts., I, 507.

7. kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë,

8. e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.

Kjo sure që përshkruan dridhjen e tokës quhet "**Surja Zelzele**". Surja Zelzele e zbritur në Medine ka 8 ajete. Për arsye se nga stili i saj ngjan me suret mekase, ka prej atyre që kanë thënë se është sure mekase. Emrin e ka marrë nga emërorja e foljes në ajetin e parë me kuptimin tërmet. Flet rreth tërmetit të fuqishëm që do të ndodhë menjëherë para Kiametit, dhe daljes së njerëzve nga varret e më pas dhënies llogari.

Në një hadith të saktë thuhet: "*Surja Zelzele është ekuivalente me gjysmën e Kuranit*"[69], ndërsa në një tjetër hadith me një të katërtën e Kuranit. Hadithi i parë është interpretuar si në vijim: Rregullat e sjella nga Kurani ndahen në dy, rregulla që kanë të bëjnë me këtë botë dhe rregulla që kanë të bëjnë me botën tjetër (Ahiret). Kjo sure përfshin shkurtimisht çështjet e gjykimet rreth botës tjetër. Ringjallja në botën tjetër për të cilën flitet në këtë sure, në një tjetër hadith thuhet se është një e katërta e besimit. Në hadithin e transmetuar nga Tirmidhiu thuhet: "*Një rob nuk quhet si besimtar pa i besuar këtyre katër gjërave: Të dëshmojë se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se Allahu më ka dërguar Mua me të vërtetën, t'i besojë vdekjes, t'i besojë ringjalljes pas vdekjes dhe përcaktimit hyjnor* (kader)."[70]

TEFSIRI

إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زِلْزَالَهَا

1. Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit)

Zilzal quhet dridhja e tokës. "**Zel**" shpreh lëvizje, por zelzele dhe zilzal duke qenë më i fuqishëm tregon lëvizje të përsëritshme. Pra, tregon se toka do të lëkundet me lëkundje të njëpasnjëshme dhe jo vetëm një pjesë e saj, por e gjithë toka do të lëkundet. Veçanërisht shprehja me prapashtesë emërore tregon që rruzulli tokësor do të dridhet me një dridhje të tmerrshme. Pra, tërmeti i ditës së Kiametit që përmendet edhe në ajete të tjera si: "**يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمْ ۚ إِنَّ زَلْزَلَةَ السَّاعَةِ شَيْءٌ عَظِيمٌ O njerëz, frikësojuni Zotit tuaj, sepse dridhja e Orës (së Kiametit), është vërtet një ngjarje e madhe!**"[71], "**Kur toka të dridhet fuqishëm, malet të thërrmohen copë-copë.**"[72] Pra, të gjitha krijesat do të shkatërrohen dhe sistemi funksional në tokë do të prishet.

وَأَخْرَجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا

2. Kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj

---

69. Tirmidhi, Theuabul-Kuran 10.
70. Tirmidhi, Kader 10; Ibn Maxhe, Mukaddime 10; Musned, I, 97, 133.
71. Surja Haxh, 22:1
72. Surja Uakia', 56:4-5

Ethkal është shumë i fjalës **thekal**, me kuptimin diçka e rëndë.

Ka dy transmetime rreth nxjerrjes së barrës së tokës nga brendia e saj. I pari: Nxjerrja e të vdekurve nga varri sipas kuptimit të ajetit: **وَإِذَا الْقُبُورُ بُعْثِرَتْ** "**Dhe kur të trazohen varret**"[73] Kjo tregon për ringjalljen kur t'i fryhet surit për herë të dytë. Ndërsa tjetri është nxjerrja e thesareve të tokës, e mineraleve që ajo mbart në brendinë e saj, që kuptohet se do të ndodhë gjatë fryrjes së surit herën e parë dhe gjatë dridhjes së tokës.

Një pjesë e mirë e interpretuesve të Kuranit, kanë thënë duke i bashkuar të dyja transmetimet që, **ethkal (barrë e rëndë)** përfshin si të vdekurit ashtu edhe thesaret që gjenden brenda në tokë. Përdorimi me kuptimin e të vdekurve dhe thesareve është në mënyrë metaforike.

Disa interpretues që nuk pajtohen me këtë mendim kanë thënë se: në ajetin "**Dhe kur të nxjerrë toka atë që ka në brendinë e saj (barrën nga brenda)**" nuk ka asnjë tregues në Kuran që të na tregojë "**barra në brendinë e saj**" ka kuptimin e thesareve që gjenden në brendi të tokës. Nxjerrja e të vdekurve nga brendia e saj është e saktë nga ana kuptimore, sepse të vdekurit janë barrë; mbartja e përgjegjësive dhe gjynaheve janë peshë e rënde, mund të jenë të rënda për tokën. Prej rëndesës së njerëzve, toka mund ta shkundë shpinën e saj dhe t'i thotë njerëzve dilni jashtë prej meje.

Interpretuesit bashkëkohorë kanë një qasje interesante rreth ajetit. Sipas tyre, në qendër të tokës ka një rëndesë, shtypje. Atje ekzistojnë magma të njohura. Ndoshta në një vend të vogël sa maja e gishtit gjendet një masë sa një ndërtesë. Pra, në të kundërt me butësinë në sipërfaqen e tokës, në brendësinë e saj ka një rëndesë. Kuptimi i drejtë i tërmetit dhe i dridhjes së tokës, copëtimi dhe thërrmimi i maleve, është dalja e masave të rënda nga brendësia e tokës në sipërfaqen e saj, si dhe dalja e llavës në sipërfaqe. Sipas disa interpretuesve, qendra e rruzullit të tokës është xhehenem i vogël.

وَقَالَ الْإِنْسَانُ مَا لَهَا

3. E njeriu të thotë: "Ç'po i ndodh asaj?"

Shprehja në këtë formë është për të përshkruar madhësinë e frikës. Pra, ajo kohë e tmerrshme, kur njerëzit, që do të shohin tërmetin dhe daljen e barrës nga brendia e tokës në sipërfaqe, do të thonë të habitur e të tmerruar: "**Ç'ka kjo që dridhet?**, **Ç'është kjo gjendje?**"

Me fjalën "Insan" ashtu siç mund të kuptohen të gjithë njerëzit, mund të kuptohen edhe njerëzit që mohojnë jetën tjetër (Ahiretin), sepse ajo që ai e quante si diçka të pamundur tani po i ndodh para syve, duke e parë atë do të mbesë i tronditur dhe i tmerruar. Për besimtarët, kjo situatë nuk do të jetë as tronditëse e as shqetësuese, sepse ata e dinë që diçka e tillë do të ndodhë.

Ditën kur të ndodhin situatat që përmenden më sipër toka:

[73]. Surja Infitar, 82:4

يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا (4) بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَى لَهَا (5)

4-5. Atë ditë ajo do të tregojë lajmet e saj, sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë

Rrëfen ngjarjet e veta me gjendjen e saj dhe me fjalë, sepse Zoti i saj e ka urdhëruar atë që të tregojë dhe flasë rreth ngjarjeve që kanë ndodhur në të. Pra, Allahu i Lartë, do të formojë në tokë situata të tilla që do tregojnë historitë e ndodhura në tokë. Bashkë me këtë është thënë edhe që, atë ditë Allahu do ta bëjë tokën që të flasë dhe të njoftojë të mirat e të këqijat që janë bërë mbi të. Transmetohet nga i Dërguari i Allahut se, toka do të dëshmojë kundër të gjithëve se çka kanë vepruar mbi të.[74]

Sipas Meududit: Ditën e Kiametit, toka do t'i tregojë ato që kanë ndodhur në sipërfaqen e saj. Mënyra se si do të flasë toka Ditën e Kiametit, për njerëzit më parë ishte diçka e paperceptueshme. Ndërsa, për njeriun e sotëm nuk është e vështirë ta kuptojë diçka të tillë, duke parë zhvillimet e teknologjisë së sotme. Fjalët e njeriut transportohen nga një cep i botës në tjetrën me anë të radios, televizorit, telefonit e kompjuterit. Të gjitha ato që flasim mund të ruhen në pajisje elektronike shumë të vogla. Allahu i Lartë, në çastin që dëshiron mund t'i përsërisë këto fjalë ashtu siç kanë dalë nga goja e njeriut herën e parë. Njeriu do t'i dëgjojë me veshët e tij që këto janë fjalët e tij dhe do t'i kuptojë. Ata që e njohin atë do t'i kuptojnë fjalët e tij nga zëri dhe theksi i tij. Po ashtu, njerëzit çdo gjë që bëjnë në rruzullin tokësor, kur e kanë vepruar dhe mënyrën sesi e kanë vepruar, të gjitha këto ruhen në sendet që gjenden përreth tij, ashtu si një fotografi. Qofshin këto edhe veprime të kryera në errësirë. Të gjitha këto "fotografi" do t'i dalin para njeriut Ditën e Kiametin si një shirit filmi. Do të tregojnë se çka ka vepruar ai në këtë botë.

Është e vërtetë se, Allahu (xh.sh.) di gjithçka që kryejnë robërit e Tij pa pasur nevojë për ndërmjetës. Por, kur të formohet gjykata e lartë Ditën e Kiametit, nëse Allahu (xh.sh.) do të dënojë dikë, do t'i garantojë të gjitha kushtet e drejtësisë. Për çdo person, kur të gjykohet Ditën e Gjykimit, do të sillen argumente të pakontestueshme dhe dëshmitarë të përkryer, në mënyrë që fajtori të mos ketë asnjë mundësi ta kundërshtojë fajin.

Transmetohet nga Ebu Hurejre (r.a.) se i Dërguari i Allahut (alejhi selam) ka thënë: "*Atë ditë, toka do të rrëfejë se çka është vepruar mbi të*." Më pas këndoi ajetin dhe i pyeti sahabet: "*A e dini se çka do të rrëfejë toka*?" Sahabet (r.a.) thanë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri". I Dërguari i Allahut (alejhi selam) shtoi e tha: "*Toka do të rrëfejë se çfarë ka vepruar çdo burrë e grua sipër saj dhe do të dëshmojë për ta. Do të thotë, këtë ditë bëtë këtë e atë ditë bëtë atë. Pra, këto janë ngjarjet që do të rrëfejë toka.*"[75]

يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِيُرَوْا أَعْمَالَهُمْ

6. Atë ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre

74. Tirmidhi, Kiamet 7, Tefsiru Sure 99; Musned, II, 374.
75. Tirmidhi, Kijame 7.

Pra, do të dalin nga vendet ku janë, do të dalin nga varret e tyre dhe do të shkojnë në mahsher (vendin e ringjalljes). Dikush me fytyrë të bardhë e dikush me fytyrë të zezë, dikush në paqe e dikush i zhytur në frikë e ankth, dikush hipur e dikush në këmbë, dikush i lirë e dikush i prangosur; që të gjithë do të shkojnë drejt mahsherit.

لِيُرَوْا أَعْمَالَهُمْ "**që t'u tregohen veprat e tyre**", pra, që të shohin se çfarë kanë punuar, të shohin librin e veprave dhe shpërblimin e punëve.

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ (7) وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ (8)

7-8. Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë

ذَرَّة dherreh, ka kuptimin e grimcës që gati sa nuk duket me sy të lirë. Ka edhe kuptimin e grimcave që duken në dritën e diellit. Kuptimi i vërtetë këtu është gjëja më e vogël që mund të perceptojë njeriu. Qëllimi i vërtetë në ajet është që, çdo punë që kryen njeriu qoftë e mirë apo e keqe nuk humbet tek Allahu i Lartë.

Ky ajet e paralajmëron njeriun rreth një të vërtete shumë të rëndësishme, dhe kjo e vërtetë është: Çdo punë sado e vogël që të jetë e ka një peshë dhe një vlerë. Kjo vlen edhe për të keqen. Çdo gjë do të shpërblehet. Për këtë arsye nuk duhet nënvlerësuar asgjë, një e vepër e mirë sado e vogël që të jetë nuk duhet braktisur. Kur ato të mblidhen të gjitha së bashku formojnë një të mirë të madhe. Po kështu duhet vepruar edhe me veprat e këqija. As e keqja më e vogël nuk duhet kryer, sepse, edhe ato do të mblidhen një ditë. I Dërguari i Allahut (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) na mëson që të mos braktisim as të mirën më të vogël duke thënë: "*Përpiquni të ruheni nga Xhehenemi qoftë edhe me gjysmë hurme apo me një fjalë të mirë***.**"[76] Aishja (r.a.) një ditë dha sadaka një kokërr rrushi dhe tha: "*Edhe në këtë ka shumë grimca peshë***.**" Aishja (r.a.) me këtë na ka treguar se edhe një sadaka e vogël, qoftë kjo edhe një kokërr rrushi do t'i bëjë dobi njeriut. Hadithi i Profetit (s.a.s.) që të japim sadaka qoftë edhe gjysmë hurme apo një fjalë të mirë tregon se edhe sadakaja më e vogël nuk duhet neglizhuar, na tregon se duhet të japim sadaka sa të mundemi dhe të mos privohemi prej dobisë së saj. Së bashku me shpërblimin e grimcës më të vogël të mirësisë apo të ligës në ajet, Kurani Fisnik në këtë çështje na mëson disa principe:

Principi i parë: Veprat e politeistëve, të mosbesimtarëve dhe të hipokritëve (pra veprat që cilësohen si të mira) kanë shkuar dëm e janë të humbura. Atyre nuk do t'u jepet asnjë shpërblim në jetën tjetër (Ahiret). Nëse e kanë një shpërblim, e kanë marrë në këtë botë. Për shembull, Araf 147; Teube, 17, 67-69; Hud, 15-16; Ibrahim, 18; Kehf, 104-105; Nur, 39; Furkan, 23; Zumer, 65; Ahkaf, 20.

Principi i dytë: Dënimi i veprave të këqija do të jetë sa veprat e kryera. Ndërsa, veprat e mira do të kenë shpërblim më të madh. Në disa ajete është thënë se, një vepër e mirë do ta ketë shpërblimin

[76]. Buhari, Edeb 34, Zekat 10, Teuhid 36; Muslim, Zekat 66-68; Tirmidhi, Kijame 1, Zuhd 37; Nesai, Zekat 63, 64; Musned, I, 388.

dhjetë herë më shumë. Ndërsa në disa ajete të jetë tjera, është thënë se Allahu do t'i shpërblejë sa të dëshirojë. Shikoni suren Bekare, 261; En'am, 160; Junus, 26-27; Nur, 38; Kasas, 84; Sebe', 37; Mu'minun, 32.

Principi i tretë: Nëse besimtari ruhet nga gjynahet e mëdha, gjynahet e vogla do t'i falen. Shikoni suren Nisa', 31; Shura, 37; Nexhm, 32.

Principi i katërt: Besimtari i drejtë do të gjykohet lehtë. Do t'i falen gjynahet dhe do të shpërblehet sipas veprave të mira. Shikoni suren Ankebut, 7; Zumer, 35; Ahkaf, 16; Inshikak, 8.

SURJA ADIJAT - 100

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالْعَادِيَاتِ ضَبْحًا (1) فَالْمُورِيَاتِ قَدْحًا (2) فَالْمُغِيرَاتِ صُبْحًا (3) فَأَثَرْنَ بِهِ نَقْعًا (4) فَوَسَطْنَ بِهِ جَمْعًا (5) إِنَّ الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنُودٌ (6)

وَإِنَّهُ عَلَى ذَلِكَ لَشَهِيدٌ (7) وَإِنَّهُ لِحُبِّ الْخَيْرِ لَشَدِيدٌ (8) أَفَلَا يَعْلَمُ إِذَا بُعْثِرَ مَا فِي الْقُبُورِ (9) وَحُصِّلَ مَا فِي الصُّدُورِ (10) إِنَّ رَبَّهُمْ بِهِمْ يَوْمَئِذٍ لَخَبِيرٌ(11)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahu, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Betohem për ata (kuaj) që vrapojnë duke dihatur,

2. që nxjerrin xixa nga thundrat

3. dhe trokojnë për sulm në mëngjes,

4. duke çuar re pluhuri,

5. ndërsa çajnë armikun në dysh,

6. se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet,

7. dhe ai, pa dyshim, këtë e dëshmon.

8. Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri.

9. Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre

10. dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse,

11. Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta?!

Surja Adijat e zbritur në periudhën Medinase, ka 11 ajete.

Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) dërgoi një ekspeditë të vogël në fisin Kinane, me në krye Mundhir b. Amr El-Ensarij. Ai (sal'la llahu alejhi ue selem) nuk mori asnjë lajm rreth tyre për një muaj rresht. Hipokritët thanë se "ata ishin vrarë". Transmetohet se kjo sure ka zbritur për të treguar se ata janë shëndoshë e mirë[77]. Dhe ky është një argument që kjo sure ka zbritur në Medine.

Por, sipas disa interpretuesve të Kuranit surja është mekase, sepse, stili letrar i saj ngjason me suret mekase. Në shumë ajete të zbritura në Meke, flitet rreth ngjarjeve që do të ndodhin në të ardhmen. Në ajetet e sures Adijat, që kanë zbritur në fillimet e Islamit, flitet për ditët që do të vijnë, kur myslimanët të dalin në ekspedita e të triumfojnë. Informimi rreth ngjarjeve që do të vijnë në të ardhmen, është nga mrekullitë e Kuranit rreth së fshehtës.

Në sure trajtohen tema të tilla si: dashuria e njeriut për këtë botë, qortohet neglizhenca për botën tjetër (Ahiret) dhe se çka është e fshehur në zemrat e njerëzve do të dalë në pah Ditën e Gjykimit, si dhe e mëson njeriun që të përgatitet për atë ditë.

TEFSIRI

وَالْعَادِيَاتِ ضَبْحًا

1. Betohem për ata (kuaj) që vrapojnë duke hingëlluar

"**Adijat**" është shumës i fjalës "**ad'u**" me kuptimin të vraposh shpejt. **Adijat**, përdoret për kuajt, devetë dhe për të gjitha ato që vrapojnë.

Sipas transmetimit të Ibn Abbas'it (r.a.), në ajet kuptohet qartë se, adijat ka kuptimin e kuajve të kalorësve që rendin me shpejtësi. Po ashtu, shumica e interpretuesve të Kuranit janë të mendimit se ka këtë kuptim, sepse fjala **ضَبْح** ka kuptimin e hingëllimës së kuajve kur vrapojnë me shpejtësi e marrin frymë shpejt.

فَالْمُورِيَاتِ قَدْحًا

2. Që nxjerrin xixa nga thundrat

قَدْحً Kad'h, xixëllimat që nxjerrin kuajt nga thundrat e tyre kur vrapojnë nëpër gurë. Kjo është e mundur të shihet natën. Ky është një tregues i fuqisë së tyre dhe që ata vraponin natën. Ky është kuptimi më i qartë i ajetit. Por, bashkë me këtë ka prej atyre që e kanë interpretuar ndryshe ajetin:

77. Uahidi, Esbabun-nuzul, Demam 1991, s. 463.

Ikrime ka thënë se: **فَالْمُورِيَاتِ قَدْحًا** janë heshtat dhe armët. Po ashtu, mund të kuptohen edhe armët e ditëve të sotme që nxjerrin zjarr.

Në kohën kur ka zbritur ajeti, në periudhën mekase, nuk kishte as kuaj e as armë, mund të thuhet se këto ajete kanë të bëjnë me periudhën që do të vinte më pas. Ajeti, ashtu siç përfshin kuajt që nxjerrin xixëllima nga thundrat e tyre, përfshin edhe armët e ditëve moderne si tanku, avioni luftarak apo armët e tjera të zjarrit. Ashtu si në këtë sure, në Kuran gjenden shumë homonime edhe në sure të tjera.

فَالْمُغِيرَاتِ صُبْحًا

3. Dhe trokojnë për sulm në mëngjes

Garrat dhe **Egarrehu** në fjalor kanë kuptimin e sulmit e të bastisjes, pra, të shkosh me shpejtësi e të sulmosh, të plaçkitësh. Por, ajo që të vjen në mendje së pari janë kalorësit që sulmojnë armikun. Arsyeja që sulmi bëhej herët në mëngjes është që të përgatiteshin gjatë natës në mënyrë që armiku të mos kishte mundësi t'i shihte. Po ashtu, sulmi në mëngjes i lejonte që ta shihnin armikun e të mos gabonin në sulm, dhe në këtë mënyre sulmi ishte më i suksesshëm.

فَأَثَرْنَ بِهِ نَقْعًا

4. Duke çuar re pluhuri

Përmbledhja e ajeteve deri këtu është: Kuajt që vrapojnë me shpejtësi e hingëllojnë, nxjerrin xixëllima nga këmbët e tyre, sulmojnë në mëngjes dhe ngrijnë një re të madhe pluhuri. Kuajt që vrapojnë me shpejtësi drejt vendit të sulmit ngrijnë një re të madhe pluhuri.

نَقْع Nek', ka kuptimin leksikor të pluhurit, ujit të mbledhur diku, apo të bërtasësh e të vdesësh. Këtu është interpretuar si **gubar** pluhur, që ka kuptimin e pluhurit që ngrihet gjatë sulmit. Po ashtu, "**nek'un**" mund të ketë edhe kuptimin e klithmave që lëshohen gjatë sulmit, e djersëve dhe gjakut që derdhet gjatë zhvillimit të sulmit.

فَوَسَطْنَ بِهِ جَمْعًا

5. Ndërsa çajnë armikun në dysh

Duke e sulmuar ushtrinë e armikut në qendër, ose duke e rrethuar ushtrinë armike, e vendosin atë në qendër, e sulmojnë, dhe më pas e shkatërrojnë atë.

إِنَّ الإِنسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنُودٌ

6. Se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet

Njeriu është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij dhe nuk e falënderon Atë. Ose nuk i vlerëson mirësitë që i janë dhënë, nuk e kryen detyrën që ka karshi tyre, harron dhe vazhdimisht përmend të këqijat që ka kaluar dhe vetëm ankohet.

كَنُودٌ fjala **Kenud**, është "**anud**" në diatezën "**kefur**", pra përbuzës ndaj mirësive të Allahut (xh.sh.) dhe mosmirënjohës i madh. Mohues, mosmirënjohës dhe fyes. Në ajet, duke qenë se në shumicën e rasteve ekziston në natyrshmërinë njeriut, kanë thënë se ka kuptimin "**mohues i mirësive**".

وَإِنَّهُ عَلَى ذَٰلِكَ لَشَهِيدٌ

7. Dhe ai, pa dyshim, këtë e dëshmon

Rreth përemrit në ajet ka dy mendime: Ata që thonë se i përket fjalës "**Rab**", e kanë interpretuar kështu: "Allahu është dëshmitar i asaj, dëgjon dhe shikon". Ky është një paralajmërim për të hequr dorë prej të këqijave.

Por, duke qenë se bëhet fjalë për njeriun dhe se në ajetin tjetër përemri i përket njeriut, atëherë është më e përshtatshme që përemri të jetë për njeriun. Për rrjedhojë, shumica e dijetarëve kanë preferuar interpretimin: "Njeriu është vetë dëshmues i mosmirënjohjes". Pra, nuk ka nevojë për argument e fakt tjetër, njeriu e dëshmon vetë që është ashtu.

Për të theksuar rëndësinë e çështjes: Betohet në kuajt e luftëtarëve që vrapojnë në rrugë të Allahut (xh.sh.), që nxjerrin xixëllima me këmbët e tyre, që ngrenë pluhur dhe që e sulmojnë armikun në mëngjes, befasisht, duke ngjalluar frikë tek ai. Ajo që theksohet me këtë betim është mosmirënjohja, koprracia dhe dashuria e njeriut për pasuri.

وَإِنَّهُ لِحُبِّ الْخَيْرِ لَشَدِيدٌ

8. Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri

Fjala "**hajr**" që përmendet në ajet, ashtu si në ajetin **إِنْ تَرَكَ خَيْرًا** "**dhe ka pasuri për të lënë pas**"[78] edhe në shumë ajete të tjera ka kuptimin e "**pasurisë**", shumë pasuri, kapital, etj. Po ashtu, edhe në ajet është interpretuar në të shumtën e rasteve si pasuri.

شَدِيد Shedid është shpjeguar në dy variante me kuptimin koprrac ose i fortë. Pra, duke e cilësuar pasurinë dhe kapitalin si "**hajr**" të vërtetë, është shumë i pasionuar pas saj dhe tregohet koprrac. Ose, është shumë i dhënë pas pasurisë dhe përfitimeve të kësaj bote. Është i fortë në përfitimin dhe

[78]. Surja Bekare, 2:180

grumbullimin e pasurisë së kësaj bote. Në ajetin 20 të sures Fexhr shprehet ky kuptim: "dhe e doni pasurinë me një dëshirë të pakufishme.". Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue selem) ka thënë: "*Në qoftë se i biri i Ademit do të kishte një luginë me flori, do të dëshironte të kishte dy lugina. Mirëpo gojën e tij nuk e mbush asgjë tjetër përveç dheut. Allahu ia pranon pendesën atij njeriu që pendohet*".[79]

Allahu (xh.sh.) pasi ia radhit njeriut gjërat e papëlqyeshme dhe e qorton shprehet:

أَفَلا يَعْلَمُ إِذَا بُعْثِرَ مَا فِي الْقُبُورِ

9. Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre

أَفَلا يَعْلَمُ "**A nuk e di?**" ose "**E di dhe nuk dëshiron ta kuptojë?**" Një paralajmërim dhe kërcënim duke i kujtuar përfundimin. A mendon ai se, duke mos dëshmuar tani që është i pasionuar pas pasurisë së kësaj bote, tregohet koprrac e mosmirënjohës dhe është duke kryer një vepër të shëmtuar, nuk do të dënohet në botën tjetër dhe nuk do t'i pranojë veprat e këqija që ka punuar?! Ajo krismë e fuqishme, Dita e Kiametit do t'i nxjerrë gjithçka mbart toka në barkun e saj dhe;

وَحُصِّلَ مَا فِي الصُّدُورِ

10. Dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse

Kur të mblidhen ato që janë në gjokse dhe të dalë përfundimi. Pra, kur të dalin në shesh të gjitha të fshehtat që fshihen në zemra, qëllimet, synimet, dhe të jepet vendimi, padyshim mosmirënjohësit do ta kuptojnë se çfarë kanë vepruar në jetën e kësaj bote.

Ndërsa sipas Meududit: Vullneti i zemrës, synimet, qëllimet, idetë dhe mendimet, që i vënë në lëvizje punët e jashtme, të gjitha këto do të dalin në shesh e do të vlerësohen si të mira ose të këqija. E shprehur ndryshe, gjykimi nuk do të jepet vetëm për punët e jashtme. Për të marrë vendimin përfundimtar, do të merren parasysh edhe qëllimet e synimet që kanë pasur në këtë botë.

Midis këtyre dy ajeteve ka një përshtatje të përkryer. Ashtu si janë të fshehura gjërat në varr, ashtu janë të fshehura edhe mendimet në zemra. Pra, në Ahiret (jetën e pafundme) të gjitha të fshehtat do të dalin në shesh, do të dalin në shesh të fshehtat që janë në varre dhe të fshehtat që janë në zemra do të mblidhen e do të vlerësohen. Allahu (xh.sh.) do t'i njoftojë njerëzit për ato që kanë kryer në jetën e kësaj bote. Njerëzit, ato gjëra që kanë mbartur në nënvetëdije dhe i kanë harruar më pas, do t'i shohin të qarta para tyre.

[79]. Muslim, Zekat 116, 119; Tirmidhi, Menakib 32, 64; Musned, V, 131, 132, VI, 55.

إِنَّ رَبَّهُم بِهِمْ يَوْمَئِذٍ لَّخَبِيرٌ

11. Zoti i tyre, pa dyshim, atë Ditë di çdo gjë për ta?!

Zoti i mirësive, ndaj të cilit ata janë treguar mosmirënjohës, sigurisht e di se ç'kanë vepruar ata në këtë botë. Nuk është i painformuar as prej grimcës më të vogël, i di të fshehtat e të hapurat, ato që kanë ndodhur më para e më pas. Atë ditë njerëzve do tu tregohet se ç'kanë punuar. Edhe sikur ata të harrojnë, Ai (xh.sh.) di gjithçka.

Allahu i Lartësuar, e di qëllimin dhe synimin që gjendet në çdo punë të kryer dhe në sajë të saj do të japë dënimin ose shpërblimin. Por, nga fjalët e përdorura në ajet kuptohet se ky vendim nuk do jepet vetëm duke e ditur Allahu (xh.sh.). Allahu (xh.sh.) edhe pse i di që më parë qëllimet dhe synimet e njerëzve, Ditën e Kiametit këto të fshehta do t'i nxjerrë në shesh dhe do të vlerësohen me gjykim të hapur se cila është e mirë dhe cila është e keqe.

Veçimi i dijes së Allahut (xh.sh.) vetëm për Ditën e Kiametit, është për arsye se atë ditë do të shpërblehen punët. Allahu i Lartë, e ka thënë këtë për t'u tërhequr njerëzve vërejtjen, sepse Ai, atë ditë, i di të gjitha, po ashtu siç i di edhe çdo ditë tjetër.

SURJA KARIAH - 101

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الْقَارِعَةُ (1) مَا الْقَارِعَةُ (2) وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْقَارِعَةُ (3) يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ كَالْفَرَاشِ الْمَبْثُوثِ (4) وَتَكُونُ الْجِبَالُ كَالْعِهْنِ الْمَنفُوشِ (5) فَأَمَّا مَن ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ (6) فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَّاضِيَةٍ (7) وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ (8) فَأُمُّهُ هَاوِيَةٌ (9) وَمَا أَدْرَاكَ مَا هِيَهْ (10) نَارٌ حَامِيَةٌ (11)

Shqipërimi:

1. Gjëmimi i tmerrshëm!

2. Ç'është Gjëmimi i tmerrshëm?

3. Kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është Gjëmimi i tmerrshëm?

4. Atë Ditë njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara,

5. kurse malet si leshi i shprishur.

6. Sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit do të rëndojnë në peshore,

7. ai do të ketë një jetë të kënaqur (në Xhenet).

8. E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore,

9. Ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehenemit).

10. Kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Humnera (e Xhehenemit)?

11. Ajo është një Zjarr i vrullshëm.

Surja Kariah e zbritur në Meke, ka 11 ajete. Ajeti i parë i sures, që është një përshkrimin i Kiametit, është bërë edhe emër i saj. Nuk është vetëm emër i sures, por në të njëjtën kohë edhe tema kryesore e saj, sepse surja flet rreth Kiametit dhe gjendjes së tij të tmerrshme, rreth Ahiretit (jetës tjetër) dhe situatat e vështira që do të kalohen aty dhe rreth situatave të ngjarjeve të mëdha që do të ndodhin atë ditë.

TEFSIRI

الْقَارِعَةُ

1. Gjëmimi i tmerrshëm

Kariah, rrjedh prej fjalës **kare'a**, që ka kuptimin me e përplas aq fort sa të nxjerrë një zë të llahtarshëm, të trokasësh në derë, të dridhet zemra prej tmerrit. Kiameti, meqë e godet njeriun me gjendjen e tij të tmerrshme, është quajtur "**Kariah**". Në Kuran përmenden emra të Kiameti si: el-Kariah, el-Hakka, et-Tamme, es-Sahha dhe el-Gashije.

مَا الْقَارِعَةُ

2. Ç'është Gjëmimi i tmerrshëm?

مَا është përemër pyetës. Por, këtu nuk ka kuptimin e një pyetjeje të vërtetë, por, është për të frikësuar me kuptimin "Ç'krismë e tmerrshme është kariah".

وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْقَارِعَةُ

3. Kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është Gjëmimi i tmerrshëm?

Ose, ku e dije ti se ç'është krisma e Kiametit. Duke theksuar se askush nuk mund ta dijë me mendjen e tij tmerrin e asaj dite, qoftë ky edhe vetë Profeti, vetëm se me lajmërimin nga Allahu (xh.sh.). Kjo e përforcon dhe shton frikën për atë ditë. Përsëritja tre herë e fjalës "**kariah**" pa përdorur përemër, është për të treguar tmerrin e asaj dite. Atëherë kuptimi është: Ruajeni veten, sepse, **Kariah** ekziston!

Kariah është shumë e frikshme, aq sa nuk mund ta kuptoni madhësinë me mendjen tuaj pa e parë me sy.

يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ كَالْفَرَاشِ الْمَبْثُوثِ

4. Atë Ditë njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara

الْفَرَاشِ Ferrash është shumësi i **ferrasheh**. Fluturat, të cilat natën sillen rrotull dritës e zjarrit, përpëliten duke fluturuar dhe bien në zjarr. **Mebthuth**, ka kuptimin të shpërndara. Tregon gjendjen e tyre të shpërndarjes, përpëliten e përpëliten dhe shpërndahen, shtrihen e shtriqen.

Sipas disa interpretuesve të Kuranit, kjo gjendje do të ndodhë kur të ngrihen njerëzit nga varret të frikësuar. Kjo gjendje e tyre u ngjason fluturave, të cilat shpërndahen sa andej këndej, prej frikës së madhe dhe tmerrit përplasen me njëri-tjetrin, sepse shprehja e përdorur në Kuran "**flutura të shpërndara**", tregon se këto insekte të mjera sillen rrotull zjarrin, përpëliten e në fund përfundojnë në zjarr. Për rrjedhojë, kuptohet se, njerëzit atë ditë, prej tmerrit të saj, do t'i humbin ndjenjat e do të bien përtokë, do të jenë të hutuar e të sfilitur. Kjo tregon tmerrin e madh, që do të ngjallë në shpirt fryrja e parë e **Bririt** që do t'i thërrasë njerëzit para Gjykatës Supreme. Ata që e dëgjojnë trumbetën ftuese atë ditë, do t'i humbin ndjenjat e do të shtrihen përtokë, përveç një pakice. Kur ta dëgjojnë zërin e dytë zgjohen e rendin drejt vendit ku ndodhet Gjykata.

وَتَكُونُ الْجِبَالُ كَالْعِهْنِ الْمَنفُوشِ

5. Kurse malet si leshi i shprishur

Kur malet do të jenë kështu, imagjinojeni gjendjen e njerëzve se si mund të jetë.

الْعِهْنِ 'Ihn, lesh, veçanërisht ka kuptimin e leshit shumëngjyrësh. Ndërsa, **menfush**, ka kuptimin i shprishur, i shpërbërë, i bërë fije-fije me dorë ose i shpupuritur e i bërë grimca-grimca. Kjo sepse malet si fillim do të zvogëlohen e do të bëhen masa të frikshme pluhuri, më pas do të përhapen në re pluhuri "**si lesh shumëngjyrësh i hedhur**". E më pas formohet një mirazh mjegullor. Përngjasimi i maleve me leshin shumëngjyrësh është për arsye se, në dukje ngjan shumëngjyrësh. Disa pjesë duken të bardha, disa të zeza e disa të kuqe. Për rrjedhojë, malet e shprishur duken si lesh shumëngjyrësh.

Pra, deri këtu, flitet rreth etapës së parë të fillimit të një bote tjetër që nis me Kiametin, i cili i bën njerëzit të humbin ndjenjat e të bien përtokë, i shkatërron e malet dhe e bën tokën fushë. Pas këtij ajeti vjen etapa e dytë ku njerëzit ngrihen nga varret dhe dërgohen para Gjykatës Supreme. Veprat e kryera në këtë botë peshohen në peshoren e drejtësisë së Gjykatës Supreme. Atij që i rëndon peshorja e veprave të mira, pra veprat e mira i peshojnë më tepër se veprat e këqija, do të jetë i lumtur në Xhenet (parajsë). Ndërsa, **atij që ka peshojën e lehtë të veprave të tij,** do të jetë në Hauije. Vendi i tyre është gropa e Xhehenemit (ferrit).

فَأَمَّا مَن ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ

6. Sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit do të rëndojnë në peshore

Fjala **meuazin** është shumësi i fjalës peshore, mizan. **Mizan** është instrumenti që peshon rëndesën e gjërave, pra peshore. Po ashtu, përdoret me kuptim të figurshëm për matjen e gjërave metafizike që nuk janë të kufizuara nga rëndesa, si drejtësia dhe të drejtat. Dihet se, rëndimi i peshores është në përputhje me rëndesën e asaj që peshohet. Edhe pse në Ditën e Kiametit, për ekzistencën e së cilës nuk ka dyshim, edhe pse në atë ditë duhet të jetë një peshore që ka dy anë ku peshohet dhe dy gjuhë që tregojnë rëndesën e secilës anë, sipas së vërtetës së punëve, është larg mendjes sonë perceptimi i saktë i formës dhe madhësisë së kësaj peshoreje. Për këtë arsye, dijetarët kanë thënë se, është kusht besimi në ekzistencën e peshores por, nuk është kusht besimi në emërtimin e madhësisë së kësaj peshoreje. Në këtë situatë, mohimi i peshimit të veprave është kufr (mohim), ndërsa, mohomi i detajeve rreth madhësisë së peshores nuk të bën mohues.

Sipas disa dijetarëve, me peshoren në ajet kuptohet drejtësia absolute e Allahut (xh.sh.) në botën e përtejme (Ahiret), sepse njerëzit e simbolizojnë drejtësinë me peshoren. Siç dihet, në të shumtën e rasteve simboli i fakultetit të drejtësisë është peshorja. Drejtësia e gjykatësit, përngjasohet me pohoren që i ka të dyja anët e barabarta. Për rrjedhojë, të krahasosh situatat e jetës tjetër (Ahiretit) të shpjeguara në Kuran me gjërat që dimë ne, dhe kështu ta mendosh peshoren me peshoren e kësaj bote është e gabuar. Mizani (peshorja) që shprehet në ajete dhe hadithe[80] (Allahu e di më së miri) janë kuptime të figurshme që simbolizojnë drejtësinë e Allahut (xh.sh.).

Kështu që, atij që i rëndohet meuazini (peshorja), pra atij që ka më shumë vepra të mira:

فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَّاضِيَةٍ

7. Ai do të ketë një jetë të kënaqur (në Xhenet)

Ai tashmë është në një jetë të lumtur. Një jetë e lumtur dhe një jetë e kënaqshme. Pra, një jetë aq e lumtur, ku ai që ka kryer vepra të mira nuk mjaftohet vetëm me të qenët i lumtur por, siç thuhet në ajet: "O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!"[81] prej gradës së nefsit radije (shpirtit të kënaqur) duke u lartësuar në gradën e nefsit merrdije (shpirtit prej të cilit Allahu është i kënaqur), do të jetë i lumtur përgjithmonë s'do të dojë të largohet asnjë çast prej aty. Do të jetë i rrethuar me lumturi nga të gjitha anët dhe do të jetë i zhytur në lumturi të pafundme.

---

80. *Ka dy fjalë që i do Allahu, janë të lehta për t'u thënë, të rënda në peshore dhe ato janë:...* كلمتان خفيفتان على اللسان، ثقيلتان في الميزان، حبيبتان إلى الرحمن: سبحان الله وبحمده، سبحان الله العظيم Buhari, Ejmen 19, Da'auat 66, Teuhid 58; Muslim, Da'auat 31; Tirmidhi, Da'auat 59; Ibn Maxhe, Edeb 56; Musned, II, 232.

81. Surja Fexhr, 89:27-30

Në fakt, atyre që u peshon rëndë peshorja e veprave të mira, në përgjithësi edhe në jetën e kësaj bote jetojnë të lumtur, sepse duke i zbatuar me përpikëri urdhrat e Allahut (xh.sh.) dhe duke u larguar prej gjërave të ndaluara, jetojnë me ndërgjegje të pastër. Po ashtu, ruhen edhe prej shumë sëmundjeve trupore. Duke qenë se i besojnë botës tjetër (Ahiretit) dhe llogaridhënies, nuk frikëson nga vdekja dhe nuk i bëjnë keq askujt. Kësodore shpëtojnë prej dënimeve dhe poshtërimeve të kësaj bote.

Ndërsa, atyre që, peshojën e veprave të mira e kanë të lehtë, edhe pse duket sikur jetojnë një jetë të lumtur në këtë botë, në fakt ata nuk janë aspak të lumtur, sepse duke mos i besuar Allahut dhe botës tjetër nuk të janë të qetë shpirtërisht. Frika prej vdekjes dhe largimit nga kjo botë, frika e mospasjes, humbja dita ditës e të afërmeve që vdesin, fakti që edhe ata do të largohen nga kjo botë që e duan tej mase, ua bren shpirtin çdo ditë. Duke qenë se nuk i zbatojnë urdhrat dhe ndalesat e Allahut (xh.sh.), bien pre e shumë sëmundjeve shpirtërore e trupore. Kësodore e jetojnë ferrin që kur janë në këtë botë.

وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ

8. E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore

Pra, ata të cilët nuk kanë sevape (punë të mira), ose kanë më shumë mëkate do të jenë në:

فَأُمُّهُ هَاوِيَةٌ

9. Ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehenemit)

Pra, vendi ku do të shkojë, shtrati i tij, vendi ku do të strehohet është hauije. Nuk do të ketë vend ku të strehohet dhe do të hidhet në gropën e Xhehenemit, që quhet hauije. Me një shprehje tjetër, do të hidhet në fund të Xhehenemit dhe atje do të valojë. Meqenëse nëna është vend mbrojtjeje e strehimi për fëmijën e saj në çaste frike e tmerri, Allahu (xh.sh.) e ka përshkruar Xhehenemin si "**Ummuhu**" (nëna e atij) që do të hidhet aty. Ashtu si nëna i ruan dhe i mbron fëmijët e saj, zjarri i Xhehenemit do t'i strehojë ata; ashtu si nëna ia hap krahët fëmijës për ta përqafuar, edhe Xhehenemi do të hapë krahët për ta. Sipas disa dijetarëve "**Hauije**" është një prej emrave të Xhehenemit. Për arsye se është shumë e thellë, i është dhënë ky emër.

وَمَا أَدْرَاكَ مَا هِيَهْ

10. Kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Humnera (e Xhehenemit)? [82]

Pra, çfarë ta bëri të ditur ty se ç'ka është Hauije? Ku e di ti se ç'gjë e tmerrshme është ajo? Pyetja në ajet, tregon se sa e madhe dhe e frikshme është Hauije.

---

82. مَا Me, është pyetëse mohuese. هَاوِيَةٌ hauije është emër i gjinisë femërore (mueneth); shkronja në fund është ha-u shahid (ha dëshmuese). Origjinali është مَا هِي që do të thotë nga se është e përbërë, nga ç'përbëhet.

نَارٌ حَامِيَةٌ

11. Ajo është një Zjarr i vrullshëm

حَامِيَةٌ Hamije, rrjedh nga fjala "**hami**" që tregon gradën e lartë të nxehtësisë, zjarr shumë i fuqishëm dhe me nxehtësi shumë të lartë. Vetë fjala **نَارٌ** zjarr nënkupton nxehtësinë, por kur kësaj i shtohet edhe përshkrimi **hamije (shumë i nxehtë)**, tregon se sa i nxehtë do të jetë zjarri i Xhehenemit.

SURJA TEKATHUR - 102

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

أَلْهَاكُمُ التَّكَاثُرُ (1) حَتَّى زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ (2) كَلاَّ سَوْفَ تَعْلَمُونَ (3) ثُمَّ كَلاَّ سَوْفَ تَعْلَمُونَ (4) كَلاَّ لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ (5)

لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ (6) ثُمَّ لَتَرَوُنَّهَا عَيْنَ الْيَقِينِ (7) ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ (8)

Shqipërimi:

1. Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar,

2. derisa të shkoni në varre.

3. Gjithsesi, do ta merrni vesh!

4. Madje, së shpejti do ta merrni vesh!

5. Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!

6. Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues!

7. Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë.

8. Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!

E zbritur në Meke, ka 8 ajete. Surja e ka marrë emrin nga ajeti i parë, ku tregohet se përpjekja për të pasur sa shumë pasuri në këtë botë është e pakuptimtë dhe se veprimi në këtë mënyrë e privon njeriun nga arritja e vlerave dhe principeve të larta për të cilat është krijuar.

TEFSIRI

أَلْهَاكُمُ التَّكَاثُرُ

1. Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar [83]

Tekathur, ka kuptimin e përpjekjes për shumim, mburrjes dhe pretendimit. Mburrja mund të jetë me gjërat si në vijim: mburrje me fëmije, pasuri dhe post. Në ajet, nuk është përcaktuar se çfarë synohet me tekathur, dhe nuk është përcaktuar se kujt i drejtohet me **elhakumu (ju ka hutuar, ju preokupoi)**. Për rrjedhojë, kjo fjalë merr një kuptim shumë të gjerë ku futen: mjetet e qejfit e të argëtimit, shkaqet e fuqisë e të forcës, konkurrenca për të pasur sa më shumë pushtet e për ta ruajtur atë, si dhe mburrja me sukseset e arritura në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, edhe ata që përfshihen në fjalën **elhakum**, nuk janë të kufizuar. Mund të jenë njerëz a popull të çdo lloj epoke apo kohe.

Pra, shumimi i ka preokupuar aq shumë njerëzit, saqë ata janë privuar nga gjëra më të rëndësishme. Ata ishin aq të dhënë pas rritjes së standardeve të jetesës, saqë e kishin marrë parasysh degradimin e nivelit njerëzor. Pasioni për të fituar sa më shumë pasuri, nuk u bën përshtypje se në ç'mënyrë e fitojnë atë. Ata duan vetëm të fitojnë sa më shumë pasuri, kënaqësi trupore e më tepër mundësi. Ata rendin pas pasioneve të tyre pa e menduar përfundimin. Ata duan që të posedojnë fuqinë më të madhe dhe armët më të fuqishme. Shkurt, "**tekathur**" shumimi ka mënyra të pafundme që i tërheq njerëzit e popujt në vorbullën e tij. Tanimë, në botën e tyre nuk ka vend për gjë tjetër veç përfitimit material dhe kënaqësive të kësaj bote.

Shkaku i zbritjes:

Sipas interpretuesve të Kuranit, fisi i Abdu Menafit dhe fisi i Sehmit i krenoheshin njëri-tjetrit se cili ka më shumë fëmijë. Fëmijët e Abdu Menafit ishin më të shumtë. Pas kësaj fisi i Sehmit kishte kërkuar që të numëronin edhe të vdekurit e tyre. Pas numërimit, doli që fisi i Sehmit ishte më i shumtë në numër. Pas kësaj ngjarjeje zbriti surja Tekathur. Sipas disa transmetimeve kishin shkuar edhe në varreza.

Transmetohet që Abdullah b. Shihir të ketë thënë: Ndërkohë që Profeti (alejhi selam) po këndonte suren Tekathur shkova pranë Tij. Ai (s.a.s.) tha: "*Bijtë e Ademit thonë pa pushim 'pasuria ime! pasuria ime!'. O Bijtë e Ademit! A keni ju pasuri tjetër veç asaj që e hani dhe e mbaroni, apo asaj që vishni dhe e vjetroni, apo që e jepni sadaka dhe e vazhdoni?*"[84] Shprehja e Profetit (s.a.s.) në këtë formë pasi këndoi suren, tregon se mburrja me shumim është mburrja për pasurinë.

---

[83]. أَلْهَىَ fjala elha, rrjedh prej fjalës لهو (prej formës if'al). Duke qenë se origjinali i fjalës "Leh'uun" është hutim, ilha ka kuptimin të argëtohesh, të preokupohesh me gjëra të pavlera e, të privohesh nga ajo që duhet të bësh në të vërtetë.

[84]. Muslim, Zuhd 3, 4; Tirmidhi, Zuhd 31, Tefsiru Sure 102, 1; Nesai, Vesaja 1; Musned, II, 368, 412;

Disa interpretues, duke u bazuar në transmetimin e parë, kanë thënë se, mburrja me shumim ka si kuptim mburrjen me shumicë numrash; ndërsa, disa interpretues të tjerë, duke u bazuar në transmetimin e dytë, kanë thënë se, mburrja me shumim ka si kuptim mburrjen me pasuri.

حَتَّى زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ

2. Derisa të shkoni në varre

الْمَقَابِرَ Mekabir, shumësi i fjalës **makbere** me kuptimin varrezë.

Rreth ajetit "**derisa të shkoni në varre (të bëheni banues të tyre, të vdisni)**" ka tre interpretime të ndryshme:

I pari: Sipas transmetimeve rreth shkakut të zbritjes të përmendur më së pari: Juve ju preokupoi përpjekja për shumin aq shumë sa, ju privoi juve nga kryerja e veprave që të çojnë në bindjen ndaj Allahut (xh.sh.) dhe afrimin me Të. Për më tepër, ju u përpoqët aq shumë sa që filluat të mburreshit edhe me të vdekurit tuaj. Përkundrazi, njerëzit që vizitojnë varrezat, në vend që të mburren me të vdekurit e tyre, duhet që të nxjerrin mësim prej tyre e të zgjohen nga hutimi, të përgatiten për botën tjetër duke kryer vepra të mira dhe të ruhen prej zjarrit të Xhehenemit. Sipas transmetimit të parë, numërimi i të vdekurve dhe mburrja me të vdekurit është figurative.

I dyti: Shumimi, pra pasioni dhe dashuria për pasuri, fëmijë, e për këtë botë ju preokupoi juve aq shumë e ju zhyti në neglizhencë derisa shkuat si të vdekur në varreza. Ose, deri sa ju erdhi vdekja, deri sa ju doli shpirti e shpërdoruat jetën tuaj në dëfrim dhe pasion, e harxhuat jetën tuaj në të kotë pa bërë asgjë me vlerë për botën tjetër. E më në fund ndërruat jetë, vdiqët dhe jeni gati për t'u varrosur. O ju që gjendeni në një hutim të tillë! Ju nuk do ta shpëtoni dot veten tuaj, do të shkoni në Xhehenem. Kështu që, vizita në varreza tregon vdekjen.

I treti: Tirmidhiu, Ibn Xherir dhe Ibn Mundhir transmetojnë nga Aliu (r.a.) të ketë thënë: "Ne dyshonim rreth dënimit në botën e varrit, derisa zbriti surja Tekathur."[85]

Pra, **حَتَّى زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ** ka kuptimin "derisa të shijoni dënimin në varreza".

Ndërsa sipas Meududit: "Pra, ju e harxhoni jetën tuaj, duke e shtuar pasurinë e fëmijët dhe duke u mburrur për numrin e shumtë të njerëzve tuaj aq shumë sa, as në momentin e fundit të jetës suaj nuk shpëtoni dot nga kjo situatë."

Sipas mendimit të parë, është e papëlqyeshme që të vizitohen varrezat për t'u mburrur me numrin e të vdekurve. Por, nga kjo nuk duhet arritur në përfundimin se është e papëlqyeshme vizita e varrezave në tërësi, sepse vizita në varreza për të kujtuar të vdekurit me mëshirë dhe për të kujtuar jetën tjetër (Ahiretin) nuk është diçka e papëlqyeshme, përkundrazi është sunet. Ajo që qortohet

[85]. Tirmidhi, Tefsiru Sure 102, 2.

është vizita që të bën të harrosh jetën e pafundme (Ahiretin). Ndërsa, vizita që të kujton jetën tjetër (Ahiretin) është e pëlqyeshme. Profeti Muhamed (alejhi selam) e vizitonte varrezën Baki dhe thosh te:

السَّلامُ عَلَيكُمْ أَهْل الدِّيارِ مِنَ المُؤْمِنِينَ والمُسْلِمِينَ وَإِنَّا إِنْ شَاءَ اللَّهُ بِكُمْ لَاحِقُونَ ، أَسْأَلُ اللَّهَ لَنَا وَلَكُمُ العافِيَةَ

"*Paqja qoftë mbi ju, O banorët besimtarë dhe myslimanë të varrezave. Kur të dojë Allahu edhe ne do të bashkohemi me ju. E lus Allahun për mëshirë për vete dhe për ju.*"[86] Për më tepër ka thënë: "*Unë më parë jua pata ndaluar ju vizitën në varreza. Tanimë, mund t'i vizitoni varrezat, sepse kjo vizitë ju kujton juve jetën tjetër (Ahiretin).*"[87]

Në këto ajete qortohet konkurrimi i njerëzve me njëri-tjetrin për të shtuar pasurinë e fëmijët, dhe humbja e jetës së tyre vetëm më këtë angazhim. Ndërsa, në ajetet në vijim, tregohet se ata do ta shohin së shpejti se përgjegjësia e jetës tjetër (Ahiretit) është e vërtetë dhe atë ditë do të japin llogari për mirësitë që u janë dhënë.

كَلاَّ سَوْفَ تَعْلَمُونَ

3. Gjithsesi, do ta merrni vesh

Pra, ky është paralajmërim. O Njerëz! Nuk është ashtu, kini kujdes! Mos humbisni kohë duke u mburrur me shumim e shtim, mos harroni detyrën më të rëndësishme që keni në këtë botë fundi i së cilës është varri, mos u shastisni me gjëra kalimtare e pa vlerë, e vërteta nuk është ashtu siç mendoni ju. Do ta mësoni së shpejti. Kur të shikoni përfundimin, do ta mësoni se në ç'hutim keni qenë dhe se sa fund të keq do të ketë gjendja në të cilën ndodheni.

ثُمَّ كَلاَّ سَوْفَ تَعْلَمُونَ

4. Madje, së shpejti do ta merrni vesh

Ky është paralajmërimi i dytë pas të parit. Qëllimi është që të tërheqë më shumë vëmendjen. Pra, kur t'ju vijë juve vdekja dhe të shihni vuajtjet e dhimbjet e saj, do të shihni dënimin e mburrjes me pasuri e fëmijë. Ibn Abasi (r.a.) thotë: **كَلاَّ سَوْفَ تَعْلَمُونَ** ka për qëllim "Do ta shihni dënimin që do t'ju vijë në varr", ndërsa **ثُمَّ كَلاَّ سَوْفَ تَعْلَمُونَ** ka për qëllim "Do ta shihni dënimin që t'ju vijë në jetën tjetër (ahiret)".

كَلاَّ لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ

5. Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri

86. Muslim, Xhenaiz 103-104; Ebu Daud, Xhenaiz 79; Nesai, Xhenaiz 103; Ibn Maxhe, Xhenaiz 36; Zuhd 36; Musned, II, 300, 375, 408.

87. Ibn Maxhe, Xhenaiz 47; Muslim, Xhenaiz 106; Ebu Daud, Xhenaiz 77.

Jekin, ka kuptimin e dijes pa lënë asnjë gjurmë dyshimi. Sipas disa interpretuesve të Kuranit, **el-jekin** ka kuptimin vdekje, pra të dish vdekjen, të dish rreth vdekjes, sikur ta dinit dënimin që ju pret në fund. Sipas këtij kuptimi, dija e njerëzve rreth vdekjes është në tre nivele:

1. Çdo njeri me mend, duke hetuar vdekjen e të tjerëve dhe duke bërë një krahasim të thjeshtë e kupton qartë se edhe ai do vdesë një ditë. Kjo është **ilmul-jekin, dije e padyshimtë.**

2. Kur i afrohet vdekjes, shikon engjëjt me sy të lirë dhe e kupton se do të vdesë. Edhe kjo është **ilmul-jekin, dije e padyshimtë.**

3. E kupton në çastin që vdes, e kjo quhet **hakkul-jekin, dije e vërtetë.**

Të gjithë interpretuesit janë të një mendjeje se, përgjigja e fjalës "**leu**" në ajet është fshirë. "Mashtroheni, sikur ta dinit ju me dije të sigurt...", përgjigja këtu është fshirë për ta bërë situatën më drithëruese. Për rrjedhojë, bashkëbiseduesi e imagjinon vetë dënimin më të madh. Vetëm se, interpretuesit i kanë dhënë disa përgjigje:

1. Nëse atë që do të vijë, do ta dinit me dije të sigurt, nuk do të vepronit ashtu, juve nuk do t'iu privonte shumimi i pasurisë.

2. Nëse do ta dinit çka ju pret përpara, çfarë nuk do të bënit. Pra, do të punonit aq shumë saqë është i pamundur përshkrimi i mundit që do të harxhonit. Por e dini, me mburrje e të painformuar shkoni në drejtim të gabuar, harxhoni kohë duke u mburrur me fitim e shumim.

Shumë mendojnë se kur thuhet dije, me atë kuptohen qëllime dhe synime të ulëta. E cilësojnë dhunti përdorimin e dijes për qëllime dhe synime të ulëta, po ashtu e cilësojnë edhe mburrjen me fjalë dhe shumim. Por kur e hulumton më gjerë, në këtë ajet ekziston një kërcënim shumë i madh për dijetarët, sepse ky ajet tregon se, sikur ta dinin ata që mburren me shumim e fitim, do të hiqnin dorë prej saj. Pra, do të thotë se, ata që mburren me shtim e fitim dhe nuk heqin dorë prej mburrjes, nuk e kanë përfituar dijen e vërtetë. Atëherë, mjerë ata, të cilët nuk e kuptojnë të vërtetën e dijes dhe e përdorin atë për keq, nuk e besojnë atë që dinë, nuk veprojnë ashtu si i shkon për shtat dijes së tyre dhe së bashku me këtë mbajnë titullin dijetar.

Kushti i parë dhe më i rëndësishmi i dijes është edhe qenia e saj stimuluesja më e madhe e veprave të mira. Nëse dija kihet parasysh gjatë kryerjes së punës, ajo bëhet shtysë, këshillues dhe udhërrëfyes për punën. Nëse dija merret parasysh pas kryerjes së punës, atëherë kthehet në pendim dhe trishtim. Trishtimi mund të ilustrohet me një shembull të tillë:

Një grup udhëtarësh po kalonte në një vend të errët. Gjatë ecjes në errësirë i kishin munduar disa gurë nëpër këmbë. Shumë prej tyre mendonin vetëm të kalonin sa më parë që të shpëtonin prej mundimit të gurëve. Ndërsa, një pjesë tjetër kishte marrë gurë në xhepat e në çantat e tyre. Kur dalin prej errësirës, shohin se ata gurë kishin qenë gurë të çmuar. Në atë moment, të dy grupet ishin trishtuar e penduar. Ata që kishin marrë gurë thanë: "Ah sikur të kishim marrë edhe më shumë." Ndërsa, at që nuk kishin marrë fare thanë: "Ah sikur të kishim marrë edhe ne gurë."

Kështu do të jetë edhe situata e njerëzve ditën e Kiametit. Ata që kanë punuar do të mërziten: "Pse nuk punuam më tepër?", ndërsa ata që nuk kanë punuar do të thonë: "Pse nuk punuam edhe ne?" Për këtë arsye, të rinjtë duhet të punojnë për të ndriçuar errësirën e jetës dhe të vdekjes me dije të padyshimtë, ata që kanë dije duhet të punojnë me sa kanë mundësi për gjërat që do t'u bëjnë dobi në jetën tjetër. Nuk duhet të përpiqen për të fituar pasuri që do të mbesë në këtë botë, dhe nuk duhet të rendin pas kënaqësive të kësaj bote. Të gjitha fitimet duhet t'i shpenzojnë në rrugë të drejtë dhe për të fituar jetën tjetër, sepse, kjo botë nuk është vend dëfrimi, por, është vend përgatitjeje për jetën tjetër (Ahiretin). Pa dyshim që, urën e Siratit në jetën tjetër do ta kalojnë vetëm ata që janë të përgatitur.

لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ

6. Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues

Xhehenemi, i cili në suren paraardhëse u përmend si "**hauije**" **(gropë)**, zjarr i nxehtë narun-hamije.

ثُمَّ لَتَرَوُنَّهَا عَيْنَ الْيَقِينِ

7. Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë

Në këto ajete pasi flitet me fjali të përsëritura se kjo botë nuk ka asnjë dobi, më pas flitet me fjali të përsëritura rreth dënimit në jetën tjetër (Ahiret).

ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ

8. Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)

Naim, përfshin çdo mirësi që me të marrim kënaqësi. Këtu futet jeta, shëndeti, apo qoftë edhe një gllënjkë ujë i ftohtë.

Fjala **thumme (pastaj)** në ajet nuk ka kuptimin pasi të futen në Xhehenem do të pyeten për mirësitë. Kuptimi i vërtetë është "Më pas po ju njoftojmë ju që, ju do të pyeteni për mirësitë që ju janë dhënë". Kuptohet se kjo pyetje do të bëhet kur të zbatohet drejtësia hyjnore. Transmetohet se i Dërguari i Allahut (s.a.s.) kur hante dhe pinte me shokët e tij thoshte:

"*Falënderimet i takojnë Allahut që na ushqeu, na dha për të pirë dhe na bëri myslimanë*".

Interpretuesit e Kuranit kanë thënë se ajeti i fundit i sures i drejtohet të gjithëve, qofshin këta mosbesimtarë, besimtarë, gjynahqarë, apo të devotshëm dhe përfshin të gjitha llojet e mirësive. Dhe nuk ka dyshim se, sa më të mëdha të jenë mirësitë, po aq e madhe dhe e rëndë është edhe përgjegjësia.

Në transmetimin e Ibn Hibanit dhe Ibn Merdudit nga Ibn Abasi (r.a.) thuhet: "Profeti (s.a.s.) dhe dy shokët e tij shkojnë për vizitë te shtëpia e Ebu Ejub Ensarit (r.a.), gruaja e shtëpisë u thotë: Paqja qoftë me Ty dhe me ata që janë pranë Teje, O i Dërguari i Allahut! Në atë çast vjen Ebu Ejubi (r.a.) dhe pret një vesh hurmë. Profeti (s.a.s.) i thotë: Pse e preve këtë për ne, sikur t'i kishe mbledhur nga pema! Ebu Ejubi: O i Dërguari Allahut, dëshirova që ju të hani nga hurmat e pjekura mirë dhe nga ato të papjekurat mirë. Pastaj theri një kec, gjysmën e tij e poqi e gjysmën tjetër e ziu. Kur e solli pranë Profetit (s.a.s.), Ai mori pak nga mishi dhe e vendosi në një petë, pastaj tha: O Eba Ejub! Dërgoja këtë Fatimes, se ajo ka ditë që nuk e ka provuar diçka të tillë. Pasi hëngrën, Profeti (s.a.s.) tha: Bukë, mish, hurma, hurma të pjekura, e hurma të papjekura, dhe nga sytë e bekuar i rrodhën lot. Betohem për Allahun që e ka në dorë shpirtin tim, këto janë mirësitë që do të pyeteni. Allahu i Lartë thotë **ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ** "**Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)**. Pra, këto janë mirësitë që do të pyeteni ditën e kiametit. Shokëve të Tij iu duk pak e rëndë kjo situatë. Më pas Profeti (s.a.s.) urdhëroi e tha: **الحمد لله الذي أشبعنا و أنعم علينا و أفضل** Kur të rastisni diçka të tillë e ta prekni me dorë thoni 'Me emrin e Allahut', dhe kur të ngopeni thoni 'Falënderimi i takon Allahut që na ngopi, na dhuroi mirësi e bereqet' sepse, kjo mjafton për të."[88]

SURJA ASR - 103

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

وَالْعَصْرِ (1) إِنَّ الإِنسَانَ لَفِي خُسْرٍ (2) إِلاَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ (3)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahu, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Për kohën!

2. Me të vërtetë, njeriu është në humbje,

3. përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.

Surja Asr e zbritur në Meke ka tre ajete.

Kjo sure fisnike bashkë me qenien e saj të thjeshtë e të shkurtër, përmbledh në kuptimin e saj të gjitha këshillat e sureve të mëparshme. Në sure theksohet se, të gjithë njerëzit janë në humbje përveç atyre që besuan e bënë vepra të mira, e porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen së vërtetës dhe e këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm. Transmetohet se, Imam Shafi'u ka thënë: "Nëse nuk do

88. Sujuti, ed-Durrul-Menthur, 8/615.

të kishte zbritur asnjë sure tjetër përveç kësaj sureje shumë të shkurtër, kjo sure do të mjaftonte për të siguruar lumturinë e njerëzve në këtë botë e në Ahiret (jetën tjetër). Kjo sure i përmbledh të gjitha mësimet e Kuranit".

TEFSIRI

وَالْعَصْرِ

1. Për kohën

Fjala "**asr**" ka kuptimin leksikor të kohës, kohës në të cilën jetojmë ose shekull. Interpretuesit e Kuranit më tepër janë përqendruar mbi këto kuptime: Namazi i ikindisë, koha e ikindisë, periudhë kohore ose shekull, shekulli i Muhamedit alejhi selam, pra, koha në të cilën u dërgua Profeti Muhamed (s.a.s.), si dhe koha e fundit (ahiruz-zeman).

Ibn Xherir pasi përmend transmetimet rreth kohës, që është një orë në kohën e drekës apo kuptimet rreth ikindisë thotë: Mendimi i drejtë në këtë çështje është ky: Allahu i Lartë betohet për "**asrin**" **kohën**. **Asr** është emri i kohës, i ikindisë, i ditës dhe i natës. Allahu (xh.sh.) nuk e ka treguar qartë se për cilat nga kuptimet që përmban fjala "**asr**" është betuar. Për rrjedhojë, çdo kuptim që mund të përmbajë kjo fjalë përfshihet në betim.

Allahu i Lartë ashtu siç është betuar për "**duhan**" **paraditen**, është betuar edhe për "**asrin**" **ikindinë**. **Duha** është fillimi i ditës, ndërsa **asr** ndodhet në pjesën e fundit të ditës. Kjo na tregon se, jeta e njerëzimit është drejt fundit të saj, sepse ashtu siç shprehet në suren Kasas "**Pasi i shkatërruam breznitë e mëparshme, Ne i dhamë Musait Librin**"[89], jeta njerëzore në Kuran është e ndarë në tre faza:

1. Periudha kohore para zbritjes së Teuratit Musait (a.s.), pra periudha që mbyllet me shkatërrimin e Faraonit, "shekujt e hershëm".

2. Periudha kohore që fillon me zbritjen e Teuratit deri në kohën e Profetit të fundit (s.a.s.), "shekujt e mesëm".

3. Dhe shekujt e fundit që fillojnë me ardhjen e Profetit Muhamed (alejhi selam) quhen "ahiruz-zeman". Kur themi "**asr**" kuptohet se kemi të bëjmë me shekullin e Profetit Muhamed (s.a.s.) dhe umetit të tij.

Përfundimi i diskutimeve të interpretuesve të Kuranit është si në vijim:

O Muhamed (s.a.s.)! Pasha **kohën (asr)** me të gjitha kuptimet e saj dhe veçanërisht periudhën kohore që është përmbledhje e të gjithë kohës së kaluar me të gjitha ngjarjet e saj të mëdha, shekullin

[89]. Surja Kasas, 28:43

e fundit që është ikindia e gjithë historisë, pra, pasha "ahiruz-zemanin" kohën e fundit që është periudha jote;

إِنَّ الإِنسَانَ لَفِي خُسْرٍ

2. Me të vërtetë, njeriu është në humbje

Pra të gjithë njerëzit, i gjithë njerëzimi, të gjithë popujt, në çdo shekull dhe veçanërisht në periudhën e fundit të historisë njerëzore janë në humbje, përveç atyre që do të përmenden në ajetin në vijim.[90] Kjo për arsye se kapitali i njeriut është jeta e tij, ndërsa ai në çdo frymëmarrje, në çdo orë që kalon shpenzon kapitalin e tij duke u afruar më shumë drejt fundit të mirësisë, si dhe kohës për dhënien e llogarisë. Nëse frymëmarrja do të ishte pronë e njeriut që mund ta shpenzojë si të dojë e kur të dojë, nëse do të ishte diçka që e ka shpikur ai vetë, jeta nuk do të kishte fund dhe njeriu nuk do të kishte asnjë dëm në shpenzimin e saj si të dëshirojë. Por, ajo është pronë e Allahut (xh.sh.) që i është dhënë njeriut si amanet që ta përdorë në formën më të bukur ashtu siç e kërkon Krijuesi. I gjithë përfitimi i njeriut është i lidhur me fitimin që do të ketë në fund nga shpenzimi dhe marrëveshja e kryer në këtë drejtim.

إِلاَّ الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ

3. Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin

Ata që posedojnë këto katër cilësi nuk janë në humbje, por janë në fitim:

1. آمَنُوا Ata që besojnë. Ata që i besojnë Zotit të botëve, gjykuesit të Ditës së Gjykimit, njëshmërisë së Tij dhe i besojnë librave që ka zbritur Allahu. I kanë dhënë fjalën Atij që do ta adhurojnë dhe do t'i binden Atij me sinqeritet.

2. وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ Dhe ata që bëjnë vepra të mira. Pra, besimi i tyre nuk mbeti vetëm në zemrat dhe gjuhët e tyre, por u reflektua edhe në punët e tyre. Punët i kryejnë në përshtatje me besimin e tyre, i kryejnë për kënaqësinë e Allahut (xh.sh.) në përshtatje me urdhrat e zbritura nga Ai, kanë punuar vetëm për mirë, kanë kryer vetëm vepra të dobishme për familjen, të afërmit, popullin e tyre e për gjithë njerëzimin. Kanë kryer punët për të cilat janë urdhëruar dhe kanë qëndruar larg gjërave të ndaluar.

Sipas Kuranit çdo punë e mirë që nuk e ka bazën në besim, nuk quhet punë e mirë. Për këtë arsye, në Kuran, kudo që është përmendur puna e mirë është përmendur edhe besimi, vepra e mirë është përmendur gjithmonë pas besimit. Në asnjë vend të Kuranit nuk është përmendur puna pa besim. Po ashtu, në asnjë vend nuk i është dhënë shpresë shpërblimit të punës së mirë pa besim. Nga ana

---

90. **خُسْر** Husr, husran; është si kufr dhe kufran, pra, në vend që të fitonte humbet, humbet kapitalin, bie në pesimizëm nga falimentimi. "**Tenuini**" në fund të fjalës **husr** është për të treguar madhështinë e humbje, se sa humbje e madhe është.

tjetër, është thënë se besimi i dobishëm dhe me vlerë është besimi i vërtetuar me punë, sepse besimtari pa punë të mira, edhe pse pretendon se beson, ndjek rrugë tjetër veç asaj që ka treguar Allahu (xh.sh.) dhe i Dërguari i Tij (s.a.s.).

Puna e mira është dy llojesh:

E para: Adhurimet që kanë të bëjnë me trupin, që kanë dobi posaçërisht për vetë mukelefin (personin përgjegjës).

E dyta: Punët prej të cilave përfitojnë edhe të tjerët si zekati dhe lëmosha. Më e rëndësishmja e këtyre është përpjekja dhe mundi i harxhuar për t'i ftuar njerëzit në rrugë të drejtë. Për këtë arsye, veç forcimit të imanit me punë të dobishme, përpjekja për të shpëtuar të tjerët, ftesa për tek i Vërteti, këshillimi i njëri-tjetrit për punë të mira, veçanërisht theksohet në vazhdim të ajetit:

3. وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ "**I këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën**".

Pra, e gjithë përpjekja e tyre drejtohet nga i Vërteti; besimin, punët, fjalët, të gjitha i shpenzojnë për të Vërtetin. I këshillojnë njëri-tjetrit të Vërtetin, në çdo punë përpiqen të bëjnë më të drejtën, takohen së bashku për hir të Allahut (xh.sh.), pra, urdhërojnë për mirë (emru bi'l-ma'ruf) dhe ndalojnë të keqen (nehju ani'l munker). Shkurtimisht, këshillojnë që çdo lëvizje të jetë e drejtë dhe për të arritur kënaqësinë e Allahut (xh.sh.), besimin, punët dhe të gjitha gjërat i kryejnë vetëm për Allahun (xh.sh.).

Dy cilësitë e përmendura më sipër duhet që t'i posedojë çdo person. Por, për të shpëtuar nga humbja ka edhe dy cilësi të tjera. Këto dy cilësi, pas besimit dhe kryerjes së veprave të mira, janë porositja njëri-tjetrin t'i përmbahen së vërtetës dhe këshillimi i njëri-tjetrin që të jenë të durueshëm. Kuptimi i kësaj, së pari është që, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, kur e kryejnë këtë personalisht nuk duhet të mjaftohen me kaq, në të njëjtën kohë duhet të përpiqen të formojnë një shoqëri besimtare dhe të drejtë. E dyta, që kjo shoqëri të ruhet nga shthurja çdo person duhet ta dijë përgjegjësinë që i takon. Për këtë arsye, çdonjëri duhet t'i këshillojë njëri-tjetrit të drejtën dhe durimin.

Fjala "**hak**" e vërteta është e kundërta e fjalës "**batil**" e shtrembra. Zakonisht përdoret me këto dy kuptime: E para, fjalë e përshtatshme me drejtësinë dhe të vërtetën. E dyta, e vërteta që duhet sjellë në vend. Kuptimi i këshillimit të së vërtetës, në një popull që përbëhet nga besimtarët, është të jesh aq i ndjeshëm sa të mos qëndrosh vetëm vrojtues në një situatë kur e shtrembra shtrihet më shumë se e drejta. Çdo person në shoqëri nuk duhet të mjaftohet vetëm me të vërtetën dhe të drejtën e tij. Në të njëjtën kohë ai duhet t'ia këshillojë këtë edhe të tjerëve. Vetëm kështu është e mundur që një shoqëri të ruhet nga shtrembërimi e shkatërrimi. Nëse në shoqëri nuk ekziston një frymë e tillë, shoqëria nuk mund të shpëtojë nga humbja. Ata që janë të drejtë e të vërtetë për veten e tyre, nëse nuk përpiqen që shoqëria të mos shkatërrohet, nuk mund të vazhdojnë të jenë të drejtë dhe nuk mund të shpëtojnë nga humbja. Për këtë arsye, Beni Israil (pasardhësit e Jakubit a.s) u mallkuan me gjuhën e Davudit (a.s) dhe Isait (a.s), surja Maide, 78-79. Po ashtu, në suren Araf flitet për shkeljen e

ndalesës së ditës së shtunë që Beni Israilët të mos gjuanin peshk, për këtë arsye zbriti dënimi prej të cilit shpëtuan vetëm ata që përpiqeshin të ftonin në rrugë të drejtë.

4. وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ "**E i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.**". Pra, e kanë këshilluar njëri- tjetrin që të jenë të durueshëm e të qëndrueshëm në rrugën e drejtë.

Bashkë me këshillimin në rrugë të drejtë, duhet edhe këshillimi për të qenë i durueshëm në këtë rrugë që të shpëtojnë besimtarët dhe të gjithë anëtarët e shoqërisë. Pra, duhet t'i këshillojnë durimin njëri-tjetrit përballë çdo vështirësie që mund të përballen në këtë rrugë, përballë fatkeqësive dhe dëmeve të ndryshme.

Pa e mohuar ndikimin e karakterit të lindur në gradën e durimit, së bashku me të, një rol të rëndësishëm luajnë edhe edukimi, praktika dhe besimi. Kështu që, durimi bën pjesë mes punëve që janë urdhëruar personat përgjegjës "ef'alul mukel'lefin": "**O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!**"[91], sepse "**Allahu është me të duruarit**"[92]dhe "**vetëm ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë!**"[93] Në një hadith thuhet: "*Durimi është çelësi i shpëtimit.*"[94]
Ajo çka shprehet në ajete dhe hadithe, durimi i cili lavdërohet dhe këshillohet është durimi që tregohet në rrugën e drejtë me besim dhe punë të mira, i cili është simbol i trimërisë, drejtësisë dhe heroizmit. Përndryshe, durim nuk do të thotë që të durosh përballë çdo ligësie, të zhytesh në baltovinën e mjerimit e të mos përpiqesh të dalësh prej saj, nuk ka kuptim të zhytesh në të keqe dhe të jesh i kënaqur me të keqen, e as të jesh i pandjeshëm ndaj çdo lloj poshtërsie dhe mjerimi, sepse të tregosh një grimcë kënaqësi ndaj të keqes, është sikur të shprehësh kënaqësi ndaj mohimit.

Pra, këto katër grupe, ata që besojnë e bëjnë vepra të mira, që i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e durimin nuk do jenë në humbje, do jenë të fituar. Të katërta këto janë tregues të besimit të plotë tek Allahu (xh.sh.). Është e qartë se ata që nuk besojnë nuk do të shpëtojnë. Ndërsa, ky ajet na tregon se, bashkë me besimin, ata që kryejnë vepra të mira dhe i këshillojnë njëri-tjetrit të drejtën dhe durimin, do të veçohen prej disa humbjesh. Kjo tregon se, mendimi i rrymës Merxhie, i cili pretendon se besimi pa vepra është i mjaftueshëm, nuk është i saktë. Mendimi i saktë është ai i Ehli Sunetit, i cili thotë se besimi pa vepra të mira sjell me vete humbje të mëdha, sepse edhe besimtarët gjynahqarë do të shkojnë në Xhehenem për një kohë të caktuar. Besimi, edhe pse do t'i shpëtojë ata në fund, besimtarët që do t'i kenë gjynahet më të shumta se sevapet (të mirat) do të shkojnë në Xhehenem derisa të pastrohen prej gjynaheve. Allahu na ruajt prej dënimit të zjarrit.

SURJA HUMEZE - 104

91. Surja Al 'Imran, 3:200
92. Surja Bekare, 2:153
93. Surja Zumer, 39:10
94. Dejlemi, Firdeus, III, 415; Keshful Hafa, I, 27 (1590).

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

وَيْلٌ لِّكُلِّ هُمَزَةٍ لُّمَزَةٍ (1) الَّذِي جَمَعَ مَالا وَعَدَّدَهُ (2) يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ (3) كَلاَّ لَيُنبَذَنَّ فِي الْحُطَمَةِ (4) وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ (5)

نَارُ اللَّهِ الْمُوقَدَةُ (6) الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الأَفْئِدَةِ (7) إِنَّهَا عَلَيْهِم مُّؤْصَدَةٌ (8) فِي عَمَدٍ مُّمَدَّدَةٍ (9)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Mjerë për çdo përqeshës - shpifës,

2. që grumbullon pasuri dhe e ruan,

3. duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm!

4. Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese.

5. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese?

6. Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort,

7. i cili depërton deri në zemrën e njeriut.

8. Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë,

9. në shtylla të gjata flakëruese.

Surja Humeze e zbritur në Meke, ka 9 ajete. Emrin e ka marrë nga ajeti i parë. Në këtë sure përshkruhet sjellja e neveritshme e atyre që përgojojnë njerëzit, tallen me ta dhe i fyejnë, duke bërë shenja me sy e vetull. Po ashtu, përshkruhet Xhehenemi (ferri) i tmerrshëm që i pret këta njerëz në botën tjetër.

TEFSIRI

وَيْلٌ لِّكُلِّ هُمَزَةٍ لُّمَزَةٍ

1. Mjerë për çdo përqeshës - shpifës

Mjerë ata, përgojuesit, të cilët e kanë bërë ves që të tallen e ofendojnë të tjerët, qoftë me duar apo me gojë, sepse janë të dënuar të vuajnë në humnerën e Xhehenemit, në luginën e mjerimit dhe të shkatërrohen nga dëshpërimi.

Edhe "Lumezeh" është e njëjtë si "Humezeh". Vjen nga fjala "Lemz", që ka kuptimin e fyerjes pas shpine sikur ngul ndonjë shtizë, apo të turpërosh dikë duke bërë me shenja apo me sy, t'ia tregosh një person tjetrit në mënyrë tallëse e nënçmuese. Po ashtu, edhe "Humeze" ka kuptimin e atij që e ka bërë ves të argëtohet duke i veshur të tjerëve mangësi dhe që i turpëron vazhdimisht të gjithë. Përdoret me të njëjtin kuptim me "lumeze" dhe me kuptim të ndryshëm.

Sipas Ebu Ebejdes, humeze dhe lumeze kanë të njëjtin kuptim, përgojues.

Shkaku i zbritjes

Sipas transmetimit të Ibn Abbasit: Shkaku i zbritjes së kësaj sureje është një person që adhuronte statujat, dhe që tallej e i injoronte njerëzit.[95]

Por siç thonë edhe komentuesit e tjerë të Kuranit, kuptimi i këtij ajeti nuk është vetëm për këtë person, por për të gjithë ata që sillen në këtë formë. Kështu, ajeti ka vendosur principin e mos nënvlerësimit dhe mos turpërimit të të tjerëve, që është baza e respektimit të të drejtave të njeriut.

Fenomeni që i shtyn njerëzit të prishin marrëdhëniet mes tyre dhe të turpërojnë të tjerët është ky;

الَّذِي جَمَعَ مَالا وَعَدَّدَهُ

2. Që grumbullon pasuri dhe e ruan

Ka mbledhur pasuri dhe merret vazhdimisht me numërimin e saj. Gjithë preokupimi i tij është numërimi e shtimi i pasurisë, dhe beson vetëm në të. Numërimi i pasurisë tregon sa dorështrënguar është ai, si dhe një person që adhuron materialen. Ose njerëzit përreth duhet të shohin vetëm atë e të ndihen krenar me të, dhe kështu bën që grupi i humeze-lumeze që i kanë sytë vetëm nga pasuria e që merren vetëm me ngatërrimin e njerëzve, të mblidhen rreth tij, dhe kështu, ai të bëhet i njohur mes tyre dhe të jetë udhëheqësi i tyre. Këta persona përse sillen në këtë mënyrë? Arsyeja pse sillen kështu është se:

يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ

3. Duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm

Të gjitha shpresat e tij janë të lidhura me idenë se, pasuria e tij do ta bëjë atë të përjetshëm.

Si përmbledhje, në këto ajete qortohen rëndë atë njerëz që ofendojnë e tallen me të tjerët, përzihen në punët e çdokujt, çdo pune i gjejnë një bisht, grumbullojnë pasuri e vazhdimisht merren me numërimin e saj, pra përpiqen mos ta pakësojnë por vetëm ta shtojnë, e sa më tepër ta shtojnë akoma më shumë iu shtohet oreksi për më tepër, dhe që nuk shpenzojnë asnjë qindarkë në rrugë të drejtë.

[95]. Taberi, XV, 293.

Ajeti në vijim, na informon se pasuria nuk do ta bëjë atë njeri të përjetshëm, por herët a vonë ai do të vdesë e do të hidhet në Hutame:

كَلاَّ لَيُنبَذَنَّ فِي الْحُطَمَةِ

4. Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese

Jo, situata nuk është ashtu si mendon ai. Ajo që do ta shpëtojë njeriun dhe do ta dërgojë në përjetësi nuk është pasuria, por ashtu si u përmend në suren paraardhëse janë besimi në Allah, dija dhe veprat e mira ato që të shpëtojnë.

Pra, betohem për Allahun se, ata që i besojnë pasurisë e merren me numërimin e saj, i ofendojnë njerëzit duke u tallur me ta, luajnë me të drejtat dhe nderin e të gjithëve, ata, përgojuesit (humeze dhe lumeze), mburravecët do të flaken në mënyre poshtëruese dhe të mjerë (në gropën e Xhehenemit). Kjo për arsye se fjala "nebedh" në arabisht ka kuptimin e flakjes, hedhjes së diçkaje, duke e nënvlerësuar dhe poshtëruar.[96] Ai që e shikon veten si të madh në këtë botë për shkak të pasurisë së tij, Ditën e Gjykimit do të hidhet në Xhehenem i poshtëruar. "**Patjetër do të hidhet në Hutame**", pra në Xhehenem.

الْحُطَمَة "**Hutame**", e ka prejardhjen nga fjala "**hatm**" që do të thotë ta thyesh dhe ta kalosh. Pra, Hutame ka një veti thyese, pra me kuptimin thyes e kalues. Natyra e zjarrit të ndezur fort është që të thyejë e të shkatërrojë çka i del përpara e të kalojë, me një shprehje tjetër t'i përpijë e t'i gllabërojë. Me këtë kuptim i është thënë Xhehenemit hutame, zjarr që përpin çka t'i dalë përpara ose i thyen e i kalon. Këtu ka dhe një nuancë tjetër që, Xhehenemit t'i thuhet hutame. Diatiza (uezn) e fjalës Hutame është e përshtatshme me diatizën e fjalëve humeze dhe lumeze. Humeze, lumeze, njeri që me fjalët e veprat e tij i thyen personalitet e të tjerëve, i lëndon ndjenjat e nderet e tyre, njeri shkatërrues. Pra, dënimi i përshtatshëm për sjelljen e tij është hedhja në hutamen shkatërruese, që i thyen copa-copa ata që bien në të e i shkatërron.

Por, për të treguar tmerrin e këtij zjarri që nuk ngjason me asnjë zjarr tjetër, në ajetin pasues, thuhet:

وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ

5. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese?

Ose "Sa e frikshme që është Hutame!"

نَارُ اللَّهِ الْمُوقَدَةُ

6. Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort

---

96. لَيُنبَذَنَّ Lejunbedhenne, betohen se do të hidhen. Lam në fillim është për betim. Ndërsa, nun në fund të fjalës është për përforcim.

نَارُ "**Nar**" **(zjarr)**, shprehja zjarri i Allahut (xh.sh.), është për të treguar madhështinë dhe frikën siç themi edhe në gjuhën e përditshme "dënimi i Allahut", tregimi veçanërisht i zemërimit dhe Madhështisë së Allahut të Lartë, shpreh frikën dhe tmerrin e këtij zjarri të ndezur fort. Pra, është aq i madh e i fuqishëm saqë nuk mund të krahasohet me zjarrin që e njohim të gjithë.

الْمُوقَدَةُ el-Mukadeh, i ndezur me urdhrin e Allahut (xh.sh.). Dhe që do të jetë i ndezur deri në pafundësi, pra nuk do të shuhet asnjëherë. Por, për të treguar se ky zjarr nuk është i ngjashëm me zjarrin normal dhe nuk është zjarr që djeg vetëm pjesën materiale por edhe atë shpirtërore, prej trupit në shpirt e deri në zemër, ai është përshkruar kështu:

الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الْأَفْئِدَةِ

7. I cili depërton deri në zemrën e njeriut

Një zjarr i ndezur aq fort sa që depërton deri në brendësi të zemrës, e cila quhet "fuad", pra arrin deri në zemër që është vendi i perceptimit. Depërton prej lëkurës në brendësi, në thellësinë e shpirtit dhe e djeg atë.

Në Kuranin Fisnik nuk thuhet në asnjë vend tjetër veç kësaj sureje "**zjarri i Allahut**". Vetëm këtu zjarri është përshkruar si diçka që i përket Allahut. Arsyeja e përmendjes në këtë ajet nuk është vetëm për të treguar tmerrin e zjarrit, por në të njëjtën kohë për të treguar se sa të urryer janë tek Allahu ata që mburren në këtë botë me pasurinë e tyre. Për këtë arsye Allahu (xh.sh.) specifikisht këtë zjarr e ka treguar si diçka të Tij. Njerëzit për të cilët bëhet fjalë do të hidhen në këtë zjarr.

Emërtimi i Hutames si zjarr që do të djegë "zemrat" ka edhe një nuancë të dytë: Zemra është pjesa më delikate e trupit, njeriu e ndjen dhimbjen më shumë pikërisht aty. Madje, në zemër ndjehet edhe dhimbja më e vogël. Po ashtu, zemra është edhe vendi i ndjenjave. Zemra që mbart qëllime të liga, ndjenja të liga, besime boshe dhe pa vlerë, do të digjet nga zjarri i formuar prej këtyre ndjenjave e qëllimeve që mbart.

إِنَّهَا عَلَيْهِم مُّؤْصَدَةٌ

8. Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë

Padyshim që, dyert e atij burgu zjarri, dhimbja e të cilit djeg zemrat, do të mbyllen sipër tyre (grupit të humeze lumeze).[97] Që dyert të mos hapen më, do të vendosen shtylla të mëdha mbrapa tyre dhe me to do të mbyllen përgjithmonë.

فِي عَمَدٍ مُّمَدَّدَةٍ

9. Në shtylla të gjata flakëruese

[97]. مُّؤْصَدَةٌ Mu'sadeh, ka kuptimin e mbyllur, e kyçur.

Në shtylla të larta, të zgjatura ose mbajtëse të larta. Kur të mbyllen dyert e zjarrit, që të mos hapen nga presioni do t'i vendosen nga pas shtylla të larta, dhe më pas do të mbyllen në atë formë. Këtu kemi një përfytyrim si të një furre që e mbush mirë me dru dhe më pas e mbyll derën, duke i vendosur diçka mbrapa që të nxehet sa më shumë. Përshkruhen dhe sqarohen vuajtjet e atyre që do jenë brenda në burg pa pasur mundësi të lëvizin, pasi dera të jetë siguruar me shtylla të gjata që s'mund të lëvizen.

Sipas disa dijetarëve, pasi të mbyllen dyert e Xhehenemit do t'u lidhen duart dhe këmbët me zinxhir. Pasi të mbyllen dyert, nuk do tu mbesë më shpresë për të dalë prej aty. Shprehja "shtylla të gjata" tregon faktin se do jenë përjetësisht aty.

Sipas Meududit ky ajet ka disa kuptime:

E para, dyert e Xhehenemit do të mbyllen dhe sipër tyre do të vendosen shtylla të larta. E dyta, këta kriminelë do të lidhen në shtylla të gjata flakëruese. E treta, është kuptimi që ka shpjeguar Ibn Abbasi që, zjarri do të lartësohet në formë shtyllash të larta.

Në fakt, këtu të formohet ideja e një burgu të tmerrshëm për ta përfytyruar njerëzit në këtë botë. Por, ky burg do të jetë i mbushur me zjarr brenda tij. Ashtu siç u mbyllet burgu të burgosurve, po ashtu do të mbyllet burgu Hutame dhe mbrapa dyerve do të vendosen shtylla të larta. Qëllimi i këtij përshkrimi është që njerëzit të frikësohen e të largohen nga veprat që i çojnë në këtë situatë. Allahu e di më së miri.

SURJA FIL - 105

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ (1) أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ (2) وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ (3)

تَرْمِيهِم بِحِجَارَةٍ مِّن سِجِّيلٍ (4) فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَّأْكُولٍ (5)

Shqipërimi

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?

2. A nuk ua prishi atyre kurthin,

3. duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh,

4. të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur?

5. Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë.

Kjo sure e zbritur në Meke, ka pesë ajete. Surja e ka marrë emrin nga ajeti i parë. Kjo sure rrëfen ngjarjen e "ushtrisë së elefantëve". Ngjarje në të cilën, këta njerëz me ushtri elefantësh dëshironin të shkatërronin Qaben e Shenjtë, por Allahu (xh.sh.) e bëri përpjekjen e tyre të dështuar dhe e ruajti shtëpinë (Qaben) prej sulmit të tyre.

TEFSIRI

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ

1. Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?

أَلَمْ تَرَ "**A nuk e ke parë?**" Pyetja këtu i drejtohet Profetit (s.a.s.). **Ru'jet (shikim)**, ka kuptimin e shikimit me sytë e zemrës, shikim zemre. Pra, O Muhamed, a nuk e di aq qartë sikur ta kishe parë me sytë e Tu? A nuk të erdhi Ty ky lajm? Kjo për arsye se ngjarja është një prej shenjave hyjnore që tregon fillimin e ardhjes së Profetit, dhe, duke qenë se bashkëbiseduesi i parë i Kuranit është Profeti (s.a.s.), posaçërisht fjala **رَبُّكَ (Zoti yt),** e tregon më së miri se ky ajet i drejtohet Profetit (s.a.s.).

Por, sipas disa dijetarëve, edhe pse këtu duket sikur ky ajet i drejtohet Profetit (s.a.s.), në fakt ai u drejtohet Kurejshëve. Në të njëjtën kohë, u drejtohet të gjithë arabëve që kanë dijeni rreth kësaj ngjarjeje.

كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ "**Se si bëri Zoti yt?**"

Një nuancë e rëndësishme këtu është edhe fakti se, në ajet nuk pyet "Çfarë bëri?", por ka pyetur formën e veprimit, "Si veproi, Si e bëri?", sepse pyetja është për të treguar se, ngjarja e ndodhur ishte shumë interesante. Pjesa mahnitëse, marramendëse dhe e mrekullueshme e ngjarjes është mënyra se si ka ndodhur. Për të treguar se, veprat e Zotit janë marramendëse, e ka vënë theksin te mënyra e rrjedhës së ngjarjes, sepse ata që janë të painformuar nga mënyra e zhvillimit të ngjarjes, nuk mund ta kuptojnë brendinë e saj. Për rrjedhojë, ata që nuk e mendojnë mirë brendinë e kësaj foljeje, duke e menduar si diçka normale, mashtrohen duke menduar se e kanë kuptuar të vërtetën. Pra, Allahu i Lartë, për të mos na zhytur në një hutim të tillë, si dhe për të treguar befasinë e ngjarjes, duke na tërhequr vëmendjen te mënyra e zhvillimit të saj, thotë: **A nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt?**

بِأَصْحَابِ الْفِيلِ "**me njerëzit e elefantit?**"

Allahu (xh.sh.) nuk ka treguar se cilët janë njerëzit e elefantit, nga është e nga vjen ushtria e elefantëve dhe për ç'arsye erdhën, sepse të gjitha këto ishin të njohura për popullin, të cilit i drejtohet Kurani në atë kohë.

Njerëzit e elefantit ishin ushtria e Ebrehasë, që kishin pushtuar Jemenin. Ebrehaja, kur ishte guvernator i Etiopisë, mblodhi një ushtri të madhe. Duke i besuar elefantit të tyre që quhej Mahmud, ata shkatërruan çka u dilte përpara, derisa arritën në rrethinat e Qabes për ta sulmuar, por aty shkatërrohen pa ia arritur qëllimit. Për këtë arsye u quajtën si "njerëzit e elefantit" dhe ndër arabët ky vit u bë i njohur si "viti i elefantit", duke u bërë referencë historike për ta. Dihet se edhe Profeti Muhamed (alejhi selam) erdhi në jetë në këtë vit. Sipas transmetimit më të saktë 50 ditë pas ngjarjes së elefantit.

Kjo ngjarje është mrekulli e pakontestueshme. Një ngjarje e tillë nuk mund të shpjegohet me shkaqet natyrore. Edhe nga pikëpamja e transmetimit është shumë e sigurt, sepse kur e këndon Profeti (s.a.s.) këtë sure në Meke, kishte shumë njerëz që ishin dëshmitarë të asaj ngjarjeje para 40 vjetësh. Profeti Muhamed (a.s.) edhe pse kishte shumë kundërshtarë nga politeistët dhe ithtarët e librit, askush prej tyre nuk e kritikoi atë për këtë sure që flet për ushtrinë e elefantit.

Mënyra se si vepron Allahu me ushtrinë e Ebrehasë është përmbledhur në katër ajete:

أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ

2. A nuk ua prishi atyre kurthin

A nuk ua nxori huq atyre dredhitë dhe e zhyti në lajthitje rendin e tyre? Pra, a nuk i shkatërroi ata e i la në gjendje të mjerë? Dihet që, **kejd** dhe **mekr** kanë kuptime të tilla si: të përgatisësh atentat të fshehtë, të marrësh masa të fshehta për të bërë dëm. Mund të përdoret edhe me kuptime si, mashtrim, dredhi, kurth apo hile.

"**A nuk ua prishi atyre kurthin?**", si pyetje retorike, ka kuptim e pe që e bëri, pra e pe se si Allahu i shkatërroi ata. Çka ishte kurthi apo dredhia e tyre? Siç dihet nga transmetimet me miratim të gjerë, qëllimi i Ebrahasë ishte që me ushtrinë dhe elefantët e tyre të vinin e të shkatërronin Qaben. Kjo për shkak se ata kishin ndërtuar një kishë me emrin Kulejs, në San'a (Jemen), dhe donin ta drejtonin pelegrinazhin dhe tregtinë e njerëzve drejt saj. Për të arritur qëllimin e tyre kishin bërë shumë përpjekje haptazi e fshehurazi. Ata kishin ardhur 17 km në afërsi të Mekes në vendin e quajtur Mugammes. Por, nga aty nuk kishin arritur ta dërgonin më tej elefantin e tyre, të quajtur Mahmud.

Ç'farë ishte kurthi apo dredhia e tyre?

Ushtria e elefantëve bëri shumë shkatërrime në rrethinat e Mekës dhe plaçkitën shumë bagëti. Gjatë kësaj kohe mekasit nga tmerri, ishin ngjitur në male. Gjyshi i Profetit Muhamed (s.a.s.), Abdulmutalibi si përfaqësues i mekasve u përball me Ebrehenë. Ebreheje e priti me respekt. Pasi e pyeti për qëllimin e vizitës, ai i tha se kishte ardhur të marrë devetë që i kishin plaçkitur ushtarët e tij. Ebreheje ia kthen:

-Kur të pash në fillim, pata një përshtypje të mirë për ty. Por, pasi the këto fjalë e humbe vlerën që kishe tek unë. A për të marrë 100 devetë erdhe deri tek unë?! Ndërsa nga ana tjetër harron që unë kam ardhur të shkatërroj Qaben, që është simboli i fesë së gjyshërve tuaj dhe nuk thua asgjë për ta mbrojtur Atë.

-Unë jam pronari i deveve dhe ruaj ato. Ai që do ta mbrojë Qaben është pronari dhe Zoti i saj,- ia ktheu Abdulmutalibi. Ebreheja i trembur ia kthen:

-Askush nuk e mbron dot Qaben nga unë. Abdulmutalibi vazhdon:

-Meqë qenka ashtu, ja tek e ke Qaben përballë teje. Pa hë njëherë, shko e sulmoje nëse mundesh. Pa asnjë dyshim që, Abdulmutalibi e kërcënonte Ebrehenë me Allahun (xh.sh.). Si fillim ia tregon qartë që Qaben do ta ruaj Zoti i saj, pastaj e sfidon hapur edhe pse ia tha me një intonacion të butë "shko e sulmoje nëse mundesh".

Ebreheje dhe komandantët e tij e nisën elefantin drejt Qabe, por nga aty elefanti Mahmud nuk kishte ecur më tej. Në fillim ky fakt ua prishi punët. Më pas u shkatërruan e u bënë "asfun-me'kul" si gjeth i grimcuar (i përtypur). Pra, ata jo vetëm që nuk e shkatërruan dot Qaben, por u shkatërruan vetë e u bënë copash, apo jo? Pra, Ai që ua ktheu ters një sulm të tillë dhe ua prishi planet është Zoti yt; Zoti yt e mundësoi atë.

Në ajet, fjala "kejd" përdoret me kuptimin "marr masa të fshehta" për të sulmuar dikë. Këtu mund të lindë pyetja se ç'janë masat e fshehta. Nuk ishte diçka e fshehtë që, Ebrehaja me një ushtri prej 60 mijë ushtarësh dhe me elefantë, u nis nga Jemeni drejt Mekës për të shkatërruar Qaben. Për rrjedhojë, këtij fakti nuk i themi masë e fshehtë. Por, qëllimi i fshehtë i Etiopianëve ishte që, duke shkatërruar Qaben të shtypnin Kurejshët. Duke i frikësuar të gjithë arabët, kishin në plan të shtinin në dorë rrugën tregtare që shtrihej nga Arabia Jugore deri në Siri e Egjipt. Ata e mbanin sekret këtë qëllim të tyrin. Në plan të parë, sulmi ndaj Qabes dukej si hakmarrje ndaj mosrespektimit që arabët kishin ndaj kishës.

وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ

3. Duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh

طَيْر është shumësi i fjalës **طائر** që ka kuptimin e zogut fluturues. **طَيْرًا** në formën e papërcaktuar, tregon që këta zogj ishin të veçantë, zogj që nuk ishin të njohur. Transmetohet se ata ishin prej zogjve që nuk ishin parë në ato anë deri në atë kohë. Në transmetime përmendet se erdhën nga kahu i Jemenit dhe detit, erdhën si një furtunë e shpejtë dhe sulmuan armiqtë si një makth i vërtetë.

أَبَابِيلَ është emër në shumës që nuk ka njëjës. Ka kuptimin që vijnë në turma njëra pas tjetrës, vijnë në grupe të njëpasnjëshme, njëri pas tjetrit. Tajran Ebebil, ka kuptimin e zogjve që vijnë njëri pas tjetrit, në rreshta, në grupe e në tufa të njëpasnjëshme.

تَرْمِيهِم بِحِجَارَةٍ مِّن سِجِّيلٍ

4. Të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur?

Zogjtë i godisnin ata (poseduesit e elefantit) me gurë prej sixhili.

سِجِّيلٍ ka kuptimin e baltës së forcuar në gurë si qeramikë. Ibn Abas (r.a.) thotë se kjo fjalë në origjinal është nga persishtja. Me kuptimin e gurit të bërë prej balte dhe forcimit të saj duke e pjekur.

Në transmetime thuhet se, zogjtë mbanin nga tre prej këtyre gurëve të vegjël sa një kokërr thjerrëze apo qiqre, ose sa jashtëqitjet e deleve, në sqep e në këmbë. Atë që e qëllonte ky gur i hynte në kokë dhe i dilte nga ana tjetër. Dhe kështu, e bënte copë e çikë. Është e lehtë për të menduar gjendja e një ushtrie të tillë, në qiell të hapur, që bombardohej nga sipër, nga zogjtë që vinin tufa-tufa si avionë të pajisur mirë me municione. Për rrjedhojë, përfundimi ishte i tillë:

فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَّأْكُولٍ

5. Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë

Dhe, në çast i bëri ata (poseduesit e elefantit) si gjethe të përtypura. **مَّأْكُولٍ** Ka kuptimin e ngrënë, e përtypur. Interpretuesit, duke thënë se **عَصْفٍ** ka kuptimin e gjetheve të të mbjellave, ata kanë përmendur disa variante:

1. Mbetjet e gjetheve që mbesin në arë pas korrjes së të mbjellave që i vërtit era sa andej këndej dhe që teprojnë pas ngrënies së kafshëve.

2. Kashta e copëtuar që e vërtit era.

3. Gjethe që kanë rënë nga ngrënia e krimbave apo buburrecëve dhe janë bërë vrima-vrima. Kjo tregon se, ushtria e Ebrehasë u bë copë-copë pas sulmit të zogjve.

Pra, Allahu i Lartë, i shndërroi në çast poseduesit e elefantit në "gjethe të grimcuara" në një mënyrë të çuditshme e të paparashikueshme. Një ushtri e tillë, që duke mos parë një fuqi që t'i dilte përballë, duke i besuar elefantit të tyre gjigand dhe ushtrisë së tyre u nisën për të shkatërruar Qaben, u shkatërrua prej një fatkeqësie qiellore dhe u bë si gjethe (e përtypur) të mbjellash. Allahu, që e bëri të mundur këtë në çast, nuk ka asnjë fije dyshimi që edhe të tjerët mund t'i shkatërrojë me forma të tilla të paparamenduara, dhe grupin e atyre "që tallen e që përqeshin" do ta flakë në Xhehenem.

Për të tërhequr vëmendjen në ndihmën e Zotit për personin që do të vinte në jetë për të lartësuar dhe njoftuar Njëshmërinë e Allahut me urdhrin "**Pastroje Shtëpinë Time për ata që e vizitojnë,**

që rrinë aty dhe që falin namaz"[98], si dhe për të lartësuar famën e Tij, në fillim të sures **أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَم بِأَصْحَابِ الْفِيل** nuk thotë "Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti juaj me njerëzit e elefantit?" por thotë **رَبُّكَ** "**Zoti yt**". Pra, kjo sure është dhuratë për Profetin Muhamed (s.a.s.), sihariq për besimtarët, dhe qortim për mohuesit, veçanërisht për mohuesit Kurejshë që nuk ia dinin vlerën asaj mrekullie të ndodhur.

SURJA KUREJSH - 106

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

لِإِيلافِ قُرَيْشٍ (1) إِيلافِهِمْ رِحْلَةَ الشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ (2) فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ (3) الَّذِي أَطْعَمَهُم مِّن جُوعٍ وَآمَنَهُم مِّنْ خَوْفٍ (4)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. (Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) për të mbrojtur fisin Kurejsh,

2. për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë.

3. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes),

4. i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.

Sures Kurejsh, i thuhet ndryshe edhe surja "**Li'ilafi Kurejsh**". E zbritur në Meke, ka 4 ajete. Emrin e ka marrë prej fjalës Kurejsh në fillim të sures. Fakti se ka një lidhje të fortë me suren paraardhëse, e bën të duket sikur është vazhdimi i saj. Tregon mirësitë që kanë fituar Kurejshët nga observimi i Qabes.

Shkaku i zbritjes

Prej shkaqeve të zbritjes është fakti se Kurejshët, duke parë ndihmën e Zotit në ngjarjen e "**poseduesve të elefantit**", në vend që të ishin të parët në pranimin e Profetit Muhamed (s.a.s.) dhe fesë së Zotit, ata ishin të parët që kundërshtuan dhe këmbëngulën në politeizmin e tyre.

TEFSIRI

[98]. Surja Haxh, 22:26

لِإِيلافِ قُرَيْشٍ

1. (Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) për të mbrojtur fisin Kurejsh

إِيلافِ Ijlaf, ka kuptimin e të mësuarit me diçka, e bërë e zakonshme. Allahu (xh.sh.), duke i bashkuar ata kur ishin të përçarë, si dhe duke i shndërruar rrugët e tregtisë në diçka të zakonshme, ua kishte mundësuar atyre që të fitonin pasuri me anë të saj. Ndërsa ata, tani distancoheshin nga adhurimi i Allahut.

Ndërkohë që, vetëm mirësia e udhëtimeve tregtare të dhuruara prej Allahut (xh.sh.), pa marrë parasysh mirësitë e tjera të panumërta, ishte një dhuratë e madhe dhe, sikur vetëm për këtë duhet ta adhuronin Allahun.

إِيلافِهِمْ رِحْلَةَ الشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ

2. Për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë

Allahu ua lehtësoi Kurejshëve rrugët e tregtisë gjatë dimrit për në Jemen dhe gjatë verës për në Siri, që ta adhurojnë Allahun.

رِحْلَةَ rihlet, ka kuptimin udhëtim, emigrim. Kurejshët udhëtonin gjatë dimrit në Jemen, dhe gjatë verës në Siri dhe Basra për tregti. Në të njëjtën mënyrë emigronin për tregti ose për arsye të tjera gjatë verës në Taif, dhe gjatë dimrit në Meke. Edhe pa i llogaritur mirësitë e tjera të pafund të Allahut (xh.sh.), Kurejshët më e pakta duhet ta adhuronin Allahun, qoftë kjo edhe vetëm për mirësinë e udhëtimit.

فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ

3. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes)

Pra, ta njohin të vërtetën që solli Profeti Muhamed (alejhi selam) e të mos jenë të pabindur ndaj Tij, të heqin dorë prej politeizmit e mohimit dhe të adhurojnë Zotin e Bejtul Atik (shtëpia e parë e ndërtuar në tokë), i Cili e ruajti atë prej sulmit të ushtrisë së elefantit, ta njohin vetëm Atë si Zot dhe të adhurojnë vetëm Atë. Adhurimi kryhet në drejtim të Qabes, por jo për vetë Qaben, por për Zotin e Qabes. Fatkeqësisht, disa besimtarë, respektin që tregojnë ndaj vetë Qabes, nuk e tregojnë për Zotin e Qabes, Profetin apo Kuranin.

الَّذِي أَطْعَمَهُم مِّن جُوعٍ وَآمَنَهُم مِّنْ خَوْفٍ

4. i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike

E kjo ishte frika nga armiku (ushtria e elefantit) i shpënë. Po ashtu, siç pohon edhe ajeti në të cilin thuhet se: "**Vallë, a nuk e shohin ata se si Ne u kemi dhënë atyre një vend të shenjtë e të sigurt (Mekën), ndërkohë që njerëzit rreth tij po grabiten? A mos vallë ata besojnë në gjëra të kota, ndërsa dhuntitë e Allahut i mohojnë?!**"[99], njerëzit përreth tyre plaçkiteshin dhe vriteshin, ndërsa Kurejshët ishin të sigurt në zonën e sigurt (Qabe) dhe udhëtonin të sigurt për të bërë tregti. Kjo, ishte bërë e mundur me lutjen e gjyshit të tyre, Ibrahimit (a.s.), sepse ai, qe lutur: "**Zoti im, bëje këtë vend qytet të sigurt**"[100]. Sërish në një tjetër dua thotë: "**Jepu fruta!**"[101] Pra, a nuk duhet që Kurejshët ta adhurojnë atë Zot që i ushqen dhe i siguron prej çdo frike?

Pra, ju ruajti ju nga frika kur askush nuk ishte i sigurt në Arabi. Në atë periudhë, në asnjë cep të Arabisë askush nuk mund të flinte i qetë. Ishin gjatë gjithë kohës përballë rrezikut të ndonjë sulmi. Askush nuk mund të dilte jashtë kufijve të fisit të tij, sepse në rast se dilte i vetëm, i pashoqëruar, ishte e pamundur të kthehej i gjallë. Mund të vritej nga dikush ose mund të zihej rob. Asnjë karvan nuk ishte i sigurt prej sulmeve, vetëm nëse i jepte ryshfet prijësve të fiseve përreth mund të kalonte shëndoshë e mirë. Po ashtu, kapitali që kishte me vete karvani mund të plaçkitej. Ndërsa Kurejshët mekas, ata ishin të sigurt prej çdo lloj rreziku. Për ata nuk ekzistonte frika e sulmit të armikut. Nuk kishin as frikë se armiku mund të sulmonte Mekën. Ata shëtisnin të lirë në çdo cep të vendit me karvanë të vegjël e të mëdhenj. Ata nuk i prekte askush, për vetë faktin që ishin "shërbyes të Qabes". Askush nuk mund ta ngrinte zërin kundër tyre. Edhe sikur një kurejsh të sulmohej gjatë ndonjë udhëtimi, mjaftonte që ai të thoshte "jam nga Haremi", pra nga Meka. Sapo dëgjonte këtë fjalë, sulmuesi ndalonte, sepse fiset që jetonin në gadishullin arabik nuk respektonin vetëm Qaben por edhe kurejshët që jetonin në rrethinat e Qabes. Ata thoshin: "Këta janë komshinjtë e shtëpisë së Allahut, janë banorët e Qabes dhe prijësit e saj, popull i Zotit."

Pra, një popull që gëzonte një prestigj të tillë si në gadishullin arabik, po ashtu edhe nga fiset arabe, që jetonin jashtë gadishullit, duke menduar se po të ndiqnin Profetin Muhamed (s.a.s.) do të ishte në dëm të interesave të tyre, dolën kundër thirrjes së Tij. Në këtë sure, urdhërohen që mos të dalin kundër teuhidit (monoteizmit), tek i cili i fton kjo thirrje, dhe ta pranojnë këtë thirrje dhe të adhurojnë Zotin e Qabes që ua ka dhuruar atyre këto mirësi.

SURJA MAUN - 107

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالدِّينِ (1) فَذَلِكَ الَّذِي يَدُعُّ الْيَتِيمَ (2) وَلا يَحُضُّ عَلَى طَعَامِ الْمِسْكِينِ (3) فَوَيْلٌ لِّلْمُصَلِّينَ (4)

الَّذِينَ هُمْ عَن صَلاتِهِمْ سَاهُونَ (5) الَّذِينَ هُمْ يُرَاؤُونَ (6) وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ (7)

[99]. Surja Ankebut, 29:67
[100]. Surja Bekare, 2:126
[101]. Surja Ibrahim, 14:37

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?
2. Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët
3. dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit.
4. Mjerë për ata, të cilët kur falen,
5. janë të pakujdesshëm për namazet,
6. të cilët duan vetëm që të duken
7. dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve.

Kjo sure ka shtatë ajete. Sipas një pjese të interpretuesve të Kuranit, surja ka zbritur në Meke. Sipas disa të tjerëve tre ajetet e para kanë zbritur në Meke, ndërsa pjesa tjetër në Medine.[102]

Sipas Meududit, kjo sure ka zbritur në Medine. Ai thotë: "Sipas nesh, në këtë sure ka tregues që na tregojnë se kjo sure është medinase. Dhe ky tregues është, paralajmërimi për ata që falin namaz dhe shprehja "mjerë" për ata që janë të pakujdesshëm ndaj namazit apo ata që e falin atë sa për sy e faqe, sepse myslimanët ishin aq të fuqishëm në Medine, sa disa njerëz, për përfitimet e tyre, shfaqeshin si myslimanë. Pjesëmarrja në xhemat (grup) ishte vetëm që të pranoheshin si myslimanë. Ndërsa në Meke nuk kishte gjëra të tilla. Atje askush nuk kishte nevojë të falte namaz për t'u dukur. Edhe për vetë besimtarët në Meke ishte shumë e vështirë të falnin namaz apo të formonin xhemat. Myslimanët faleshin fshehurazi në Meke."

Pavarësisht sqarimit të Meududit, që hipokritët fillojnë të shfaqen më tepër në Medine, mund të lindë një pyetje se si mund të shpjegohet mendimi i disa komentuesve që kjo sure ka zbritur në Meke? Përgjigja mund të jetë e tillë: Allahu i Lartë, me dijen e Tij hyjnore, duke zbritur suret dhe ajetet në Mekë, ka dashur të njoftojë për situatat që do të formohen në Medine.

Surja e ka marrë emrin nga ajeti i fundit që ka kuptimin "**e dhënies ndihmë**", dhe prej temës dominante në sure. Në sure theksohet, se besimi dhe veprat e kryera do ta kenë shpërblimin në jetën tjetër (Ahiret), dhe se ndihmesa e mbështetja ndaj njëri-tjetrit është e domosdoshme në shoqëri.

Surja flet për dy grupe njerëzish:

1. Mosmirënjohësit, që i mohojnë mirësitë e Allahut (xh.sh.) dhe mosbesimtarët që e quajnë si të rreme ekzistencën e Ditës së Gjykimi e jetën tjetër.

[102]. Sipas Suleyman Ates, surja ka zbritur e plotë në Meke, sepse ajetet kanë lidhje me njëri-tjetrin. Fe-ja lidhëse në ajetin e katërt, ashtu siç tregon lidhjen me ajetet para, fjala **مُصَلِّينَ** tregon lidhjen me ajetet pas. Këto ajete që shpjegojnë njëri-tjetrin, dhe që kanë lidhje të pandashme nga njëri-tjetri, nuk mund të mendohet se kanë zbritur veçmas. Shk: Çadas Tefsir, tefsiri i sures Maun.

2. Hipokritët, të cilët, në punët që kryejnë nuk kanë si synim kënaqësinë e Allahut (xh.sh.), por i kryejnë punët e falin namaz sa për sy e faqe.

TEFSIRI

أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالدِّينِ

1. A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?

أَرَأَيْتَ A e ka parë? Duket sikur i drejtohet Profetit Muhamed (s.a.s.). Por, siç e kërkon rregulli i metodës Kuranore, në raste të tilla u drejtohet të gjithë atyre që zotërojnë mendje të shëndoshë. Pyetja retorike (tea'xhub) është përgatitëse për ato që do të njoftojë në vijim. Pyetja "**A e ka parë?**", ka kuptimin e shikimit me sy, sepse gjërat që do të sqarohen më vonë, janë elemente që mund t'i shikojë çdo njeri që i shohin sytë. Por, kuptimi i saj mund të jetë edhe ta kuptosh, ta dish dhe të meditosh rreth saj. Për shembull, ne themi: "Hej shikojeni mirë!", pra mendoni pak. Nëse e marrin kuptimin e fjalës në ajet në këtë formë, kuptimi i ajetit do të jetë ky: "A e di se cilët janë ata njerëz, që përgënjeshtrojnë Ditën e Gjykimit?" Por, mund të jetë edhe "Mendoje gjendjen e atij personi, që mohon shpërblimin dhe dënimin për veprat e kryera!" Ose, "O Muhamed! I shikon apo jo, dhe i njohe, se ç'ka bëjnë ata të cilët mohojnë ndër Kurejshët?"

Shkaku i zbritjes

Sipas transmetimit: Ebu Xhehli ishte kujdestar (ekzekutor testamenti) i një jetimi. Një ditë jetimi shkon pranë Ebu Xhehlit këmbëzbathur dhe i kërkon nga pasuria e tij. Por, ai as që e përfilli fare dhe e përzuri duarbosh. Paria e kurejshëve iu drejtua me një ton tallës: "Shko te Muhamedi të ndërmjetësojë për ty." Jetimi, duke mos e kuptuar qëllimin e tyre, shkoi tek i Dërguari Allahut (s.a.s.) dhe kërkoi ndihmë prej Tij. Profeti (a.s.) duke qenë se e kishte zakon të mos kthente asnjë njeri duarbosh, ngrihet e shkon bashkë me të tek Ebu Xhehli. Ebu Xhehli e përshëndet dhe i thotë: "Urdhëro!" dhe ia jep mallin jetimit. Kurejshët për ta qortuar për atë që bëri i thonë Ebu Xehlit: "Edhe ti devijove, dole nga feja jonë dhe u fute në fenë e Muhamedit". "Jo", ia ktheu ai, "nuk devijova, por në të djathtën dhe të majtën e jetimit pashë dy ushtarë të armatosur. U tremba se po mos t'i jap mallin atij do më sulmonin."

Ndërsa, në transmetimin e Ibn Abbas'it thuhet se ka zbritur rreth një koprraci, mburravec dhe hipokrit. Pra, kjo sure ka zbritur për njërin prej tyre ose për një histori të ngjashme. Por, vlefshmëria e gjykimit nuk është e kufizuar vetëm për ata, por i përfshin të gjithë njerëzit që janë të tillë.

Fjala "Din" në ajet, sipas terminologjisë së Kuranit, ka kuptimin e shpërblimit të veprave në botën tjetër dhe në njëjtën kohë përdoret edhe për Islamin. Por, kuptimi i parë këtu është më i përshtatshëm, sepse një njeri që beson në jetën tjetër (Ahiret) nuk sillet në atë mënyrë me jetimin.

Është e qartë se ai që tallet me jetimin dhe nuk e ushqen të vobektin, do të thotë se nuk beson në jetën e përhershme dhe nuk i frikësohet kërcënimit të Allahut.

فَذَٰلِكَ الَّذِي يَدُعُّ الْيَتِيمَ

2. Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët

Pra, nëse e ke parë e di, e nëse nuk e ke parë mësoje! Për arsye se nuk i besojnë fesë dhe dënimit në jetën tjetër, ata mosbesimtarët e tillë e përbuzin jetimin. Duke e cilësuar si të dobët jetimin dhe duke mos pasur frikë prej dënimit të Allahut (xh.sh.), ata e përzënë në mënyrë të vrazhdë jetimin pa pasur asnjë pikë mëshire.

وَلا يَحُضُّ عَلَىٰ طَعَامِ الْمِسْكِينِ

3. Dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit

Pra, nuk nxit dhe nuk dëshiron që të ushqehet me diçka i varfëri. Ashtu si nuk i ndihmon vetë të varfrit, po ashtu, as që dëshiron që të tjerët ose të afërmit e tij, që janë në gjendje të mirë, ta ndihmojnë, ushqejnë apo kujdesen për të. Dhe as që i këshillon apo nxit ata në këtë rrugë. Ndërkohë që ajo pjesë ushqimi i përket të varfrit e të mjerit, dhe jo atij që kontribuon.[103] Ky ushqim, dhënia e të cilit është vaxhib (e domosdoshme) për atë që e jep, është e drejta e jetimit. Ai që e jep, nuk e jep atë për bamirësi, përkundrazi ai është i detyruar që ta japë këtë, duke qenë e drejta e jetimit. Kuptimi i ajetit 19-të i sures Dharijat "**Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.**" Pra, ai që ushqen një të mjerë në një gjendje të tillë, është sikur t'i ketë dhënë atij pjesën që i takon, sikur i ka shlyer borxhin.

Ata që kanë nevojë të jetojnë së bashku, të familjarizuar dhe në harmoni në shoqëri, dhe që, me ndihmën e Allahut të Lartë, kanë shpëtuar prej varfërisë e frikës, duhet ta adhurojnë Allahun e të jenë vetëm rob të Tij. Dhe, për të kryer këtë adhurim, si një detyrë e fesë së drejtë, duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin për të ushqyer e për t'u kujdesur për jetimët, të varfrit e të vobektët. Ata që nuk e kryejnë këtë detyrë, kur ekziston mundësia, dhe akoma më keq ata që e përzënë dhe tallen me jetimin, duke ia mohuar të drejtën pa treguar as përkujdesjen më të vogël për ushqimin e jetimit që gjendet pranë tyre, tregon se në ç'gjendje të ulët dhe të turpshme ndodhen ata, që të bën të ndjesh dhimbje e keqardhje në emër të humanizmit. Ka edhe kuptimin që, përzënia e jetimit dhe mos përkujdesja ndaj të varfërve, janë vepra të pamëshirshme që i kryejnë ata të cilët e mohojnë fenë. Sado që, mosbesimi i një njeriu të duket si diçka e paperceptueshme, sjellja e mosbesimtarit në këtë formë, në një farë mënyre, mund të perceptohet. Por, ajo që të habit më shumë është fakti që, ata që

[103]. Përdorja "ta'amul miskin" në vend të "it'amul miskin" që mund të ishte me kuptim më të qartë, ka një tjetër nënkuptim, sepse po të ishte "it'amul miskin" do të kishte këtë kuptim: "Nuk nxit në ushqyerjen e të varfrit". Ndërsa, "ta'amul miskin" ka kuptimin "Nuk ia jep të varfrit ushqimin që i takon".

duken si besimtarë e sillen me hipokrizi në punët dhe adhurimet fizike e kapitale, tregohen aq koprracë saqë nuk dhurojnë as gjënë më të vogël.

فَوَيْلٌ لِّلْمُصَلِّينَ

4. Mjerë për ata, të cilët kur falen

Ose "sa keq për ata që kur falen". Pra, mjerë ata që falin namaz e do të bien në gropën e Xhehenemit, ose më saktë që hiqen sikur falin namaz.

الَّذِينَ هُمْ عَن صَلاتِهِمْ سَاهُونَ

5. Janë të pakujdesshëm për namazet

Ata që kanë gabuar ndaj namazit të tyre dhe janë mashtruar. Duhet pasur kujdes, nuk janë qortuar ata që kanë gabuar apo harruar në namazin e tyre, por ata që kanë gabuar ndaj namazit të tyre, sepse të gabosh apo harrosh ndonjëherë në namaz është diçka njerëzore, e pashmangshme. Për këtë arsye transmetohet nga Ata b. Dinar të ketë thënë: "Falënderimet i takojnë Allahut, i Cili nuk ka qortuar për gabimet në namaz, pra nuk ka thënë **في صَلاتِهِمْ سَاهُون** "ata që gabojnë apo janë të pakujdesshëm në namazin e tyre" por, ka thënë **عَن صَلاتِهِمْ سَاهُونَ** "ata që janë të pakujdesshëm ndaj namazit të tyre".

Ka disa sqarime të ndryshme të interpretuesve të Kuranit rreth kuptimit të shprehjes "janë të pakujdesshëm ndaj namazit": Të tregohesh i pakujdesshëm ndaj rëndësisë së namazit e mos ta kryesh atë si një detyrë të rëndësishme, të mos tregohesh i kujdesshëm ndaj kohës së tij, të mos shqetësosh për kohën e namazit që po kalon e ta vonosh atë, të mos shqetësohesh në rast të braktisjes së tij, të falësh namazin pa pasur si synim kënaqësinë e Allahut të Lartë, por ta falësh për ndonjë përfitim të kësaj bote, ta falësh në mënyrë hipokrite, të mos e falësh si madhërim dhe shfaqje të robërisë para prezencës së të Vërtetit por thjesht sa për t'u dukur e për argëtim.

Kjo çështje është argumentuar me dy transmetime nga Ibn Xherir. Transmetimi i parë, i ardhur nga Sa'd b. Ebi Uakas në të cilin thuhet: Pyeta të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) rreth **الَّذِينَ هُمْ عَن صَلاتِهِمْ سَاهُونَ**. Profeti (s.a.s.) tha: "*Këta janë ata që e vonojnë namazin nga koha e tij*."[104] Ndërsa tjetri: Nga Ebu Berzele el-Eslemi (r.a.): Kur zbriti ajeti **الَّذِينَ هُمْ عَن صَلاتِهِمْ سَاهُونَ** Profeti (a.s.) tha: "*Allahu Ekber, kjo*

[104]. Bejheki, es-Sunenu'l Kubra, II, 214.

për ju është më e dobishme se t'ju dhurohet e tërë bota. Ndërsa, ata kur falin namaz nuk mendojnë se do të kenë ndonjë dobi, dhe kur nuk e falin nuk frikësohen prej Zotit të tyre."[105]

Duhet të kuptohet qartë se, gjatë faljes së namazit të vijnë mendime të tjera është gjë tjetër, ndërsa të mos tregosh fare kujdes ndaj namazit është gjë tjetër. Cilësia e parë është dobësi njerëzore. Njeriut mund t'i vijnë në mendje mendime jashtë vullnetit të tij. Një besimtar, kur e kupton se është shpërqendruar nga namazi, përpiqet sërish të përqendrohet. Ndërsa, cilësia e dytë i përket atyre që janë të hutuar në namazin e tyre, sepse namazi i njerëzve të tillë është si sport. Njerëz të tillë nuk kanë si qëllim në zemrat e tyre përmendjen dhe afrimin tek Allahu i Lartë, sepse ata nuk besojnë që namazi është farz (detyrim). Që në fillim të faljes së namazit e deri në fund të tij, ata nuk ia drejtojnë zemrat Allahut. Me ato mendim që e fillojnë namazin po me atë mendim e përfundojnë atë. Për arsye se falin disa kohë të namazit, njerëz të tillë mburren dhe mendojnë se feja përbëhet vetëm nga namazi. Ata, të cilët nuk kryejnë adhurime të tjera përveç namazit janë po kjo kategori njerëzish.

Ndërsa, sipas disa interpretuesve të tjerë të Kuranit, ky ajet është rreth hipokritëve në besim e vepra që përmenden në ajete të tjera: Lidhja me ajetin 142 të sures Nisa' është më e përshtatshme.

إِنَّ الْمُنَافِقِينَ يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَهُوَ خَادِعُهُمْ وَإِذَا قَامُوا إِلَى الصَّلَاةِ قَامُوا كُسَالَىٰ يُرَاءُونَ النَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ اللَّهَ إِلَّا قَلِيلًا

"**Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por është Ai që i mashtron ata. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t'u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak.**"
Pra, është më e përshtatshme të themi se, ata falin namazin, por nuk e kuptojnë përmbajtjen dhe esencën e tij të vërtetë.

الَّذِينَ هُمْ يُرَاؤُونَ

6. Të cilët duan vetëm që të duken

Çdo punë që bëjnë nuk e bëjnë për të arritur kënaqësinë e Allahut, por e bëjnë për t'iu dukur njerëzve dhe në vende ku mund të duken.

Pavarësisht se, shumë interpretues të Kuranit janë të mendimit se këto ajete kanë zbritur rreth hipokritëve, ka edhe prej atyre që janë të mendimit se kanë zbritur rreth mosbesimtarëve mekas. Për shembull, sipas Sulejman Ates, për atë arsye që kanë zbritur tre ajetet e para, për ata persona dhe për ato cilësi që përshkruajnë, po ashtu për të njëjtën arsye, persona dhe për të përshkruar të njëjtat cilësi, kanë zbritur edhe katër ajetet e fundit.

Sipas këtij mendimi, kuptohet se edhe politeistët mekas falnin namaz, por nuk i jepnin rëndësi namazit, nuk faleshin rregullisht, faleshin ndonjëherë duke e perceptuar namazin si një traditë, pa qenë të mirinformuar rreth tij, faleshin për argëtim. Ajeti 35 i sures Enfal: "**Lutja e tyre në shtëpinë e shenjtë ishte vetëm me fërshëllimë dhe rrahje duarsh**", na tregon se, edhe politeistët faleshin,

[105]. Sujuti, ed-Durrul Menthur, VIII, 642.

por namazin e kishin shndërruar në mjet argëtimi, duke lëshuar britma e duke duartrokitur gjatë faljes.

Adhurimet si namazi, zekati e agjërimi, nuk janë adhurime që i solli Islami për herë të parë pa ekzistuar fare më përpara. Këto adhurime ekzistonin edhe në fetë hyjnore para Islamit. Kështu që Isa (a.s) kur ishte akoma fëmijë në djep u tha njerëzve përreth: "**Ai më ka porositur që të falem e të japë zeqat sa të jem gjallë.**"[106] Po në të njëjtën sure, në ajetin e 55-të të saj njoftohet se Ismaili (a.s.) e ka urdhëruar familjen e tij që të falë namaz. Në Kuranin Fisnik tregohet se, të gjithë profetët u kanë kumtuar popujve të tyre vazhdimisht të njëjtat principe: Adhurimin e Allahut të Lartë, kryerjen e veprave të mira dhe besimin në jetën tjetër.

وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ

7. Dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve

Fjala **الْمَاعُونَ Maun**, ka këto kuptime leksikore, të nxjerra prej interpretuesve të Kuranit: zekat, donacion e bamirësi, diçka që ka një vlerë të mirëfilltë, gjëra që janë bërë zakon të merren si hua midis komshinjve, si enë balte, enë të vogla, sofër, sëpatë, qyrek dhe mjete të tjera pune që kërkohen hua për ndihmë dhe që nuk shihen me smirë prej askujt.

Ata, për të cilët bën fjalë ajeti, janë ata njerëz që janë aq koprracë saqë edhe diçka që mund ta marrin sërish mbrapsht ngurrojnë ta japin. Për njerëz të tillë as që bëhet fjalë të japin zekat, sadaka apo ndonjë ndihmë tjetër bamirësie, por edhe diçka hua që do ta marrin sërish mbrapsht nuk e japin. Ata që sillen me koprraci edhe për gjëra të vogla, për gjëra të mëdha janë akoma më shumë koprracë. Kuptohet lehtë se njerëz të tillë nuk japin zekat. Hipokritët, që nuk japin diçka të vogël hua, zekat e sadaka nuk mund të japin fare.

Një pyetje të tillë si: "A përfshihet në gjykimin e ajetit mosdhënia hua atyre që nuk janë korrektë në shlyerjen e huas?", mund t'i përgjigjemi në këtë formë: Kjo ndoshta nuk futet në gjykimin e ajetit. Nëse një mysliman nuk është përballur tre herë me të njëjtën situatë, nuk është e drejtë që të mos e japi diçka që i kërkohet hua. Nëse është përballur në të tre rastet me të njëjtën situatë, e kur t'i kërkohet sërish diçka, duke treguar bujarinë e tij mund t'i thotë se ti nuk je sjellë korrekt në herët e shkuara por unë po të jap sërish edhe një herë. E ka të drejtën e një paralajmërimi të tillë.

Pra, kështu fal namaz, duket si besimtar por mashtrohet nga namazi i tij. Kjo situatë e atyre që duan të shtiren, ndërkohë që refuzojnë të japin edhe ndihmën më të vogël, edhe pse jo siç të habit gjendja e mosbesimtarit, gjendja e tyre është tepër e habitshme kur nuk ndihmojnë të vobektët e përzënë jetimin. Kjo për arsye se në Kuran, pas besimit, përmenden bashkë namazi dhe zekati si bazat e veprave të mira. Për rrjedhojë, ka disa njerëz që shtiren si fetarë, duken sikur falin namaz dhe me faljen e tyre pretendojnë se i kanë shlyer të gjitha detyrimet fetare. Nuk i japin rëndësi adhurimeve të

[106]. Surja Merjem, 19:31

tjera si zekati dhe refuzojnë ta japin atë. U pëlqen të kërkojnë për hir të Allahut, ndërsa kur vjen puna për të dhënë edhe gjënë më të vogël apo për të ndihmuar robt e Allahut e për të sjellë në vend urdhrat e Allahut me aq sa kanë mundësi, i shmangen kësaj përgjegjësie.

Si përfundim: Padyshim që, besimi në Ahiret (jetën e pafundme) është një nga shkaqet më të rëndësishme që e pengon njeriun të kryejë vepra të këqija, e nxit atë drejt punëve të mira dhe ia shton ndjenjën e dhembshurisë për të varfrit. Ata që nuk besojnë në Ahiret nuk mendojnë për të varfrit, jetimët e të vobektët. Ata shumë pak ose aspak mendojnë diçka tjetër veç interesave të tyre. Për këtë arsye, në këtë sure tregohet se ata që nuk besojnë në botën tjetër, që nuk e falin namazin me përkushtim dhe nuk i japin rëndësinë e duhur shpirtit të fesë, nuk mendojnë për të tjerët, nuk janë të sinqertë, veprojnë vetëm sa për sy e faqe dhe nuk i ndihmojnë të tjerët.

Pra, ata që besojnë në llogaridhënien dhe gjykimin në Ahiret (jetën tjetër), tregohen të mëshirshëm ndaj jetimit, i ndihmojmë nevojtarët, e falin namazin me përkushtim, sinqeritet, vazhdimisht dhe në kohën e caktuar. Nuk u pëlqen të mburren, adhurimet i kryejnë me sinqeritet dhe i ndihmojnë të tjerët.

SURJA KEUTHER - 108

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ (1) فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَانْحَرْ (2) إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ (3)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira,

2. andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!

3. Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë.

Kjo sure, e cila ka zbritur në Meke, në periudhën e parë të Shpalljes Hyjnore, është surja më e shkurtër e Kuranit. Në të, tregohen mirësitë e mëdha, të cilat Allahu ia bëri të mundur të Dërguarit të Tij (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

Shkaku i zbritjes së sures

Transmetimet, më së shumti, pohojnë se kjo sure ka zbritur për shkak të fjalëve fyese që mohuesit përdorën ndaj të Dërguarit të Allahut, duke i thënë atij "ebter" (të është shuar fara, soji). Ndërsa për sa i përket vetë personit, i cili e ka thënë këtë fjalë dhe mënyrës së thënë, rreth kësaj çështjeje ka transmetime të ndryshme. Transmetimi më i hasur është: El-'As bin Uail, një ditë, thotë: "E urrej Muhamedin. E kush ka urrejtje për dikë, këtij të fundit i shuhet soji". Në një transmetim tjetër

thuhet se, Ukbe bin Ebi Muajt të ketë thënë për të Dërguarin e Allahut: "Ai nuk ka djalë. Kështu që fara e tij është e shuar (ebter)".

Në një transmetim tjetër, i cili përcillet nga Ibn Abasi (r.a.), thuhet: "Fëmija më i madh i të Dërguarit të Allahut ishte Kasemi. E dyta, Zejnebja. I treti, Abdullahu. Më pas Umu Kulthum. Më pas Fatimja dhe e fundit Rukija. Kasemi (paqja qoftë mbi të), ndërroi jetë i pari në qytetin e Mekës. Pas kësaj ndodhie, El-'As bin Uail, tha: "U shua soji i Tij. Ai është 'ebter'." Pas kësaj, Allahu i Lartë zbriti ajetin: "**Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë.**".

Disa transmetues të tjerë, përcjellin një ngjarje tjetër ku thonë se, kur djali i të Dërguarit të Allahut ndërroi jetë, armiqtë e tij flisnin me njëri-tjetrin duke thënë: "Muhamedit sonte iu shua soji (ebter)". Pas kësaj, Allahu (xh.sh.) zbriti suren Keuther.

I vetmi transmetim, i cili tregon se kjo sure mund të ketë zbritur në Medine, është transmetimi që flet rreth vdekjes së Ibrahimit (paqja qoftë mbi të). Ndërsa, të gjitha transmetimet e tjera flasin rreth ngjarjeve të ndodhura në Meke dhe vërtetojnë se kjo sure ka zbritur në Meke. Mendimi i dytë është ai më i përhapuri mes dijetarëve.

Ajo që kuptohet nga këto transmetime është se, mohuesit, duke përdorur fjalën "ebter", nënkuptojnë se të Dërguarit të Allahut i është shuar vazhdueshmëria e trungut familjar dhe njëkohësisht, as profetësinë nuk do ta trashëgojë dot. Si duket, këto fjalë do ta kenë rënduar shumë të Dërguarin e Allahut e, për këtë arsye, Allahu i Lartë i ka zbritur suren Keuther. Në këtë sure, Ai (xh.xh.), i thotë të Dërguarit të Tij se me dhënien e profecisë, Ai (xh.xh.) i ka dhuruar shumë të mira, saqë emri i tij (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), do të përmendet përgjithmonë. Gjithashtu, i rikujton se ata që e urrejnë të Dërguarin e Tij, në fakt janë pikërisht ata që u është shuar soji. Në fund, Allahu (xh.sh.) e urdhëron të Dërguarit të Tij që të falë namaz dhe të therë kurban për Të, si shenjë falënderimi ndaj mirësive që Allahu i ka dhuruar.

Kjo sure, krahas numrit të paktë e të shkurtër të ajeteve që ka, brendia e saj është si një plotësuese për të gjitha suret e tjera paraardhëse dhe si një gurë-themel për suret e tjera që vijnë pas saj. Në veçanti, me suren Maun, ajo ka një lidhje shumë të fortë kuptimore me fenomenet negative, të cilat trajtohen në suren Maun dhe me ato pozitivet të trajtuara në suren Keuther. Për shembull:

1. Në suren Maun flitet rreth veçorive të mohuesve dhe mosbesimtarëve, ndër të cilat është edhe përgënjeshtrimi i jetës tjetër (Ahiretit). Ndërsa në suren Keuther, flitet rreth besimit në jetën tjetër.

2. Në suren Maun flitet rreth një tjetër veçorie të mohuesve e cila është koprracia dhe jo-njerëzorja. Ndërsa në suren Keuther flitet rreth cilësive pozitive si lëmosha, ndihma, bamirësia. Nënkuptime të cilat rrjedhin nga fjala "Keuther".

3. Në suren Maun, flitet rreth një cilësie tjetër negative të mohueseve, mosbesimtarëve dhe hipokritëve e cila është të falurit namaz për t'u dukur. Ndërsa në suren Keuther, tregohet cilësia e mirë e besimtarëve e cila është falja e namazit, pra kryerja e adhurimeve vetëm për Zotin. Kjo kuptohet qartë nga fjala "Li-Rabbike" (për Zotin tënd).

4. Në suren Maun flitet rreth koprracisë së mohuesve, qoftë kjo edhe për gjërat më të vogla. Ndërsa në suren Keuther, flitet rreth bamirësisë dhe lëmoshës duke therur kurban.

TEFSIRI

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ

1. Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira

Ky ajet i drejtohet të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Me fjalën "**Ne të kemi dhënë Ty**" nënkuptohet madhështia e Allahut të Lartë. Ashtu siç tregon Madhështinë e Dhuruesit, kjo fjalë tregon edhe madhështinë e asaj që dhurohet, pra Keutherit. Allahu (xh.sh.) në vend të përdorimit të kohës së ardhme "Ne do të japim ty Keutherin (shumë të mira)", ka përdorur kohën e kryer të thjeshtë, duke treguar kështu një veprim, kryerja e të cilit ka marrë fund dhe do të dhurohet patjetër, pra "**Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira**".

الْكَوْثَرَ Keuther: Origjina e kësaj fjale është "kethijr" e cila ka kuptimin, shumë, në nivel ekstrem, sa më shumë, me tepri. Një kuptim tjetër i kësaj fjale është: Emri i një lumi në Xhenet prej të cilit degëzohen të gjithë përrenjtë e tjerë. Sipas disa gjuhëtarëve, ka edhe kuptimin, shumë të mira ose shumë mirësi. Këtu nënkuptohet Kurani, ndërmjetësimi, dituria, e shumë cilësi të tjera të mira.

Për sa i përket kuptimit më specifik të kësaj fjale, duhet të parashtrojmë mendimet që kanë dijetarët e shkencës së interpretimit të Kuranit. Rreth komentimit të kësaj fjale, kemi hasur rreth njëzetë e gjashtë mendime të ndryshme. Më poshtë, do të përmendim disa që janë më të rëndësishmet dhe më të përdorurat ndër to.

E para: Kuptimi më i lëvruar mes librave të interpretimit të Kuranit, rreth fjalës Keuther është lumë në Xhenet. Ky kuptim është përftuar nga një hadith i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.) ku thotë: "*Keutheri, është një lumë të cilin Allahu ma ka dhuruar mua në Xhenet.*"[107] Në një transmetim tjetër, thuhet: "*(Keutheri) është një luginë e madhe, në të cilën gjinden shumë mirësi. Bashkësia ime do të pijë prej këtij uji. Numri i tasave do të jetë sa numri i yjeve. Aty do të ketë edhe njerëz të cilët do të hidhen brenda. Unë do të them: 'O Zoti im! Ata janë prej popullit tim.' (Do të më thuhet): 'Ti nuk e din se ç'kanë bërë ata pas teje'.*"[108] Në këtë hadith, fjala Keuther është përdorur në kuptimin e shumë të mirave por duke pasur në epiqendër kuptimin e kësaj fjale si lumë në Xhenet. Për sa i përket veçorive të këtij lumi, këtë na e sqaron një hadith tjetër, ku thotë: "*Brigjet e tij janë të rrethuara me perla në formë kubesh. Lumi kundërmon një aromë shumë të mirë misku. Është më i bardhë se qumështi dhe më i ëmbël se mjalti. Gjatësia dhe gjerësia e tij janë sa hapësira e lindjes me perëndimin, ndërsa thellësia, është në një hark kohor prej shtatëdhjetë mijë vitesh. Kush do të pijë nga ky ujë, nuk do të ketë më etje asnjëherë. Kush do të marrë abdes prej këtij uji, nuk do ta gjejë asgjë e keqe. Kush e thyen besën që*

[107]. Buhari, *Tefsiru Sure* 108, 1; Muslim, *Salat* 53, *Fedail* 37, 40, *Taharet* 36; Nesai, *Iftitah* 21; Tirmidhi, *Kijamet* 15; Ibn Maxhe, *Zuhd* 36; Musned, III, 102, 281.
[108]. Buhari, *Rikak* 53.

më ka dhënë mua dhe kush vret një prej prestarëve të ehli-Bejtit (pasardhësve të Mi), nuk ka për pirë asnjëherë prej këtij uji."[109]

Hadithet rreth hauzit (lumit-vendgrumbullimit të ujërave) të Keutherit, janë transmetuar me miratim të gjerë. Duke u bazuar në këto transmetime, dijetarët e fushës së besimit janë të mendimit se besimi në ekzistencën e këtij burimi është vaxhib (i domosdoshëm). Edhe pse nuk ka diskutim se Keutheri i është dhënë të Dërguarit të Allahut, (siç citohet në këtë sure), nuk mund të thuhet e njëjta gjë për sa i përket të qenët të tij një burim, lumë apo hauz, sepse të gjitha këto mendime mund të jenë të sakta, por nuk mund të jetë vaxhib (i domosdoshëm) besimi në llojin e tij. Kjo, për shkak se, ekzistojnë edhe mendime të tjera rreth specifikave të tij.

E dyta: Sipas mendimit të Ikrimes, ajo që nënkuptohet me fjalën Keuther, është vetë profetësia. Pasi me dhënien e profetësisë, atij (sal'la llahu alejhi ue selem) i ishin dhënë të mirat e kësaj bote e të jetës tjetër (Ahiretit).

E treta: Janë dijetarët e bashkësisë islame. Me të vërtetë që mirësia më e madhe janë dijetarët, sepse ata janë trashëgimtarët e diturisë dhe moralit profetik.

E katërta: Janë ndjekësit e shumtë të Dërguarit të Allahut. Allahu i ka dhënë një mirësi aq të madhe të Dërguarit të Tij, saqë më shumë se gjysma e banorëve të Xhenetit, transmetohet se do të jetë nga populli i të Dërguarit të fundit.

E pesta: Pasardhësit e shumtë të të Dërguarit të Allahut. Meqenëse kjo sure zbriti për shkak të fyerjes që bënë mohuesit ndaj shuarjes së familjes së të Dërguarit të Allahut, duke përdorur fjalën "ebter", mund të mendohet se kuptimi i përshtatshëm i kësaj fjale është ky. Pra, një kundërpërgjigje se jo vetëm që nuk do të shuhet kurrë soji i tij, por ai do të ketë fëmijë, nipër dhe trashëgimtarë brez pas brezi. E në të vërtetë kështu ka ndodhur.

Megjithëse kësaj fjale i janë dhënë shumë kuptime të tilla të ndryshme, shumica e ekspertëve të interpretimit të Kuranit, i kanë dhënë kuptimin "shumë të mira". Kjo, për shkak se edhe kuptimi bazë në fjalor, është ky. Po ashtu,është një kuptim shumë herë më i gjerë, i cili lë hapësira për më shumë nënkuptime dhe përfshin në të, të gjitha llojet e mirësive.

فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَانْحَرْ

2. Andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban

E nuk kishte mënyrë tjetër më të mirë, për të çuar në vend falënderimin ndaj mirësive të pafund (keuther), vetëm se duke bërë atë çka urdhërohet nga ajeti.

[109]. Buhari, *Rikak* 53; Muslim, *Salat* 53; Ebu Davud, *Salat* 122; Sunen 23; Tirmidhi, *Tefsiru Sure* 108, 1; Nesai, *Iftitah* 21; Darimi, *Rikak* 113; Musned III, 102.

Për Zotin tënd: Kjo pjesë e këtij verseti, do të thotë se atë që e bën, ta bësh me sinqeritet të plotë, vetëm e vetëm për hir të Zotit, Një, të Vetëm e të Pashoq. Për ta bërë akoma më të qartë mënyrën se si duhet të falet namazi, pas fjalës "falu" menjëherë është përdorur togfjalëshi "**për Zotin tënd**".

Dhe ther kurban: Krahas namazit që fal, ther edhe kurban. Kjo, të jetë si një kundërveprim ndaj atyre që ngurojnë të japin edhe gjënë më të vogël. Ndërsa ti, ji i gatshëm që të therësh e të sakrifikosh diçka të çmueshme, të kushtueshme dhe me vlerë (deve, lopë, dele, dhi) vetëm për Zotin tënd. Ashtu siç e fal namazin vetëm për Allahun, po me këtë qëllim dhe ndjesi, të therësh edhe kurbanin. Pra, të dyja bëji me një qëllim të pastër dhe të sinqertë vetëm për Allahun (xh.sh.). Ashtu siç nuk mund të quhet më namaz, një namaz i falur jo për Allahun, po ashtu nuk quhet kurban diçka që nuk është therur për Allahun. Për më tepër, jo vetëm që nuk mund të konsiderohet kurban, por nëse ajo kafshë është therur në emër të dikujt tjetër, apo nuk është thënë "bismilah" në momentin e therjes, e bërë kjo me dijeni, atëherë ajo kafshë nuk është gjë tjetër vetëm se diçka e ngordhur dhe haram për t'u ngrënë.

Siç e shohim, në këtë ajet, vihet re një nxitje për seriozitet, përkushtim dhe vendosmëri në faljen e namazeve të detyrueshme dhe ato vullnetare. Akoma më tej, ky ajet sinjalizon për të mos u vetëmjaftuar për të shprehur falënderimin vetëm me namaz, por falënderimet të shprehen edhe duke bërë sakrifica materiale, siç është therja e kurbanit. E në fund, të gjitha llojet e adhurimeve, të kurorëzohen me: "**Thuaj: 'Në të vërtetë, namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij'.**"[110]

Disa dijetarë, thonë se në fjalën "falu" të këtij ajeti, nënkuptohet kryerja e pesë namazeve gjatë ditës. Disa të tjerë kuptojnë se këtu bëhet fjalë për faljen e namazit të kurban bajramit. Një mendim tjetër është edhe se këtu bëhet fjalë për faljen e namazit të kurban bajramit dhe pas faljes, therja e kurbanit. Megjithatë, nëse do ta analizojmë mirë rrjedhën e ngjarjes, ajeti sikur thotë kështu: "O i Dërguar! Zoti ty të ka dhënë aq shumë të mira, saqë ti tani fal namaz dhe bëj kurban për hir të Tij!"

Namazi i kurban bajramit dhe kurbani, u legjitimuan për umetin (bashkësinë e Profetit të fundit) në ditën e dhjetë të muajit Dhul-hixhe, në Medine. Mirëpo, obligueshmëria në zbatueshmërinë e namazit të bajramit dhe të therjes së kurbanit, nuk u urdhëruan nëpërmjet kësaj sureje, sepse kjo është sure e zbritur në Meke, por nëpërmjet praktikës së Profetit (s.a.s.). "*Tre gjëra më janë bërë mua detyrim ndërsa umetit tim, jo. Ato janë: namazi i duhasë, therja e kurbanit dhe namazi i vitrit.*"[111] Do të thotë se, disa gjëra që edhe pse të Dërguarit të Allahut i janë bërë detyrim, umetit të tij nuk i janë bërë të detyrueshme. Kështu që, edhe ato të cilat nënkuptohen prej fjalëve "falu" dhe "ther kurban" në këtë ajet, nuk janë të kategorisë së farzeve. Ato janë të kategorisë së vaxhibeve. Jo vetëm namazi i bajramit, por edhe therja e kurbanit, janë prej vaxhibeve. "*Kush ka mundësi të mira ekonomike dhe nuk ther kurban, mos t'i afrohet xhematit tonë (bashkësisë sonë)*".[112] "*Therni kurban në ditën e bajramit, sepse kjo është*

110. En'am, 6:162-163.
111. Musned, I, 231; Sujuti, *ed-Durru`l-Mensur*, I, 536.
112. Ibn Maxhe, *Edahi* 2; Musned, II, 321.

një traditë profetike prej babait tuaj Ibrahimit (paqja qoftë mbi të)."[113] Therja e kurbanit pas faljes së namazit të kurban bajramit, është praktikuar nga vetë i Dërguari i Allahut. Ky veprim i zbatuar nga ana e tij, nuk është bërë farz (detyrë) për umetin, por është synet i pabraktisur ndonjëherë prej Tij. Me kalimin e kohës, ky synet ka zënë një vend shumë të rëndësishëm në fe dhe në simbolet e saj, saqë herë-herë ka marrë edhe nuancat e një praktike afër farzit. Edhe pse një praktike të tillë nuk mund t'i thuhet farz, duke marrë shkas thënien e Profetit se: "*Kush ka mundësi të mira ekonomike dhe nuk ther kurban, mos t'i afrohet xhematit tonë* (bashkësisë sonë)", medhhebi hanefi e ka stabilizuar këtë çështje duke e kategorizuar në nivelin e vaxhibit. Pavarësisht se, ka një argument të fshehur brenda ajetit, ky gjykim nuk kategorizohet në nivelin e farzit, por në atë të vaxhibit, dhe ky i fundit nuk është gjë tjetër vetëm se një përngjasim i farzit. Në hadithet profetike është sqaruar se kafshët që mund të theren për kurban, janë dashi, delja, dhia, lopa, viçi, deveja.

Zakonisht, në Kuran, kur flitet për namazin, menjëherë pas tij vjen zekati. Mirëpo, në këtë sure, pas namazit flitet për kurbanin për shkak të ngjashmërisë që kurbani ka me zekatin. Pra, në këtë sure të shkurtër, i është kushtuar vëmendje edhe nevojave të të varfërve e nevojtarëve, duke u gjendur pranë tyre me ndihma materiale, siç është edhe mishi i kurbanit.

Nëse do t'i bëjmë një përmbledhje të shkurtër atyre që u parashtruan deri më tani, mund të themi kështu: Falënderoje Zotin tënd për të mirat aq të shumta që të ka dhënë (keuther), duke kryer ndaj Tij adhurim trupor, pra duke falur namaz dhe duke kryer adhurim material, pra duke therur kurban për Të. Adhuroje Zotin me sinqeritet dhe me përkushtim, si shenjë falënderimi ndaj mirësive të Tij të panumërta që të ka dhuruar. Nëse je falënderues, Zoti nuk do t'i ndërpresë asnjëherë mirësitë e Tij ndaj teje.

Një besimtar, i cili lexon Kuran, duhet t'i mendojë dhe t'i përjetojë ajetet kuranore sikur po i zbresin atij. Në këtë linjë, duhet të nxjerrë këtë mësim: Të jetë falënderues për të gjitha mirësitë të cilat Allahu i ka dhënë atij deri më sot. Të mendojë rreth tyre dhe t'i shtojë falënderimet, duke falur sa më shumë namaz dhe duke therur sa më shumë kurbane për hir të Allahut të Lartësuar.

إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ

3. Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë

Sigurisht, ai që të urren ty: Kushdo që ka urrejtje ndaj teje, dhe ndjen në brendinë e tij dëshirë për hakmarrje, qoftë e pakët apo e shumtë, në të vërtetë "**ai vetë është fatprerë**". Pra, atij që do t'i shuhet trungu, do t'i ndërpritet soji, do të shuhet, nuk do të jesh ti o Muhamed (s.a.s.), por ai që të urren ty. Ndërsa soji yt do të vazhdojë, e prej teje do të vijnë shumë njerëz, të cilët do t'u sjellin mirësi shoqërisë. Prej teje do të dalin shumë njerëz, të cilët do të jenë tregues për vazhdimin e sojit tënd. Edhe në jetën e pafundme (Ahiret), ti do të jesh prej të begatuarve, prej të shpërblyerve me shumë të mira.

---

[113]. Ibn Maxhe, *Edahi* 3.

(Ebter) Fatprerë: Kuptimi leksikor i fjalës "ebter" është të jesh i prerë, pa vazhdim. Ndërsa kuptimi terminologjik, është, shuarja e sojit. Mosvazhdimi i trungut familjar dhe mospasja e një trashëgimtari, pra mungesa e një trashëgimtari të hairit, të mirë.

Profeti Muhamed (s.a.s.) shprehet në një hadith: "*Çdo punë e cila nuk fillon me (Bismilah) me emrin e Allahut, ajo punë është e shuar (ebter) që në krye*".[114] Pra nuk ka vazhdim, e nuk ka mirësi. Këto janë disa nga kuptimet e nxjerra prej një hadithi tjetër, në të cilin përmendet fjala "**ebter**".

Kushdo që të thotë ty se të është shuar soji, për shkak se djali yt ndërroi jetë, ai është vetë soj-shuar. Me të vërtetë, kushdo që i ka thënë diçka të tillë të Dërguarit të Allahut, i është shuar soji. Ata, ose janë shuar fizikisht, pra nuk kanë pasur pasardhës, ose janë shuar shpirtërisht, pra emri i tyre është përmendur vetëm për keq dhe ashtu janë fshirë nga kujtimet e njerëzve. Askush nuk ka parë mirësi, qoftë edhe prej atyre që fizikisht u ka vazhduar soji, por që e kanë fyer të Dërguarin e Allahut në këtë formë.

Ata që e kanë akuzuar apo kanë dëshiruar për Profetin diçka të tillë, gjithmonë kanë pasur si arsyetim mospasjen e një djali nga ana e të Dërguarit të Allahut. Mirëpo kanë harruar se vazhdueshmëria e brezit, e sojit, është edhe nëpërmjet vajzës. Vajza, fëmijët e saj, më pas fëmijët e tyre, më pas fëmijët e tyre, e me radhë, janë të gjithë vazhdimi i sojit dhe i familjes së Profetit (s.a.s.). Sigurisht që, edhe fakti se djemtë e të Dërguarit të Allahut kanë ndërruar jetë që të vegjël dhe soji i tij ka vazhduar ndërmjet vajzës së tij, ka një urtësi. Ndër to, mund të jetë fakti se profetësia është mbyllur me të Dërguarin e fundit (s.a.s.). Profetit i janë dhënë edhe djem edhe vajza. Po ashtu, Allahu i ka mundësuar vazhdimin e sojit të tij nëpërmjet vajzës së tij. Mirëpo, profetësia i është dhënë vetëm të Dërguarit të Allahut, Muhamedit (s.a.s.), e askujt tjetri. Profetësia është mbyllur me të dhe nuk mund të vazhdojë më. Pas tij, do të jenë vetëm libri i shenjtë, Kurani dhe Tradita e tij (Suneti). Mirëpo, nëse djemtë e të Dërguarit të Allahut do të jetonin, mund edhe të binin pre e mendimeve për trashëgiminë e profetësisë, ose mund të ishin objekt për turbullirat që do të krijonte më vonë historia e njerëzimit, për të shkatërruar besimin e pastër. Kështu që, për t'i mbrojtur ata nga një gjendje e tillë, Allahu e ka parë më të hajrit që të jetë kështu. Edhe nëse djemtë e të Dërguarit të Allahut nuk do të pretendonin apo nuk do të vendoseshin nga të tjerët në pozitat e trashëgimtarit të profetësisë, një mundësi e madhe është që ata të konsideroheshin si udhërrëfyesit, udhëheqësit fetarë pas tij. Atëherë një fenomen i tillë, do të dëmtonte rëndë meritokracinë në pozicione të ndryshme dhe do të vendoste një tabu se lidershipet mund të trashëgohen. Gjë që bie ndesh me mësimet profetike. Ndërsa për sa i përket grave, duke qenë se ato nuk mund të jenë profetë, të dërguara, atëherë nuk ka asnjë problem nëse soji i të Dërguarit të Allahut vazhdon prej së bijës së tij. Kështu, këtë aspekt mund ta përmbledhim në dy arsyetime të urta kryesore, të cilat janë: Mos vazhdueshmëria e profecisë pas të Dërguarit të Allahut dhe paprekshmëria e një kriteri hyjnor, siç është meritokracia, duke mos hapur derën e trashëgimisë së lidershipit fetar nga babai te djali. Nuk mund të biem dakord me tezën që kanë hedhur mohuesit se trashëgimia e një babai vjen vetëm nga djali. Trashëgimia e babait vazhdon edhe nëpërmjet vajzës. Këtë sinjal na jep edhe ky ajet kuranor dhe mund të themi se është një ajet, i cili na jep një lajm nga e fshehta.

---

[114]. Bejhaki, *e`s-Sunenu`l-Kubra*, III, 209.

Mohuesit, duke u shprehur në këtë formë, kanë shpresuar më tepër që Profetit t'i ndërpritej trashëgimia shpirtërore. Pra, pas vdekjes së tij, askush më nuk do të kujtohej për të. Askush nuk do ta ndiqte, e askush nuk do ta përmendte më. Mirëpo, ai u përmend, u njoh, u kujtua, u studiua dhe akoma përmendet, kujtohet e studiohet nga miliona njerëz në mbarë botën. Fakti që, sot ai ndiqet nga miliona besimtarë në mbarë botën, të cilët kanë mbushur xhamitë, është një demonstrim në praktikë i lajmit që jep kjo sure.

Siç e kemi thënë edhe në interpretimin e sures Fatiha, qëllimet e Kuranit, janë katër:

1- Teuhidi, Njësimi i Allahut
2- Profetësia
3- Jeta e pafundme (Ahireti)
4- Të qëndruarit i palëkundur në adhurime dhe në drejtësi

Këto katër qëllime që përmendëm, janë të dukshme edhe në suren më të shkurtër të Kuranit, në suren Keuther:

1- "**Ne të kemi dhënë ty**", është tregues për Njësimin e Zotit.

2- "**Të kemi dhënë ty**", është tregues për profetësinë.

3- "**Të kemi dhënë ty shumë të mira (keutherin)**", është tregues për jetën tjetër, sepse siç e sqaruam edhe më lart, një nga kuptimet e fjalës keuther, është një luginë, lumë, hauz i madh, i cili do t'i jepet të Dërguarit të Allahut në jetën tjetër, në Xhenet.

4- "**Andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!** ", është tregues për vendosmërinë në adhurime dhe në drejtësi. Të falurit namaz në mënyrë të vazhdueshme është një qëndrim i palëkundur që besimtari shpalos në adhurime. Ndërsa, të ushqyerit e të varfërve me mishin e kurbanit të therur, është një shenjë e drejtësisë, e cila vihet në zbatim duke u dhënë të varfërve nga ajo që të pasurit kanë.

SURJA KAFIRUN – 109

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ (1) لا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ (2) وَلا أَنتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ (3) وَلا أَنَا عَابِدٌ مَّا عَبَدتُّمْ (4)

وَلا أَنتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ (5) لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ (6)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Thuaj: "O ju mosbesimtarë!

2. Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni

3. dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj.

4. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni

5. dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!

6. Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!"

E zbritur në Meke, ka gjashtë ajete. Kjo sure e ka marrë emrin prej ajetit të parë. Kjo sure, na informon se myslimanët qëndrojnë të palëkundur përballë mohuesve, duke u kapur fort pas teuhidit (monoteizmit), dhe, në të njëjtën kohë, nuk ja imponon mosbesimtarëve me forcë Islamin por i lejon ata që të bëjnë zgjidhjen e tyre. Dhe kështu, thekson principin e lirisë së fesë në Islam.

Kjo sure quhet edhe "Surja Ibadet" apo "Surja Ihlas". Për këtë arsye, surja "Kul hue Allahu ehad" dhe kjo sure quhen të dyja së bashku "Ihlasejn", pra, dy ihlas. Po ashtu, në transmetimet e Ibn Omerit (r.a.) dhe Aishes (r.a.) vërehet se, Profeti (alejhi selam) këndonte në namazin e sabahut e të akshamit "kul ja ejuhel kafirun" dhe "kul hu-Allahu Ehad", që në transmetim përmenden si "Ihlasejn".[115]

Profeti ynë (s.a.s.) thotë në një hadith: "*A t'ju tregoj një sure që ju ruan nga shirku* (politeizmi)?", më pas vijon: "*Para se të flini këndoni suren (Kul ja ejuhel kefiru).*"[116]

Në një tjetër hadith ka thënë: "*Kjo sure është sa një e katërta e Kuranit.*"[117] Rreth interpretimit të këtij hadithi ka pasur mendime të ndryshme, më i thjeshti është ky: Sipas një mendimi, temat që trajton Kurani janë këto: Adhurimet, marrëdhëniet, ahireti dhe ngjarjet historike. Kjo sure, meqenëse urdhëron shpalljen publike të teuhidit dhe ihlasit (sinqeritetit) që janë shpirti i fesë, ka kuptimin e një të katërtës së Kuranit.

Shkaku i zbritjes

Disa politeistë nga paria e Kurejshëve i propozojnë Profetit Muhamed (s.a.s.) që të ndiqte fenë e tyre në mënyrë që edhe ata të ndiqnin fenë e tij, të adhuronte një vit zotat e tyre, pastaj edhe ata do të adhuronin një vit Zotin e tij. Profeti alejhi selam u tha: "Më ruajttë Allahu nga adhurimi i dikujt tjetër përveç Tij." Pastaj ata i kërkuan që të prekte me dorë disa prej idhujve të tyre, që edhe ata ta pranonin atë dhe të adhuronin Zotin e tij. Fill pas kësaj ngjarjeje zbriti surja Kafirun. I Dërguari i Allahut në mëngjes shkoi në Mesxhidu Haram, në Qabe. Atje ndodhej një grup nga paria e

115. Ibn Maxhe, Ikamet 102.
116. Sujuti, ed-Durrul Menthur, VIII, 657.
117. Kurtubi, XX, 224; Alusi, Ruhul Meani, Bejrut, 1985, XXX, 249.

Kurejshëve, i lexoi atyre këtë sure, dhe kështu ata i humbën shpresat për pranimin e propozimit të tyre.[118]

Si fillim, kjo sure u drejtohej Kurejshëve dhe zbriti pas propozimit të tyre. Por, vlefshmëria e sures nuk është e kufizuar vetëm për atë periudhë e për ata njerëz. Ky urdhër, që përmendet në Kuran, do të jetë i vlefshëm deri Ditën e Gjykimit. Sido që të jetë feja e mohuesve, duhet qëndruar larg saj me fjalë e vepra.

TEFSIRI

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ

1. Thuaj: "O ju mosbesimtarë

Rreth faktit pse surja fillon me foljen **قُلْ Kul**, interpretuesi i madh i Kuranit er-Razi, ka përmendur mbi dyzet hollësi të ndryshme. Shtjellimi i tyre mund të zgjasë, kështu që, po mjaftohemi me përmendjen e disa prej tyre: E para, ky fakt është argument se Profeti (a.s.) nuk flet nga vetja e Tij, por që është i ngarkuar me detyrë nga Allahu i Lartë. Profeti (s.a.s.) u drejtohet atyre "O ju mosbesimtarë", duke e ditur se kjo shprehje i acaronte ata, dhe ky është një argument se, Ai mbrohej nga Allahu i Lartë dhe se nuk trembej prej idhujve të tyre.

Thirrja "O ju mosbesimtarë", nuk është e përgjithshme për të gjithë mohuesit, por, është e veçantë për disa mohues që Allahu i Lartë i di se nuk do besojnë asnjëherë. Fjala "**kafirun, mosbesimtarë-mohues**" nuk është përdorur për t'i ofenduar mosbesimtarët, por, për të shprehur një të vërtetë. Në gjuhën arabe, fjala kafir përdoret për mohuesit e mosbesimtarët, antonimi i së cilës është "**mu'min, besimtar**". Pra, ai që pranon dhe nënshtrohet. Në fakt, urdhri i Allahut Profetit të Tij që t'i drejtohet atyre "**O ju mosbesimtarë**", ka kuptimin "O ju që mohoni profetësinë dhe largoheni nga urdhri im". Në të njëjtën formë, përdorja e fjalës "mu'min" ka kuptimin e atyre që "i besojnë Muhamedit alejhi selam".

Në ajet përdoret shprehja "O ju mosbesimtarë", dhe nuk është përdorur shprehja "O ju politeistë apo idhujtarë". Për rrjedhojë, ajeti nuk i drejtohet vetëm politeistëve (mekas), por të gjithë atyre që nuk e pranojnë Muhamedin (alejhi selam) si të Dërguarin e Allahut dhe atyre që i kundërshtojnë urdhrat e sjella prej tij. Këta mund të jenë: Hebrenjtë, të krishterët, zoroastrianët apo politeistët e idhujtarët. Ajeti nuk i drejtohet vetëm politeistëve kurejsh apo mohuesve që gjendeshin në gadishullin arabik, por i drejtohet të gjithë mohuesve dhe politeistëve në të katër anët e botës.

Thirrja "O ju mosbesimtarë" që u bëhet mohuesve, qafirëve, është si t'i thërrasësh dikujt "O armik, o kundërshtar!" Për rrjedhojë, duhet pasur parasysh fakti se, kur i thërret dikujt në këtë mënyrë, nuk ke për qëllim personin individualisht, por si ke si qëllim cilësitë e tij. Kështu që, ajeti i drejtohet atij personi për aq kohë sa ai posedon cilësitë e mohuesit. Nëse ai heq dorë nga armiqësia e mohimi dhe

[118]. Sujuti, ed-Durrul Menthur, VIII, 654.

kthehet në mik e mbrojtës, atëherë ajeti nuk i drejtohet më atij. Pra, thirrja që u bëhet atyre "O ju mosbesimtarë", nuk është për vetë ata si persona, por për shkak të mohimit të tyre. Ata që vazhdojnë deri në fund të jetës së tyre në këtë situatë, përfshihen në gjykimin e ajetit. Ndërsa, ata që heqin dorë nga mohimi e bëhen besimtarë nuk përfshihen më në këtë gjykim.

لا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ

2. Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni

Pra, unë nuk adhuroj ato idhuj që ju i cilësoni si zot dhe i adhuroni vazhdimisht, dhe që kërkoni prej meje t'i adhuroj. Ose, ajo që më kërkoni mua, që të adhuroj idhujt tuaj, unë as më parë nuk e kam bërë (pra, para se të më vinte profetësia) dhe nuk kam për ta bërë asnjëherë.

وَلا أَنتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ

3. Dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj.

As ju, nuk po e adhuroni Zotin tim të vërtetë që unë e adhuroj me teuhid dhe sinqeritet, as në të kaluarën nuk e keni adhuruar dhe nuk e adhuroni. Ai është Zoti i vetëm. Unë adhuroj Zotin e Vërtetë. Ai, është Zoti i botëve, Allahu (xh.sh.). Ndërsa ju, adhuroni idhuj e gurë. Sa larg që është adhurimi i Mëshiruesit nga adhurimi i epsheve, statujave dhe idhujve.

وَلا أَنَا عَابِدٌ مَّا عَبَدتُّمْ

4. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni

Ky ajet, është përforcues i qëndrimit larg adhurimit të statujave që u tregua më parë dhe jua lë mosbesimtarëve dëshirat në fyt. Sikur do të thotë: As në të ardhmen e as tani nuk i adhuroj idhujt tuaj. Unë, sa të jem gjallë nuk kam për t'i adhuruar asnjëherë idhujt që ju i adhuroni. Idhujt tuaj nuk i adhuroj tani, e as kam për t'i adhuruar në të ardhmen.

وَلا أَنتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ

5. Dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!

لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ

6. Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!"[119]

"**Ju keni fenë tuaj**", pra e gjithë përgjegjësia ju takon juve, dënimi, i gjithë gjynahu është i juaji, "**ndërsa unë kam fenë time**". Pra, feja e vërtetë, Islami, është feja ime. Shpërblimi dhe të mirat më përkasin mua. Ju keni politeizmin tuaj, ndërsa unë kam Allahun, e Vetëm e të Pashoq. Kjo tregon se Profeti Muhamed (alejhi selam) është shumë larg adhurimit që politeistët i bëjnë idhujve të tyre, dhe thekson se ai (s.a.s.) adhuron Allahun e Plotfuqishëm dhe të Vetëm.

Interpretuesit e Kuranit thonë se: Në dy fjalitë e para tregohet se, njerëzit janë shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri në çështjen e Zotit. Zotët e politeistëve janë statujat e idhujt e tyre, ndërsa Zoti i Muhamedit (a.s.) është Allahu i Lartë. Ndërsa, në dy fjalitë e fundit tregohet se, janë shumë të ndryshëm në çështjen e adhurimit. Profeti Muhamed (alejhi selam) sikur ka dashur t'u thotë: "As Zotin se kemi të njëjtë, e as adhurimin." Pra, feja ime është tjetër dhe feja juaj tjetër. Unë nuk jam prej atyre që adhurojnë statujat tuaja, e as ju nuk jeni prej atyre që adhurojnë Zotin tim. Unë nuk mund t'i adhuroj idhujt tuaj. Dhe, as ju nuk jeni gati që të adhuroni Zotin tim. Për rrjedhojë, rruga ime dhe rruga juaj nuk mund të bashkohen asnjëherë. Kjo shprehje nuk është për t'iu dukur mosbesimtarëve si i mirë, por është për të treguar se, për aq kohë sa ata e vazhdojnë këtë rrugë, duhet të shkëputen marrëdhëniet me ta. Në njëjtën kohë, përfshihet edhe fakti se, mosbesimtarët nuk mund të bien asnjëherë dakord me Profetin (s.a.s.) dhe ata që i besojnë atij, dhe që duhet t'i presin shpresat në këtë aspekt.

Kjo sure që ka zbritur si përgjigje për propozime të tilla nga politeistët, tregon se, gjithsecili është i lirë, që me ndërgjegjen e tij, të besojë çka të dojë, të veprojë si të dëshirojë dhe se do të japë llogari për veprat që ka kryer. Me të vërtetë që Kurani Fisnik ka sjellë lirinë e ndërgjegjes. Nuk ka urdhëruar që askush të konvertohet në fe me dhunë dhe që as Profeti (alejhi selam) nuk është një despot që i detyron njerëzit në fenë e tij, por është shprehur se Profeti (a.s.) është paralajmërues dhe këshillues: "**Detyra jote është vetëm të kumtosh.**"[120] Dhe në shumë ajete të tjera si këto tregohet se detyra e Profetit (s.a.s.) nuk është t'i detyrojë njerëzit në fe, por të kumtojë të vërtetat; "**por ti nuk do ti detyrosh ata me dhunë (që të besojnë)**"[121] pra, ti nuk je imponues në fenë Islame. "**Nuk ka detyrim në fe**"[122], "**Thuaj: 'O njerëz, ju erdhi e Vërteta nga Zoti juaj. Kush udhëzohet në rrugën e drejtë, ai është udhëzuar për të dobinë e vet dhe kush e humb rrugën e drejtë, ka humbur në dëmin e vet, ndërsa unë nuk jam mbikëqyrësi juaj'.**"[123] Këto ajete dhe të tjerë janë shembull i qartë i lirisë së besimit në Islam.

Imam Ebu Hanife dhe Imam Shafiu, duke u bazuar në ajetin e 6-të të sures Kafirun, kanë thënë se, sado të ndryshme të jenë fetë e mosbesimtarëve me njëra-tjetrën, ata janë një popull i vetëm. Për rrjedhojë, një hebre mund të jetë trashëgimtar i një të krishteri, e një i krishterë mund të jetë

---

[119]. Origjinali i دِين është دِينِيَ . Por, "**je**" është fshirë duke u mjaftuar me kesren e nunit.
[120]. Surja Al 'Imran, 3:20, Nahl, 16:82, Shura, 42:48
[121]. Surja Kaf, 50:45
[122]. Surja Bekare, 2:256
[123]. Surja Junus, 10:108

trashëgimtar i një hebreu, apo një mosbesimtar i një feje tjetër mund të jetë trashëgimtar i një mosbesimtari tjetër.

SURJA NASR - 110

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ (1) وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا (2) فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا (3)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)

2. dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe,

3. atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.

E zbritur gjatë periudhës medinase, ka tre ajete. Surja Nasr, quhet ndryshe edhe si surja "Idha xha'e". Transmetohet nga Aishja (r.anha) të ketë thënë: Pas zbritjes se sures **إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ** Profeti (alejhi selam) në çdo namaz që falte lexonte shpesh në ruku dhe sexhde **سبحانك اللهم ربنا وبحمدك اللهم اغفر لي** "*Zoti ynë është i pastër nga të gjitha cilësitë që tregojnë mangësi! Të gjitha lavdet dhe lavdërimet janë për Allahun, Allahu im më fal mua.*"[124]

Omeri (r.a.) e ftonte Ibn Abasin (r.a.) në kuvendin e konsultimit edhe pse ishte në një moshë relativisht të vogël. Sahabeve të tjerë, që kishin marrë pjesë në luftën e Bedrit u dukej e çuditshme kjo situatë. Një ditë, Omeri (r.a.) pyeti të pranishmit në kuvend se çfarë mendonin rreth sures Nasr. Përgjigjet ishin të ndryshme. Në fund pyeti edhe Ibn Abasin (r.a.). Përgjigja e tij ishte: "Kjo tregon se Profeti e ka përmbushur detyrën e tij dhe i është afruar fundit të jetës në këtë botë". Omeri (r.a.) duke e vlerësuar për përgjigjen tha: "A ka njeri që e kundërshton pjesëmarrjen e këtij djaloshi në kuvendin tonë?"[125]

Transmetohet se kur zbriti kjo sure, Profeti Muhamed (s.a.s.) ka thënë: **نعيت إلي نفسي** "*Mu njoftua se do të ndërroj jetë*"[126]. Për këtë arsye kjo sure quhet edhe surja **التوضيع**, surja e "lamtumirës".

Në një transmetim tjetër thuhet se: Kur zbriti kjo sure Profeti (s.a.s.) e thirri Fatimen (r.a.) pranë vetes dhe i tha: **نعيت إلي نفسي** "*Mu njoftua se do të ndërroj jetë*", në fillim ajo qau, më pas buzëqeshi. Kur e pyetën për arsyen ajo thotë: "Në fillim më njoftoi se do të ndërronte jetë dhe qava, pastaj më tha se

---

124. Buhari, Tefsiru Sure 110, 1, 2; Muslim, Salat 218-220.
125. Buhari, Tefsiru Sure 110, 3.
126. Buhari, Tefsiru Sure 110, 3; Alusi, Rruhul-Meani, XXX, 326.

unë do të jem e para nga familja që do të shkoj pas tij në botën tjetër dhe u gëzova". Ka transmetime që kjo sure të ketë zbritur gjatë ditëve të teshrikut në Haxh, pra në Meke. Sipas disa interpretuesve të Kuranit kjo është surja e fundit e zbritur në Kuran, si sure dhe jo si ajet apo grup ajetesh.

TEFSIRI

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ

1. Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)

نَصْرُ اللَّهِ ka kuptimin "**ndihma e Allahut**". Premtimi i Allahut të Lartë për ndihmë dhe fitore se Profetin e Tij dhe besimtarët do t'i bëjë triumfues përballë armiqve të tyre. Kjo ndihmë dhe fitore, është fitorja e Profetit (s.a.s.) kundrejt politeistëve e arabëve, si dhe çlirimi i Mekës. Është thënë edhe që kjo është ndihma e Allahut për besimtarët dhe urdhri për çlirimin e vendeve të politeizmit nga besimtarët. Kuptimi i çlirimit nuk ka të bëjë vetëm me çlirimin e vendit, por më tepër ka të bëjë me çlirimin e zemrave me besim dhe islam. Arsyeja që ky çlirim është kuptuar si çlirimi i Mekës, është sepse zemrat e atyre që ishin të mbyllura ndaj fesë, për shkak të refuzimit që i bënë Kurejshët Islamit, pas çlirimit të Mekës dhe Taifit futen në Islam grupe-grupe.

Buhariu transmeton nga Amr b. Seleme të këtë thënë: Në kohën e çlirimit, të gjithë vrapuan për tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe u përqafuan Islamin. Të gjithë popujt i kishin sytë nga Meka për të pranuar Islamin dhe thoshin: "Le ta lëmë atë me popullin e tij, nëse ai fiton atëherë do të thotë se është profet".

"Çlirimi" për të cilin flitet në sure, ashtu siç thotë edhe shumica e dijetarëve se është çlirimi i Mekës, në të njëjtën kohë, është edhe hapja e zemrave ndaj fesë së Allahut. Me hapjen e derës së Islamit për të gjithë botën, ky u quajt si çlirimi i çlirimeve. Shtrirja e Islamit menjëherë në të gjithë gadishullin arabik dhe prej aty në të gjithë botën, çlirimet materiale dhe shpirtërore të Islamit filluan pas hapjes së dyerve të Qabes.

Sipas Meududit komentimi i ajetit është kështu: Ajo çka kuptohet nga Fet'h nuk është një fitore e caktuar në një luftë. Në fakt, këtu ka për qëllim një fitore të pakontestueshme. Kjo është një periudhë e tillë ku nuk ka mbetur më asnjë fuqi që t'i dalë përballë Islamit dhe Islami ka triumfuar në të gjithë Arabinë. Disa interpretues të Kuranit në këtë ajet kanë kuptuar çlirimin e Mekes. Por, çlirimi i Mekes ka ndodhur në vitin e 8-të hixhri, ndërsa kjo sure ka zbritur në fundin e vitit të 10-të hixhri. Ndër të tjera, edhe interpretimi i Ibn Abasit (r.a.) bie ndesh me këtë mendim. Ai është i mendimit se, surja Nasr është surja e fundit e zbritur në Kuran. Në këtë situatë, ajeti nuk mund të ketë kuptimin e çlirimit të Mekes, sepse surja Teube ka zbritur pas kësaj sureje. Atëherë, si është e mundur që surja Nasr të jetë surja e fundit e zbritur në Kuran?

Padyshim që, çlirimi i Mekes, nga një pikëpamje, mund të cilësohet si fitore e pakontestueshme, sepse pas kësaj ngjarje politeistëve iu dobësua hovi që kishin ndaj myslimanëve. Pavarësisht kësaj,

mes politeistëve kishte akoma forcë e fuqi të mjaftueshme. Vetëm pas fitoreve të arritura në Taif dhe Hunejn u bë e mundur që Islami të triumfonte në të gjithë Arabinë, dhe kjo ndodhi dy muaj pas çlirimit të Mekës.

Pra, kishte kaluar periudha kur njerëzit futeshin në Islam nga dy e nga tre, dhe tani kishte ardhur koha kur njerëzit futeshin në grupe e fise në Islam. Kjo situatë kishte filluar në fillim të vitit të 9-të hixhri. Për këtë arsye, ky vit u quajt si "viti i grupeve". Nga çdo cep i Arabisë njerëzit vinin në grupe tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i jepnin besën atij dhe futeshin në Islam. Kur Profeti (alejhi selam) kryen haxhin e lamtumirës në vitin e 10-të, të gjithë arabët ishin bashkuar nën një flamur dhe nuk kishte mbetur më asnjë politeist.

Sipas disa interpretuesve bashkëkohorë, me Fet'h nuk synohet çlirimi i vendeve, por më tepër ka si qëllim çlirimin e zemrave me iman dhe Islam. Ndoshta, ky është edhe më i madhi. Çlirimi i vendit madje kalon nga çlirimi i zemrave. Pa u çliruar zemrat, nuk mund të çlirohen vendet, edhe nëse arrihet, atëherë ky quhet pushtim e invazion.

وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا

2. Dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe

Në ajet nuk është shprehur **دخُلُوا u futën**, por **يَدْخُلُونَ duke hyrë**, duke dhënë sihariqin se nuk do të futen të gjithë njëherësh, por kur të fillojnë të futen do të vijojnë njëri pas tjetrit. "**Nas**" **njerëzit,** përfshin arabët dhe jo arabët, edhe ata që hyjnë në të ardhmen futen në këtë kategori. Pra, futen aq shumë, në **أَفْوَاجًا grupe-grupe** dhe në grupe. Pas çlirimit të Mekes nuk ka pasur luftë tjetër përveç Hunejnit dhe Taifit, dhe gjatë kësaj periudhe paqeje që zgjat dy vjet deri në largimin e Profetit (s.a.s.) nga kjo botë, të gjithë arabët, duke ardhur te Profeti (alejhi selam) në gupe, në turma dhe delegacione të shumta, i japin besën Profetit (alejhi selam) dhe futen në Islam. Kur të vijë ndihma dhe fitorja e premtuar nga Allahu i Lartë, dhe kur t'i shohësh njerëzit të futen turma-turma në fenë e Allahut,

فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا

3. Atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve

Allahu i Lartë i thotë Profetit (s.a.s.) se, kur e gjithë Arabia të bëhet myslimane dhe kur t'i shohësh njerëzit të futen në Islam grupe-grupe, do të thotë se misioni yt në këtë botë është drejt fundit. Pas kësaj, e ka urdhëruar Profetin (alejhi selam) që të angazhohet me falënderimin dhe lartësimin e Allahut (xh.sh.), sepse ai (s.a.s.) vetëm me ndihmën e Allahut arriti një sukses kaq të madh.

Në këto ajete, Allahu i Lartë e urdhëron Profetin (alejhi selam) se, kur të vijë ndihma e Allahut e t'i shohësh njerëzit të futen në Islam grupe-grupe, lartësoje Zotin tënd, duke e falënderuar, dhe kërko falje prej Tij. Ky ajet i drejtohet Profetit Muhamed (a.s.), por duke qenë se veprimet e Profetit (s.a.s.)

janë shembull për çdo besimtar, duhet që çdo besimtar, kur të shohë ndihmën e Allahut, ta falënderojë Atë dhe të kërkojë falje prej Tij.

Këtu ka edhe një pikë të rëndësishme, ndryshimi ndërmjet një lideri të kësaj bote dhe profetit. Nëse një lider i kësaj bote arrin të kryejë një revolucion të madh, ai njeri duke u mburrur me udhëheqjen e tij do të organizonte festime të shumta. Ndërsa, Profeti Muhamed (alejhi selam), i cili, për një kohë relativisht të shkurtër, 23 vjeçare, duke ia shndërruar rrënjësisht popullit të tij besimin, ideologjitë, moralin, kulturën, politikën e ekonominë, si dhe botëkuptimin rreth luftës, arriti ta nxirrte popullin nga injoranca e errët ku ishte zhytur, duke e sjellë në një gjendje që ishin të përshtatshëm për të udhëhequr gjithë botën. Pavarësisht këtij fakti, në vend që të festonte e të krenohej me arritjet e tij, atij (s.a.s.) iu urdhërua që të falënderonte Allahun dhe të kërkonte falje prej Tij.

Lartësimi i Zotit është lartësimi i Tij nga çdo e metë. Sipas transmetimit të interpretuesve të Kuranit kur e pyetën Profetin (s.a.s.) për tesbihun, tha: "*Lartësimi i Allahut nga çdo e metë*"[127]. Pra, tesbih ka kuptimin e lartësimit të individualitet të Allahut, atributeve dhe emrave të Tij nga çdo e metë e mangësi. Sipas Ebu Suud ka edhe kuptimin: "duke e falënderuar Allahun të thuash Subhanallah".

Kuptimi i "hamd" këtu është në këtë formë: "As që duhet ta çosh nëpër mend se ky sukses u arrit me marifetet e tua. Kjo ka ndodhur plotësisht me mëshirën e Allahut. Për rrjedhojë, falënderoje Allahun dhe shprehe këtë me gjuhë e zemër, sepse realizuesi i një vepre kaq të madhe dhe krijuesi i këtij suksesi të madh është vetëm Allahu (xh.sh.) dhe vetëm Ai është i denjë për t'u falënderuar."

Një kuptim tjetër i "tesbihut" këtu është: "Allahu nuk ka nevojë për përpjekjet tuaja që të lartësojë fjalën e Tij. Shpreheni këtë të vërtetë dhe duhet ta besoni plotësisht se, suksesi i përpjekjes tuaj arrihet vetëm me mbështetjen dhe ndihmën e Allahut. Allahu ia bën të mundur realizimin e një punë cilit të dojë Ai prej robve të Tij. Që robit t'i jepet një mundësi e tillë për të realizuar diçka, është prej mirësisë së Allahut. Dhe, mirësia e Allahut ndaj jush është që t'jua japë juve nderin për t'i shërbyer fesë së Tij." Po ashtu, të thuash "subhanallah" shpreh edhe një lloj habie apo çudie. Kur ndodh diçka që është e vështirë të perceptohet nga mendja njerëzore themi "Subhanallah". Dhe kuptimi është që, asgjë tjetër përveç forcës e fuqisë së Allahut nuk mund ta krijojë diçka kaq mahnitëse.

وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve. Ata që kthehen me pendim, Ai i fal.

Teube ka kuptimin e pendesës ndaj gjynahut të kryer dhe është një kthese për të qenë i vendosur që të mos e përsërisësh më atë gjynah. Ndërsa, **Istigfar** ka kuptimin e të kërkuarit falje prej Allahu (xh.sh.). Askush nuk mund të bëj teube për dikë tjetër veç vetes së tij, por mund bëj istagfar për gjynahet e të tjerëve, pra, mund të kërkojë që Allahu t'i falë ata. Në Kuran thuhet: **رَبَّنَا اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِلْمُؤْمِنِينَ يَوْمَ يَقُومُ الْحِسَابُ** "**O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën, kur do të jepet llogari.**"[128], si ky ajet ka edhe plot shembuj të tjerë. Për këtë arsye urdhri në ajet **وَاسْتَغْفِرْهُ** "**kërko falje nga Ai**", mbart edhe kuptimin që, Profeti (alejhi selam) nuk e ka të detyruar që të

127. Ibn Maxhe, Ikamet 179; Musned, V, 384; Alusi, Rruhul-Meani, XXX, 326.
128. Surja Ibrahim, 14:41

kërkojë falje vetëm për veten e Tij, por mund të kërkojë falje edhe për popullin e tij. Më tepër ky urdhër është që të kërkojë falje për popullin e tij, sepse Allahu i Lartë e ka ruajtur Profetin Muhamed (s.a.s.) nga gjynahet. Për rrjedhojë, istigfari i tij është që t'u mësojë njerëzve se sa i nevojshëm është istigfari, që t'i kërkojë falje Allahut për popullin e tij dhe, duke qenë se ai vazhdimisht lartësohej në grada, duke e parë gradën e mëhershme si më të ulët bënte istigfar.

Aishja (r.a.) transmeton se, kohët e fundit Profeti (alejhi selam) e kishte shtuar përsëritjen e shprehjes: **سبحان الله وبحمده أستغفر الله وأتوب إليه** dhe kur e pyesin për arsyen, Ai thotë: "*Zoti im më njoftoi se do të më tregonte një shenjë nga populli im dhe, kur e pashë atë, më urdhëroi që ta falënderoja atë duke e lartësuar dhe t'i kërkoja falje Atij*".[129]

Këshillohet që, ai që fal namazin të bëj tri herë istigfar pas farzit, ai që fal namazin e natës (tehexhud) të bëj istigfar sa të dëshirojë deri në kohën sabahut dhe, haxhiu që bën haxh të bëj istigfar. Po ashtu, njoftohet nga transmetimet e ndryshme se duhet bërë istgfar pas abdesit dhe çdo mbledhjeje. Profeti (s.a.s.) pasi ngrihej nga mbledhja thoshte **سبحان الله وبحمده أستغفر الله وأتوب إليه**.[130]

Transmetohet se kur zbriti kjo sure Profeti Muhamed (s.a.s.) mbajti një hutbe dhe tha: "*Allahu e la të lirë një rob që të zgjidhte midis takimit me Atë dhe kësaj bote. Ai, robi zgjodhi takimin me Allahun.*"[131] Robi për të cilin flet Profeti Muhamed (s.a.s.) në këtë hadidh është vetë ai. Ebu Bekri (r.a.), i cili e kuptoi se çfarë donte të thoshte Profeti (s.a.s.) dhe se ai kishte preferuar largimin nga kjo botë, tha: "U flijofshim ne, pasuria jonë, paraardhësit e pasardhësit tanë për ty, o i Dërguari i Allahut!"

Në një tjetër transmetim thuhet: Kur Profeti (s.a.s.) ia lexoi këtë sure shokëve të Tij u gëzuan, ndërsa xhaxhai i tij, Abasi (r.a.) qau. Profeti (s.a.s.) tha: "Pse qan xhaxha?" Ai i tha: "Ty po të lajmërohet vdekja." Profeti (s.a.s.) ia ktheu: "Po, ashtu është".[132]

SURJA TEBET - 111

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ

تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ (1) مَا أَغْنَى عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ (2) سَيَصْلَى نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ (3) وَامْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ (4)

فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ (5)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

---

129. Muslim, Salat 221; Nesai, Sarik 3; Ibn Maxhe, Hudud 29; Darimi, Rikak 15; Musned, II, 282, 341, 450; VI, 35, 77, 184.
130. Muslim, Salat 218-220, Musafirin 201; Ebu Daud, Salat 119, Edeb 27; Tirmidhi, Daauat 32.
131. Buhari, Menakibul Ensar 45, Salat 80, Fadailul-Sahabe 3, Menakibul Ensar 45, Muslim, Fadailul Sahabe 2.
132. Buhari, Tefsiru sure 110, 3; Darimi, Mukadime 14; Musned, I, 217, 344, 356, 449.

1. Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka!

2. Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera.

3. Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara,

4. po ashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit,

5. në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme.

Kjo sure quhet ndryshe edhe surja "Mesed" ose "Leheb". Është prej sureve të zbritura në fillim të periudhës mekase. Tregon fundin e hidhur të armiqve të fesë si Ebu Lehebi dhe gruaja e tij, të cilët për arsye të urrejtjes dhe mllefit që kishin ndaj fesë së drejtë, u njoftuan me fundin e hidhur që i priste në jetën e pafundme, shumë vite para se Ebu Lehebi të vdiste si mosbesimtar.

Shkaku i zbritjes

Transmetohet në librin e Buhariut, Tirmidhiut dhe në disa libra të tjerë të hadithit nga Ibn Abasi (r.a.) se ai ka thënë: "Kur zbriti ajeti **وَأَنْذِرْ عَشِيرَتَكَ الْأَقْرَبِينَ** "**Paralajmëroje farefisin tënd më të afërt**"[133], Profeti (s.a.s.) doli në kodrën Safa dhe thirri **يا صباحاه** 'O njerëz zgjohuni se u bë mëngjes'."

- Kush është ky?- thanë njerëzit dhe rendën drejt Profetit (s.a.s.). Profeti (s.a.s.) u tha:

- A më besoni mua nëse ju them se, pas kësaj kodra po vjen një grup kalorësish?

- Ne nuk kemi dëgjuar deri më sot prej Teje asgjë tjetër veç të vërtetës, thanë ata.

-Atëherë, unë po ju paralajmëroj ju për një dënim që ndodhet para jush, tha Profeti (s.a.s.). Ebu Lehebi ia ktheu:

-**تبا لك**, Mallkuar qofsh, për këtë na mblodhe këtu?, - dhe u ngrit e iku. Pas kësaj zbriti "Surja Tebet".[134]

Në disa transmetime thuhet se, Ebu Lehebi pasi tha këto fjalë mori një gurë nga toka dhe u përpoq të sulmonte të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Në një transmetim të Ibn Abasit (r.a.) thuhet:

"Kur Ebu Lehebi u largua prej aty dhe takoi Kurejshët, u tha atyre: 'Muhamedi na premtoi ne disa gjëra që nuk i dimë se çfarë janë, ai pretendon se këto do të ndodhin pas vdekjes, por çfarë më dha ai mua në dorë?, - dhe i fryu duarve duke thënë **تبا لك** mallkuar qofshi, unë nuk shoh asgjë këtu nga ato që premtoi Muhamedi. Pas kësaj, transmetohet të ketë zbritur surja Tebet.[135]

Me zbritjen e kësaj sureje, duke përmendur emrin e xhaxhait të Profetit (s.a.s.) dhe duke e mallkuar atë, u shuan shpresat se mund të arrinin në një pajtim në çështjen e fesë, sepse Profeti (s.a.s.), i cili

133. Surja Shuara, 26:214
134. Sujuti, Durrul Menthur, VIII, 665.
135. Buhari, Xhenaiz 98; Tefsiru Sure 111, 1-3; Muslim, Fiten 91.

nëpërmjet shpalljes u shpreh kështu për xhaxhain e Tij, ishte e pamundur që të pajtohej me të tjerët. Një i huaj që besonte ishte më i afërm me Profetin (s.a.s.) se kushërinjtë, ndërsa, ai që nuk besonte edhe po të ishte nga të afërmit e Profetit mbetej i huaj. Nuk kishte asnjë vlerë nëse ishte i biri i këtij apo i atij.

TEFSIRI

تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ

1. Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka

تَبَّتْ "**Tebbet**" vjen nga rrënja تباب "Tebab", me kuptimin "shkatërrim, humbje", dhe është folje në kohën e shkuar, kur përdoret si lutje, dua ka këto kuptime: u shkatërroftë, mallkuar qoftë. Kjo folje, për të shpjeguar mallkimin që e meriton shkatërrimin dhe humbjen, ka kuptimin e qortimit dhe mospëlqimit. **تبا لك** "**Teben Leke**" dhe shprehje të tjera të ngjashme përdoren si mallkime e qortime me kuptimin "**mallkuar qofsh**". Për rrjedhojë, edhe kuptimi iu thafshin duart është shumë i përhapur.

Ebu Lehebi edhe pse kishte një privilegj të madh që për arsye se ishte xhaxhai Profetit (s.a.s.), ishte i afërmi i tij dhe vinte nga një familje fisnike, për shkak se ai nuk i besoi Profetit (s.a.s.) u soll si armiku i tij, dhe këmbëngulja në mohim bëri që ai të shkatërrohej. Nëse ky afrimitet nuk e shpëtoi as xhaxhain e Profetit (s.a.s.), mendoni se si do të jetë gjendja e atyre fatkeqëve që e urrejnë Profetin (s.a.s.) dhe nuk pendohen.

Xhaxhai i Profetit (s.a.s.) e kishte emrin Abdul Uza, por meqë e kishte fytyrën afër ngjyrës së kuqe, i thuhej Ebu Leheb. "Leheb" ka kuptimin e shkëndijës së zjarrit, ndërsa "Ebu Leheb" ka kuptimin fytyrë e ndritur si shkëndijë. Fakti që përmendet në sure me këtë epitet ka disa arsye:

E para, ai më tepër njihej me epitetin e tij se sa me emrin.

E dyta, emri i tij Abdul Uza (robi i idhullit Uza), meqë ishte emër politeist, Kurani nuk ka dashur ta përmendë atë me këtë emër.

E treta, fakti se këtu lajmërohet fundi i tij, ky epitet është më i përshtatshëm për përfundimin e tij të hidhur, sepse arabët e kishin traditë që njerëzit e lig i thërrisnin "Ebu Sherr", ndërsa njerëzit e mirë i thërrisnin "Ebu Hajr".

Ashtu siç u përmend edhe më sipër, folja tebet, së pari është mallkuese: Ju thafshin duart Ebu Lehebit, u shkatërroftë. Ndërsa së dyti, **وَتَبَّ** "ue teb" na njofton për gjendjen tij. Na njofton se, Ebu Lehebi me të vërtetë u shkatërrua, dhe në humbje u largua nga kjo botë. Përmendja e "dorës" ka si qëllim pronarin e saj. Kjo është një mënyrë shprehjeje sipas arabëve. Arabët, duke cituar një pjesë të një gjëje kanë si qëllim të gjithën. Pra, edhe vetë Ebu Lehebi u shkatërrua. U shkatërrua e u asgjësua pa ia arritur qëllimit.

مَا أَغْنَى عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ

2. Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera. [136]

Sipas disa mendimeve fjala كَسَبَ "**fitimet**" në ajet, ka si kuptim fëmijët e Ebu Lehebit. Në një hadith Profeti (s.a.s.) shprehet: "**Prej fitimeve të çdo njeriu janë ushqimi i pastër dhe fëmijët**".[137] Ndërsa sipas disa të tjerëve, përftimet e tij janë ato vepra që i ka kryer duke menduar se po bën diçka të dobishme. Ajeti 23 i sures Furkan mbart këtë kuptim: "**E Ne i dolën para çdo vepre që ata e kryen dhe, i bëmë ato hi e pluhur.**" Transmetohet se Ebu Lehebi ka thënë se, po të jetë e vërtetë ajo që thotë djali i vëllait tim, do t'i jap si kompensim pasurinë e fëmijët e mi, dhe kështu do të shpëtoj. Kur u sëmur Ebu Lehebi nuk i bëri dobi atij as pasuria e as fëmijët, por e braktisën në vdekje. Fëmijët e tij nuk kishin pasur mundësi as ta varrosnin atë me nder. Kështu që, të gjithë e mësuan se lajmi i dhënë nga Kurani Fisnik u vërtetua brenda disa viteve.

سَيَصْلَى نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ

3. Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara

Një zjarr që as është parë e as është dëgjuar në këtë botë, zjarri i Xhehenemit, i cili nuk të djeg vetëm fizikisht por mbështjell edhe shpirtrat, duke penetruar në thellësi të zemrës.

وَامْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ الْحَطَبِ

4. Po ashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit

Pra, jo vetëm Ebu Lehebi por edhe gruaja e tij do të hidhet në zjarr. Gruaja e tij, Umu Xhemil, e bija e Harbit, motra e Ebu Sufjanit (r.a.). Edhe ajo do të hidhet në zjarr si mbartëse drush për zjarrin e Xhehenemit, duke ia shtuar zjarrin Ebu Lehebit apo duke ia rritur nxehtësinë zjarrit ku do të digjen së bashku, si dënim i bashkëpunimit në mohim e mosbesim në këtë botë, sepse kjo grua kishte armiqësi ndaj Profetit (s.a.s.) po aq sa burri i saj.

Shprehja "hammaletel hatab", ka kuptimin mbartëse drush. Transmetohet se, kjo grua vendoste gjemba drush gjatë natës në rrugën ku kalonte i Dërguari Allahut (s.a.s.) që ta lëndonte Atë. Për këtë arsye është damkosur si hamalle drush.

Sipas disa mendimeve të tjera, ajo, për të ngjallur përçarje në popull, përhapte thashetheme sa andej këndej. Rrjedhimisht, si epiteti më i përshtatshëm në gjuhën arabe për këtë situatë u quajt si "grua që mbart dru". Arabët tipave të tillë që merren me thashetheme u thonë "njerëz që mbartin dru".

---

136. مَا këtu është pyetje retorike ose nyje mohuese, tregon shkatërrimin e Ebu Lehebit. Pra, çfarë dobie i bëri atij? Nuk pati asnjë dobi. Nuk e ndihmoi atë as pasuria e tij e as fitimet e tjera.
137. Ebu Daud, Buju' 77; Nesai, Buju' 1; Ibn Maxhe, Tixharet 64; Musned, II, 214, VI, 41, 201.

فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ

5. Në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme

Fjala **جِيدِهَا** e përdorur në ajet edhe pse ka kuptimin e qafës, veçanërisht përdoret për qafën e bukur të zbukuruar me varëse e me stoli të tjera. Umu Xhemil vendoste në qafë xhevahiret dhe thoshte: "Betohem për Latin dhe Uzan se, do t'i shes këto xhevahire dhe fitimet do t'i përdor në dëm të Muhamedit". Për këtë arsye fjala (xhid) në ajet është përdorur në formë tallëse. Qafën që e zbukuronte me gjerdan e krekosej me bukurinë e saj, në Xhehemen do ta ketë të lidhur me litar.

مَّسَدٍ Mesed ka kuptimin lastar. Në gjuhën arabe, të gjitha gjërat që përdridhen me fije ose me lastar hurme, quhen mesed. Duke thurur fije të forta me lastar të trashë, formohet një litar shumë i fortë.

Si përfundim, mesed ka kuptimin e një litari të trashë të thurur me lastar hurme. Pra, ajeti ka kuptimin e "shndërrimit të gjerdanit të qafës në një litar të fortë".

Ndërsa sipas disa dijetarëve të tjerë të tefsirit, fjala "mbartëse drush" në ajet është përdorur si fyerje për të treguar moralin e saj të keq. Në qafën e njeriut të pamoralshëm që vendos gjerdan argjendi në këtë botë, në botën tjetër do t'i vendoset një litar zjarri, si dënim i njëjtë për krimin e kryer.

Njerëzit që Kurani i ka përmendur haptazi dhe i ka mallkuar përjetë, janë vetëm Ebu Lehebi dhe gruaja e tij. Kjo situatë, tregon dëmin që i dha kauzës islame sjellja e tyre armiqësore dhe se sa shumë e hidhëroi Profetin (s.a.s.) sjellja e tyre.

Si përfundim dëshirojmë të transmetojmë disa interpretime të sures Tebet nga dijetarët e kohës sonë:

Kurani me taktin dhe edukatën e tij nuk shprehet për gruan e Ebu Lehebit me fjalën gomar, edhe pse, portreti që na pikturon rreth saj është i tillë. E rëndësishme këtu është krahasimi që i bëhet, sepse mendimi se Umi Xhemil mbarte dru në shpinë dhe mbarte gjemba për t'i hedhur në rrugët ku kalonte Profeti (s.a.s.) nuk mund të jetë shumë i saktë. Kjo për arsye se ajo ishte e bija e Utbes, nga fisi aristokrat i Umejes. Ajo, jo që nuk mbarte dru, por as që kishte rastisur që ajo të prekte dru me dorë ndonjëherë. Por, thelbi nuk është ky, ajo edhe pse nuk mbarte dru, forma e treguar në ajet na jep përshtypjen e një gomari që transporton dru. "**Në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme**", na tregon qartë për një gomar tipik me frerë.

Kjo sure, ka zbritur për të treguar dënimin e atyre që do të pengojnë kauzën e Profetit (s.a.s.) deri në Ditën e Gjykimit. Përveç kësaj, ftesa që i bëhet veçanërisht Ebu Lehebit në fe, tregon rëndësinë e ruajtjes së afrimitetit farefisnor.

Kjo sure, që tregon dënimin e armiqve të fesë, për të krahasuar nga afër fitoren me humbjen, falënderimin me mohimin, përfundimin e mirë me atë të hidhur, ka zbritur pas sures Nasr. Po ashtu, ka ardhur pas sures Nasr për të treguar se, edhe pas ndërrimit jetë të Profetit Muhamed (s.a.s.), armiqtë nuk do të mundin dot ta shuajnë dritën e Islamit.

Një çështje tjetër që mund të trajtohet nga ajeti është: A lejohet mallkimi i mosbesimtarëve? Në ajet është vetë Allahu (xh.sh.), Ai që e mallkon Ebu Lehebin. Nëse situata qëndron kështu, mund të na vijë në mend një pyetje e tillë: po ne a mund t'i mallkojmë armiqtë e fesë? Duke marrë si argument këtë ajet, mund të bëhet një mallkim i tillë si, "Tebbet ejdij 'ada'ina" ju thafshin duart armiqve tanë. Siç mund të shprehemi kështu, ndonjëherë edhe mund të shtojmë: "Përveç atyre që dëshiron t'i udhëzosh në rrugën tënde të drejtë."

Duke pasur lidhje me suren Tebet, po përcjellim edhe një pyetje që i është bërë M. Abdulfetah Shahinit:

Pyetje: Pse Kurani flet për persona si Ebu Lehebi, a mund të flisni rreth kësaj urtësie? Si përshtatet kjo me nivelin e elokuencës dhe retorikën e tij?

Përgjigje: Ebu Lehebi pavarësisht se u rrit në një ambient afër Profetit (s.a.s.), ai, si një njeri i pafat dhe po aq kryeneç, nuk arriti të përfitojë nga drita e Profetit (sal'la llahu alejhi ue sel'lem).

Ai e përdori vazhdimisht vullnetin e tij në të ligë. Ai e shtroi me gjemba rrugën ku do të kalonte i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe në rrugën drejt Qabes hera herës ndizte zjarr. Patjetër që, edhe dënimi do të jetë i të njëjtit lloj. Ai do të hidhet në zjarrin e Xhehenemit. Në të vërtetë ai është quajtur si "Ebu Leheb" babai i zjarrit. Ai duke u pozicionuar përballë kauzës islame, gjithë jetën e tij do ta kalonte duke thurur kurthe e intriga kundër së vërtetës. Por, çdo përpjekje e tij mbeti e shterpë. Pasuria që fitonte nga fisi Umeje dhe pasuria e gruas, nuk i bënë asnjë grimcë dobi atij. Po ashtu, as fëmijët e tij nuk e shpëtuan dot atë. Megjithëse, ai ishte krenuar shumë me ta...

Ai nuk mori dot pjesë në luftën e Bedrit. Kur i erdhi lajmi i triumfit të myslimanëve, ai pësoi krizë nervore. Lajmëtari e njoftoi se në luftë kishte ndodhur një ngjarje krejt e papritur, e njoftoi se myslimanëve u kishin ardhur në ndihmë ushtarë të panjohur me çallmë. Ebu Rafi, që e kishte mbajtur të fshehtë besimin e tij deri në atë çast, ishte prej atyre që po dëgjonin ngjarjen. Kur dëgjoi këto fjalë nuk e përmbajti dot më veten dhe tha: "Për Allahun këta janë engjëjt". Ebu Lehebi sapo e dëgjoi këtë u tërbua nga mllefi, shkoi pranë Ebu Rafit e goditi atë me forcë dhe e shkelmoi, duke e shtrirë përtokë. Ebu Rafi ishte robi i Abasit (r.a.). Gruaja e Abasit, Umu Fadl, shpejtoi drejt tyre dhe e goditi Ebu Lehebin me një dru pas koke. "A po e rreh një rob se nuk është i zoti i tij prezent?", tha ajo. Ebu Lehebi nuk mundi t'i thoshte asgjë kunatës së tij, dhe ashtu me kokë të gjakosur u kthye në shtëpi dhe nuk doli më prej saj. Për shkak të kësaj goditjeje ose diçkaje tjetër, ai u sëmur me një sëmundje të quajtur "Adese". Kjo sëmundje në atë kohë cilësohej më e rëndë se murtaja. Ebu Lehebi kishte pasuri e fëmijë, por asnjë nga ata nuk i bëri dobi. Lëngoi në shtrat për shtatë ditë, i vetëm. Kur vdiq askush nuk ishte pranë tij. As për të varrosur kufomën nuk shkonte njeri. Më në fund prej turpit, paguan disa beduinë të merreshin me kufomën e tij dhe ashtu e hodhën në një gropë dhe e mbuluan me gurë.

Edhe pse ishte kaq i afërm me Profetin (s.a.s.) ai jo vetëm që nuk përfitoi prej Tij, por ishte nga armiqtë e Tij të përbetuar. Për këtë arsye, atë e priste një dënim i ashpër në këtë botë e në tjetrën (Ahiret). Dënimi në këtë botë ndodhi, tani ai është i vetëm me veprat e tij në jetën tjetër...

Gruaja e tij ishte nga fisi Umeje, aristokrate dhe e pasur. Armiqësia ndaj Profetit (s.a.s.) sikur i dhuronte asaj një kënaqësi sadiste. Merrte pjesë në sulmet e paturpshme që i bëheshin Profetit (s.a.s.) dhe ndjente kënaqësi kur i kryente këto veprime. Mbarte gjemba dhe i hidhte në rrugët ku do të kalonte i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe mbarte dru që t'i digjte në rrugët ku do të kalonte ai (s.a.s.). Në fakt ajo ishte e dhënë pas rehatisë saqë mund të kishte shumë shërbëtore, por urrejtja që kishte ndaj Profetit (s.a.s.) e cyste atë që të bënte punë të rëndomta që as shërbëtoret nuk i bënin. Ajo që nuk hiqte dorë nga vendosja e bizhuterive të ndryshme në qafë, tani ajo ka një litar në qafë e dru në shpinë. Dënimi i veprave të kryera në këtë botë do të jetë po nga lloji i tij, ashtu siç e paralajmëron Kurani Fisnik.

Ebu Lehebi ishte një njeri shumë inatçi. Ebu Xhehli thoshte për të: "Aman mos e nxehni këtë, se po kaloi në krahun tjetër askush nuk mund ta kthejë mbrapsht". Dhe kishte të drejtë. Por, ai e përdori inatin kundër Profetit (s.a.s.), e shpenzoi në armiqësi kundër tij. U bë bashkë me gruan e tij, dhe i lartësoi idhujt që ndodheshin në Qabe. Vazhdimisht thanë Lat, Menat, dhe nuk e kthyen njëherë kokën nga i Dërguari Allahut (s.a.s.) që gjendej pranë tyre. Nuk u përpoqën fare ta kuptonin këtë njeri, i cili ishte një indeks i tërë gjithësisë. Nuk e panë të nevojshme të përfitonin nga ky njeri i mrekullueshëm.

Ata, jo vetëm që nuk përfituan prej tij, por Ebu Lehebi vazhdimisht e sulmonte të Dërguarin e Allahut (s.a.s.). Sikur të qëndronte bota pa lëvizur, e ai të kishte qëndruar bashkë me të, qëllimi i tij nuk do të ndryshonte. Ebu Lehebi ishte prej atyre që, bashkë me Ebu Xhehlin, përgatitën bojkotin trevjeçar ndaj Profetit (s.a.s.) dhe njerëzve të tij. Myslimanët i kaluan këto tre vite duke luftuar me vdekjen. Shumë të vjetër e fëmijë humbën jetën gjatë këtij bojkoti. Por, Ebu Lehebi nuk ndjeu asnjë lloj dhimbjeje në ndërgjegjen e tij përballë kësaj situate. Ai ishte njeri i privuar nga ndërgjegjja e pastër. Edhe Hatixhja (r.a.) ishte dobësuar shumë nga situata e vështirë në të cilën ndodheshin myslimanët, duke mos e duruar dot më këtë pamje rrëqethëse. Ajo nuk i duroi dot më padrejtësitë e vuajtjet e myslimanëve dhe ndërroi jetë në këtë vit të quajtur "viti i hidhërimit". Edhe Ebu Talibi vdiq në të njëjtin vit.

Në një kohë kur xhaxhai i tij Ebu Talibi e mbronte dhe e ruante Profetin Muhamed (s.a.s.), xhaxhai tjetër, Ebu Lehebi, nuk la sulm e torturë pa ia bërë Atij. Profeti (s.a.s.) i vizitonte fiset njëri pas tjetrit, u fliste atyre rreth fesë së drejtë dhe i ftonte në Islam. Një njeri me flokë e fytyrë të kuqërremtë e ndiqte atë nga pas, si hije, dhe përpiqej pa pushim që ta përgënjeshtronte atë, dhe ky nuk ishte askush tjetër veçse Ebu Lehebi.

Në një kohë kur ata që ishin më të largët nga ana farefisnore përpiqeshin si e si të afroheshin sa më tepër me Profetin (s.a.s.), në të kundërt Ebu Lehebi e kishte kthyer në detyrë largimin nga ai. Sa i verbër ishte ai që nuk mund të shikonte atë diell, burim drite që ndodhej pranë tij?!

Tani, a nuk është e drejtë dhe parimore që Kurani t'i thotë një njeriu të tillë "**Iu thafshin duart Ebu Lehebit**"?! Nëse atij nuk do t'i thuhej kështu, do të ishte padrejtësi ndaj miliona njerëzve. Një situatë e tillë, si mund të përshtatej me metodikën e Kuranit?

Kanë zbritur edhe ajete të tjera që flasin qartë ose jo rreth atyre që e sulmojnë Islamin. Uelid b. Mugire ishte njëri prej tyre. Kurani shprehet rreth tij: "**Qoftë i shkatërruar, po si perceptonte**". Ai ishte babai i Halid b. Uelidit. Por, ai ishte një nga armiqtë e përbetuar të Profetit (s.a.s.). Mendohej me veten e tij se çka mund të thoshte rreth Muhamedit (s.a.s.). Ishte në hezitim, a t'i thoshte poet, fallxhor apo magjistar. Më pas arriti në përfundimin që t'i thoshte Kuranit magji dhe profetit magjistar, dhe Kurani pas këtij vendimi i drejtohet atij: "**Qoftë i shkatërruar, po si perceptonte**". Dhe shumë mosbesimtarë të tjerë janë qortuar dhe mallkuar në Kuran. Nëse Ebu Lehebi nuk do të ishte përfshirë në këtë grup njerëzish, a do të përshtatej kjo situatë me universalitetin e Kuranit? Sigurisht që jo, sepse në një vend ku mallkohet Uelid b. Mugire, nëse nuk do të mallkohej Ebu Lehebi, dëshmitarët e kësaj situate do të mendonin se Ebu Lehebi është mbrojtur për shkak të lidhjes farefisnore me Profetin Muhamed (s.a.s.). Pra, Kurani nuk i la hapësirë një situate të tillë, dhe e ka përfshirë edhe Ebu Lehebin në kategorinë e politeistëve.

Kjo sure është zbritur në Meke. Ndërsa Ebu Lehebi vdiq pas luftës së Bedrit. Pra, do të thotë se këtu kemi të bëjmë me një lajm rreth së fshehtës. Ebu Lehebi dhe gruaja e tij do të largoheshin si mosbesimtarë nga kjo botë dhe ashtu ndodhi. Ashtu siç Profeti Muhamed (alejhi selam) pati lajmëruar për vdekjen e politeistëve në luftën e Bedrit në vendet ku ai pati lajmëruar, për t'i dhënë forcë e kurajë besimtarëve, po ashtu edhe vdekja e Ebu lehebit do t'i jepte fuqi e kurajë besimtarëve, dhe do t'u tërhiqte vëmendjen të tjerëve që të ishin vigjilentë. Kjo për arsye se çdo gjë që lajmëroi Kurani u vërtetua si e tillë. Dhe ky ishte një lajmërim triumfi dhe i tillë do të ishte. Për një grusht myslimanësh, që ishin të rrethuar nga të katërta anët me armiq, këto lloj përforcimesh nuk ishin gjëra aspak të vogla. Përkundrazi, ishte diçka e nevojshme dhe kusht për rezultatet pozitive që arriti.

Ndonjëherë një fatkeqësi e vogël ka një ndikim aq të madh në aspektin moral dhe shpirtëror të njeriut, saqë sikur të hapej perdja e së fshehtës e njeriu të shihte mirësitë që do t'i sjellë kjo fatkeqësi, do të lutej me gjithë zemër që t'i ndodhte një fatkeqësi e tillë. Ato që fitohen më vonë nga kjo fatkeqësi, e eliminojnë dhimbjen që ajo mund ketë shkaktuar.

SURJA IHLAS - 112

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَـنِ الرَّحِيمِ
قُلْ هُوَ اللَّـهُ أَحَدٌ (1) اللَّـهُ الصَّمَدُ . لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ (2) وَلَمْ يَكُن لَّهُ كُفُوًا أَحَدٌ (3)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit
1. Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!

2. Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.

3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur.

4. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!"

Nga suret e para që ka zbritur; ka 4 ajete. Surja Ihlas (Sinqeriteti) ka një shprehje tejet koncize dhe të mrekullueshme që tregon për ekzistencën, unitetin dhe pangjashmërinë e Allahut (xh.sh.). Çdo ajet është rrjedhojë logjike e ajetit paraardhës dhe të gjitha ajetet janë si argumente të njëri-tjetrit. Ashtu si surja Fatiha, edhe kjo sure ka shumë emërtime, më të spikaturit ndër ta janë "Ihlas" dhe "kul hu-Allahu ehad".

Kjo sure është quajtur "Ihlas", sepse e shpreh në mënyrën më të qartë e më të bukur teuhidin, besimin monoteist islam mbi Allahun, Zotin e gjithësisë, që është parimi themelor i fesë islame. Për këtë arsye përmendet edhe me emrin "esas, me kuptimin bazë, themel".

Allahu i Lartë, nuk është përshkruar në asnjë libër tjetër veç Kuranit dhe në asnjë fe tjetër veç Islamit aq bukur sa ç'është përshkruar në ajetin Kursi dhe në suren Ihlas. Kjo sure, me pak fjalë, i mohon të gjitha llojet e shirkut (politeizmit).

Gjithashtu kjo sure është quajtur si "Surja e Teuhidit (surja e monoteizmit)", "Surja e Tefridit (surja e njëshmërisë)", "Surja e Texhridit (surja e veçimit)", "Surja e Nexhatit (surja e shpëtimit)", "Surja e Uelajetit (surja e autoritetit)", "Surja e Ma'rifetit (surja e njohjes)", sepse me kuptimin e plotë të kësaj sureje njihet Allahu (xh.sh.).

Kësaj sureje i është vënë edhe emri "surja e Nesebit (surja e origjinës, prejardhjes)", sepse në një transmetim të Tirmidhiut politeistët shkojnë te Profeti i Zotit dhe i thonë "**انسب لنا ربك**" "Na e trego ne origjinën (prejardhjen, gjenealogjinë) e Zotit tënd" dhe për këtë zbriti surja Ihlas[138] që tregon se Allahu i Lartë është i pastër nga origjina (nuk ka paraardhës e as pasardhës).

Gjithashtu, kjo sure është quajtur si "Surja Samed" dhe "Surja Muauidh". Abdullah b. Unejs ka thënë: I dërguari i Allahut e vendosi dorën në kraharorin tim dhe më tha "**قل thuaj**". Unë nuk dija se çfarë të thosha. Pastaj urdhëroi "**قل هوالله أحد**"dhe unë e thashë dhe e mbarova. Pastaj urdhëroi " **قل أعوذ برب الفلق (1) من شرما جلق (2)**" dhe unë e lexova dhe e përfundova. Pastaj urdhëroi " **قل أعوذ برب الناش (1) ملك الناس (2)**" dhe unë e lexova dhe e përfundova. Pas kësaj i Dërguari i Allahut (s.a.s.) tha: "*Kështu mbështetu tek Allahu, askush prej atyre që mbështeten nuk i janë mbështetur (Zotit) me diçka të tillë*".[139]

Sipas transmetimit të Ibni Abbasit meqë të mbron nga dënimi i varrit është quajtur "Surja Mani'a" (ndalesë, mburojë). Në një hadith profetik thuhet se: "*Çdo gjë e ka dritën e saj dhe drita e Kuranit është* " **قل هوالله أحد**", për këtë arsye është quajtur edhe "Surja Nur" (surja dritë).[140]

Është quajtur edhe si "Surja e Imanit, besimit", sepse pa qenë teuhidi që përcjell kjo sure, besimi nuk do të ishte i plotë. Surja Kafirun dhe kjo sure, meqenëse të dyja vërtetojnë monoteizmin dhe

138. Tirmidhiu: Tefsiru Sure 112, 1, 2; Musned V,134
139. Nesai: Istiadhe 1, Musned III, 417; IV 144, 153
140. Alusi, Rruhul-Meani, XXX, 266.

mohojnë çdo formë të politeizmit, dhe vërtetojnë shprehjen "**لا إله إلا الله**", janë emërtuar të dyja si "**suret Ihlasejn**".

Koha e zbritjes

Ka dy mendime rreth zbritjes në Mekë apo Medine. Rreth shkakut të zbritjes ka dy mendime të ndryshme për shkak të dy haditheve, që në plan të parë duket sikur bien ndesh me njëri-tjetrin; disa kanë arritur të gjejnë kompromis midis dy haditheve, duke thënë se zbritja është përsëritur.

Dy hadithet e kundërta kanë të bëjnë me dy transmetime që thonë se shkaku i zbritjes janë politeistët apo çifutët dhe të krishterët.

Shkaku i zbritjes

Ata që thonë se shkaku i zbritjes ishin politeistët kanë transmetuar nga Ubej bin Ka'b me metodën e Ebu'l-Alije dhe transmetimi i Xhabirit me metodën e Sha'bi'ut ku politeistët thonë: "انسب لنا ربك Na e trego neve origjinën (prejardhjen) e Zotit tënd". Allahu i Madhëruar zbriti suren "قل هوالله أحد".

Nga transmetimi i Ikrimes: Politeistët i thonë të Dërguarit të Allahut (s.a.s.): "صف لنا ربك ما هو و من أي شي هو؟ أخبر عن ربك Na informo ne rreth Zotit tënd, na i përshkruaj ne cilësitë e Zotit tënd, ç'është Ai dhe nga se është krijuar?" Thanë: Cila është përbërja e Tij dhe nga se është bërë. Allahu i Madhëruar zbriti قل هوالله أحد deri në fund të sures.

Ata që thonë se shkaku i zbritjes ishin hebrenjtë, kanë përmendur këtë transmetim: Një grup hebrenjsh shkuan tek i Dërguari i Allahut (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) dhe e pyetën: "O Muhamed! Ky Allahu paska krijuar gjithçka, po Allahun kush e krijoi?" Profeti i Allahut u nxeh, aq sa i ndryshoi ngjyra e fytyrës, u inatos me ata ngaqë bënë një pyetje të tillë për Zotin e Madhërishëm dhe u foli atyre ashpër. Në atë çast erdhi Xhibrili (a.s.) dhe e qetësoi Atë. "Mbaji krahët mbi vete! Qetësohu o Muhamed! Pyetjes së tyre i erdhi përgjigje nga Allahu. Pastaj tha: Allahu urdhëroi: قل هوالله أحد".

Sipas transmetimit të Katades: Një grup hebrenjsh erdhën tek i Dërguari i Allahut dhe thanë: " انسب لنا ربك Na e trego neve origjinën e Zotit tënd". Për këtë arsye zbriti surja قل هوالله أحد"[141].

Sipas transmetimit të Razit, shkaku i zbritjes janë pyetjet e të krishterëve.[142] Ata' transmeton nga Ibn Abbasi se: Kur erdhi grupi Nexhran thanë na shpjego Zotin tënd me cilësitë e Tij, "Nga ç'gjë është Ai, nga ç'materie?" Profeti i Allahut (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) u tha: "Zoti im nuk është ndonjë gjë, Ai është krijuesi i gjërave".. Për këtë arsye zbriti surja قل هوالله أحد.

Ashtu siç vërehet edhe nga transmetimet, Profeti (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) pyetjeve të politeistëve në Meke dhe pyetjeve të Ehli kitabit (ithtarëve të librit) në Medine "Na trego ne cilësitë e

141. Sujuti, Durrul-Menthur,VIII, 670.
142. Fahru-Rrazi, et-Tefsirul-Kebir, Bejrut ts., XXXII, 175.

Zotit tënd" i është përgjigjur me suren Ihlas. Pra të dyve u është përgjigjur duke u lexuar suren Ihlas. Nga ky këndvështrim disa thonë se surja Ihlas ka zbritur edhe në Mekë edhe ne Medinë, por rreth shkakut të zbritjes në çështje të tilla ka një mendim të përgjithshëm dhe ky është: ashtu siç janë disa situata shkaktare të zbritjes, për shkak të lidhjes me një ngjarje të tillë është e mundur që Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue sel'lem) ta ketë lexuar atë sërish dhe Sahabet e nderuar (r.a.) pandehën se ajo ka zbritur për shkak të lidhjes me një ngjarje të tillë. Në fakt ajo vetëm sa është përsëritur nga Profeti i Allahut për e lidhjen e saj me ngjarjen.

Në ajetet dhe suret e tilla që nuk behët fjalë për shfuqizim, vendi dhe koha nuk kanë shumë rëndësi. Informacioni rreth qenies mekas apo medinas, nuk e ndryshon përfundimin e nxjerrë apo gjykimin. Për sure të tilla të dish shkakun e zbritjes, është vetëm njohje e vendit të zbritjes dhe informacion shtesë. Prandaj surja ashtu siç mohon dhe refuzon çdo lloj shirku (politeizmi), padyshim që e mohon dhe besimin e krishterë në trinitet.

TEFSIRI

قُلْ هُوَ اللَّـهُ أَحَدٌ

1. Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm

Fillimisht këtu i drejtohet të Dërguarit të Allahut (sal'la llahu alejhi ue sel'lem), dhe më pas, rrjedhimisht, të gjithëve atyre që mund t'u drejtohet. Shprehja e urdhrit në formë të hapur, tregon se ky definicion është fjali hyjnore dhe tërheq vëmendjen se duhet kumtuar në të njëjtën formë. Ato që njofton Allahu (xh.sh.) ashtu siç i miraton me zemër dhe i përsërit me gojë pa asnjë lloj dyshimi, pra ashtu siç ia thua vetes tënde, kumtoja edhe të tjerëve dhe thuaja hapur, dhe të gjithë kështu të thonë.

Allahu i Lartë, i adhuruari i vërtetë është **أحد** Një, i Vetëm dhe i Pashoq.

Në pamje të parë, duket sikur emrin **Ehad** (Një i vetëm) mbart të njëjtin kuptim me emrin **Uahid** (një). Mirëpo mes tyre ka një nuancë kuptimore të imtë. Fjala "**ehad**" është shprehja më elokuente e Uahdetit, që ka kuptimin e mohimit të çdo gjëje tjetër përveç vetes. Fjala Uahid mund të jetë relative dhe konvencionale, dhe gjithashtu tregon edhe një kuptim numerik. Ndërsa Ehad, nuk pranon ndarjen e individualitetit, as krahasimin dhe as një numër tjetër në formën e ekzistencës së një tjetri, është një i vërtetë që në asnjë mënyrë nuk ekziston mundësia e të qenët dy ose një të dyti, ka kuptimin një përherë. Uahid dhe Ehad nuk janë sinonime të njëri-tjetrit. Ehad do të thotë individ, tek. Ehad është një nga atributet e Allahut, i përket vetëm Atij dhe askush nuk mund të jetë ortak me Të në këtë atribut.

Si konkluzion, "**Allahu është Një**" do të thotë se, si nga individualiteti, si nga atributet dhe emrat, ashtu edhe nga çdo pikëpamje që të hulumtohet, është një e vërtetë e vetme që nuk ka ekuivalent në asnjë formë. Për rrjedhojë, hyjnia është e veçantë vetëm për Atë. Njëshmëria e Allahut nuk ka kuptimin e një objekti që është gjysma e dyshit, pra nuk ka kuptimin i njëshit matematikor.

Njëshmëria e Allahut të Lartë, nuk ka shumë ose të ngjashëm as brenda e as jashtë, është një që e mohon nga çdo pikëpamje partneritetin dhe ndarjen.

Nga çdo pikëpamje Ai është Një, gjithmonë Një, gjithmonë tek. "Allahu ekziston dhe bashkë me Atë nuk ekzistonte asgjë. Po ashtu vazhdon të jetë edhe tani." Imami Adham në veprën e tij "Fikhu Ekber" duke thënë: "Allahu i Lartë, nuk është një nga pikëpamje numerike por nga pikëpamja e të mos pasurit të përngjashëm e partner", ka vënë në dukje atë që përmendëm më sipër.

اللَّـهُ الصَّمَدُ

2. Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim

Çdokush dhe çdo gjë ka nevojë për Të, ndërsa Ai s'ka nevojë për askënd dhe për asgjë. Në të vërtetë, Samedi më i mrekullueshëm dhe i vetëm është vetëm Allahu.

Rreth kuptimit të fjalës samed transmetohet nga Ebu Hurejre që të ketë thënë: "**Çdo gjë është nevojtare për Të, por Ai s'është nevojtar për asgjë**".[143] Meqë çdo gjë ekziston vetëm me Të, vetëm në sajë të Tij, atëherë, çdo gjë është nevojtare për Të. Fjala Samed mbart në vetvete edhe kuptime të tjera: Samed, për ç'do rast i drejtohen Atij, mbështeten tek Ai, pa urdhër të Atij nuk bëhet asgjë dhe që i binden Atij pa asnjë lloj kundërshtimi. Nuk ia ka nevojën askujt, nuk ha e nuk pi. Pa zbrazëti të brendshme, i fortë, konkret, pa të meta. Që gjendet në kulmin e pjekurisë, perandor i perandorëve, e kështu.

Në fjalinë اللَّـهُ الصَّمَد fjala الصمد është marife (e përcaktuar).[144] Pra nuk është si fjala أحد ehad pa elif-lam. Kjo situatë, i jep fjalës këtë kuptim: Do të thotë se, kur përmendet fjala samed ajo që kuptoni, njihni, e vërteta që synoni, me të gjitha cilësitë e saj, është e veçantë vetëm për Allahun.

Sipas këtij përfundimi nuk mund t'i thuhet askujt tjetër veç Allahut Samed. Fjala samed në qoftë se përdoret në formë nekire (e papërcaktuar) pra jo në formën es-Samed, vetëm samed mund të përdoret edhe për njerëzit. Kështu mund t'i thuhet samed edhe dikujt tjetër veç Allahut. Kjo është edhe arsyeja e emërtimit të liderit të një populli "samedul-kaumi".[145]

لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ

143. Alusi, po aty, XXX, 274.

144. Në fjalinë الله الصمد ka shkurtim sepse fjala الصمد është marife (e përcaktuar). Në formimin e fjalisë emërore në gjuhën arabe ka dy faktorë, Mubtede dhe Haber. Në këtë fjali Mubtede është Allah dhe Haber është Samed. Në këtë fjali, Musnedi marife tregon shkurtim. Do të thotë se kur përmendet fjala samed ajo që kuptoni, njihni, e vërteta që synoni, me të gjitha cilësitë e saj është e veçantë vetëm për Allahun. Sipas këtij përfundimi nuk mund t'i thuhet askujt tjetër veç Allahut Samed.

145. Në ajet ka një pyetje që duhet përgjigjur: Pse ehad është nekire (e papërcaktuar) ndërsa es-Samed është marife (e përcaktuar)? Disa kanë thënë se: për arsye se ehad nuk është përdorur për dikë tjetër përveç Allahut, nuk është e nevojshme ta përcaktosh me shkronjat e përcaktimit. Ndërsa "samed" nuk është kështu, sepse ai përdoret edhe për njerëzit.

3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur

Me një shprehje më të përgjithshme, as Allahu është një qenie që ka lindur (është shkëputur, është ndarë apo veçuar) nga një qenie tjetër, as kjo ekzistencë që shihet është një gjë e lindur ose e ndarë prej Tij. Ai është Kadim (pa fillim) nuk është i krijuar më mbrapa. Pra nuk është një baba Allah që ka lindur apo një nënë Allah që ka lindur, as nuk është djalë Allah i lindur apo vajzë Allah e lindur. Pra, ata që janë të lindur vetë dhe kanë lindur të tjerë, assesi nuk mund të jenë zot.

"**Lem jelid**" **nuk ka lindur kënd**, e mohon atësinë dhe mëmësinë. Pra, Allahu nuk ka lindur ndonjë fëmijë si ç'do nënë e baba, për rrjedhojë Ai nuk është nëna e babai i askujt. Më së pari, u bëhet e ditur njerëzve se Allahu kurrsesi s'është si njerëzit, pra nuk ka grua e fëmijë. Kurse në mënyrë konvencionale tregohet se ekzistenca, gjithësia nuk është diçka e ndarë prej Tij ose e dalë si produkt ose tepricë prej Tij, siç pretendojnë një pjesë filozofësh. Kështu, tërhiqet vëmendja për faktin se qeniet apo gjërat, që lindin qenie apo gjëra të tjera, që pjesëtohen, që shtohen e shumohen duke nxjerrë produkte e teprica dhe që pësojnë ndryshime, nuk mund të jenë zot.

"**Lem juuled**" **nuk është i lindur**, ky ajet e mohon bijërinë. Siç nuk ka lindur kënd, Allahu s'është as i lindur, pra nuk ekziston dikush apo diçka që ta ketë lindur Atë, nuk është i lindur nga një nënë e baba si njerëzit, për rrjedhojë nuk ka nënë e baba.

Në besimin e krishterë në trinitet, pretendimi i tyre që në fillim ishte Zoti baba pastaj Zoti djalë pra qenia e Zotit baba para djalit Zot, për këtë arsye edhe mohimi në ajet ka ardhur sipas pretendimeve të tyre në fillim "lem jelid" nuk ka lindur, më pas "lem juuled" nuk është i lindur.

Ky ajet i mohon të gjithë ata që i sajojnë fëmijë Allahut. Për shembull përgënjeshtron çifutët që thonë: "**Uzejri është i biri i Allahut**"[146], të krishterët që thonë: "**Mesihu (Jezusi) është djali i Allahut**"[147] dhe politeistët mekas që pretendonin se: "**Engjëjt janë bijat e Allahut**"[148]. Allahu i Lartë i ka mohuar të gjitha këto, duke njoftuar se nuk ka fëmijë, sepse fëmija duhet të jetë nga lloji i babait. Allahu është pa fillim dhe ekziston që në parapërjetësi. Nuk ka asnjë të ngjashëm me Atë, është e pamundur që Ai të ketë fëmijë.

Gjithashtu fëmijë kanë vetëm ata që kanë partnere, e Allahu (xh.sh.) nuk ka partnere, sepse nuk ka asnjë të llojit dhe që i ngjan Atij që ta ketë partnere, e për më tepër të kenë fëmijë. Kështu që ajeti: "**Ai është krijuesi qiejve dhe i Tokës! E si mund të ketë Ai fëmijë, ndërkohë që nuk ka bashkëshorte?! Ai ka krijuar çdo gjë dhe është i dijshëm për çdo gjë**"[149] e tregon më së miri këtë fakt. Ai nuk është as djali i një babai e as i një nëne, sepse çdo gjë që lind është e krijuar më pas. Ndërsa Allahu (xh.sh.) është pa fillim dhe i paraqenë, nuk ekziston diçka para Tij.

Dikush apo diçka që lindet dhe lind, ka të kaluarën e vet kur nuk ka ekzistuar dhe të ardhmen e vet kur nuk do të ekzistojë më. Ndërsa, dikush apo diçka që nuk lindet dhe nuk lind, nuk ka as të kaluar

---

146. Surja Teube, 9:30
147. Surja Teube, 9:30
148. Surja Nahl, 16:57
149. Surja En'am, 6:101

kur nuk ka ekzistuar, e as të ardhme kur nuk ka për të ekzistuar më. Allahu është pafillimisht i parë dhe pafundësisht i fundit.

Allahu është Uaxhibul Uxhud, Qenie e domosdoshme, i Vetëqenë dhe Vetekzistent. Ai nuk është një qenie e lindur nga dikush më pas dhe e sjellë në ekzistencë më pas. Ekzistenca e Tij është e paraqenë. Nuk ekziston asnjë çast kur Ai të mos ketë qenë.

وَلَمْ يَكُن لَّهُ كُفُوًا أَحَدٌ

4. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!"

كفو kufuu, të jesh i barabartë në masë dhe vlerë, pra të jesh ekuivalent dhe i barasvlershëm, kjo do të thotë të jesh i të njëjtit rang dhe i ngjashëm.

Allahu nuk ka të ngjashëm as në individualitet, as në atribute dhe as në akte. Ai nuk ka shok, nuk ka ndihmës, nuk ka partner, nuk ka as ekuivalent, as antagonist dhe as analog. Gjërat e paqena janë që të gjitha vepër e Tij dhe këto vepra, sado të përsosura që të jenë, si Ai nuk mund të jenë. Ai nuk i ngjan asgjëje. Ai s'ka të bëjë me asgjë që mund të imagjinohet, që mund të marrë formë në mendje, sepse çdo gjë e tillë është e krijuar. Ato, edhe cilësitë që zotërojnë i kanë të krijuara. Ndërsa, Allahu (xh.sh.) është i pafillim dhe i pafund me individualitetin, atributet dhe aktet e Tij.

Ai që u ngjet krijesave të veta, nuk mund të jetë Zot. Krijesat janë vetëm si pasqyra që tregojnë (pasqyrojnë) emrat dhe atributet e Tij. Si rrjedhojë, i gjithë universi, e gjithë bota dhe çka në të, qiejt, toka e krijesat, shpirti e materia, materialja dhe shëmbëlltyrat, koha dhe vendi, kursiji dhe arshi (froni hyjnor), kjo botë dhe bota tjetër, të gjitha këto së bashku nuk mund të jenë të barabarta dhe në një rang me Atë, sepse, kur të gjitha këto nuk ekzistonin, Ai ekzistonte, dhe Ai është Krijuesi i gjithçkaje.

Çdo gjë mund ta ketë një të ngjashëm, një partner apo një të kundërt. Ashtu siç shprehet edhe në ajet: "**Ne e krijuam çdo gjë në çift**"[150]. Ndërsa Allahu nuk ka partnere e as ndonjë të rangut të Tij, as ka pasur dhe as nuk do të ketë. Allahu i Lartë ka thënë në një hadith kudsi: "Njeriu më ka përgënjeshtruar dhe më ka fyer, pa pasur të drejtë a ndonjë arsye. Përgënjeshtrimi i tij ndaj Meje është kur tha se Zoti nuk do të më ringjallë ashtu si më krijoi herën e parë, e pra krijimi i parë nuk është më i lehtë sesa rikrijimi (ringjallja), kurse fyerja e tij ndaj Meje është kur tha se Zoti ka fëmijë, kurse Unë jam i Vetëm, i panevojshëm për asgjë, nuk kam lindur kënd, as nuk jam i lindur, dhe askush nuk më përngjet (nuk është i ngjashëm e as i barabartë me Mua)."[151]

Hadithe rreth vlerës së sures Ihlas

[150]. Surja Dharijat, 51:49
[151]. Buhari, Tefsiru sure 112, 1-2; Nesai, Xhenaiz, 117

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka njoftuar se, surja Ihlas ka vlerën e një të tretës së Kuranit: "*A është ndonjë prej jush aq i pafuqishëm sa të mos e lexojë një të tretën e Kuranit në një natë?*" Kjo ishte pak e vështirë për Sahabët e nderuar. Pastaj tha: "*Ai që e lexon suren* **قُلْ هُوَ اللَّـهُ أَحَدٌ**, *ajo që lexoi është e barasvlershme me një të tretën e Kuranit*".[152]

Në një transmetim tjetër i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë: "*Ai që e lexon një herë* **قُلْ هُوَ اللَّـهُ أَحَدٌ** *është sikur ka lexuar një të tretën e Kuranit, ai që e lexon dy herë është sikur ka lexuar dy të tretat e Kuranit, ndërsa ai që e lexon tri herë është sikur ka lexuar të gjithë Kuranin*".[153] Ka dhe shumë transmetime të ngjashme, por ne po mjaftohemi me këto dy transmetime.

Atëherë, si është interpretimi i hadithеve të këtij lloji? Në ketë çështje dijetarët dhe interpretuesit e Kuranit kanë dy mendime: Një pjesë e dijetarëve kanë konstatuar se, qenia i barasvlershëm me një të tretën nuk ka të bëjë me aspektin e sevapeve, por ka të bëjë me aspektin kuptimor, sepse Kurani përbëhet nga tre tema kryesore: tema e teuhidit, tema e legjislacionit islam dhe tema e moralit. Kjo sure e përcjell në mënyrën më të mirë temën e teuhidit, që është edhe baza e temës së legjislacionit islam dhe temës së moralit.

Gjithashtu, janë shprehur se, ajetet në Kuran ndahen në tre grupe: Ajetet që tregojnë njëshmërinë e Allahut, ajetet e gjykimeve (legjislacionit), si dhe ajetet rreth historisë. Kjo sure, duke qenë se përmban ajete që tregojnë njëshmërinë e Allahut, është cilësuar si një e treta e Kuranit. Një pjesë tjetër dijetarësh kanë konstatuar se është e barasvlershme me një të tretën e Kuranit nga aspekti i sevape (shpërblimeve). Kanë thënë se kjo kuptohet nga kuptimi sipërfaqësor i hadithеve. Ka pasur edhe nga ata që e kanë interpretuar si haram të cilësosh një sure më me vlerë se tjetra, dhe e kanë mohuar vlerën jo të njëjtë të sureve midis tyre. Por, është për t'u habitur me ata që e mohojnë vlerën e ndryshme të sureve midis njëra-tjetrës, ndërkohë që në lidhje me këtë temë kanë ardhur shumë transmetime nga i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Kështu që, ajetet që përmban surja Ihlas rreth monoteizmit dhe atributeve të Allahut nuk gjenden në suren Tebet. Për rrjedhojë, një sure është më me vlerë se një sure tjetër, vetëm nga kuptimi i lartë dhe i shumtë që ajo përcjell.

Ajetet që tregojnë madhështinë e emrave dhe atributeve të Allahut, ato që tregojnë madhështinë dhe lartësinë e Tij, mund të thuhet se kanë vlerë më të lartë, famë më të madhe se ajetet që nuk janë të tillë. Mund të thuhet se një sure është më me vlerë edhe nga kjo pikëpamje: Allahu i Lartë e ka bërë leximin e saj sa shumë e shumë herë leximi i një tjetre, i ka dhënë leximit të saj sevape që s'ia ka dhënë tjetrës, edhe se nuk dihet nga ne kuptimi që e ka bëre atë të arrijë këtë vlerë… Ashtu siç thuhet se vlera e disa periudhave kohore është mbi të tjerat apo e vendeve mbi vendet e tjera, është përcaktim hyjnor i shpërblimit të adhurimeve. Si përfundim, ekzistenca e vlerave jo të njëjta nga pikëpamje të ndryshme nuk bie ndesh me qenien e tyre të barabarta dhe mbartjen e të njëjtave cilësi, duke qenë se janë fjalë të Allahut.

---

[152]. Buhari, Ejman 3, Fedailul-Kur'an 3, Teuhid 1; Muslim, Musafirin 259, 261.
[153]. Muslim, Musafirin 259.

Profeti (s.a.s.) i thotë njërit prej sahabeve (shokëve të Tij) që e lexonte gjithmonë këtë sure në namaz: "*Dashuria jote për të, të shpie ty në Xhenet*".[154]

SURJA FELEK - 113

بِسْمِ اللهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ (1) مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ (2) وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ (3) وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ (4) وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ (5)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

1. Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit,

2. që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar

3. dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri

4. dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji)

5. dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë."

Emrin e ka marrë nga ajeti i parë ku përmendet fjala "felek", që do të thotë agim. Surja ka 5 ajete. Na mëson se si t'i mbështetemi Allahut dhe si të hyjmë nën mbrojtjen e Tij, prej çdo dëmi e të keqe që mund të na vijë.

TEFSIRI

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ

1. Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit

Audh, meadh, 'ijadh, istiadhe kanë kuptime si: kërkoj mbrojtje, strehim, mbështetje me qëllim të largimit të dëmit material, si dhe të të ligave e të këqijave të tjera të natyrës shpirtërore. Në foljen "**strehoem**" ekzistojnë tre elementë: e para, i strehuari aidh ose musteidh; e dyta, strehuesi musteadhun bih; e treta, asaj së cilës i druhemi dhe kërkojmë strehim prej frikës së saj, i thuhet muste'adhun minh.

[154]. Buhari, Salat, babul-xhem'i bejne suretejn; Tirmidhi, Fadiletul-Kur'an 11.

Kuptimi i "**strehimit**" është, për shkak të frikës t'i mbështetesh dikujt, të hysh në mbrojtjen e tij dhe t'i dorëzohesh atij. "Mbështetësi" për arsye se i trembet diçkaje dhe ndjehet i pafuqishëm para saj, ndjen nevojë t'i mbështetet dikujt. "Mbështetësi" ka besim të plotë se, ai tek i cili është strehuar do ta mbrojë dhe ruajë nga ajo prej së cilës frikësohet.

Fjala **قل kul** "**Thuaj**", në krye të sures, shpreh formën e këshillës hyjnore të Krijuesit, i Cili, e mëson të Dërguarin e Vet se kujt duhet t'i mbështetet për të kërkuar mbrojtje. Gjithashtu me të njëjtën këshillë, u drejtohet të gjithë besimtarëve.

بِرَبِّ الْفَلَقِ "**Zotit të agimit**" Ai , i Cili ndan dhe krijon, nxjerr të gjallin nga i vdekuri, e të vdekurin nga i gjalli, veçues i natës nga dita.

اَلْفَلَقُ , në aspektin leksikor do të thotë: ndarje, çarje. Kuptimi i saj në kontekst të fjalisë do të thotë agim i mëngjesit, feksja e parë e dritës, proces ky që simbolizon veçimin e dritës nga errësira me fillimin e dritës së parë të agimit. Shumica e dijetarëve të tefsirit, kanë theksuar se kuptimi i fjalës mëngjes, siç është i njohur mes njerëzve, është kuptimi i parë i fjalës "**felek**". Për rrjedhojë, "**Rabi'l-felek**" ka kuptimin Zoti i mëngjesit. Rabu'l-felak ashtu si feliku'l-isbah ka kuptimin, Ai që nxjerr në pah mëngjesin. Ashtu si, ai që ka mbetur në errësirë dhe pret zbardhjen e dritës, edhe ai që është përballur me frikën pret dritën e shpëtimit dhe suksesit. Pas errësirës së natës vjen drita e mëngjesit. Gjithashtu, këtu theksohet se pas vështirësisë vjen lehtësimi. Në të njëjtën kohë, mund të nënkuptohet edhe çdo gjë që e ndan dhe e nxjerr në pah Allahu. Fjala "**felek**" mund të marrë edhe kuptimin e krijimit ose më saktësisht çdo gjë që shpërthen në jetë, siç ndodh kur fara çahet dhe filizi del mbi tokë ose uji kur shpërthen nga shkëmbinjtë, shiu kur bie e shkëputet nga retë, të vegjlit që dalin nga barqet e nënave, etj.

Nëse e pranojmë kuptimin e "Rabu'l-felek" si: "Zoti që nxjerr në pah dritën e agimit", nga ajeti do të nxirrnin një kuptim të tillë: "I mbështetem Zotit që më nxjerr nga errësira e natës në dritën e agimit. Zotit, që më nxjerr nga frika dhe terri i natës, në qetësinë e ditës". Zoti përfshin të strehuarin, gjithashtu edhe atë prej të cilit kërkohet strehim. Zoti, është krijuesi i strehuesit, i atij prej të cilit kërkohet strehim dhe i gjithë krijesave, sepse, Ai është Zoti i botëve.

مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ

2. Që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar

Pra, përfshin të gjitha krijesat që ka krijuar Zoti: përfshin dëmin që mund të vij nga cilado lloj krijese, si nga aspektin material apo shpirtëror, qoftë në lidhje me këtë botë apo me jetën e pafundme (Ahiretin), objektive apo subjektive, qoftë ky një dëm që vjen jashtë vullnetit tonë apo nga vullneti ynë. Për rrjedhojë, përfshin: dëmet që vijnë nga të gjithë shejtanët njerëz dhe xhindë, nga shtazët e egra, insektet dhe mikrobet, helmet dhe zjarret, gjynahet dhe kapriçot e egos, punët e dëmshme, deri tek të gjitha dëmet që mund të vijnë nga çdo lloj krijese.

وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ

3. Dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri

غَاسِقٍ "**gasik**", fjalë e cila është interpretuar me kuptime të shumta, një fjalë me kuptim të gjerë. Dijetarët e tefsirit, të cilët kanë konkluduar se "felek" ka kuptimin mëngjes, kanë thënë se "gasik" ka kuptim natë, ndërsa **وقب** "**uekab**" do të thotë "ka hyrë, është shtrirë", dhe simbolizon shtrirjen e errësirës në tokë. Me shtrirjen e territ të natës, fillon të përhapet e liga, sepse shumica e krimeve kryhen gjatë errësirës së natës. Shtazët e dëmshme dhe helmuese dalin në terren gjatë errësirës së natës. Për rrjedhojë, është me rëndësi që të sigurohet mbrojtja (strehimi), pa e kapluar ambientin përreth errësira dhe terri i natës. Në ajet tregohet që t'i mbështetemi dhe kërkojmë mbrojtje Allahut, veçanërisht, nga të këqijat dhe ligësitë që dalin në pah gjatë errësirës së natës. Një hollësi tjetër e ajetit është strehimi tek Allahu, që sjell agimin nga e keqja e territ të natës.

Disa dijetarë e kanë interpretuar fjalën "gasik" hënë, ndërsa "uekab" si eklips të hënës ose tre ditët e fundit të muajit në të sosur të saj. Në një transmetim të përcjellë nga Aishja (r.a.) thuhet se i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e kishte porositur atë me fjalët: "*Kërko mbrojtje tek Allahu prej kësaj* (hënës në të sosur)**,** *sepse kjo është 'gasiku' errësira kur ngryset*".[155]

Sipas Meududit interpretimi i saktë i hadithit është: Duke qenë se hëna del vetëm natën, ndërsa ditën, megjithëse ndodhet në qiell, nuk duket, atëherë shprehja e të Dërguarit të Allahut merr këtë formë: "Kërko mbrojtje tek Allahu prej kësaj (hënës), sepse kjo është 'gasiku' errësira kur ngryset", sepse drita e hënës nuk i bën shumë dobi atyre që janë duke u përpjekur të mbrohen nga sulmuesit, por, ajo është më e favorshme për ata që kanë si qëllim të bëjnë keq.

Nata kur ngryset është "gasik". Po ashtu, edhe hëna (në të sosur) është "gasik". Allahu i Madhëruar, nuk e ka përcaktuar se cilën prej këtyre të dyjave ka dashur të përmendë, por e ka përgjithësuar. Për rrjedhojë, ne jemi urdhëruar që të kërkojmë mbrojtje prej dëmit të cilido "gasik", në kohën që ai shfaqet.

وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ

4. Dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji)

النَّفَّاثَاتِ pra, fijet, penjtë, penjtë e lidhur nyje, ose nyje dashakeqe në zemra, besëtytnitë, ata që fryjnë me entuziazëm, ose shpirtrat që fryjnë nyje në fshehtësi e bëjnë yshtje, ose gratë që fryjnë nyje, ose të këqijat që vijë nga shoqëria.

155. Tirmidhi, Tefsiru sure 113,114-1; Ahmet İbn Hanbel, 6/60, 206, 215, 237, 252.

الْعُقَد është shumësi i fjalës **عقدة**. Ukde ka kuptimin e të kapurit diçkaje nga cepat dhe t'i lidhësh fort me njëri-tjetrin, pra, t'i lidhësh nyje. **عقدة** Ukdetun emër që rrjedh nga fjala "akd" me kuptimin të lidhësh kopsat, kuptimin esencial e ka nyje.

Një pikë tjetër që tërheq vëmendjen te fjala "neffathat" është qenia e saj në gjininë femërore dhe shumës. Për rrjedhojë, për përcaktimin e emrit, i cili ka si mbiemër "nefathat", ka tre mendime të ndryshme:

Sipas kuptimit sipërfaqësor, supozohet të jenë gratë, me kuptimin "gratë që fryjnë nyje". Gjithashtu edhe këtu ka dy aspekte të ndryshme: E para, qenia e magjisë një simbol i grave dhe roli i tyre i lartë në këtë fushë. Ndërsa aspekti tjetër është që, intriga e gruas ka një ndikim shumë të lartë mbi vendosmërinë dhe fuqinë e burrit. Ndikimi magjik që ka në zemër kurthi i femrës apo atraktiviteti i saj, është aq i lartë, saqë edhe ata që e mohojnë magjinë, detyrohen ta pranojnë. Gjithashtu mund të thuhet së të dy mendimet, përmbajnë në vetvete të njëjtin kuptim. Supozimi i të qenët me kuptimin nufus (egot), përfshin mashkullin dhe femrën, që do të thotë "egot fryrëse". Sipas një hamendësie tjetër, ka kuptimin shoqëri, bashkësi, pra, "shoqëri fryrëse".

A është e lejuar të lexosh (diçka nga Kurani, syneti apo ndonjë dua), dhe ta frysh (dikujt tjetër ose vetes)?

Pa u përzier me magji, pra, pa qenë për ndonjë djallëzi por për t'u ruajtur prej saj, apo lutje për shërim Allahut nga ndonjë sëmundje apo fatkeqësi, qoftë kjo për vete apo për ndonjë tjetër, të lexosh një ajet apo dua me zemër të sinqertë dhe nijet (qëllim) të pastër dhe ta frysh, fryma e nxjerrë në këtë formë është e lejuar. Kjo për arsye se në këtë mënyrë nuk dëmtohet askush, nuk ka devijim nga rruga e drejtë apo mbështetje dhe drejtim dikujt tjetër përveç Allahut. Në këto sure, urdhrat **قل أعوذ** "**Thuaj i mbështetem**", tregojnë domosdoshmërinë e mbështetjes tek Allahu, për çdo gjë. Gjithashtu, në traditën Profetike, ka ndodhur dhe është parë se, i Dërguari i Allahu (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi Të) ka vepruar vetë duke fryrë, dhe i ka lejuar shokët e tij që të fryjnë (rukje) për mirësi, dhe në këtë mënyrë kanë gjetur shërim, si nga sëmundjet trupore po ashtu edhe nga ato shpirtërore.

Nuk ka asnjë dyshim se, ashtu siç në këtë sure edhe në ajete të tjera, urdhërohet që t'i mbështetemi Allahut dhe ti lutemi Atij për veten tonë dhe për të tjerët, pra kjo jo vetëm që është e lejuar, por është një urdhër fetar.

Në hadithin që transmeton Afu b. Melik Eshxhei (r.a.) thotë: Ne në periudhën e injorancës lexonim dhe frynim. Pastaj pyetëm të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) çfarë na thua rreth kësaj? Ai tha: "*M'i tregoni mua rukjet* (duatë) *tuaja, në rukje nuk ka problem për aq kohë sa nuk ka shirk* (politeizëm)".[156] Rukjet të cilat janë të ndaluara (haram), janë ato të cilave nuk u dihet brendësia, që ekziston mundësia e magjisë ose që mund të kenë përmbajtje shirku (politeizmi).

[156]. Muslim, Selam 64; Ebu Davud, Tibb 18.

Siç kuptohet nga ajetet dhe hadithet, feja jonë i ka ndaluar: nyjët që përzihen me magji, gjërat e pakuptueshme që nuk dihet se çfarë janë, gjërat e dyshimta, gjithashtu edhe fryrjet djallëzore që mund të përbejnë rrezik për besimin apo trupin tonë. Për rrjedhojë, dijetarët e tefsirit e kanë interpretuar kuptimin e ajetit vazhdimisht rreth magjisë, kanë thënë që të ruhemi nga rukjet (leximet dhe fryrjet) që mund të jenë përzier me magji, dhe, gjithashtu, i kanë cilësuar leximet duke lidhur nyje me fije si magji.

"*Çdo sëmundje e ka shërimin*"[157], në përputhshmëri me hadithin, ashtu si sëmundjet shpirtërore e kanë shërimin me metoda shpirtërore, sëmundjet fizike me metoda fizike, edhe sëmundjet e përziera (shpirtërore-fizike), e kanë metodën e kurimit të përzier. Me kusht që, shërimi duhet ditur prej Allahut jo prej ndikimit të shkaqeve, dhe në të gjitha rastet duhet të distancohet nga intrigat, magjia dhe mashtrimi.

Nuk është aspak e saktë të pranohet si magji, mbështetja me qëllim të sinqertë dhe frymë të pastër tek Allahu, leximi dhe fryrja, duke kërkuar shërim nga Allahu. Kështu që, ata që e cilësojnë si të lejuar rukjen (leximin) kanë sjellë si argument shumë hadithe, që ekzistojnë në librat e saktë të hadithit.

Njëherë Profeti (s.a.s.) ishte sëmurë, dhe transmetohet se erdhi Xhibrili (a.s.) lexoi dhe fryu: **بِسْمِ اللهِ أَرْقِيكَ مِنْ كُلِّ شَيْءٍ يُؤْذِيكَ وَ اللهُ يَشْفِيكَ** "*Bismilah* (me emrin e Allahut), *të bëj rukje* (dua) *ty nga çdo gjë që të mundon, Allahu të jep shërim*".[158]

Aishja (r.a.) transmeton se: Kur ndonjëri nga ne sëmurej ose kur shkonte për vizitë te ndonjë i sëmurë, e fërkonte me dorën e djathtë dhe thoshte **اِذْهَبِ ٱلْبَأْسَ رَبَّ النَّاسِ اِشْفِهِ أَنْتَ الشَّافِى لاَشِفَاءَ اِلاَّ شِفَاؤُكَ شِفَاءً لاَيُغَادِرُ سَقَماً** "*Zoti i njerëzve, largoje sëmundjen, jep shërim, Ti je shërues, nuk ka shërim përveç shërimit tënd, shërimi jot nuk le asnjë sëmundje*".[159]

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) lutej për Hasanin dhe Hysejnin (r.a.) kështu: **أَعُوذُ بِكَلِمَاتِ اللهِ التَّامَّةِ مِنْ كُلِّ شَيْطَانٍ وَ هَامَّةٍ وَ مِنْ كُلِّ عَيْنٍ لاَمَّةٍ** "*Mbështetem me fjalët e plota* (pa të meta) *të Allahut, nga çdo shejtan, nga çdo insekt e nga çdo sy i keq* (nadhar)", pastaj shtoi e tha: "*Babai im, Ibrahimi, lutej në të njëjtën mënyrë për fëmijët e tij, Ismail dhe Is'hak*".[160]

Osman b. Ebil-As Thekafij (r.a.), ka thënë se: Kisha një dhimbje të tmerrshme, për pak do të më vdiste. Shkova pranë Profetit (s.a.s.), dhe më tha: "*Vendose dorën atje ku të dhemb, pastaj thuaj shtatë herë kështu*:

---

157. Muslim, Selam 59, Fedailus-sahabe 92; Buhari, Tibb 1; Ebu Davud, Tibb 1,11; Ibn Maxhe, Tibb 1; Tirmidhi, Tibb 2; Ahmet Ibn Hanbel, I/377, 413, 443, 446.

158. Buhari, Tibb 38; Muslim, Selam 40; Ebu Davud, Tibb 19; Tirmidhi, Xhenaiz 4; Ibn Maxhe, Tibb 36, 37; Ahmet Ibn Hanbel, 6/332.

159. Buhari, Merda 20, Tibb 38, 40; Ebu Davud, Tibb 17, 19; Tirmidhi, Xhenaiz 4, Daauat 111; Ibn Maxhe, Tibb 36, 39, Xhenaiz 64; Ahmet Ibn Hanbel I/76, 381.

160. Buhari, Enbija 10; Muslim, Dhikr 54,55; Ebu Davud, Tibb 19, Sunnet 39; Tirmidhi, Tibb 18; Ahmet Ibn Hanbel, 2/290.

بِسْمِ اللهِ بِسْمِ اللهِ بِسْمِ اللهِ أَعُوذُ بِعِزَّةِ اللهِ وَ قُدْرَتِهِ مِنْ شَرِّ مَا أَجِد وَ أُحَاذِرُ مِنْ وَجَعِى هَذَا '*Bismilah* (Me emrin e Allahut, tre herë)**,** *i mbështetem madhërisë dhe fuqisë së Allahut, nga sëmundja dhe nga e keqja në të cilën ndodhem*"'. Dhe unë ashtu veprova, Allahu më dha shërim.[161]

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) këndonte çdo natë, para se të flinte muauidhat (suret Ihlas, Felek dhe Nas), pastaj i frynte duarve dhe fërkonte të gjithë trupin (aq sa mundej).[162] Një transmetim tjetër nga Aishja (r.a.): "Profeti i Zotit (s.a.s.) kur sëmurej dikush nga familja e Tij, i lexonte atij muauidhat (suret Ihlas, Felek dhe Nas) pastaj i frynte".[163] Në sëmundjen në të cilën ndërroi jetë, i lexoja, i fryja dhe ja prekja trupin me dorën e tij, sepse bereqeti i dorës së tij, ishte shumë më i madh se bereqeti i dorës time".

Nga gjithë këto transmetime nxjerrim si konkluzion se: Me kusht që të mos jetë magji, është e lejueshme që të bësh rukje (lexim, fryrje) për të shpëtuar nga sëmundjet fizike dhe shpirtërore. Por nuk është cilësuar si e përshtatshme t'i kërkosh të tjerëve që të të lexojnë (istikra') e të fryjnë. Gjithashtu, nuk është e përshtatshme të kërkosh ndërmjetësimin e dikujt tjetër për t'iu mbështetur Allahut.

Sipas gjykimit të dijetarëve Hanefi, për aq kohë sa të besojë se shëruesi i vërtetë është Allahu, dhe se është po Ai që ilaçin e ka bërë shkak për shërim, nuk ka ndonjë problem të përpiqet për shërim. Por, nëse beson se shëruesi i vërtetë është ilaçi, atëherë ka problem. Ashtu siç kuptohet nga shpjegimet, shërimi me lexim dhe fryrje nuk përbën një urdhër fetar ashtu siç e pandeh shumica e njerëzve, por është një leje, si zgjidhje përfundimtare.

Detyrim i vërtetë fetar, është t'i mbështetesh vetëm Allahut dhe t'i lutesh vetëm Atij, pa kërkuar ndërmjetësimin e dikujt tjetër. Duaja e besimtarit për besimtarin, qoftë në prani apo në mungesë të tij, është diçka legjitime dhe e pëlqyeshme, për më tepër një detyrë fetare. Padyshim se, sipas hadithit profetik **الدُّعَاءُ مُخُّ الْعِبَادَةِ** "*Duaja është esenca e adhurimit*"[164], duaja zë një vend të rëndësishëm në fe, por të bësh dua është gjë tjetër, të lexosh e të frysh, të presësh ndihmë nga dikush tjetër, është tjetër gjë. Allahu i Lartë e ka urdhëruar duanë: "**Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem!**"[165]. "**Kur robërit e Mi** (besimtarë) **të pyesin për Mua,** (thuaju se) **Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë**"[166]. "**Thuaj: 'Zoti im nuk do t'ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj'**"[167]. Por e ka ndaluar shirkun (politeizmin), e ka ndaluar lutjen dikujt tjetër përveç Tij: "**Thuaj** (o Muhamed)**: 'Unë i lutem vetëm Zotit tim dhe nuk i shoqëroj Atij askënd** (në adhurim)**'**"[168].

---

161. Ebu Davud, Tibb 19; Tirmidhi, Tibb 29, Daauat 125; Ibn Maxhe, Tibb 36; Muuatta, Ajn 9; Ahmet Ibn Hanbel, 6/390.
162. Buhari, Tibb 39; Ibn Maxhe, Dua 15.
163. Buhari, Megazi 83, Fedailul-Kur'an 14, Tibb 41, Daauat 12; Ebu Davud, Tibb 19; Muuatta, Ajn 10; Ahmet Ibn Hanbel, 6/104, 124.
164. Tirmidhi, Dua 1.
165. Surja Mu'min, 40:60
166. Surja Bekare, 2:186
167. Surja Furkan, 25:77
168. Surja Xhin, 72:20

Në të njëjtën mënyrë, Kurani na ka mësuar duatë më të bukura me gjuhën e ëmbël të Profetit (s.a.s.), dhe në suret (Felek, Nas) na ka urdhëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë që t'i mbështetemi vetëm Allahut. Ashtu siç transmetohet nga i Dërguari i Zotit (s.a.s.), çdo natë dhe sa herë të ketë nevojë besimtari duhet t'i lexojë me zemër të pastër dhe me devotshmëri, t'i fryjë vetes së tij, të lutet për besimtarët e tjerë dhe t'ia këshillojë atyre duanë, dhe të mos e mohojë bereqetin e duasë së atyre që bëjnë dua me një frymë të pastër. Kur dihet se dera e Allahut është e hapur për të gjithë ata që luten, dhe se Ai i thërret të gjithë për në atë derë, kërkon që të gjithë t'i drejtohen dhe luten Atij, dhe që nuk e pranon turpin e shirkut (politeizmit); por nuk duhet kaluar në një gjendje të tillë që të thuhet "Unë nuk mund të shkoj tek ajo derë, as që e di se çfarë të kërkoj". Njerëzit nuk duhet ta privojnë veten e tyre nga duaja, dhe t'i kërkojnë të tjerëve të lexojnë për ta dhe t'i fryjnë.

Atëherë përmbledhja është kjo: Fjala "**Ukad**" **nyjet**, edhe pse mund të ketë kuptime të ndryshme, kuptimi esencial i saj është, nyje. Por, gjithashtu, është e qartë se nuk bëhet fjalë për një fije apo litar, bërja e tij nyje duke i fryrë apo pështyrë, sepse është tepër e qartë që, jo në çdo nyje të lidhur ka dëm apo ligësi. Për rrjedhojë, qëllimi nuk është e vërteta e jashtme e nyjës, por magjia. Kështu në ajetin **النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ**, kërkohet mbështetje, strehim prej dëmit të magjistarëve dhe magjistareve. Magjia nuk është e përkufizuar vetëm në nyjet e fijeve, por ajeti përfshin të gjitha llojet e magjisë.

وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ

5. Dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë"

Lakmia (hased), ka kuptimin e të ushqyerit të dëshirës që një njeri të humbasë prej duarsh një pasuri që e ka fituar me të drejtë. Në një nivel më të tepruar, lakmia shndërrohet në përpjekje për të shkaktuar që njeriu ta humbasë atë pasuri që e ka fituar me të drejtë. Pra, arrin deri në atë pikë sa që t'i thuash: "Atë që posedon ai t'i mbetet atij, ndërsa ty të japim tjetër" sërish nuk kënaqet. Kërkon me patjetër që tjetri të humbasë atë që posedon, edhe sikur atij vetë të mos i jepet asgjë, përsëri mbetet i kënaqur. Personin, të cilin e lakmon, po qe se ka ndonjë të mirë fizike ose talent të veçantë, atëherë ai që lakmon e humb fare kontrollin dhe tërbohet nga inati. Ai mund të qetësohet vetëm duke e dëmtuar tjetrin. "Allahu na ruajttë".

Lakmia është sjellja e atyre shpirtrave të mjerë e zemërngushtë që në vend që të kërkojë prej thesarit të pafund të Allahut, i gëzohen humbjes së pasurisë së tjetrit. Por, nëse nuk kërkon që ai tjetri ta humbasë atë që zotëron, por vetëm ka dëshirë që edhe ai të ketë si tjetri, në këtë rast s'është smirë, por ambicie. Profeti ynë (paqja qoftë mbi të), duke tërhequr vëmendjen te ky dallim mes lakmisë dhe ambicies ka thënë: "*Besimtari ushqen ambicie, hipokriti ushqen lakmi*". Kurani e paraqet lakminë si sjellje të dëmshme dhe burim të ligash, prej së cilës duhet të kërkojmë mbrojtjen e Allahut. Ashtu siç dihet, lakmia cilësohet gjynah i madh. Ndërsa, për ambicien, të cilën e ka të lindur, njeriu duhet të përpiqet të formojë një karakter të mirë, dhe assesi s'duhet të bjerë pre e lakmisë. Por, duhet vazhdimisht të luftojë me egon (vetveten) e tij, nuk duhet t'ia lejojë egos t'i marrë frerët në dorë; kjo do të bëhet pretekst që ai të fitojë shumë shpërblime (sevape).

Ambicia nuk është dëshirë që ai tjetri ta humbasë atë që zotëron, por vetëm dëshirë që edhe ai të ketë si tjetri. Ambicia është diçka që nuk përbën rrezik për besimtarin. Ashtu siç transmetohet nga i Dërguari i Zotit (paqja qoftë mbi të): "*Nuk lejohet hasedi* (ambicia) *vetëm se në dy gjëra: Një njeri, të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon atë në rrugë të Allahut dhe, një njëri, të cilit Allahu i ka dhënë dije dhe ai punon me të dhe i këshillon të tjerët*".[169]

Sedra, edhe pse përdoret ndonjëherë në kuptimin e smirës, në arabisht përdoret termi "**gijret**". Të ruhesh nga gjendjet dhe situatat që e dëmtojnë ndershmërinë dhe dëlirësinë. Për shembull, xhelozia i burrit për gruan e tij nga të huajt, dhe anasjelltas, nuk është smirë por gijret. Ndërsa, mos honepsja e dikujt për gruan apo burrin, për bukurinë e gruas së tjetrit, nderin apo fëmijët e tij, talenteve që ata mund të posedojnë, dhe dëshira që ai t'i humbasë këto mirësi është smirë, dhe nuk pëlqehet. Smira është cilësuar si e keqe, ndërsa gijreti me kuptimin sedër dhe patriotizëm është i lavdëruar dhe moral i mirë.

Thuaj i mbështetem dhe kërkoj mbrojtjen Zotit të agimit, prej së keqes së gjithçkaje që u përmend. Mbështetu tek Ai, Samedi (i vetëmjaftueshmi) që ka krijuar gjithçka dhe është po Ai, që do të ruajë e mbrojë prej së keqes së gjithçkaje. Ai u ka premtuar mbrojtje atyre që i mbështeten me sinqeritet Atij: "**Allahu është Ruajtësi më i mirë dhe Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve**"[170].

Pasi thuhet që i mbështetem Allahut: "**Prej dëmit të asaj që Ai krijoi**", ka kuptimin që i mbështetem Allahut edhe për gjëra të tjera, dhe kjo tregon se sa shumë gjëra të dëmshme ekzistojnë. Dhe në fund i mbështetemi prej: "**dëmit të lakmitarit, kur vepron me lakmi**", dhe kjo, na tregon se e keqja e lakmisë (hasedit) është më e madhe. Kjo për arsye se lakmia është bërë pretekst që Allahu të kundërshtohet për herë të parë në qiell e tokë. Iblisin (shejtanin) lakmia që ushqente për Ademin (a.s) e shtyu që të kundërshtonte Allahun. Po ashtu, ishte smira që ushqente për Habilin (djali i Ademit a.s.) ajo që e shtyu Kabilin (djali tjetër i Ademit a.s.) që të vriste vëllain e tij.

SURJA NAS - 114

بِسمِ اللَّهِ الرَّحمٰنِ الرَّحيمِ

قُل أَعوذُ بِرَبِّ النّاسِ (1) مَلِكِ النّاسِ (2) إِلٰهِ النّاسِ (3) مِن شَرِّ الوَسواسِ الخَنّاسِ (4)

الَّذى يُوَسوِسُ فى صُدورِ النّاسِ (5) مِنَ الجِنَّةِ وَالنّاسِ (6)

Shqipërimi:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

[169]. Buhari, Zekat 5, Ahkâm 3, Temenni 5, İtisam 13, Tevhît 45; Ahmet İbn Hanbel, 2/9,36.

[170]. Surja Jusuf, 12:64

1. Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve,

2. Sundimtari i njerëzve,

3. i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve,

4. nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)

5. e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve,

6. (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!"

Kjo sure është emërtuar "**Nas**", sepse fjala "**Nas**" **(njerëzit)** përmendet 5 herë në këtë sure. Kjo sure përbëhet nga 6 ajete. Duke qenë si vazhdimësi e sures paraardhëse "Felek", kjo sure, na urdhëron t'i mbështetemi Allahut prej cytjeve të njerëzve dhe xhindeve. Gjithashtu, kjo sure dhe ajo "Felek", quhen ndryshe edhe "Muauidhetejn".

TEFSIRI

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ

1- Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve

Ashtu si në suren "Felek", edhe në këtë sure, duke thënë "eudhu" (mbështetem), janë përmendur tre atribute të Allahut dhe është urdhëruar që t'i mbështetemi Atij. Atributi i parë, "Rabu'n-Nas", Ai, Zoti, Krijuesi, Edukuesi dhe Mbikëqyrësi i njerëzve. I dyti, "Meliku'n-Nas", Sunduesi, Zotëruesi dhe Poseduesi i gjithë njerëzve, Allahu. I treti, "I'lahu'n-Nas", i Adhuruari i Drejtë dhe i Vërtetë.

Fjala "**Ilah**" **(zot)**, në Kuran është përdorur në dy kontekste. Në kontekstin e parë, ka kuptimin e dikujt ose diçkaje që adhurohet, edhe pse nuk është i adhuruar i vërtetë. Ndërsa në kontekstin e dytë, ka kuptim e Atij që duhet adhuruar në të vërtetë. Ai, edhe nëse adhurohet edhe nëse nuk adhurohet, është Zoti i vërtetë. Atje ku është përdorur fjala "ilah" për Allahun, ka kuptimin e kontekstit e dytë.

Në të njëjtën kohë, përmendja e këtyre tre atributeve hyjnore dëshmon për një nderim dhe vlerësim të veçantë ndaj njeriut, si një krijesë e dashur e Allahut. Veçimi si "Zot, Sundues dhe i Adhuruar i njerëzve", edhe se Allahu është Zoti i botëve dhe i gjithçkaje që ekziston, shpreh lidhjen e ngushtë, e cila duhet të ekzistojë mes njeriut dhe Zotit të Madhërishëm, si dhe fisnikërimin e nderimin që i është bërë njeriut nga ana e Krijuesit. Nderimi dhe fisnikërimi që i ka bërë Allahu njeriut, shprehet në këtë mënyrë: Çdo gjë që ekziston në univers ia ka nënshtruar njeriut, i ka mbështetur njerëzit, duke u dhënë intelekt e dije, ka bërë që engjëjt të përulen (bien në sexhde) përpara njeriut në shenjë respekti ndaj urdhrit të Allahut. Gjithashtu, e ka bërë njeriun superior mbi të gjitha krijesat e tjera.

مَلِكِ النَّاسِ

2- Sundimtari i njerëzve

Pra, i mbështetem Sunduesit, i Cili i mban të gjithë njerëzit nën kontrollin e Tij, Sunduesi që i drejton njerëzit me urdhra e ndalesa, në përputhje me dijen dhe urtësinë e Tij; jo një mbreti apo udhëheqësi, që ne e njohim dhe e shohim në këtë botë, por sipas ajetit: "**O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë**"[171]. Pra, Sunduesi që ia jep pushtetin kujt të dojë, kë të dojë e zbret nga froni kur është mbret, kë të dojë e lartëson në nivelin e mbretërve, Mbret i mbretërve, Zoti i gjithësisë.

Sipas një pjese të dijetarëve të tefsirit, urdhri në ajetin: **بِرَبِّ النَّاسِ مَلِكِ النَّاسِ إِلَهِ النَّاسِ** "**Mbështetem** (mbrohem) **në Zotin e njerëzve, Sunduesin e njerëzve, të Adhuruarin e njerëzve**", është për këtë arsye: Midis njerëzve ndodhen edhe mbretër (liderë, presidentë, kryeministra). Për këtë arsye, Allahu përmend se është edhe Zoti i tyre. Gjithashtu, midis njerëzve ka nga ata fatkeqë që adhurojnë të tjerë përveç Allahut. Tregon gjithashtu se është edhe Zoti i tyre dhe i Adhuruari i vërtetë, për rrjedhojë, duhet t'i mbështetemi vetëm Atij, jo mbretërve apo udhëheqësve.

إِلَهِ النَّاسِ

3- Të adhuruarin e njerëzve

I mbështetem të adhuruarit të njerëzve, pra, Zotit të vërtetë, të Cilin e kanë përgjegjësi dhe për detyrë ta adhurojnë të gjithë njerëzit që kanë zhvillim mendor normal dhe që kanë arritur moshën e pubertetit, që të arrijnë shpëtimin në jetën tjetër. Pra, i mbështetem Atij, Samedit (i Cili nuk ia ka nevojën asgjëje dhe çdo gjë ka nevojë për Të), i Cili e ka të gjithë tagrin për të sjellë në ekzistencë dhe urdhëruar, për të krijuar dhe shkatërruar, për të sjellë në jetë dhe për të marrë jetë, për të dënuar dhe shpërblyer, madhështia e të Cilit kërkon të jetë Ehad (një, i vetëm e i pashoq).

Tani vëmë re se, në suren paraardhëse "musteadhun bih" (Atij të Cilit i mbështetemi), është përmendur vetëm me një atribut **رَبُّ الْفَلَقِ (Zotit të agimit).** Ndërkohë që, gjërat prej të cilave druhemi dhe kërkojmë strehim prej së keqes së tyre janë tre: gasik (natë, terr), nefathat (atyre që fryjnë fjalë të magjisë), hasid (smirëzi). Ndërsa, në këtë sure "musteadhun bih" (Atij të Cilit i mbështetemi), është përmendur me tre atribute: "Rabbi'n-nas, Meliki'n-nas, I'lahi'n-nas", ndërkohë që, "muste'adhun minh" asaj prej së cilës druhemi dhe kërkojmë strehim prej frikës së saj, është vetëm një gjë. Me këtë kuptojmë se, kjo e keqe, kjo fatkeqësi është më e madhe se të tjerat, dhe më e rrezikshmja. Për rrjedhojë, duhet që njeriu të kërkojë mbrojte dhe mbështetje në çdo aspekt të jetës së tij, veçanërisht në periudhën e fundit të saj. Kështu që, edhe lëvdatat për të kërkuar mbrojtje dhe strehim duhet të jenë ekuivalente me madhështinë e atij prej të cilit kërkohet mbrojtja.

---

[171]. Surja Al 'Imran, 3:26

Zot, Sundues dhe i Adhuruar janë tre atribute të Allahut të Lartë. Ai është Zoti dhe Sunduesi i gjithçkaje. Çdo gjë është rob dhe krijesë e Tij. Për rrjedhojë, ai që kërkon mbështetje, është urdhëruar që t'i mbështetet dikujt që i posedon këto cilësi.

مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ

4- Nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)

Pra, mbështetem prej së keqes së atij; që cyt dhe tërhiqet, që pështpërit dhe mashtron, ai tradhtar i cili, duke pështpëritur, e ka bërë zakon të largojë nga rruga e drejtë kah së keqes, prej tinëzarit dhe prej burimit regresiv të cytjeve.

اَلْوَسْوَاسِ fjala "**uesuese**" nënkupton pështpëritjen, të flasësh me zë shumë të ulët. Ndërsa fjala "**muesuis**", është përdorur në mënyre hiperbolike si mbiemër ose emër, që tregon se marrja gjithë kohës me pështpëritje dhe dyshime, e ka shndërruar atë në një burim vesveseje. "**El'uesuas**" me "lam" (pra, në formë të përcaktuar), është emër i shejtanit, sepse gjatë gjithë kohës, gjithë fuqinë dhe aftësitë e veta i përdor për pështpëritje dhe mbjellje dyshimesh.

Këtu është përdorur fjala "Uesuasil-Hannas". Kuptimi i fjalës "uesuas" është "ai që vazhdimisht mbjell vesvese". Ndërsa kuptimi i fjalës vesvese është të fusësh në zemrën e njeriut mendime të liga dhe dyshime njëra pas tjetrës pa e ndjerë vetë njeriu. Ashtu si në fjalën "zelzele", edhe fjala "uesuese" tregon vazhdimësi dhe diçka që bëhet pa u ndalur, sepse të cytësh njeriun vetëm një herë nuk është e mjaftueshme. Këtij veprimi i thuhet "uesuese", ndërsa atij që e vepron "uesuas".

Fjala "Hannas" e ka prejardhjen nga "Hunus" në rasën dhanore ose në rasën kallëzore me të njëjtën diatezë (uezn) si përcaktor i "uesues". Kjo tregon se veprimi, për të cilin bëhet fjalë, përsëritet shumë shpesh. Gjithashtu, është më se e qartë se ai që sjell uesuese shkon te personi herë pas here. Për rrjedhojë, hannas merr këtë kuptim: Ai që sjell uesuese dhe fshihet, dhe që përpiqet vazhdimisht të sjellë uesuese. Nëse nuk ia arrin qëllimit herën e parë, vjen herën e dytë, të tretë e të katërt, derisa t'ia arrijë qëllimit. Ashtu siç ka aluduar edhe shumica e dijetarëve "uesuasi'l-hannas" ka për kuptim shejtanin.

Ç'është uesueseja? Uesuese i thuhet pështpëritjes me zë të ulët, e folur e fshehtë. Mbresë e keqe, mbresat e këqija që le në zemër nefsi (egoja, vetvetja) ose shejtani. Ajeti: "**Ne e kemi krijuar njeriun dhe, Ne e dimë se ç'i pështpërit atij shpirti i vet**[172]" është rreth pështpëritjes së nefsit (egos, vetvetes). **فَوَسْوَسَ إِلَيْهِ الشَّيْطَانُ** "**Por djalli e cyti: 'O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?'**." Ndërsa ky ajet flet rreth uesueses së shejtanit.

Këtu arrihet në përfundimin se, uesuese'ja është filli i punëve te këqija. Uesuese'ja në një njeri mendjelehtë dhe të hutuar si fillim formon një fushë ndikimi që më pas sjell në zemër një dëshirë për

[172]. Surja Kaf, 50:16

të keqen. Kjo dëshirë apo nijet (qëllim) për keq, më vonë merr formën e vullnetit, dhe nga ndikimi i uesueses, vullneti përforcohet. Kuptimi i mbështetjes tek Allahu nga e keqja e uesueses, është eliminimi i së keqes që në origjinë.

Nëse e shohim çështjen nga një aspekt tjetër, mund t'i radhisim përpjekjet e atyre që sjellin uesuese në këtë mënyrë: Si fillim i nxisin njerëzit drejt kufrit (mohimit të Allahut), shirkut (politeizmit), ateizmit, drejt kundërshtimit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij (paqja qoftë mbi të) dhe i shtyjnë myslimanët drejt armiqësisë midis tyre. Nëse nuk arrijnë të kenë sukses në këtë përpjekje, dhe nëse personi nuk ka rënë në grackën e tyre dhe është bërë mysliman, e cytin atë të bëjë bidate (risi, gjëra të paqena në fe) duke i thënë se në këtë nuk ka ndonjë problem. Duke i shtuar gjynahet (mëkatet) e vogla, duan që ato, duke i bërë vazhdimisht, t'i kthejnë në gjynahe të mëdha. Personi pavarësisht gjithë kurtheve, nëse nuk bie në grackë, duke i vënë në lëvizje të gjithë shejtanët njerëz dhe xhind, e shtyjnë të gjithë shoqërinë kundër atij personi. Në këtë pikë shejtani vjen dhe e nxit besimtarin duke i thënë: "Durimi yt përballë gjithë këtyre, tregon që t'i je një frikacak. Në fakt ti duhet t'u kundërvihesh atyre". Kjo, është arma e fundit e shejtanit. Në këtë mënyrë, shejtani përpiqet t'i devijojë njerëzit që ftojnë në rrugë të drejtë dhe t'i shtyjë ata në një ambient shterp. Ftuesi nëse shpëton edhe nga ky kurth, shejtani mbetet i pafuqishëm dhe pa zgjidhje.

Për mos të rënë në dyshim se çfarë është "uesuasul-hannas", ka urdhëruar kështu:

الَّذى يُوَسوِسُ فى صُدورِ النّاسِ

5- E që hedh dyshime në gjokset e njerëzve

Pra, në brendësi të njerëzve; qoftë kjo në brendësi të personit, qoftë në brendësi të shoqërisë, midis tyre apo në gjokset e atyre që e kanë harruar Allahun, në brendësi të zemrës deri te ndjenjat, duke futur uesuese nga më të ndryshmet në zemrat e tyre, pa u futur mirë fillon të pështpërisë helm, duke e ledhatuar ngadalë, dhe zgjon në të ndjenja e dëshira të këqija. Në këtë mënyrë ia turbullon mendimet, duke bërë që të mendojë ligësi nga më të ndryshmet. Duke e penguar nga rruga e Allahut dhe nga arritja drejt qëllimit final, më në fund bën që të dalë prej fesë dhe të shkojë drejt humbjes së përjetshme. Pra, uesuasil-hannas, cytja si nëna e çdo të keqeje, është çdo gjë që pështpërit dhe cyt të keqen në zemrat e njerëzve të hutuar.

مِنَ الجِنَّةِ وَالنّاسِ

6- (Qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!"

Pra, uesuasul-hanas i përfshin të dy grupet, qofshin ata që sjellin uesuese nga grupet e fshehta të xhindeve apo nga njerëzit. Pra, shejtanët cytës që sjellin uesuese janë dy lloje: Njëri, nga bashkësia e fshehtë e botës metafizike, nga pasardhësit e xhindeve, ndërsa tjetri, nga njerëzit që ne i shohim dhe kemi kontakt. Ashtu siç na e tregon ajeti: "**Dhe kështu** (sikurse edhe ty) **çdo profeti i bëmë armiq**

disa nga njerëzit dhe nga xhinët e djallëzuar, që me fjalë të shkëlqyeshme në mënyrë të fshehtë nxisin njëri-tjetrin në mashtrime. E sikur të donte Zoti yt, ata nuk do bënin ato (armiqësi)**, po ti lëri ata me ato trillime**"[173], duhet që t'i mbështetemi Allahut dhe të kërkojmë mbrojte prej Tij, nga e keqja (dëmi) e pështpëritjes dhe cytjes së djajve, qofshin ata prej xhinëve apo prej njerëzve.

Çdo njeri e ka një shejtan, i cili përpiqet t'ia zbukurojë atij gjërat e këqija dhe që vazhdimisht e shtyn drejt së keqes. Profeti Muhamed (paqja dhe bekimi qoftë mbi të) ka thënë se: "*Nuk ka asnjë prej jush që të mos e ketë një shok xhind dhe një engjëll, të ngarkuar në detyrë për të*". Sahabet e pyetën: "Edhe Ti o i Dërguari i Allahut, e ke një të tillë (shok xhind dhe engjëll)? "*Po e kam*", tha Ai, "*por, vetëm se Allahu ma ka nënshtruar Mua atë*".[174]

Ajeti i fundit i sures, na mëson që të kërkojmë mbrojtje prej së keqes së të gjithë njerëzve dhe xhinëve. Pa dyshim që shejtanët njerëz, janë më të rrezikshëm dhe më vrasës se shejtanët xhind, sepse shejtanët xhind, kur i mbështetemi Allahut fshihen. Ndërsa shejtanët njerëz, ia tregojnë personit gjërat e dëmshme si të mira dhe cysin kah së ligës. Asgjë nuk mund ta bëjë që ai të heq dorë nga synimi i tij. Të mbrojtur, janë vetëm ata që Allahu i ka marrë nën mbrojtjen e Tij.

Ilaçet e mbrojtjes nga uesueset (cytjet) e shejtanit, janë tre: E para, përmendja e shumtë dhe shpeshtë e Allahut (dhikri); e dyta, mbështetja tek Allahu, dhe gjëja më e dobishme në këtë rast është këndimi i kësaj sureje (Sures Nas); dhe e treta, qëndrimi me vendosmëri maksimale kundrejt shejtanit, dhe veprimi i kundërt i asaj që na cyt ai.

Pra, është urdhëruar së fundmi mbështetja te Zoti i vetëm i njerëzve, Allahu i Lartë, Zoti i njerëzve dhe Sunduesi i tyre, prej dëmit të gjithçkaje dhe veçanërisht prej së keqes së uesueses (cytjes). Në këtë kontekst, i është premtuar atyre që i mbështeten Allahut, arritja e përfundimit të mirë me anë të mbështetjes, dhe si falënderim, sa e këndshme është të fillosh me suren Fatiha: **الْحَمْدُ للهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ** "**Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!**[175]"

Kjo sure e madhështore, posedon 22 shkronja pa përsëritje (duke përfshirë edhe shkronjat zgjatëse). Po kështu janë edhe shkronjat e sures Fatiha. Një përkim ky, që tregon lidhjen e fillimit të Kuranit me fundin e tij, si nga ana kuptimore ashtu edhe nga aspekte të tjera.

Një pikë tjetër e rëndësishme është edhe lidhja që formohet ndërmjet fillimit të Kuranit dhe fundit të tij me anë të muauidhetejn (Surja Falek dhe Nas). Kurani nuk është radhitur sipas mënyrës së zbritjes. Por, ajetet (versetet) e Kuranit, duke zbritur për 23 vjet në përputhje me kohën, vendin dhe nevojat e ndryshme, nuk janë radhitur nga Profeti Muhamed (sal'la llahu alejhi ue sel'lem), por janë radhitur me urdhër të Allahut. Në përputhje me këtë radhitje, Kurani fillon me suren Fatiha dhe mbyllet me Muauidhetejn. Nëse hulumtohet me vëmendje kjo sure në hyrje robi, pasi e lavdëron Allahun që është Rrahman (Mëshirues) dhe Rrahim (Mëshirëplotë), Sundues i Ditës së Gjykimit,

---

173. Surja En'am 6:112
174. Darimi, Rikak 25; Musned, I, 385.
175. Surja Fatiha 1:2

lutet kështu: "O Allah! Vetëm Ty të adhuroj dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkoj. Ndihma më e madhe, për të cilën kam nevojë të pafundme, është të më udhëzosh në rrugë të drejtë… Allahu, për t'i treguar rrugën e drejtë e vendos përpara të gjithë Kuranin. Më pas Allahu, i Cili është Zoti i agimit, Zoti i njerëzve, Sunduesi i njerëzve dhe i Adhuruari i njerëzve na urdhëron që të themi: Të mbështetmi Ty nga çdo e keqe e çdo dëm. Veçanërisht prej uesueseve (cytjeve) të shejtanëve xhinë dhe njerëz, sepse ata janë pengesa më e madhe e rrugës së drejtë…

Së fundmi: në sure ka një përputhje tingullore, që është e pamundur ta përshkruash. Kjo bukuri mund të vihet re vetëm duke e kuptuar leximin në arabisht. Në sure, i mbështet Allahut prej xhinëve dhe njerëzve, që i futen njeriut fshehurazi dhe cytin për mendime të liga. Tema që trajton kjo sure është futja e mendimit të lig me anë të pështpëritjeve. Tani le ta këndojmë suren arabisht:

Kul eudhu bi-rabbin-nas,
melikin-nas,
ilahin-nas,
min sherril-uesuasil-hannas,
el-ledhi juuesuisu fi sudurin-nas,
minel-xhinneti uen-nas

Në vesh ju vjen një zë pështpëritjeje, apo jo? Tingulli (s) në fund të fjalëve, formon një pështpëritje në vesh. Pra, kështu është Kurani. Atë që do të përcjellë te ne, nuk e shfaq vetëm me kuptimin e fjalëve, por edhe me anë të tonit të zërit të fjalëve. **SubhanAllah!**